MAL BERISHA
SHQIPTARËT,
EUROPIANËT MË TË LASHTË
DHE MË TË RINJ

# SHQIPTARËT, EUROPIANËT MË TË LASHTË DHE MË TË RINJ

---

Përgatitur nga

**Mal Berisha**

Drejtor i botimit: Bardhyl Musai
Redaktore letrare: Edlira Birko,
Korrektor letrar: Tomorr Plangarica
Përpunimi grafik: Anduena Manushi
Ballina: Arian Dheri
Përpunimi grafik i fotove: Studio grafike *Visi Design*

*...PARAQITJE PIKTORESKE E DRAMËS SË PANDËRPRERË NJERËZORE, SHPRESAVE, ARRITJEVE, DËSHTIMEVE DHE KONFLIKTEVE TË POPUJVE SHUMËGJUHËSH TË KONTINENTIT TË VJETËR...*

*...EUROPA E SOTME, ME INSTITUCIONET E SAJ QË RUAJNË PAQEN...*

*...VENDI HISTORIK DHE BASHKËKOHOR I SHQIPTARËVE NË KONTINENTIN E TYRE...*

*Kujtimit të babait tim të ndjerë!*

# HYRJE

## "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa"

Pas një vargu ngjarjesh të jashtëzakonshme për atë kohë, p.sh., ardhja në Tiranë e Perez De Kuelarit, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, hyrja masive në ambasadat e huaja, dalja në shtypin e përditshëm e disa shkrimeve jo të zakonshme të intelektualëve shqiptarë, largimi nga atdheu i shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare, protestat e studentëve të Universitetit të Tiranës etj., erdhi çasti kur u njoftua se më 12 dhjetor 1990 do të mbahej një miting i madh tek Qyteti i Studentëve, ku do të shpallej ligjërisht alternativa e parë demokratike në Shqipëri. I entuziazmuar, si dhe shumë e shumë bashkëmoshatarë të mi të asaj kohe, bashkë me një mikun tim, me një motor Java, rendëm nga qyteza e lodhur dhe e përgjumur e Mamurrasit për tek sheshi i Qytetit të Studentëve në Tiranë. Diçka e fuqishme na kishte shtyrë që të bëheshim dëshmitarë të njërës prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së re të Shqipërisë. Po shpallej formimi i Partisë Demokratike. Një grup intelektualësh bënë të ditur programin e partisë, në thelb të të cilit ishte parulla "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa".

Në një dhomë konvikti studentësh, ndoshta brenda një dite, një grup intelektualësh formuluan atë program politik i cili do t'i hapte

Shqipërisë shtegun, deri atëherë plotësisht të mbyllur, drejt Perëndimit. Parulla që ata kishin zgjedhur, përbënte mjetin me fuqinë më të madhe tërheqëse që shqiptarët kishin patur ndonjëherë për arritjen e synimeve të tyre. Ajo parullë u bë motoja e një transformimi të jashtëzakonshëm e të gjithanshëm, që niste me vrasjen e frikës ndaj diktaturës, me fjalën e lirë, fillimin e lëvizjes së lirë, lirimin e të burgosurve të ndërgjegjes, respektimin e lirive e të drejtave të njeriut, kthimin e pronës pronarëve të ligjshëm, lirinë e veprimtarisë ekonomike…, … dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me lirinë e individit në shoqëri.

Pas rreth një viti e disa muajsh, me një votë plebishitare, Partia Demokratike erdhi në pushtet, duke e ndarë një herë e mirë Shqipërinë nga e kaluara e saj e zymtë komuniste dhe duke e orientuar atë drejt Europës. Ditën që pasoi fitoren, në konferencën e parë për shtyp, kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, prof. dr. Sali Berisha, iu përgjigj pyetjes së një gazetari belg se Shqipërisë do t'i duhen ndoshta 15 deri 20 vjet që të arrijë tek disa standarde të mirëfillta europiane. Asnjëherë nuk kisha menduar kohë më të gjatë se atë afat që vuri lideri i demokratevë atë ditë. E megjithatë, koha vërtetoi se ai kishte të drejtë. Janë bërë shumë ndryshime në Shqipëri, është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit me Bashkimin Europian, institucionet demokratike janë vënë në veprim, vendi është transformuar i tëri, por, për të shkuar në pjesën tjetër të qenies sonë, në Europë, Shqipëria ka ende shumë rrugë për të bërë.

Në përpjekje për të shpjeguar vështirësitë e kësaj rruge të gjatë që na duhet të kaptojmë për të qenë europianë dinjitozë, ne shqiptarëve na duhet të mendojmë me urtësi se në ç'*largësi* ndodhet Europa prej nesh apo sa larg jemi ne me Europën; sa jemi vërtet europianë jo vetëm gjeografikisht, por edhe në pikëpamje të tjera. Përse jemi kaq afër, madje bash brenda në Europë, e megjithatë, kaq larg? A është Europa një nënë e mirë apo një njerkë e keqe? A është Europa siç e ka përshkruar Fishta ynë i madh apo një "nuse e re", që sot ka ndërruar pamje dhe qëndrim jo vetëm brendapërbrenda kombeve e shteteve të saj të mëdha, por edhe ndaj kombeve a shteteve më të vogla, siç jemi ne? Cilat kombe e përbëjnë atë, si janë formuar ato, çfarë trajektoreje

historike kanë ndjekur dhe në ç'lartësi gjenden sot? Çfarë kemi bërë ne shqiptarët, a kemi të drejtë të mburremi me të kaluarën tonë dhe çfarë duhet të bëjmë që padrejtësitë historike, të cilat vetë Europa ia ka imponuar popullit tonë, të korrigjohen në rendin e ri botëror dhe europian që po përftohet sot? Në kushtet e reja të europianizimit të Ballkanit, ç'vend zë tani në skakierën politike europiane zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare, çështje që vetë europianët e krijuan rreth njëqind vjet më parë?

Gjatë rrugës së integrimit, të europianizimit, lëvizjes së lirë e përparimit, çdo shqiptar i ka sot në mendje të gjitha këto pyetje.

Ishin pikërisht këto arsye, por edhe dëshira e zjarrtë e shqiptarëve për të zënë vendin që meritojnë në platformën europiane të zhvillimit bashkëkohor, domosdoshmëria për të kuptuar më mirë se ç'ka qenë Europa e para Luftës së Parë Botërore, mes luftërave botërore, pas Luftës së Dytë Botërore apo cila është ajo e sotmja, që më nxitën t'i hyja përgatitjes së këtij libri, duke sjellë materiale që japin informacion të konsiderueshëm për Europën e djeshme dhe të sotme, por edhe për vendin që zëmë ne shqiptarët në të. Kredoja e rilindësve tanë, sipas së cilës nuk do të ketë paqe as në Ballkan, as në Europë derisa të zgjidhet çështja e kombit shqiptar, është vërtetuar herë pas here në historinë e Europës. Shembull i qartë i vërtetësisë së asaj kredoje ishte Kosova, me luftën e saj të vitit 1999, luftë që tërhoqi vëmendjen e tërë opinionit botëror, dhe po ashtu detyroi ndërhyrjen ushtarake të *Aleancës së Atlantikut Verior,* për herë të parë që nga formimi i saj. Kjo çështje është ende në tavolinë dhe, derisa ajo të zgjidhet, askush nuk mund të thotë se Ballkani apo Europa janë të qetë.

Përkthimi dhe përgatitja e këtyre materialeve synon t'i ndihmojë lexuesit të marrin informacion të konsiderueshëm për Europën sot, institucionet e saj, marrëveshjet dhe traktatet, pjesëmarrjen e shteteve në organizmat e ndryshme të *Komunitetit Europian* dhe vendin e Shqipërisë në to. Përmes këtij informacioni synohet gjithashtu të ndërgjegjësohet fakti se të bëhesh qytetar europian nuk është thjesht një privilegj, por prej atij statusi burojnë edhe një mori detyrimesh

qytetare që fillojnë që nga sjellja individuale në mjediset publike, në rrugë, në lokal, në trafik, deri tek respektimi i të gjitha lirive të tjetrit, respektimi i rregullit dhe ligjit, pa të cilat nuk mund të sigurohet as respektimi i lirisë tënde individuale.

Libri është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin dy studime mbi racat në kontinentin e vjetër, të përkthyera nga anglishtja. I pari titullohet *Racat në Europë*, shkruar nga G. H. Grasnover, profesor shumë i njohur amerikan i *Kolegjit Robert* të Stambollit, botuar në vitin 1918, në revistën amerikane *National Geographic*. Për të bërë dhe hartuar këtë studim atij i është dashur që të shkelë me këmbë çdo pëllëmbë të Europës. Shkrimi e rendit edhe kombin shqiptar midis kombeve më të vjetra të Europës. Ky fakt na bën vërtet krenarë, por edhe na detyron që të arrijmë zhvillimin e kombeve të tjera, që, megjithëse mund të jenë të pranishme më vonë se ne në këtë kontinent, kanë bërë përparime të mëdha. Materiali tjetër është *Racat dhe fetë në Maqedoni*, shkruar nga Luigi Villari, në librin *Çështja Ballkanike*, botuar në vitin 1912.

Botimi i këtyre dy studimeve synon të sjellë në vëmendjen e lexuesit materiale të cilat vetë europianët i kishin në dorë në kohën kur merrnin vendimet për copëtimin e Shqipërisë. Ato kanë vlera studimore, por edhe historike. Madje, lexuesi do të ketë kënaqësinë të shohë se si shumë gjëra të konstatuara në atë kohë për origjinën e Europës dhe racave të saj, të jenë ripohuar edhe në studimet e mëvonshme që gjenden po në këtë libër. Por lexuesi do të shohë gjithashtu se ka edhe gjëra që koha i ka mënjanuar, për shkak të metodave të sofistikuara moderne që përdoren sot në studimet për origjinën dhe veçantitë e racave; në mënyrë të veçantë duhet shënuar kontributi që jep gjenetika dhe, padyshim, analizat e ADN–së.

Pjesa e dytë e librit përbëhet nga materiale të nxjerra nga analet e institucioneve bashkëkohore europiane, mbi gjendjen e sotme në Europë, institucionet e saj, shtetet e Europës në përgjithësi dhe ato që përbëjnë *Bashkimin Europian, NATO-n, Këshillin e Europës, OSBE–në* etj.

Titulli i librit *Shqiptarët, europianët më të lashtë dhe më të rinj* është frymëzuar nga përcaktimet që i kanë bërë popullit tonë autorë të huaj, kur kanë shkruar për ne, në kontekstin e pasqyrimit të tërë kombeve europiane, si dhe nga aspirata e madhe e çdo shqiptari sot për të zënë

vendin që kishte në familjen e kombeve të qytetëruara europiane, para se qytetërimi ynë të ndërpritej për shkaqe që tashmë historia i ka nxjerrë në pah. Duke e konsideruar veten "europian i lashtë", unë i referohem thënies së G. H. Grasnoverit se:

> …. shqiptarët zënë një territor në lindje të Adriatikut, që i korrespondon afërsisht Epirit të Lashtë dhe Ilirisë Jugore ..., ata i kanë rrënjët në vendin e tyre... Është e pranueshme që t'i shohim ata si popullin më të vjetër të Europës Juglindore, pasardhës të pellazgëve...

Ndërsa kur i referohem vetes si "europiani më i ri", kam parasysh jo vetëm faktin që popullsia shqiptare në tërë rajonin e Ballkanit është më e reja në moshë, krahasuar me kombet e racat e tjera në Europë, por edhe faktin se të tëra vendet ku sot jetojnë shqiptarët në rajonin e Ballkanit janë në proces asociimi, kandidimi, anëtarësimi ose integrimi në Europë. Shqipëria vetë, si dhe Kosova, tashmë janë duke ecur nëpër atë udhë të vështirë, por që të çon drejt qytetërimit të cilit i përkasim, udhë që ndriçohet edhe nga idealet e rilindësve tanë, të cilët e shihnin përparimin e kombit tonë të vinte *andej nga dielli perëndon*.

Shpresoj që puna e bërë për të sjellë një informacion të tillë tek lexuesi shqiptar, do të ndihmojë sadopak në ndërgjegjësimin e shqiptarëve se në kushtet e prirjeve të sotme politike, të integrohesh në Europë duhet që, më së pari, të kesh njohje të plotë për të, të pranosh standardet e saj dhe, më së fundi, të luftosh për t'i plotësuar ato. Pas kaq vitesh, që nga 12 dhjetori 1990, një gjë është e qartë: Shqipëria është tashmë në rrugën e integrimit europian. Më 12 qershor 2006, ajo nënshkroi *Marrëveshjen për Hapjen e Negociatave të Asociim Stabilizimit*. Një ndër garancitë më të mëdha në këtë rrugë të integrimit është edhe miqësia e Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë anëtar me të drejta të plota në organizma apo institucione europiane, ose i ndjekin nga afër organizmat dhe institucionet europiane. Këtë miqësi e çimentoi më shumë vizita historike e presidentit Xhorxh W. Bush në Tiranë, më 10 qershor 2007, pikërisht në ditën historike të Lidhjes së Prizrenit.

Në materialet që botohen në këtë libër, nga secili autor ose studiues ka përcaktime të ndryshme për Europën. Përderisa emërtimi i kontinentit tonë është më shumë i bazuar në hipoteza sesa në dokumente të sakta historike dhe shkencore, të gjitha variantet e parashtruara janë lënë ashtu siç i kanë trajtuar vetë studiuesit. Në këtë mënyrë, është synuar që lexuesi të njihet me teza alternative, të cilat shpesh janë të ngjashme me njëra-tjetrën, por kanë edhe dallime mes tyre.

**Mal Berisha**
Prishtinë, Kosovë, Gusht 2007

*...Në shkrimin e parë të këtij libri, "Racat e Europës", lexuesi do të njihet jo vetëm me pozicionin gjeografik të kontinentit europian, por edhe me tëra grupet etnike, popujt, shtetet dhe pozitat e tyre të para Luftës së Parë Botërore. Sado që shkurtimisht, autori ka arritur të japë në mënyrë shumë të përmbledhur dhe thelbësore, vetitë, dallime por edhe ngjashmëritë e popujve europianë me njëri tjetrin. Materiali i vjen lexuesit pa asnjë ndërhyrje dhe ka për qëllim që të tregojë saktësisht opinionin që autori kishte formuar për ne shqiptarët në mozaikun e pafund e të larmishëm të popujve europianë.*

*"Shqiptarët zënë një territor në lindje të Adriatikut, që i korrespondon, afërsisht, Epirit të Lashtë dhe Ilirisë Jugore. Origjina dhe gjuha e tyre paraqet shumë vështirësi. Profesor Ripley beson se ata i kanë rrënjët në vendin e tyre. Dr.Deniker i quan "një racë e veçantë adriatikase ose dinarike." Është e pranueshme që t'i shohim si popullin më të vjetër të Europës Juglindore, pasardhës të pellazgëve.*

*Gjuha e tyre mendohet të jetë e vetmja gjuhë që ka mbijetuar nga grupi i gjuhëve të lashta trako-ilire"*

Gilbert Hovey Grosvenor

# RACAT E EUROPËS

Kjo është një paraqitje piktoreske e dramës së pandërprerë njerëzore ku lexuesi gjen shpresat, dështimet, arritjet dhe konfliktet e popujve shumëgjuhësh të kontinentit me popullsinë më të dendur në botë, Europës.

Dr. Grosvenor[1], autori i këtij artikulli, i ka kushtuar pesëdhjetë vjet studimit të racave të Europës. Njëzet vjetët e punës së tij si profesor i historisë në Kolegjin e famshëm Robert, në Stamboll, i kanë dhënë atij një mundësi të madhe për të vëzhguar nga afër çështjet që trajton. Duke jetuar në një vend ballkanik i cili, si askund tjetër në botë, është i mbushur me batica e zbatica të historisë, ai ka demostruar faktin se

[1] *Gilbert Hovey Grosvenor,* 1875-1966**,** botues amerikan, i lindur në Stamboll, Turqi. Drejtor (1903-1919) dhe më vonë president (1920-54) i *Shoqërisë National Geographic* dhe botues (1899-54) i Revistës *National Geographic*, ai inkurajoi eksplorimin në shkallë botërore dhe rriti numrin e tirazhit të revistës, veçanërisht duke përdorur fotografitë me ngjyra. Ndërkohë që ai ishte drejtues i *National Geographic*, shoqëria u rrit nga 900 pjesëmarrës në 2 milion. Ai ishte studjues i madh i racave të njerëzimit sikundër edhe një aktivist e pakompromis i ruajtjes së jetës së egër.

askund tjetër mësuesi i historisë nuk ka më shumë nevojë për njohuri më të plota për lëndën e tij. Nuk ka qoftë edhe një vend në Europë, të cilin ai nuk e ka vizituar dhe ku të mos kishte miq dhe të njohur. Ai është autor i librave "Konstadinopoja", dy vëllimeve të "Historisë bashkëkohore", i studimit "Qëndrueshmëria e tipit grek", gjithashtu i rreth treqind artikujve me tema nga lindja në enciklopedi të ndryshme si dhe i Referencave Historike të Botës, në Fjalorin Ndërkombëtar Uebster, ka përkthyer nga frengjishtja në variant të përpunuar "Historinë e Kohëve Moderne" dhe "Historinë e Botës"si dhe "Andromaka", romanin grek më të popullarizuar nga greqishtja e re. Në vijim vazhdon studimi i tij për Europën. Ky është një ndër studimet më të plota, ku ne shqiptarët jemi përshkruar përkrah kombeve më të lashta europiane.

## EUROPA

*P*as Australisë Europa është kontinenti më i vogël i globit me një sipërfaqe, thuajse të barabartë me Kanadanë ose me Brazilin. Dikush, madje, mund ta vërë në pikëpyetje nëse ajo meriton të quhet kontinent apo jo. Siberia ia kalon asaj me një sipërfaqe prej më se një milion kilometrash katrorë. Në hartën e hemisferës lindore ajo duket gati e parëndësishme. Në jug zvogëlohet po ta krahasosh me gjerësinë e Afrikës, ndërsa Azia së cilës ajo i ngjitet e shtyn atë shpërfillshëm drejt veriperëndimit.

Është një vijë kufitare tokësore e pacaktuar qartë, e cila rend në një gjatësi prej më shumë se tre mijë kilometrash, që bën të pamundur të thuhet se ku mbaron Azia dhe ku fillon Europa. Atë kufi tokësor e ndërpret Deti Kaspik. Njëra pjesë ravijëzohet midis tij dhe Arktikut, ndërsa tjetra midis tij, Maleve të Kaukazit dhe Detit të Zi.

## ORIGJINA E EMRIT EUROPË

Në hartë Europa është vetëm zgjatim i Azisë; por shtrirja e saj e veçantë, cilësitë unike fizike dhe historia aq e larmishme i japin asaj një përparësi të veçantë.

Në mes të Europës dhe të Azisë nuk ka kufij natyrorë; madje nuk ekziston as ndonjë vijë ndarëse zyrtare. Rusët, disa herë, e imagjinojnë këtë si një vijë që përshkon "Kreshtën e Uraleve". Por në rajonin e gjerë, mbi të cilin shtrihen Uralet e gjera dhe të ulëta, nuk është vënë re dhe as mund të shihet ndonjëherë ndonjë kreshtë e tillë. Për më tepër, Uralet përshkojnë vetëm një pjesë të vijës, e cila ndan Europën nga Azia. Për shkak të këtij arbitrariteti në përcaktimin e kufijve lindorë, vlerësimet mbi territorin e plotë të Europës ndryshojnë me disa qindra mijëra kilometra katrore.

Emërtimi Europë ka qenë në përdorim prej mëse dymijë e pesëqind vjetësh. Origjina dhe kuptimi i emrit të saj janë të panjohura. Ndoshta ai rrjedh, sikundër besojnë të lashtët, nga Virgjëresha e bukur Europa, e dashura e Jupiterit. Ose ndoshta vjen nga fjala *irib* ose *ereb* e gjetur në monumentet asiriane e që supozohet të ketë pasur kuptimin errësirë, ose rënie e diellit, në dallim nga *asu*, e gjetur në të njëjtët monumente dhe që supozohet se do të thoshte lindja e diellit, ose Azia. Megjithatë, le të pajtohemi me Herodotin, i cili me naivitet pranon se "asnjë i vdekshëm nuk do të mund, qoftë edhe të shpresojë ndonjëherë, që të gjejë të vërtetën e kuptimit të kësaj fjale të trashëguar prej paraardhësve tanë".

## PËRSE RACAT EUROPIANE JANË PËRPARIMTARE?

Europa është më e vogël se një e pesëmbëdhjeta pjesë e sipërfaqes së tërë globit e, megjithatë, ajo popullohet prej 450.000.000 njerëzish ose më shumë se një e katërta e popullsisë së përgjithshme. Por jo të gjithë europianët gjenden në Europë. Ata dhe bijtë e tyre kanë pushtuar dhe populluar tërë hemisferën perëndimore, të cilën vetë e kanë zbuluar. Ata e kanë nënshtruar dhe ndarë mes vetes, thuajse, gjithë Afrikën. Me përjashtim të Kinës dhe të Japonisë, ata kontrollojnë tërë Azinë dhe ishujt e tërë deteve. Gjatë njëzet e pesë shekujve të fundit, prej europianëve, si prej një vatre, ka rrezatuar arti, shkenca dhe mendimi njerëzor i gjithë botës.

Si kemi ardhur deri te kjo arritje e jashtëzakonshme? Cila është arsyeja më bindëse që i ka bërë europianët të vijnë deri te ky monopol praktik i udhëheqjes universale?

Nuk ka arsye për të besuar që paraardhësit e tyre të hershëm të kenë qenë më të aftë se fqinjët ose bashkëkohësit e tyre ose të zotëronin aftësi më të mëdha për zhvillim.

Shkaqet janë gjetur në përparësitë fizike që zotëron Europa, të cilat u kanë dhënë europianëve dhe pasardhësve të tyre epërsi të padiskutueshme.

Thuajse e tërë Europa shtrihet në gjysmën veriore të Zonës së Butë Veriore. Pika e saj më veriore, Kepi i Veriut, është nëntëmbëdhjetë gradë nga Poli, ndërkohë që Tarifa, pika e saj më jugore, është tridhjetë e gjashtë gradë nga Ekuatori.

Askund tjetër përveçse në largësitë veriore, të ftohtët e egër nuk e mpin trupin dhe mendjen si aty. Askund tjetër të nxehtët e madh dhe i vazhdueshëm nuk i than aq shumë energjitë dhe nuk e ligështon aq fort dëshirën. Shfaqjet e vetvetishme e të gjithanshme të natyrës nxisin një nevojë të thellë për përpjekje mbinjerëzore dhe luftë të ashpër ndaj plogështisë.

Këtu njeriu, nëse do të mbijetojë, duhet të punojë papërtueshëm. Shpërblimi që vjen nga puna sjell një siguri të arsyeshme për jetën, por njeriun e shtyn diçka më shumë drejt domosdoshmërisë për të kaluar nga plotësimi i nevojave të përditshme në një të ardhur që i sjell atij më shumë se kaq. Vargu i gjatë i "lëkundjeve ritmike" të stinëve, ku dimri pasohet nga vera dhe vera nga dimri e shtrëngon njeriun që të mbledhë mendjen dhe të sigurojë rezerva ushqimore, strehë dhe rroba për ditët që vijnë. Madje edhe punëtori më i pakushtuar ndaj punës, por që është sadopak largpamës, nuk mund t'i shpëtojë nxitjes që i sjell nevoja e jashtëzakonshme që nga lufta për një ekzistencë primitive dhe të egër të kalojë në një gjendje zhvillimi më të lartë.

Shumë prej gjërave që u thanë më sipër mund të thuhen edhe për Amerikën e Veriut, Kanadanë dhe SHBA-në. Kjo nuk vihet re në ndonjë pjesë tjetër të globit. Pjesa më e madhe e Afrikës dhe e Amerikës së Jugut përfshihet nga Zona e Nxehtë. Pllaja e pafund e shkatërruar e Azisë Kontinentale është e rrethuar në perëndim, në jug dhe në lindje prej kodrave dhe maleve që e "ruajnë" atë nga ndikimi i deteve.

Klima e Europës perëndimore përcaktohet nga Rryma e Golfit, e njohur në çdo gjuhë si *Golfstrim*, rryma më e shpejtë dhe më e dobishme

e tërë oqeaneve. Masa e saj e ngrohtë e merr drejtimin nga Bregu i Njufolklandit drejt lindjes dhe arrin në brigjet e Europës duke krijuar në udhën e vet një bazë të pafund peshkimi në Detin e Veriut. Ngrohtësia e saj thyen forcën e dimrit dhe i mban gjiret pa ngrica në fjordet norvegjeze. Ajo i jep Liverpulit një klimë më të butë se ajo e Uashingtonit, ndonëse ky i fundit është një mijë e gjashtëqind kilometra më në jug, duke ndikuar edhe tek ishujt britanikë, për shkak të Labradorit Lindor.

Pasi nuk ka prita për t'u penguar nga deti, erërat që mbizotërojnë në Europë, të ngopura me lagështirën e oqeanit, shpërndahen qindra kilometra brenda kontinentit, duke zbutur dallimet e mëdha midis stinëve dhe duke ndihmuar pjellorinë e tokës.

## VIJA E GJATË BREGDETARE EUROPIANE

Linja bregdetare e Europës është e njohur për gjatësinë dhe arritshmërinë e saj. Amerika e Jugut është dy herë më e madhe se Europa, ndërsa Afrika tri herë më e madhe, megjithatë, edhe pse Europa është e mbylllur në anën e saj lindore aziatike, ajo ka një vijë bregdetare më të gjatë se këto dy kontinente të marra së bashku. Amerika e Veriut ka hapësirë dy herë më të madhe se Europa, por po të hiqet pjesa e pabanueshme e Arktikut, pamja ballore detare e të dyjave është gati e barabartë.

Vija bregdetare europiane ndërpritet prej një numri të pafund gjiresh të mëdha, të ngushta, të futura, përgjithësisht, në brendësi të tokës dhe të dala përsëri në dete, të cilat thyejnë pandërprerje konturin duke e shumëfishuar vijën e saj gjatësore.

Nuk ka sasi tjetër ujore që të matet me Mesdheun, detin e pakrahasueshëm, i cili formon kufijtë jugorë të Europës. Drejtimi i tij i përgjithshëm është nga lindja në perëndim për afro 3800 kilometra dhe është tërësisht, i përvijuar në jug, më jetëdhënës në pjesën e tij të zonës së butë. Duke i lagur brigjet e tërë kontinenteve të botës së lashtë, sipërfaqja e tij prej afro 1.500.000 kilometrash katrorë e bën të duket si një oqean në brendësi të tokës. Dy gadishuj të mëdhenj e ndajnë atë mespërmes, njëri prej të cilëve në më shumë se njëmijë e dyqind kilometra.

Një varg ishujsh të mëdhenj, në largësi thuajse të barabarta, ndjekin njëri - tjetrin përgjatë një vije të ashpër paralele me drejtimin e tij të përgjithshëm. Ishuj të tjerë të panumërt pikëzojnë zgjerimin e tij dhe rrethojnë brigjet. Që këtej vjen një labirinth i vertetë prej nga lidhen detet e tjera, si dhe përvijohen gjire pa batica dhe zbatica, të cilat joshin sipërmarrjet e tregtarëve dhe u sigurojnë atyre mbrojtje nga stuhitë.

## NDIKIMI I EGJEUT

Prej gjithë këtyre deteve të ndërlidhura vlen të veçohet ndikimi dhe qëndrueshmëria që shfaq Egjeu bashkë me arqipelagët e tij. Askund tjetër bota antike nuk ka arritur të na japë një pamje kaq të mrekullueshme të stërvitjes në det, si kjo. Banorët e brigjeve gadishullore të Greqisë dhe të Azisë së Vogël qenë shtyrë nga rrethanat e fatit të tyre që të ndërmerrnin aventura duke e kuptuar gradualisht se do të bëheshin zotër të deteve. Dhe deti nga ana e vet u ktheu atyre më shumë se sa vlera materiale.

Mbretëritë e lashta si Egjipti, Asiria, Persia, India, i hodhën pashmangshmërisht bijtë e tyre në sipërfaqen e pamatshme ujore të deteve. Dhe po ashtu, herë herë në grupe prej dy-tri vetësh, njerëzit u kacafytën me detin duke e mposhtur atë dhe duke rritur ndjenjën e tyre vetjake të pavarësisë ndaj natyrës. Kjo u shoqërua sa me arritje, aq edhe me zbulime të mëdha. Ishte një motiv nxitës që fillon që nga Maratona në thellësitë e kohëve, vijon me luftëra të tjera për liri, për të ardhur deri në ditët e sotme.

Greqia klasike ishte krijesë e Mesdheut. Pa Mesdheun nuk do të kishim pasur Romën, shteti i së cilës ishte atëbotë zemra dhe nyja lidhëse e qytetërimit. As vendi i saj në botë nuk do të kishte qenë aq i shquar në rrjedhën e Mesjetës e deri te kohët moderne. Deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, kapitali i ndryshueshëm i botës ishte i vendosur diku në njërin prej tre gadishujve. Prej tërë këtyre arsyeve të numërta deri këtu për epërsinë e europianëve, asnjë nuk është më bindëse se fakti që Europa ngrihet si një piramidë pikërisht mbi Detin Mesdhe.

## TË KLASIFIKOSH RACAT E EUROPËS – NJË DETYRË SHUMË E VËSHTIRË

Dy gjëra duhen marrë si të vërteta kur diskutojmë për racat në Europë: që të gjithë europianët vijnë nga një trung fillestar; që stërgjyshërit e lashtë e të largët të banorëve të sotëm erdhën nga Azia. Ne duhet të pranojmë se shumë studiues të shquar i kanë hedhur poshtë këto hamendje dhe që asnjëra nuk është provuar me siguri të plotë, por mendimi i përparuar priret gjithnjë e më shumë drejt njohjes të së vërtetës.

Një racë është një ndarje e madhe e njerëzimit, e cila ka edhe gjëra të veçanta edhe të përbashkëta, duke formuar kështu një klasë gjithëpërfshirëse, që, në dukje, rrjedh prej një burimi të veçantë primitiv.

Klasifikimi sipas racave i 1.700.000.000 njerëzve që popullojnë botën mund të duket i lehtë. Një europian, një negër dhe një kinez dallohen me një të hedhur të syve. Megjithatë, çdo përpjekje për t'i klasifikuar ata ka treguar se është një prej detyrave më të ngatërruara dhe më të vështira. Klasifikimet më të shumta, sidomos ato për racat e vogla, ose nuk kanë qenë gjithëpërfshirëse, ose kanë hasur në shumë kundërshtime.

Gjatë dyqind vjetëve të fundit janë bërë shumë përpjekje të tilla. Ngjyra e lëkurës, ngjyra dhe forma e syve, ngjyra dhe cilësitë e flokëve, disa karakteristika anatomike, si, bie fjala, trajtat e hundës ose gjatësia e gjymtyrëve në përpjesëtim me trupin, veçanërisht në pjesë të ndryshme të skeletit, trashësia[2] ose hollësia e kafkës, kapaciteti i kafkës i matur me vëllimin e rërës së futur në të, perimetri horizontal i kafkës, këndi i fomuar prej ndërprerjes së boshtit të faqes me boshtin e kafkës (i njohur me emrin këndi faqor), indeksi cefalik, gjatësia, gjerësia, thellësia dhe lartësia e kafkës, kanë qenë midis provave që janë përdorur për të përcaktuar racën. Gjuha ka qenë një pjesë e pandashme e provave dhe shpesh vendimi përfundimtar është bazuar pikërisht në të.

**(Footnotes)**

[6]

Studiues të palodhur kanë synuar që të demonstrojnë dhe të zbatojnë saktësinë e plotë të njërës ose tjetrës prej këtyre provave. Kërkimet e tyre kanë zbuluar se sa e pamundur është të shquhen dallimet qenësore midis bijve të njeriut. Përpjekjet për të zgjidhur

lëmshin përbërës të njerëzimit kanë ardhur për herë tek i njëjti përfundim se kjo është natyra homogjene e njerëzimit.

Megjithatë, secila prej këtyre provave ka një shkallë të caktuar vërtetësie dhe zbatueshmërie. Midis atyre më të fundit, dhe tani e njohur si më e përhapura, është ajo e indeksit cefalik, që nënkupton, "Formë që shpreh raportin midis gjerësisë më të madhe ndaj gjatësisë më të madhe të kafkës, duke marrë një masë prej njëqind njësish". Nëse raporti i mësipërm është 80 njësi me 100 njësi të tilla, atëherë përdoret fjala "brakycefalik". Nëse raporti është 80 njësi me 100 njësi, atëherë përdoret fjala "dolikocefalik" ose "kokëgjatosh".

## PESË GRUPET E MËDHA TË RACAVE

Numri i grupeve të ndryshme njerëzore të racave është ndryshueshmërisht i vlerësuar prej këtyre të trijave, Jafetik[2], Semitik[3] dhe Hamitik[4] të Biblës ose prej tri të tjerave të Kaukazianëve, Mongolëve dhe Negrove të Kuvierit[5] ose njëmbëdhjetëve të Pikeringut dhe gjashtëmbëdhjetëve të Dosmoulinsit[6]. Vlerësimi i bërë prej babait

---

[2] *Japhetic*, është një term i përdorur dikur prej disa studiuesve për të treguar një familje të madhe të tretë gjuhësore, e afërt me atë Semitike dhe Hamitike.

[3] *Semitic* - "Semitic" është një mbiemër që i referohet popujve, të cilët kanë folur tradicionalisht gjuhën semitike ose dy gjuhë të tjera që lidhen me të. Analiza gjenetike sugjeron se popujt semitike vijnë nga e njëjta origjinë përkundër dallimeve të rëndësishme dhe kontributeve që kanë në grupet e tjera. Ka shumë debate rreth asaj se çfarë do të thotë fjala semitik, por ka një farë pajtimi që ai të jetë një term gjuhësor që u referohet popujve hebre, arabë dhe amharikë. Forma negative antisemitizëm është përdorur, thuajse, gjithmonë me kuptimin e veçantë, "anti-hebrenj". Ajo rrjedh prej fjalës *Shem*, një prej tre djemve të *Noes*. Njerëzit parasemitikë – stërgjyshërit e semitëve në Lindjen e Mesme, mendohet të kenë ardhur që prej fillimit nga Gadishulli Arabik.

[4] Hamitic – si term u referohet popujve që tradicionalisht besohet të kenë qenë pasardhës të *Hamit*, njërit prej djemve të *Noes*. Gjatë historisë ka pasur disa interpretime të veçanta, por edhe të ndërthurura të këtij termi. Në Bibël djemtë e Hamit janë popujt të cilët tradicionalisht janë armiq të hebrenjve, veçanërisht egjiptianët. Thuhet se djemtë e Hamit janë paraardhësit e popujve të Afrikës Jugore.

[5] *George Cuvier* ishte një prej njerëzve më me ndikim në shkencën e fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ai ishte i suksesshëm në krijimin e imazhit të vet si një njeri i madh i shkencës. Ka lindur në Francë më 23 gusht 1769.

[6] *Camille Desmoulins* (1760–1794), revolucionar francez dhe gazetar i shquar i kohës së Revolucionit Francez.

të antropologjisë, Dr. Blumenbah[7], në vitin 1781, i ka qëndruar kohës më mirë se çdo teori tjetër. Ai gjen pesë raca: kaukaziane, mongoloide, etiopiane, amerikane dhe malajane.

Pasigurisë që shoqëronte përcaktimi i emërtimit të racës së parë njerëzore i doli në ndihmë një kafkë e pastër e gjetur në Kaukaz dhe që atëherë lindi ideja që ajo të thirrej *Raca Kaukaziane.* Ky emërtim ka lidhje vetëm me vendgjetjen, por jo me ndonjë teori që e lidh origjinën e racës njerëzore me Kaukazin.

Bouillet i tregon karakteristikat e *kaukazianit* të tilla, si: "kokë vezake; fytyrë jogjatoshe, buzë të holla, sy horizontalë; të bardhë, flokë të gjatë dhe me shkëlqim; mjekër të gjerë; me epërsi mendore". Për mongoloidët ai thotë: faqet – kockëdala; kapakët e syve të tërhequr poshtë drejt tëmthave, kokë rrumbullake, faqe të plota, hundë të shtypur, veshë të dalë dhe të gjatë, lëkurë të verdhë dhe nganjëherë kafe, mjekër qose, flokët të drejta dhe të zeza".

Tri racat e tjera nuk janë aq me rëndësi për ne, pasi nuk kanë pasur ndonjë ndikim në historinë e Europës ose në jetën e saj. Për më tepër, kaukazianët dhe mongoloidët janë të ndarë në degë ose në grupe që shquhen prej dallimeve në gjuhë dhe karakteristika të veçanta të vogla fizike.

Ndarjet kryesore janë, njëherazi, të njohura si kaukaziane, të emërtuara si indo-europiane ose jafetike dhe syro-arabe ose semitike. Termi indoeuropian tregon se europianët vijnë nga një bazë induse, ndërsa termi siriano-arabë tregon origjinën siriane dhe arabe.

## FAMILJA INDOEUROPIANE

Familja indoeuropiane përfshin tetë degë ose grupe. Këto janë: në Azi, asirianët ose hindutë e Indisë, persianët dhe armenët, dy grupe

[7] *Blumenbach* (1752–1840), natyralist dhe antropolog gjerman. Ai paraqiti dhe zhvilloi shkencën krahasuese të anatomisë në Gjermani. Vepra e tij *De generis humani varietate nativa*, 1775; (Mbi natyrën e ndryshme të njerëzimit) shënoi fillimin e antropologjisë fizike dhe përshkroi pesë ndarjet e njerëzimit, të cilat u bënë baza e klasifikimeve të mëvonshme racore. Analiza e Blumenbachut mbi një koleksion të gjerë kafkash e botuar nën titullin *Collectio craniorum diversarum gentium* (1790–1828), shënoi themelimin e studimeve kafkore.

të fundit të quajtur shpesh iranianë nga Pllaja e Madhe e Iranit ku ata e kanë origjinën; në Europë, grekët, latinët, keltët, teutonët ose gjermanët dhe sllavët.

Në gjuhën e përditshme këto grupe përmenden si raca, kështu ne, me të drejtë flasim për racën kelte ose sllave ose për *Racat e Europës*. Për shkak të marrëdhënieve të ngushta të grekëve dhe të latinëve dhe të afërsisë së tyre gjuhësore, këto të dyja janë paraqitur si greko-latine. Gjermanët dhe teutonët janë të ndërthurur duke përbërë terma sinonimë.

Numri më i madh i njerëzve që e kanë pushtuar Europën, pasardhësit e të cilëve janë tani të vendosur aty, i takojnë familjes indoeuropiane. Përveç kësaj, rreth 30.000.000 njerëz ose një e pesëmbëdhjeta e banorëve të Europës janë fino-ugrians[8] dhe turq, pjesëtarë të degës Uralo-Altaike të familjes mongoloide. Të gjithë të tjerët, përveç hebrejve, maltezëve dhe saraçenëve (siriano-arabëve) dhe, ndoshta edhe me përjashtim të baskëve, vijnë nga një trung indoeuropian.

Uralo-altaikët përfshijnë popuj që gjenden midis maleve Altai dhe Urale. Fino-ugrianasit janë një popullsi e veçantë e grupit perëndimor të Uralo-altaikëve. Emri rrjedh nga Fin dhe Ugra, rajone në të dy anët e Uraleve.

## KUSHTET GJEOGRAFIKE PËRCAKTOJNË RACËN E TË SHPËRNGULURVE

Drejtimet e ndryshme të shpërnguljeve brenda Europës, më vonë ecejaket e emigrantëve dhe rivendosja e tyre e përhershme, mund të gjenden te shkaqet gjeografike prej të cilave sistemi malor, lumenjtë dhe fushat patën pjesën e tyre përcaktuese.

---

[8] *Ugro-finët* janë një grup i larmishëm popujsh të lidhur që në kohë të lashta prej trashëgimisë së dallueshme gjuhësore ndaj asaj indoeuropine që i rrethon ata. Prej afro 25 milionë fino-ugrianëve, më të njohurit janë estonezët dhe finlandezët në bregdetin e Balltikut lindor dhe hungarezët në pellgun e Karpateve. Por ata përfshijnë, gjithashtu, lapët në veriun fino-skandinav dhe në Gadishullin Kola, erzasët, moksasët, udmurtët dhe komisët në zonën pyjore të veriut të Rusisë europiane dhe khantysët e mansisët e Siberisë Perëndimore. Të afërm të largët me fino-ugrianët janë popuj të ndryshëm të Siberisë, Nentës, Enetës, Nganasansit dhe Selkupit.

Shtylla kurrizore dhe faktori mbizotërues i kontinentit janë Alpet. Pirenejtë dhe pllajat e thyera skandinave qëndrojnë të veçuara dhe të ndara. Por Cevenes, Jura, Vosges dhe Apeninet, Bohema trianëshe, Karpatet, Ballkani dhe masivi gjigand i Malit të Zi, i Shqipërisë dhe i Greqisë janë degëzime të Alpeve. Nga perëndimi, jugu dhe juglindja, rrëzët e maleve shtrihen drejt deteve.

Megjithëse Alpet përvijohen mespërmes kontinentit duke krijuar një pritë natyrore, ato janë më pak të vështira për udhëtarët se sa Pirenejtë. Për ekspeditat ushtarake romake ishin të njohura më shumë se një dyzinë shtigjesh të Alpeve. Një qafë mali nuk është pengesë, por përkundrazi një udhë që të shpie nga ultësirat drejt lartësive të mëdha dhe prej andej, nëpërmjet luginave të thella, drejt fushave në anën tjetër. Pikërisht mbi ato fusha u lëshuan jo vetëm trupat e Hanibalit dhe të Napoleonit, por një numër i pafund pushtuesish si para ashtu, edhe pas Jul Qezarit.

Në Alpe gjenden ujënisjet e lumenjve si burimet e Rhone, Rinit dhe Posë, si dhe degët që derdhen në lumenjtë Loiren, Sena, Meuse, Elba, Oderi, Vistula, dhe Danubi. Secili nga këta lumenj ose ka penguar ose ka përcaktuar ecejaket e njerëzve, marshimet e ushtrive dhe kufijtë e shteteve. Danubi ishte rruga natyrore e pashmangshme e barinjve në udhëtimet e tyre drejt perëndimit.

## ALPET, SHENJA ORIENTUESE E RACAVE TË EUROPËS

Një vijë e hequr nga mali i Pruthit te mali i Niemenit dhe që andej e përshkuar nëpërmjet Balltikut dhe Gjirit të Bohemisë për te burimi i Torne Elfit, jep një ide përafërsisht të saktë historike të kufijve lindorë të Europës dhe të shtrirjes së saj. Në perëndim të asaj vije dhe në veri të Alpeve një fushë e pamatshme e prerë vetëm prej ujërave vaditëse të lumenjve shtrihet drejt Detit të Veriut.

Kur filloi epoka e krishterë, e tërë ajo fushë ishte e mbuluar me pyje me përjashtim të moçaleve që shtriheshin në lindje. Ajo rrafshinë, sikundër edhe ajo skandinave, e populluar thuajse tërësisht prej teutonëve, nganjëherë quhej Gjermani. Në lindje të asaj vije ishte edhe

një fushë tjetër, po ashtu e pafund, e quajtur Sarmatia, vendbanimi i një race gati të panjohur, e sllavëve. Alpet, veriu i Italisë, një pjesë e Spanjës, Franca dhe ishujt britanikë banoheshin prej keltëve. Qendrat e greko-latinëve ishin Greqia dhe Italia.

Kështu në atë kohën e Krishtit, Alpet qenë pikat orientuese të Europës që na japin, afërsisht, idenë se ku gjenden racat: në veri të Alpeve, teutonët[9]; në jug të Alpeve, greko-latinët; në perëndim të Alpeve, keltët[10]; më larg nga Alpet dhe krejt në lindje, të pandikuara prej tyre dhe për rrjedhojë të pandikuar as nga Europa, ndaj së cilës edhe ata vetë ndikuan pak, ishin sllavët dhe fino-ugrianët.

## BJONDËT E VERIUT TË ALPEVE

Përderisa studiuesit e kanë pasur të vështirë të përcaktojnë racat e mëdha të njerëzimit dhe, madje, të pamundur për t'u pajtuar lidhur me numrin e tyre, nuk është habi që ata ta kenë pasur edhe më të vështirë të bënin dallimet e karakteristikave të nëndarjeve të ndryshme, pra të racave më të vogla. Ky fakt vihet re menjëherë sapo dikush fillon të kërkojë në tiparet fizike të keltëve, teutonëve, sllavëve dhe greko-latinëve. Ata mund të përshkruhen vetëm me terma të përgjithshme, sepse terma të tillë asnjëherë nuk janë të saktë.

Grekët e lashtë i thërrisnin tërë njerëzit bjondë që jetonin në veri të Alpeve me emrin e përbashkët *keltoi* ose *keltët*. Më vonë këta keltë u njohën si dy grupe të ndarë nga njëri-tjetri.

Emri "kelt" u kufizua më pas vetëm në grupin e njerëzve që jetonin më afër alpeve dhe në pllajat e mëdha perëndimore. Ky grup është quajtur, gjithashtu, alpin. Në përgjithësi njerëzit e këtij grupi ishin me

---

[9] *Teuton* quhet a) ai pjesëtar i një populli të lashtë, ndoshta me origjinë gjermane ose kelte, i cili jetonte në Jutland deri aty rreth vitit 100 para erës së re; b) ai pjesëtar i ndonjërit prej popujve që flasin gjermanisht, veçanërisht një gjerman.

[10] *Keltët* ishin një grup popujsh që pushtuan toka që shtriheshin deri në Ishujt Britanikë të Gallatisë. Të dhënat e para historike që paraqesin veçori kulturore të shoqëruara me ato kelte, vijnë prej veriut të Italisë aty rreth vitit 400 para erës së re, kur një grup i panjohur më parë i përbërë prej *barbarësh* zbriti nga alpet dhe i zhvendosi etruskët nga lugina pjellore e Lumit Po, një shpërngulje që ndihmoi në heqjen e etruskëve nga qendra e vëmendjes së historisë.

trup të shëndoshë, me shtatlartësi mesatare, kokë të rrumbullakët, me fytyrë të gjerë, me sy gri ose ngjyrë lajthie, me hundë më të gjerë, me çehre të zbetë dhe me flokë kafe të hapur. Kjo është pamja tipike kelte.

Grupi i dytë është i vendosur në Skandinavi dhe është i shpërndarë drejt jugut, deri sa përzihet me grupin e parë. Pjesëtarët e tij ishin, në përgjithësi, më pak të shkathët se keltët dhe kishin kokë më të gjata, fytyrë më të gjatë, hundë më të ngushtë, flokë më të bardhë, sy blu, dhe ishin më të gjatë. Tipi i tyre është teutoni, ose gjermani ose, një term më pak i përdorur, nordiku, domethënë veriori.

Sllavët, emërtim i cili sipas filologëve rusë vjen nga fjala "slava" që do të thotë "lavdia", "lavdiplotë", ose "slova" që do të thotë "fjalim, dikush që flet" nuk dalin asgjëkundi në histori deri në shekullin e pestë të erës së re. Ata, në përgjithësi, janë më pak të gjallë dhe me fytyrë më pak shprehëse sesa teutonët ose keltët.

Në përgjithësi ata janë shtatlartë, të fuqishëm, me flokë dhe me mjekër të dendur, me duar e këmbë të vogla. E megjithëse kanë kaluar qindra vjet që atëherë, ende sot nuk ka një tip fizik sllav, siç ka qenë dhe siç është ai teuton dhe kelt. Ky fakt, ndoshta, rrjedh nga aftësia e jashtëzakonshme e sllavëve për t'i bërë për vete racat tjera që i patën nën sundim, si dhe për shkak të feve të ndryshme që praktikojnë sllavët. Me çehre të zeshkët dhe nganjëherë të hapur fare, me trup të shkurtër ose të gjatë, me mjekër të dendur të kuqe, të zezë ose të verdhë, sllavi zbulon karakteristikat fizike më kozomopolite midis racave të tjera.

Greko-latini në dy tipat e vet, grek qoftë ose romak, është i njohur si aktiv, demonstrativ, i shkathët në politikë dhe në administrim, në filozofi dhe në art, mësues i njerëzimit.

## FILLIMI I RACAVE I MBËSHTJELLË ME MISTER

Fillimi ose foshnjëria e çdo race është e panjohur, e mbështjellë me mister, të cilin legjenda më shumë e ngatërron sesa e ndriçon. Sido që të jetë një e dhënë, edhe në se është jo e plotë ose e copëzuar, mbi racat e Europës, në këto dymijë vitet e fundit është më e kapshme.

Është interesante të shihen këto të dhëna shkurtimisht. Pa këtë do të ishte e vështirë të vlerësohej gjendja e ndërlikuar e ditëve të sotme të Europës.

Në vitin 117, Perandoria Romake arriti shtrirjen e saj më të madhe. Ajo përfshiu të gjitha vendet në Mesdhe sikundër edhe një rrip toke që e rrethonte tërë Detin e Zi. Ajo, gjithashtu, përfshiu Britaninë dhe tërë atë territor që tani e kanë zënë rumunët në Transilvani, Rumaninë vetë dhe Besarabinë, madje edhe një territor më të gjerë midis Tigrit dhe Eufratit. Ajo i fortifikoi fuqishëm kufijtë veriorë, prej nga rrjedh Rini dhe Danubi dhe u shtri deri aty ku shtrihet sot qyteti i Budapestit. Më shumë se në çdo perandori tjetër që ka parë njerëzimi, ajo arriti kulmin dhe mishërimin e rregullit dhe të rendit, me zbatimin e ligjit, të drejtësisë dhe të qytetërimit. Por përtej kufijve të saj veriorë, në një pllajë, gëlonte një botë tjetër e ashpër. Ishte një botë e paqytetëruar dhe e palidhur, një masë e çrregullt njerëzish, krejt e kundërta e asaj që njihnin romakët. Fiset teutone dhe sllave, të cilat pushtuan territore të pafund në luftërat e ashpra ndaj njëri - tjetrit, ishin aq në lëvizje sa, veçse me fjalë të përgjithshme, njeriu nuk di të përcaktojë vendodhjen e ndonjërit prej tyre.

## SHPËRTHIMI I FURTUNËS HUNE[11]

Papritur mbi Europë shpërtheu furtuna e hunëve, një popull finlandezo-altaik, i cili prej shumë kohësh rrinte i vendosur në fushat e mëdha aziatike përtej Kaspikut. Numri i tyre po rritej pandërprerë, duke u shtrirë drejt perëndimit.

Në shekullin e katërt të erës së re, sikur të ndodhte me sustë, e tërë mizëria e këtyre njerëzve, me karroca të mëdha, me kuaj, duke marrë me vete gjithçka që kishin, u dyndën drejt Europës. Me të kaluar

---

[11] *Hunët* – Shumë historianë i konsiderojnë hunët (që do të thotë gjuha mongole) të parët popuj mongolë dhe turq të përmendur në historinë europiane. Nuk dihet se prej nga erdhën, por ngjan që ata ta kenë origjinën në tokat midis Siberisë së sotme dhe Koresë, pastaj emigruan me shpejtësi në drejtim të perëndimit. Në burimet kineze gjenden referenca ndaj germave *"Xiong"*, të cilat shkojnë thellë në histori deri në vitin 1200 para erës së re. Sundimtarët Xiong përmenden për herë të parë në vitin 1766 para erës së re dhe janë, ndoshta, stërgjyshërit e Xionu–ve. Një legjendë koreane e shekullit XIX thotë se ishte një aleancë e fiseve altaike veriore nën sundimtarin "Huan" që themeloi Kinën.

Vollgën, ata i detyruan allanët, një popull luftarak me gjak të përzier, t'u bashkoheshin atyre në atë udhëtim të furishëm.

Gotët[12], një popull teuton nga Skandinavia, në atë kohë pushtoi tërë territorin midis Donit dhe Theisit. Dy degët e tyre – visigotët ose gotët perëndimorë dhe ostrogotët ose gotët lindorë – ishin shkrirë në një, duke bërë kështu së bashku fuqinë më të madhe të Europës jashtë Romës. Këtë perandori tronditën hunët.

Ostrogotët ose gotët lindorë u gjunjëzuan, duke u dhënë kohë sa të kalonte furtuna. Visigotët ose gotët perëndimorë kërkuan strehë në jug të Danubit në Perandorinë Romake të Lindjes, e cila sapo kishte themeluar kryeqytetin e saj, Konstandinopojën.

Hunët u mbrojtën për një gjysmë shekulli në qendër të Europës. Ata themeluan një kryeqendër të tyre mbi lumin Danub dhe e quajtën Buda, i cili bashkë me Pest-in, në anën tjetër të bregut të lumit, përbën kryeqytetin e sotëm hungarez.

Fjalët nuk mund ta shprehin tmerrin me të cilin ata qenë cilësuar si prej romakëve, ashtu edhe prej teutonëve. Sytë e tyre të picërruar shpues, fytyra kockë e lëkurë, balli i ngushtë, hundët e tyre të gjera, të shtypura, veshët tejet të mëdhenj, lëkura e bërë me tatuazh dhe e vizatuar, format e fytyrës së tyre të shtrembëruara dhe të çuditshme, i bënin ata të dukeshin më shumë përbindësha se njerëz.

Të etur për gjak dhe shpërfillës ndaj vuajtjeve, të varfër në ndjenjat e dhembshurisë njerëzore, ata thuhej se ishin bijtë e vetë djallit dhe të shtrigave; kishin shpirt të zi, aftësi të zotëronin gjithçka të errët; ishin mjeshtër të magjisë skëterrore.

Të ashtuquajturat pushtime barbare të Europës janë quajtur, me të drejtë të tilla si fillim me këtë dyndje të hunëve. Shumë dyndje popullsie kishin ndodhur. Shumë popuj i kishin sulmuar krahinë romake që kur Brennus[13] dhe Gualsi[14] i tij rrënoi Italinë dhe Romën

---

[12] *Gotët* – ishin fise gjermane të lindjes, të cilat sipas traditave të tyre vinin nga Skandinavia (veçanërisht prej Gotlandit dhe Gëtlandit) Ata zbritën drejt jugut dhe pushtuan pjesë të Perandorisë Romake. Dy fise të lidhura ngushtë, Gutar dhe Gëtar, të cilët mbetën në Skandinavi, thirren shpesh gotë, trajtohen në mënyrë të veçantë, respektivisht si Gotlanders dhe Greats.

[13] *Brennus* – 389 para erës së re, udhëheqës legjendar gal. Ai e pushtoi Romën po dështoi në marrjen e Kapitolit nga Manliusi, (*Marcus Manlius Capitolinus*).

[14] *Galët* – (nga latinishtja Gallia dhe nga greqishtja Galatia) është rajoni i Europës Perëndimore

republikane; por çdonjëra prej këtyre pushtimeve dhe sulmeve pati qenë një ngjarje e izoluar, që vinte e shkonte duke lënë pas pasoja relativisht të vogla. Asnjëri nuk e pati tërhequr mbarë kontinentin në një trazirë të plotë si kjo.

## RRËMUJA I SHOQËRONTE HUNËT KUDO QË NDODHESHIN

Përpara ardhjes së hunëve, jashtë Perandorisë Romake kishte pasur mungesë rendi, por një mungesë rendi e lokalizuar dhe e izoluar. Gjatë shekujve pas hunëve, kudo, nga Skandinavia dhe Vistula deri në Afrikën veriore, çrregullimi i vazhdueshëm dhe përherë i ndryshueshëm mbretëroi kudo e kurdoherë. Popujt e ndryshëm u shpërngulën vazhdimisht, duke u bërë turmë njëra mbi tjetrën, keltët, sllavët, teutonët, hunët dhe romakët të përzier dhe të humbur në pështjellimin e egër të kohës.

Atila, mbreti i hunëve e zgjoi popullin e vet që të rifillonte furinë e pushtimit drejt perëndimit. 700.000 luftëtarët e tij përbëheshin jo vetëm prej hunëve, ku ai kishte besimin më të madh, por edhe prej popujve të tjerë të nënshtruar.

Europa, së cilës po i merreshin këmbët, e mori veten në një përpjekje titanike nën komandën e Etiusit[15], "gjenerali i fundit romak" dhe solli në fushën e betejës tërë ata burra, të cilët shquheshin për patriotizëm dhe jepnin shpresë për fitore.

Një mori e panumërt njerëzish u takuan në atë pllajë të valëzuar që shtrihet midis Kështjellës Thierri[16] dhe asaj Chalons[17]. Në rrezik

---

zënë prej Francës së sotme, Belgjikës, Zvicrës perëndimore dhe prej disa pjesëve të Hollandës dhe të Gjermanisë, si dhe prej bregut perëndimor të lumit Rin. Në anglisht fjala Gaul gjithashtu i referohet njëherazi një banori kelt të atij rajoni të kohëve të lashta, por galët ishin shpërndarë anë e mbanë Europës që prej kohëve romake dhe flisnin dialekte të gjuhës gale. Përveç galëve që jetonin në territorin e Francës së sotme, aty u vendos edhe Leoponti II, i cili zaptoi pllajat e Italisë së Veriut (Gallia, Cisalpina) dhe Helvetinë në veri të alpeve Raetia.

[15] *Flavius Aetius* ose thjesht *Aetius* (396-454) ishte gjeneral romak i periudhës përmbyllëse të Perandorisë Romake të Perëndimit. Ai është quajtur shpesh, nganjëherë bashkë me Kontin Bonifac, "I fundit i romakëve". Fitorja e tij mbi Atilën hun, i siguroi atij pavdekësi për aq kohë sa njerëzimi do ta kujtojë Romën.

[16] *Thierry* – Kështjella Thierry shtrihet në pyllin perëndimor të fshatit Falmignoul, në

nuk ishin vetëm interesat e një shteti, por vetë pavarësia dhe qytetërimi i njerëzve që ishin gjallë në atë kohë. Me të drejtë kjo është quajtur si një ndër betejat më vendimtare në historinë e botës. Ndonëse kjo i takon pesëmbëdhjetë shekujve të kaluar, këto vite tragjike të së kaluarës marrin një kuptim kryesor dhe të rinovuar të betejës së Chalons-it, e para betejë e Marnës.[18]

Atila[19] nuk e mbijetoi gjatë humbjen. Fiset teutonike dhe sllave e rifituan pavarësinë e tyre. Hordhitë e hunëve u shpërndanë; disa mbetën në të djathtë të lumit Danub, në Hungarinë e sotme; disa u vendosën në Dobrunjë; disa u kthyen mbrapsht dhe u përthithen në mbretëritë e sojit të tyre, duke iu ngjitur më pas Dnieprit dhe Vollgës. Përveç kujtimeve të neveritshme ata lanë pas shumë pak gjëra për t'u mbajtur mend.

## ARRITJA E GJERMANËVE

Disa vite pas përçarjes së hunëve, Odoacer[20], kreu i Herulit Gjerman[21] dhe i fiseve të lidhura me të, e detyruan perandorinë e

---

në jug të qytetit Dinant në Belgjikë. Kështjella e parë ishte pronë e Thierrit, Lordi i Faingut, por nga ajo asgjë nuk ka mbetur tashmë. Prej saj ai mbrojti abacinë kishtare.

[17] *The Battle of Chalons* - Beteja e *Chalons*, e quajtur gjithashtu edhe Beteja e Fushave Catalaunian, u zhvillua në vitin 451 ndërmjet forcave aleate dhe atyre federative të të drejtuara prej Gjeneralit Romak Aetius dhe mbretit visigot Theorodhid në njërën anë dhe hunëve të drejtuar prej mbretit Atila dhe aleatëve të tij. Beteja ishte operacioni i fundit i madh i Perandorisë Romake të Perëndimit.

[18] *Marne* – lumë në lindjen qendrore të Francës, i cili shtrihet në pllajën më të gjerë Langres në veri të Dizhonit dhe rrjedh në një gjatësi prej 525 km në veriperëndim, për t'iu bashkuar Senës afër Parisit. Në atë luginë janë zhvilluar dy beteja shumë të rëndësishme gjatë Luftës së Parë Botërore në shtator të vitit 1914 dhe në korrik të vitit 1918. Kjo e fundit i dha fund mësymjes gjermane.

[19] *Atila i hunëve* (406-453), mbret i hunëve (433-553). Një prej barbarëve më famëkëqij dhe më i frikshmi i gjithë kohëve, Atila, besohet të ketë qenë me prejardhje të largët mongole. Ai e shkatërroi kontinentin europian gjatë shekullit të pestë të erës së re. Me sa duket Atila ishte aq i tmerrshëm ndaj fiseve teutone sa ç'ishte edhe ndaj romakëve.

[20] *Odoacer* (Gjerman) Odoacer ose Odovacar, 435–493, prijës e Herulit, Skirit dhe Rugit. Ai dhe trupat e tij ishin mercenarë të Romës, por në vitin 476 Heruli u ngrit në revoltë dhe e shpalli Odoacerin mbretin e vet. Ky i fundit e mundi gjeneralin romak Orestes në Piacencë, mori Ravenën (pjesa perëndimore e kryeqytetit romak) dhe e shfronësoi perandorin e fundit romak të perëndimit Romulus Agustulus. Viti 476 kur ndodhi kjo shpesh merret edhe si data që shënon fundin e Perandorisë Romake të Perëndimit.

fundit të Romës të hiqte dorë nga froni. Kështu ai e shuajti Perandorinë Romake të Perëndimit, përcaktoi kufijtë midis historisë së lashtë dhe asaj moderne dhe e përjetësoi vetveten si i pari barbar verior që merrte në dorë udhëheqjen e Italisë. Mospërfillës ndaj fiseve të dobëta sllave të shpërndara në mesin e tyre dhe ndaj atyre sllavëve të panumërt të vendosur më tej nëpër këneta dhe pyje, pa pasur më frikë as nga përzierja e Romës as nga tmerret e hunëve, teutonët ishin tashmë të gatshëm që të pushtonin Europën Perëndimore.

Pastaj, Teodoriku[22], më i madhi i gotëve vdiq në kryeqyetin e tij Ravena në vitin 526, pikërisht pesëdhjetë vjet pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit. Ai pushtim tashmë dukej se ishte arritur. Nënshtrimi përfundimtar i Britanisë, ndonëse jo i kryer plotësisht, u bë falë vendosjeve të pandërprera të jutëve[23], të saksonëve[24] dhe të anglezëve[25].

Të panënshtruar kishin mbetur vetëm pak keltë të Armorikës[26] ose të Britanisë, Irlandës dhe Skocisë, pak baskë në Pirenej dhe ajo

---

[21] *German Heruli* - fiset kryesore gjermane, përfshirë alemanin, anglezët, urgundin, lombardët, saksonët dhe visigotët.

[22] *Theodoric* – I lindur rreth vitit 451, ai u mor peng në oborrin perandorak të Bizantit në moshën 8 vjeçare, ku mbeti për dhjetë vjet. Edhe pse e përqafoi kulturën greko – romake më mirë se çdo *barbar* tjetër, ai mbeti një luftëtar i popullit të vet. Nuk mësoi asnjëherë shkrim e këndim. Me t'u kthyer nga Konstandinopoja ai mori kontrollin mbi pjesën perëndimore të ostrogotëve të Panonisë dhe i mposhti sarmantianët në fushën e betejës.

[23] ***Jutët*** – ishin një popull gjerman që mendohet se rrjedhin prej Jutlandit, i cili gjendet në Danimarkën e sotme dhe në një pjesë të bregdetit frisian. Bashkë me anglezët, saksonët dhe frisianët, jutët qenë midis fiseve gjermanike, të cilët lundruan mespërmes Detit të Veriut për të plaçkitur dhe më në fund edhe për të pushtuar Britaninë e Madhe që prej fundit të shekullit të katërt e me radhë ose duke zhvendosur ose duke shkatërruar popujt keltë vendës të atyshëm.

[24] *Saxone* – Anglo-saksonët ishin një grup fisesh gjermane nga Angelini – një gadishull në pjesën jugore të Schlesvingut i cili zgjatet brenda Detit Balltik dhe në atë që tani njihet si Saksonia e Ulët, në bregdetin veriperëndimor të Gjermanisë – të cilët ia dolën që të vendosnin sundimin e tyre në jug të Britanisë nga mesi i shekullit të 5 – të deri në mesin e shekullit të 11 – të, duke formuar bazat e hershme të kombit modern anglez, gjuhën dhe kulturën e tij.

[25] *Anglezët* (nga Schlesëig-Holstein), saksonët dhe jutët pushtuan dhe u vendosën në pjesën jugore dhe qendrore të Britanisë nga fundi i shekullit të katërt e me radhë.

[26] *Armorica* është emri që i është dhënë në kohët e lashta pjesës së Galëve që përfshin Gadishullin Bretanias dhe territoret midis Lumit Sena dhe atij Loire deri në brigjet e Atlantikut.

pjesë e Gadishullit Ballkanik, të cilët i mbrojtën muret e pathyeshme të Konstandinopojës. Me këto përjashtime, gjithë Europa që nga perëndimi i Vistulës dhe i Dnieprit, nga Norvegjia dhe Suedia e deri në Mesdhe, u pushtua prej Mbretërisë Gjermane dhe u udhëhoq prej mbretërve gjermanë. Bota perëndimore ishte bërë e tëra teutone. Pushtimi jo vetëm që dukej i tërësishëm, por edhe i përhershëm.
Më të fortët midis të tilla mbretërive ishin ostrogotët në Itali dhe visigotët në Spanjë. Njëra palë sundonte nga Siçilia deri në Danub, ndërsa tjetra nga jugu i Spanjës deri në Loire.

Gotët u bënë të krishterë në shekullin e katërt, shumë më parë se çdo popull tjetër teutonik. Shndërrimi i fesë së tyre u bë jo vetëm me shpatë e hekur ose me urdhër mbretëror, por edhe nëpërmjet psallmeve të Ulfilas,[27] apostullit të tyre të madh, i cili duket qartë se ka ndikuar në sjelljen dhe në karakterin e tyre. Ulfilas predikonte në variantin e bërë enkas për ta, në një alfabet, ndoshta, të shpikur prej vetë atij. Ata u vunë në zotërim të përkthimit të parë të Biblës në ndonjërën prej gjuhëve teutone, kelte ose sllave. Ulfilas hoqi prej saj me kujdes katër Librat e Mbretërve, pasi trembej se ata do të ngjallnin pasione më të mëdha për luftë te bashkëvendësit e tij. Gotët ishin barbarët e fundit dhe më njerëzorët e të gjithë pushtuesve më të hershëm. E megjithatë, asnjëra prej mbretërive të tyre nuk zgjati shumë.

Banimi në një klimë jugore ua thante fuqitë luftëtarëve të pyjeve të veriut. Të gjithë gotët, mbështetës të doktrinës ariane, hasën në kundërshtimin e vendosur të Kishës së Romës. Grindjet familjare shkaktuan humbje burimesh dhe energjish. Në Itali, Lombardët e hershëm bredharakë, një fis teuton, dhe hordhia hune e Avarsëve zëvendësuan ostrogotët. Në Spanjë, visigotët u shfronëzuan prej pushtimit arab. Kështu, më shumë se 300.000 gotë u zhdukën, u tretën midis banorëve të dy gadishujve. Ende ekzistojnë pjesë të shkëputura

---

[27] *Ulfila* – ose *Wulfila* (që do të thotë ndoshta "ujku i vogël") 310-383, prift, misionar dhe përkthyes, ishte got ose gjysmëgot i cili e kaloi kohën brenda Perandorisë së Bizantit në një kohë kur arianizmi ishte mbizotërues. Ulfiliasi kishte marrë dorë te prifti Eusebios i Nikomedisë dhe u kthye te njerëzit e vet si një misionar. Ai e përktheu Biblën nga greqishtja në gjuhën gote. Për këtë ndërtoi një alfabet got, fragmentet e mbijetuara të të cilit njihen si Codex Argenteus dhe gjenden në bibliotekën e Uppsalës.

të Biblës gotike, si relike të vlefshme të një gjuhe të shuar. Madje edhe vetë arkitektura gotike nuk ka ndonjë lidhje me gotët ose me ndonjë ndërtesë që ata kanë ngritur ndonjëherë. Ky term u përdor prej puristëve në shekullin e shtatëmbëdhjetë, si një shprehje turpi që nënkuptonte gjithçka barbare ose gjithçka që kishte një stil joklasik.

Historia e gotëve është e rëndësishme, pasi ajo jep një shembull të vijueshmërisë së ekzistencës së tyre në rrjedhë të kohës nëpër tokat që një herë e një kohë, ishin pjesë e Perandorisë Romake. Shtetet, të vogla e të mëdha, me shkallë të ndryshme emri e dinjiteti, qenë, në mënyrë të vazhdueshme, të ndërtuara prej fisesh dhe racash të ndryshme, për të rënë pastaj nga fuqia, ndërsa krerët dhe përkrahësit e tyre shkriheshin me popullsinë vendase. Çfarëdo ndarje politike që të kishte, përherë kishte një vatër ndryshimi të një madhësie të tillë, ku të shkriheshin racat.

Meqë Britania kishte qenë një krahinë romake në pak gjë më shumë se sa me emër, Roma e rrënuar u bë për Britonin thjesht një traditë që i takonte së kaluarës dhe prej madhështisë së saj kishte mbetur shumë pak në Angli sa t'i bënte përshtypje pushtuesit barbar. Në pjesë të tjera të Europës, këmbëngulja greko-latine për ndikim te të tjerët është thuajse befasuese. Çdo vend europian në të cilin sunduan romakët flet një formë të gjuhës latine dhe administrohet prej ligjit romak.

## FUNDI I PERIUDHËS SË PUSHTIMEVE

Periudha kryesore e shpërnguljeve pushtuese fillon me dyndjet e hunëve dhe mbaron me pushtimin norman të Anglisë në vitin 1066. Kryqëzatat, të cilat erdhën më vonë, qenë ngjarje të mëdha jo në kuptimin e pushtimit ose të vendosjes së përhershme të tyre në vendet e pushtuara, por në kuptim të ikjes së tyre prej andej. Disa prej tyre u tërhoqën me luftë, por shumica i lanë eshtrat anëve të rrugëve në vendet e lindjes, duke ndikuar fare pak në formimin e racave moderne europiane.

Trazira vazhdoi nëpër një shteg, të cilin Homeri e quajti "brezi i burrave luftëtarë". Në atë periudhë, si teutonët, ashtu dhe greko-latinët tërhoqën vëmendjen për shkak se ishin aktorët kryesorë në skenën e kohës. Kudo që shfaqej kelti, roli i tij ishte ai i një njeriu guximtar që bën qëndresë të kotë dhe që shtyhet edhe më tej drejt cakut të tij.

## ARDHJA E SLLAVËVE

Sllavët u bënë më të dukshëm aty nga shekulli i gjashtë, në kohën e pushtimeve të hapësirave të cilat teutonët ose i linin zbrazur ose nuk merreshin me to për shkak se ishin të zënë me luftime të tjera. Dokumenti i parë që vërteton të folurën sllave është gjetur në qytetin e Novgordit, i cili i lodhur nga trazirat e brendshme që nuk po i përballonte dot, në vitin 862 dërgoi këtë mesazh te kreu i një fisi verior të quajtur Varngian: "Vendi ynë është i madh dhe pjellor, por kudo mbretëron rrëmuja. Eja na qeveris dhe na sundo!".

Nuk ka arsye të vihet në dyshim besueshmëria e kësaj ngjarjeje, e cila në rastin e sllavëve është tipike dhe nuk të habit aspak. Në vitin 1862 e tërë Perandoria Ruse festoi përvjetorin e mijëveçarit të ardhjes së Ruricit[28] dhe të vëllezërve të tij në përgjigje të asaj thirrjeje për qeverisje e sundim, duke shënuar me atë rast fillimin e historisë ruse.

Mungesa e vetësigurisë ose e aftësisë për të ndërmarrë nisma, si në lashtësi, ashtu dhe në ditët e sotme, duket se është një cilësi që bashkudhëton me sllavët. Varësia nga një dorë e fortë drejtuese ose ndihmëse e saj, shpesh ka sjellë shthurje të plotë të tyre. E ndërsa ndodh kështu, sllavi vetë është treguar i paaftë të ruajë atë që i ka sjellë atij guximi dhe zelli i përhershëm. Historia e racës sllave e ka dëshmuar këtë shumë herë.

Një ndër cilësitë kryesore të fuqisë së sllavit është ajo që vë re Profesor Hrdliçka:[29] "…Duket se brenda qenies sllave ka diçka që nxit

---

[28] *Ruric* (Themeluesi i Rusisë ose i pari sundimtar i Rusisë). Në Rusi një burrë me emrin Ruric u zgjodh kreu i fiseve të tyre dhe u quajt Car. Ai njihet si themeluesi i Perandorisë Ruse në vitin 863. Rusia ishte pagane nga feja në atë kohë. Në vitin 955 nëna e Ruricit, dukesha e madhe Ollga, shkoi në Konstandinopojë ku u mahnit nga Kisha Ortodokse Greke, andaj edhe u pagëzua. Kur u kthye, ajo nuk arriti ta bindte të birin që të pagëzohej. Më vonë, nipi i saj, Vladimiri, do të vizitonte edhe ai Konstandinopjën, ku do të takonte Anën, motrën e perandorit dhe do të martohej me të. Perandori këmbënguli që, nëse ai donte të martohej me të motrën e tij, duhej të pagëzohej. Ai u pagëzua dhe u martua në të njëjtën ditë në vitin 988. Sapo u kthye në Kiev, ai lëshoi një dekret pagëzimi në masë.

[29] *Profesor Ales Hrdlicka* (1869-1943) ishte një antropolog shumë i famshëm. Ai u lind në një familje nga Bohemia në një qytet të vogël të quajtur Humpolec, i cili tani është në Çekosllavaki. Në vitin 1881 emigroi në SHBA. Ai punoi në Nju Jork ku u bë edhe i famshëm si antropolog.

numër të madh lindjesh…sllavët, të marrë në tërësi, dëshmojnë lindshmërinë më të lartë midis popujve më të rëndësishëm europianë."

Perandoria Romake e Lindjes si dhe ajo Greke ose Bizantine, pas një ekzistence disa herë të lavdishme, por disa herë edhe të palavdishme në rrjedhën e saj mijëvjeçare, mori fund në vitin 1453 me rënien në dorë të Turqve Osmanë, pushtimi i të cilëve ishte krejt i ndryshëm nga çdo pushtim tjetër pararendës.

Tmerret e Perandorisë Hune u fashitën dhe nuk zgjatën shumë. I ashtuquajturi pushtim barbar solli jo vetëm të këqia, por edhe të mira, pikësëpari sepse futi në venat e asaj race të brejtur gjakun e vet burrëror, duke pasqyruar tërë atë çfarë Europa kishte qenë dhe kishte bërë. Por për pushtimin turk nuk mund të gjendet qoftë edhe një fjalë që ta lehtësojë atë nga bëmat e tij.

## PAS PUSHTIMEVE NUK KA MË RACA TË PAPËRZIERA

Barbarët e hershëm karakterizoheshin nga besnikëria fisnore dhe nga dashuria ndaj kryetarëve. Shpresa për të fituar dhe prestigji i fitores tërhiqte vullnetarë dhe mercenarë sapo shihej se një udhëheqës ishte i suksesshëm. Ushtritë pushtuese përbëheshin kështu prej trupash të përzier, të përbërë prej aventurierësh, të ardhur nga shumë drejtime, por me kalimin e viteve ata shiheshin, gabimisht, si të afërm fisnor të udhëheqësve të tyre.

Për shembull, burrat që pasuan Uilliamin Norman për në Angli, janë quajtur zakonisht normanë. Pa dyshim që shumë prej tyre ishin të tillë. Por, qëkurse baronët e tyre i zhgënjyen ata në ndërmarrjet e rrezikshme, Uilliamit iu desh "të mblidhte burra shtëpiakë nga më të ndryshmit në çdo anë të Francës". Pas kësaj, lavdia dhe shkëlqimi u nda midis çdo shtëpiaku, sado pa emër të ketë qenë, duke marrë emrin Norman, vetëm pse ishte bashkuar me Uilliamin Norman.

Pushtimet më shumë bëheshin me ushtri të formuara prej ushtarësh dhe kryheshin, kryesisht, nga deti. Në përgjithësi, pushtimet e bëra vetëm prej ushtrive linin pasoja më të qëndrueshme se ato ku një vend dhe një popull pushtonte një vend dhe një popull tjetër. Kishte një prirje që ushtarët pushtues të shoqëroheshin prej familjeve të tyre në vendet që pushtonin, në mënyrë që të mos përziheshin me

vendasit e pushtuar për të ruajtur racën e tyre të veçantë. Ndërsa, kur kjo bëhej vetëm me ushtri, ata krijonin lidhje me të pushtuarit dhe që këtej rridhte njësimi i tyre me këta të fundit. Megjithatë, pas pushtimeve barbare nuk ekzistonte më një racë e tillë e papërzier. Ajo nuk ekziston as sot. Pastërtia racore tashmë është vetëm një trill i përfytyrimeve njerëzore.

## PROVA E GJUHËVE

Ne kemi parë se si nga përzierja e përgjithshme e njerëzimit në Europë të gjitha veçoritë racore qenë përzier, ngatërruar ose edhe shuajtur fare. Prandaj nuk ka prova fizike ose kombinim provash të tilla që të zbatohen, ndaj, për rrjedhojë, në sytë e studiuesve modernë, "gjuha" formon bazën e dallimit etnik.

Prapëseprapë, gjuha nuk është një udhërrëfyes i pagabueshëm. Disa herë ajo duket e papranueshme dhe, ndoshta, çorientuese. Shpesh herë ajo paraqet vështirësi dhe duket se arrin në përfundime të kundërshtueshme. E, megjithatë, nuk ka mjet tjetër që t'i kundërvihet asaj në përpikërinë e vet. Sado që duket se edhe ajo nuk na kënaq plotësisht, gjuha përsëri mbetet më e sakta nga tërë provat që kemi deri sot.

Po të nisemi nga faktet, nuk kemi ndonjë tjetër përveç atij gjuhësor. Fjalori i ri ndërkombëtar Uebster ka të drejtë kur e shpjegon fjalën "sllav" si vijon: "person i cili flet sllavishten si gjuhë të nënës". Enciklopedia Britanike ka të drejtë kur përcakton: "…gjykuar prej provës gjuhësore, pasi asnjë tjetër nuk është e përdorshme". Libri vjetor më autoritar për emrat e udhëheqësve përkufizon drejt në sistemin e tij të pandryshueshëm të përcaktimit: "elementet etnike mbi bazën e gjuhëve".

Në fillimet e historisë biblike, ishte gjuha ajo që u bë shkak që njerëzit e Gileadit[30] të zbulonin fisin e Efraimit[31] në shtegkalimin e

[30] *Gilead* (nga Bibla), që do të thotë i dhëmbëzuar, ishte një rajon malor në lindje të Lumit Jordan që shtrihej afërsisht nga fundi jugor i Detit të Galileut deri në fundin verior të Detit të Vdekur me Lumin Jabok që, thuajse, shënon pikën e tij mesore. Ai njihet si "mali" ose "kodra" "vendi i Gileadit", por quhet po ashtu edhe "toka e Gileadit" ose thjesht "Gilead".
[31] *Ephraim* (nga bibla) ishte i biri i Josefit dhe Asenathit dhe vëllai më i vogël i Manassehut. Sipas Biblës kur Jozefi i solli dy djemtë te babai i tij Jakobi, për t'i pagëzuar, Ephraimi mori të drejtën e pagëzimit pas lindjes në vend të Manasseut. Sipas kësaj, djalit që lind i pari, i takojnë privilegjet e veçanta, të cilat burojnë nga e drejta e paraardhësit.

Jordanit. Kjo ndodhi kur një prej eufraimëve që kishin shpëtuar tha: "Më lër të kaloj!" Menjëherë njeriu nga Gileadi ia ktheu, "A jeni ju efraimë?" dhe kur ai tha, "Jo"; ata i kërkuan të thoshte: "Thoni Shiboleth[3]", dhe ai tha, "Siboleth", pasi nuk mundi ta shqiptonte si duhet. Kjo bëri që ata ta merrnin dhe ta vrisnin.

Ka pasur një gjuhë racore të përbashkët përkundër dallimeve që viheshin re midis keltëve, teutonëve dhe sllavëve. Ishte një lidhje kryesore, që i mbante afër njera-tjetrës disa prej këtyre racave. Megjithatë, dihet shprehja: "E folura bën që të zbulohesh se nga çfarë fisi je."

Megjithatë, nganjëherë, kur njeriu dëgjon një prusian-balto-sllav tek e flet gjermanishten si gjuhë të nënës, ose një irlandez-kelt tek e flet anglishten, prova e gjuhës duket që ngec në mënyrë qesharake. Gjithësesi, të tilla dukuri nuk i zbehin mundësitë e mëdha që na jep gjuha në përcaktimin e racave njerëzore.

## NJË INTERES I RRALLË DHE JETËSOR PËR RACAT E EUROPËS

Racat e Europës janë sot të rrethuara nga një interes aq i madh sa kurrë më parë. U deshën katër vite të mundimshme përpjekjesh, duke qëndruar në mesin e këtyre popujve, nga njëri te tjeri, që çdo gjë të bëhej me imtësi. Popuj pak të njohur janë nxjerrë në pah, ndërkohë që popujve më të njohur u është dhënë rëndësia që meritojnë.

Racat e Europës janë tani në trazira më pak të dukshme se më parë, por më të thella dhe po aq intensive sa ç'ishin kur u shkundën prej furisë hune pesëmbëdhjetë shekuj më parë. Rendi i Vjetër ka vdekur bashkë me milionat e njerëzve që nuk janë më. Një Europë e Re është në bërje e sipër. Nuk do të mjaftojë as një vit, as një brez për ta arritur këtë. Asnjë prej atyre që jetojnë sot nuk do të ketë mundësinë ta shohë kur ajo të jetë bërë. Konferenca e Paqes do të marrë vendimet e saj të rëndësishme dhe anëtarët e saj do të shpërndahen tej e tutje, por racat do të mbeten në vendin e tyre, aty ku mbi to do të zhvillohet Europa e re.

> Europa, edhe pse më e vjetra, në pjesën më të madhe është e re dhe papërvojë në vetëqeverisje, në detyrimet politike dhe në mundësitë që i janë dhënë. Ecja e më shumë se një populli me të drejta të plota votimi, do t'i ngjajë ecjes së pasigurtë të një fëmije të sapozgjuar. Nuk ka mrekulli nëse liria e tij duket si e përfituar me lejen e dikujt, ndërsa ai vetë e përdor lirinë e fituar për të shkelur lirinë e tjetrit. Përparimi i kombeve më të zhvilluara për të ardhur deri te lartësitë e tanishme nuk është bërë i pashoqëruar me gabime dhe dështime. Solidariteti moral i njerëzimit është bërë më në fund manifest i një demonstrimi pa precedent në histori. Zemra e botës mund të jetë shkulur kur ka parë sakrificat e bëra prej francezëve, belgëve ose serbëve, por është ndërgjegjja e botës, ajo që përcakton pozitën që zë çdo popull, të cilit i është dhënë mundësia të shprehet i lirë, me përjashtim të katër kombeve, lakmia dhe makutëria e të cilëve ka zhdukur çdo ndjenjë turpi dhe mëshire. Të katra këto, përgjegjëse për krimet e patregueshme të luftës së fundit, nuk kanë as aleat, as dikë tjetër si vetja e tyre në këtë botë.

Europa e re do të ndërtohet mbi një themel të gurtë më të qëndrueshëm se ajo e vjetra. Forca dhe vetëm forca ka qenë kryefjala e Europës së Vjetër. Europa e Re duhet të qëndrojë mbi një shkëmb të fortë, mbi të vërtetën madhështore të shpallur prej Mirabeaut[33], "E drejta është sundimtari i botës".

Për ta gjetur këtë të drejtë aleatët e Antantës kanë shpenzuar me bujari pasurinë e tyre, të vënë me përpjekje e mundime të mëdha, si dhe gjakun e paçmuar të miliona bijve e bijave të tyre. E meqë fitoren e arritën me forcën absolute të armëve, përgjegjësia e tyre përpara njerëzimit futet në një fazë të dytë: të mbrojë atë që është arritur nga një armik ende i papenduar, i fortë dhe dinak.

---

[33] *Mirabeau* u lind në Xhorxhia në vitin 1798. Ai shkoi në Teksas në vitin 1835. Aty u fut vullnetarisht në ushtrinë e Teksasit. Pas një shërbimi të suksesshëm arriti të bëhej gjeneral. Kur Teksasi fitoi pavarësinë, ai u zgjodh nënpresident dhe më pas president. Vdiq më 1859.

Në parime, qëllime dhe ide, të gjithë aleatët janë një. E megjithatë, për shkak të fuqisë së tyre, përgjegjësia më e madhe bie mbi britanikët, francezët, italianët dhe amerikanët.

Ka shumë sfida politike që ende presin, që rrinë mënjanë, shumë trazira, ndoshta shumë gjakderdhje të tjera na presin para se të vijmë tek e drejta e plotë e shprehjes së lirë të vullnetit politik me anë të votës, të votës së lirë, e cila është e vetmja mënyrë për të gëzuar drejtësi, rend dhe liri. Por në këtë rrugë të gjatë duhet që të gjithë të vendosin besimin dhe simpatinë në të, nga më i padituri deri te më i afti i kësaj bote.

## SHPJEGIMI I HARTËS SË RACAVE

Harta jonë tregon në mënyrë grafike faktet dhe parimet në lidhje më shpërndarjen e popujve të Europës dhe me marrëdhëniet e tyre bazuar në kërkimet e bëra prej studiuesve Deniker[34], Hrdlica dhe shumë dijetarë të tjerë.

Kufijtë racorë kanë ndryshim prej kufijve politikë midis krahinave dhe shteteve. Këta të fundit janë të përcaktuar me saktësi, shpesh herë të hequr me vija matematike. Të parët janë përherë bishtnues dhe të papërcaktuar. Midis dy racave që gjenden pranë e pranë ka gjithmonë një zonë asnjanëse, e cila nuk i takon asnjërës palë dhe nuk është pasuri as e rajonit kufitar ku ato të dyja shkrihen me njëra-tjetrën dhe ndahen prej gardhesh të padukshme.

Për herë të parë në përvojën njerëzore po bëhen përpjekje prej fitimtarëve, pas një lufte të madhe, që të zbulojnë kufijtë e rinj në pajtim me synimet racore dhe me prirjet e popujve të interesuar. Për shkak të kësaj pamundësie për të përcaktuar kufij të saktë racorë, bëhet i pashmangshëm përvëlimi i shumë zemrave në rrugën e gjatë të vendosjes së kufijve të rinj të Europës.

Profesor Hrdlicka vlerëson se Europa ka rreth 145 deri në 150 milionë njerëz të shartesës sllave, 144 deri në 148 milionë të asaj teutone dhe 125 deri në 127 milionë të asaj greko-latine.

---

[34] *Joseph Deniker* (1852-1918), natyralist dhe antropolog francez i njohur në radhë të parë për përpjekjet e tij për të zhvilluar një hartë tejet të hollësishme të racave në Europë.

Përshkrimi ynë i racave të Europës fillon më në lindje. Në fillim do të marrim racat që një herë e një kohë njiheshin si perandoria e Gjerë Ruse, pastaj do të trajtojmë rumunët, racat e Gadishullit të Ballkanit, ato që një herë e një kohë shiheshin si perandoritë qendrore dhe kështu me radhë duke ndjekur Hartën e Racave deri sa të arrijmë tek ishujt Britanikë.

## RACAT E MBIZOTËRIMEVE RUSE

Të marrë së bashku, rusët, siç ishin në ditët e Pjetrit, janë një masë e pazhvilluar. A nuk ishte cari i ashpër, i cili kërkoi ta qytetëronte popullin e vet me kamzhik? A ishte kjo me të vërtetë në të mirë të tyre? Ky është një problem që mbetet për t'u parë. Të paktën kjo të jep të kuptosh se, kur nuk ndihet më një dorë autokratike, pjesët përbërëse të perandorisë, të cilat nuk i janë bashkëngjitur asaj natyrshëm, por me forcë, do të gjejnë mënyra për t'u mëvetësuar. Një pamje të tillë të përçarë e shohim sot. Pjesët që përbënin fillimin nuk janë më me njëra-tjetrën. Tani kemi Rusët e Mëdhenj dhe Rusët e Vegjël, Rusët e Bardhë dhe Kozakët, gjithë sllavët, ata që flasin disa forma të rusishtes, ata që e pranojnë si të tyren Kishën Ortodokse Lindore, por edhe ata që nuk e pranojnë atë. Por le të fillojmë me grupin e parë.

## RUSËT E MËDHENJ

Rusët kryesorë u shpërndanë me shpejtësi që nga Moska, si qendra e tyre historike. Lumi Moska i dha emrin jo vetëm kryeqytetit, i cili qëndron në brigjet e tij, por edhe Perandorisë Moskovite dhe Carëve të Moskovit. Në tërë Lindjen, rusi i thjeshtë thirret me emrin moskov. Shën Petërburgu ose Petrogradi, gjithmonë i huaj, nuk ngjall dashuri ose përkushtim. Që prej dy shekujsh është Moska që i shpërndan njerëzit e saj për t'i shtypur tartarët e Hordës së Artë[35]. Në

[35] *Golden Hord* – kështu quhej dega prej nga udhëheqësit tartarë ridhnin drejtpërsëdrejti nga familja e Xhengiz Khanit, por gjatë shekullit XIV ata u turqizuan dhe Golden Hord, në të vërtetë, u kthye në Perandorinë Turke. Khanati Kazan, si vijim i Golden Hord-it, u pushtua nga Ivani i Tmerrshëm në vitin 1552. Më pas rajoni u kthye në pjesë të Perandorisë Ruse. Megjithë përpjekjet e tyre për të hequr qafe zgjedhën ruse, ata nuk ia dolën dot asnjëherë.

vitin 1613 i shpartalloi polakët duke i dhënë atij kombi një lindje të re; Perandoria e Napoleonit ra në flakët e saj. Dhe ajo mbetet edhe sot e kësaj dite "Nëna e Shenjtë, Moskë".

Rusë të tjerë janë në rritje, të shtuar prej pushtimeve të kryera ose prej popujve të nënshtruar vullnetarisht. Rusët e mëdhenj janë rusët e vërtetë. Midis tyre gjenden tipat më të mirë të Kaukazit. Ata janë të zellshëm, pa ambicje, të ngathët, ëndërrues, të durueshëm, të përkushtuar, që nuk duan përgjegjësi, më shumë moskokëçarës se sa të shkujdesur, jo praktikë, paqësorë. I tyri është vetëm himni kombëtar, i cili është shenja e parë e lutjeve për paqe. Kur marrin urdhër, s'ka njerëz që t'i binden atij si ata. Nuk ka ushtarë më të guximshëm dhe më të durueshëm se ata.

Rusët e Mëdhenj janë njerëzit më të paqenë kur mbeten pa një qëllim të caktuar nxitës në jetë. Më parë ata kishin dy gjëra kryesore: Zotin dhe Carin. Cari tashmë është zhdukur dhe në paqartësitë që mbretërojnë tani, po të shpreheshim me një fjalë të urtë sllave "Qielli është larg". Kështu ata po rropaten që prej një kohe të gjatë në një baltovinë politike dhe fetare duke mos e ndier ende se kur do të prekin në tokë të fortë.

Duke u zgjeruar, më shumë falë lindshmërisë së lartë se sa luftërave, ata ia kanë dalë të zmbrapsin finlandezët, të cilët patën pushtuar më shumë se gjysmën e pllajës ruse, madje duke u shtrirë edhe më në veri. Si rezultat i kësaj, mënyra e të menduarit dhe temperamenti i tyre u ndikuan thellë për shkak të përzierjes së gjakut me finlandezët dhe në një shkallë më të vogël me tartarët. Trupat e tyre janë të formuar mirë dhe muskulozë, flokët dhe mjekrat të dendura dhe me kaçurrela, hunda e shprehur, sytë blu dhe të kafenjtë, çehrja e përskuqur.

Të tërë së bashku, ata numërojnë 80.000.000, një numër ky i mjaftueshëm për të përbërë një shtet të madh, në tërë atë hapësirë tokësore që prek Arktikun, pa një "dritare të hapur nga perëndimi". Ata ndoshta do të ishin të kënaqur sikur një varg shtetesh të mos krijonin një zonë ndërmjetëse nga Deti i Zi deri në Gjirin e Bothnies, duke e ndërprerë atë nga komunikimi i drejpërdrejtë me Europën. Tolstoi, Turgenievi, Dostojevski, Vereshagin qenë rusë të mëdhenj.

## UKRAINASIT

Rusët e Vegjël ose ukrainasit numërojnë rreth 30.000.000 banorë. Është territori i tyre ai që nderohet prej rusëve si më i shenjtëruari.

Olegu, vëllai dhe trashëgimtari i Varangian Ruricit e zhvendosi oborrin mbretëror nga Novgorodi i braktisur për në Kiev. Jeta e Mbretëreshës Ollga,[36] "Shenjtorja", shndërrimi më pas në të krishterë i Mbretit Shën Vladimir dhe i popullit Rus në Kherson[37] dhe e tërë historia heroike e Kishës Ruse, qenë farkëtuar në Ukrainë.

Afërsia me tartarët dhe me turqit, si dhe lidhjet e tyre të gjakut i kanë bërë rusët e vegjël më luftarakë se vëllezërit e tyre të veriut. Ata janë më të vegjël, me shtat më të shkurtër dhe më pak të fuqishëm. Fytyrat e tyre kanë më shumë shprehje. Ata janë më të ngadalshëm, më shpërthyes dhe më imagjinues, e duan muzikën dhe janë shumë të lidhur me familjen dhe me shtëpinë. Gogoli[38] i lindur në Poltava jep shumë pamje tërheqëse të rusëve të vegjël.

Rusët e vegjël ose ukrainasit numërojnë rreth 30.000.000 banorë të cilët, jetojnë, kryesisht, në rajonet e mbizotëruara sllave.

Vendi i tyre qe pushtuar dhe qe aneksuar në vitin 1320 nga polakët, të cilët e quajtën Ukrainën "prita" mbrojtëse kundër tartarëve. Pjesa lindore e Dnieprit iu kthye Rusisë në vitin 1686, ndërsa ajo perëndimore, në vitin 1793.

---

[36] *Mbretëresha Ollga* – Dukesha e Madhe Ollga Konstantinovna e Rusisë (1851 – 1926) ishte mbretëresha mikeshë e Mbretit Xhorxhi i Parë i Greqisë. Stërmbesë e Carit Nikolla i Parë i Rusisë dhe kushërirë e Carit Nikolla II, Ollga ishte e bija e Dukës së Madh Konstandin Nikolajeviç Romanov dhe Aleksandra Iosifovna, kjo e fundit bijë e Dukës së Sakse – Altenberg. Ajo e takoi mbretin e ri gjatë udhëtimit të tij në Rusi për t'u takuar me motrën e tij Dagmar, gruaja daneze e Carit Aleksandër III. Ata ranë në dashuri dhe u martuan në vitin 1867 kur ajo ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe.

[37] *Kherson* është një qytet port në Ukrainë, një port lumi dhe port detar që e bën atë të lidhet me 42 vende të botës.

[38] *Gogol*, shkrimtar i madh rus i njohur veçanërisht për veprën e tij "Shpirtra të vdekur".

Dy shembuj piktoreskë të gruas ukrahinase

Rusët e Vegjël ose ukrainasit

## RUSËT E BARDHË

Emri Rus i Bardhë rrjedh ose nga fytyrat e zbehta të tyre, ose prej rrobave të bardha që veshin zakonisht. Ata numërojnë jo më shumë se 5.000.000 dhe gjenden, përgjithësisht, në fqinjësi me lituanezët. Ata nuk janë trupa të fortë ose të fuqishëm, rrallë e lodhin veten më tepër se ç'duhet dhe janë, në përgjithësi, të varfër. Nuk kanë qytete, me zor

u gjenden fshatrat dhe jetojnë nëpër pyje. Ata kanë qenë përherë të shtypur. Dialekti i tyre dallohet shumë nga ai i Rusisë së Madhe dhe të asaj të Vogël.

## KOZAKËT GJAKNXEHTË E BESNIKË

Ukraina jugore është një stepë "e egër" dhe "e paanë". "Vendi i shkretë" i romancës misterioze të Sienkieviçit[39] "Me Zjarr e Hekur". Kur Ukraina ishte territor polak, u mblodhën mijëra skllevër dhe keqbërës të shpëtuar, të cilët dalngadalë u ndanë në grupe. Qendrat e tyre ishin pikërisht poshtë ujëvarave të Dnieprit. Ata morën emrin "Kazaki" nga një fjalë tartare që do të thotë *piratë ose aventurierë*.

Të nxjerrë jashtë ligjit prej fisnikërisë katolike romake polake, ata shpesh u bashkuan me tartarët e Krimesë dhe më vonë me rusët ortodoksë lindorë, siç ishin edhe vetë. Ata ishin zotërit e vërtetë të Ukrainës, të cilët udhëheqësi i tyre kozak Cmielnicki i bëri që të kthehen përsëri në rusë. Një udhëheqës tjetër i tyre i pabesë, Mazepa i poemës së Bajronit, u përpoq më kot ta dorëzonte atë për te Karli XII në Poltava.

Përherë gjaknxehtë, por edhe besnikë deri në vdekje ndaj Carit, ata emigruan për në Krime dhe pastaj edhe më në lindje. U bënë "Mbrojtësit e Kufijve". Tani përbëhen prej dhjetë grupesh të veçanta prej të cilave kozakët e Donit, të Usurit, të Orenburgut dhe të Atrakhanit janë më të rëndësishmit. Mosbindja ndaj ligjit tani ka rënë tek ata, por jo edhe instinktet luftarake të besnikërisë së tyre.

Perandoria e rënë nga fuqia nuk ka më ushtarë besnikë përveç 320.000 kalorësve kazakë.

Në kohë paqeje ata janë fermerë, blegtorë, mbarështues kuajsh, peshkatarë, bletërritës, kultivues verërash. Midis tyre arsimimi popullor qëndron në një plan më të lartë se kudo tjetër në Rusi. Kanë relativisht

---

[39] *Sienkievicz* (poet ukrainas) Sienkievicz, Henryk (1846-1916), romancier dhe tregimtar polak.Vepra e tij më e njohur historike është *Quo Vadis?* (1896) në lidhje me krishtërimin e kohës së Neronit. Ai mbuloi me lavdi luftën e polakëve për ekzistencë kombëtare në trilogjinë popullore "*Me zjarr e hekur"* (1883, 1890), "*Përmbytja"* (1886, 1891) etj. Në vitin 1905 mori çmimin Nobel në letërsi.

më shumë shkolla dhe më shumë fëmijë në to. Të zellshëm, nikoqirë, shtëpiakë, ata nuk i meritojnë fjalët që thonë europianët për ta, përveç kur është fjala për origjinën e tyre.

## RACAT E RAJONIT TË BALLTIKUT

Po t'i hedhim një sy hartës, do të shohim se lindja e Balltikut, midis Gjirit të Finlandës dhe Lumit Niemen, një territor prej rreth njëqindmijë kilometrash katrorë, është i banuar, kryesisht, prej estonezëve, letonezëve ose lituanezëve. Ky territor formon një njësi gjeografike natyrore. Studimi i Balltikut lindor dhe i pjesëve të afërta jugore të Gjirit të Finlandës, që zgjaten drejt Petrogradit dhe Rusisë së brendshme, është i një rëndësie të veçantë strategjike. Ndoshta asnjë pjesë tjetër e Europës veriore nuk ka parë luftime më të ashpra dhe nuk është larë më shumë në gjak se kjo pjesë. Kjo njësi gjeografike korrespondon kryesisht me krahinat e famshme balltike që përbënin Estoninë, Livoninë dhe Kourlandin e lashtë. Ajo formon një gjysmë qarku të thellë përreth qytetit Riga, e njohur si mbrojtësja dhe roja e saj.

Në përgjithësi vendi është i ulët dhe moçalor, i pikëzuar me një numër të pafund liqenesh dhe i mbuluar nga pyje të dendura kudo ku liqenet dhe moçalet lejojnë rritjen e drurëve. Drejt mesit të saj një pllajë e vogël mbresëlenëse shtrihet disa qindra metra, të cilën poetët vendas e quajnë "Zvicra Livoniane".

E tërë popullsia nuk është më shumë se 3.100.000 vetë, prej të cilëve 1.150.000 janë esthë ose estonezë, më të shumtë në veri, 1.500.000 letë ose lituanezë, në drejtim të jugut në Livoni dhe Kourtland; aty ka 200.000 gjermanë dhe 100.000 hebrenj. Rusët kurrë nuk kanë përbërë më shumë se 2 përqind të banorëve.

## ESTONEZËT

Esthët janë popull ugro-fin, njëherë e një kohë të ashpër dhe aventurierë, që e tmerronin Balltikun me piraterinë e tyre, duke i sulmuar vazhdimisht dhe vazhdimisht të sulmuar prej danezëve dhe suedezëve.

Nënshtrimi i tyre përfundimtar prej Vëllezërve të Shpatës dhe pranimi me forcë i krishterimit ua shtypi shpirtin dhe i shndërroi në skllevër të pronarëve gjermanë.

Estonezët ua kalojnë gjermanëve në krahinën e vjetër të Estonisë, njëzet e nëntë me një në numër, e prapëseprapë, nëntë të dhjetat e tokës mbeten pronë e gjermanëve. Në ish krahinën e Livonisë estonezët përbëjnë, afërsisht, gjysmën e popullsisë, ndërsa gjermanët përbëjnë një të nëntën. Aty toka është e ndarë në prona që kapin, mesatarisht një shtrirje që i kalon të dhjetë mijë akrat për njësi, por që asnjëra nuk është pronë as e lituanezëve as e estonezëve, por në mënyrë të pandryshueshme e gjermanëve. Qeveria ruse është përpjekur, kohë pas kohe, nëpërmjet ligjeve agrare, të lehtësojë kushtet e fshatarëve. Përpjekje të tilla kanë dështuar përpara qëndresës së vendosur të pronarëve të mëdhenj.

Estonezët janë kapur fort e në mënyrë të përkushtuar pas gjuhës së tyre kombëtare, e vetmja trashëgimi e së kaluarës. Ata i duan poezitë dhe këngët. Karakteristikat e tyre fizike janë si të finlandezëve: fytyrëshkurtër, të gjerë, qose; ballëngushtë, gojëvegjël, krahëgjatë, këmbëshkurtër.

Fotografi nga A.W.Kutler

Kjo është një pamje e haraçpaguesve të Danubit, një rrugë natyrore për çobanët që lëvizin nga Azia në Europë.

Lumenjtë e Europës kanë kushtëzuar dhe përcaktuar ecejaket e njerëzve, marshimet e ushtrive, kufijtë e shteteve. Ky barí hungarez ruan një tufë të çuditshme derrash mbi shpinën e të cilëve rritet një lloj leshi në vend të qimes së fortë.

Në ndryshime me varfërinë e skajshme, arsimimi është relativisht i përparuar. Përveç një numri të vogël prej katër përqind, pjesa tjetër e tyre janë Protestantë Luterianë.

Që prej zgjimit të përgjithshëm e të papritur në vitin 1918, estonezët ose "zotëruesit e tokave" kanë këmbëngulur në njohjen e tyre kombëtare. Por pronësia e tyre mbi tokën mbetet nevoja më e madhe.

## LETONEZËT

Letonezët janë njëri prej tri fiseve të afërta, që dallohen prej çdo fisi tjetër në Europë, të cilat, një herë e një kohë, jetonin krah për krah në brigjet lindore të Balltikut; shumë më tutje, në perëndim, gjënden borusët, që u kthyen në prusianë. Në drejtim të pjesës qendrore ndodhen lituanezët e vërtetë dhe shumë më në veri letonezët. Kaq shumë i ngjajnë këta dy të fundit njëri-tjetrit në pamjen fizike, në gjuhë, në punë dhe në jetë të vështirë, saqë të huajt i marrin shpesh për të njëjtë. Në regjistrimin e përgjithshëm nuk është vënë re ndonjë dallim midis tyre. Ata, megjithatë, janë popuj të ndarë edhe pse nuk është e lehtë, madje, edhe për vetë ata që të specifikojnë se ku qëndron ndryshimi midis tyre. Deri vonë ata kanë menduar pak për ndjenjën e tyre kombëtare. Rrethana të caktuara u mohojnë atyre një vend të gjerë në histori. Thuajse të tërë janë protestantë. Libri i parë i botuar në gjuhën letoneze ishte Pyetësori i Madh Luterian[40]. Por edhe ai nuk qe dhënë për botim deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë.

---

[40] *Katetizmi i madh i Luterit* – Katetizmat janë zakonisht të shkruara në formë pyetjesh dhe përgjigjesh. Thuajse aq të vjetra, sa edhe vetë krishterimi, ato përdoren, veçanërisht, si udhëzime për edukimin e fëmijëve. Katetizmi ishte popullor në Mesjetën e vonë dhe mori rëndësi më të madhe prej emfazave të Martin Luterit në edukimin fetar të fëmijëve. Libri i tij mbi katetizmin i botuar në vitin 1529 mbetet edhe sot një libër standard.

## LITUANEZËT

"Në sytë e etnologëve, lituanishtja është gjuha më e rëndësishme në Europë." Ajo është e afërt me degët perëndimore të sllavishtes, ngjan më shumë si latine se sa si kelte ose si gjermane dhe është më shumë sankrishte. Në gramatikën dhe në fjalorin e saj kanë depërtuar disa forma të sllavishtes dhe shumë fjalë sllave.

Të hutuar prej misterit të prejardhjes së lituanezëve dhe të gjuhës së tyre, studiuesit, kanë zbatuar për të dyja, si për popullin, ashtu edhe për gjuhën, shprehjen *balto-sllav*. Karakteri racor i banorëve të moçaleve dhe të pyjeve ka ndryshuar fare pak.

Në shekullin e trembëdhjetë zhvilluan një shtet të pavarur, i cili më në fund u shtri prej Balltikut deri në Detin e Zi. Ata vuajtën tmerrësisht nga veprimet e pamëshirshme të Vëllezërve të Shpatës[41] dhe të Kalorësve Teutonikë. Urdhri Teutonik[42] i Kalorësve Teutonikë të Spitalit të Shën Mërisë në Jeruzalem dhe Kalorësit, ose Vëllezërit e Shpatës, në fillim thjesht bamirës, qenë organizuar gjatë Kryqëzatave. Pasi u vendosën në Balltik dhe u kthyen në forcë ushtarake, ata përdorën zjarr dhe hekur që t'i kthenin në të krishterë banorët e egër vendas dhe i nënshtruan ata deri në skllavëri.

Lituanezët mbetën paganë deri sa Duka i tyre Jagellon[43], në vitin 1386, u martua me Mbretëreshën e bukur polake Jadvidja. Fill pas

[41] *Vëllezërit e Shpatës*, një urdhër ushtarak gjerman i themeluar në vitin 1202 prej peshkopit Albert të Livonisë, me qëllim që të pushtonte dhe të krishteronte tokat e Balltikut. Kalorësit ishin organizuar në të njëjtën mënyrë si edhe Kalorësit Teutonikë (*Teutonic Knights*). Ata vishnin një mantel të bardhë dhe mbanin kryq të kuq e shpatë. Pushtuan livët, estët dhe letët, territoret e të cilëve më vonë u njohën si Livonia dhe Courlandi dhe u bënë dominimet e urdhrit. Në vitin 1236 kalorësit u mposhtën keq prej lituanezëve në Siauliai; si rezultat ata u bashkuan në vitin 1237 me Urdhrin Teutonik, por vazhduan të ndërtonin shtete të ndara.

[42] *Urdhri Teutonik* u themelua në vitin 1190 gjatë rrethimit të Akres, kur një spital i vëllezërisë qe ndërtuar për t'u kujdesur për shumë kryqëzues gjermanë të sëmurë. Pas pushtimit të qytetit atyre iu dha një ndërtesë dhe në vitin 1198 u kthye në një urdhër – ushtarak të manastirit, model i pjesëtarëve të urdhrit, që mbronin të sëmurët e Shën Gjonit dhe juristët që jetonin nëpër tempuj. Ky urdhër pasqyronte rritjen e përfshirjes së dinastisë së Hohenstaufen në Tokën e Shenjtë.

[43] *Duka Olgierd Jagellon* (Lituani) u lind në vitin 1296. Ai e mori titullin Dukë i Madh i Lituanisë në vitin 1345.

martesës ai pranoi të pagëzohej dhe i urdhëroi tërë vartësit e tij të bindur të bënin të njëjtën gjë.

Që nga ajo kohë ata i provuan të tëra peripecitë së bashku. Më në fund, në vitin 1410, doli një komandant lituanez, me një ushtri, kryesisht lituaneze, që u shkaktoi një humbje të rëndë Kalorësve Teutonikë.

Varfëria dhe mjerimi nuk u janë ndarë atyre për shekuj të tërë. Edhe pse ata vetë janë shumë bujq, toka është, thuajse, e tëra në dorë të pronarëve polakë dhe gjermanë. Ligjet ruse mbi tokën, të cilat i japin pronësinë mbi tokën fshatarësisë, nuk zbatohen më për ta, por për estonezët dhe letët. Shumë lituanezë kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara, ku njihen si njerëz të thjeshtë, të ndershëm dhe të zellshëm. Me ca përjashtime ata janë protestantë luterianë. Ushtarë të shkëlqyer, ata luftuan trimërisht në nivele të ndryshme të ushtrisë ruse gjatë luftës së fundit. Rreth gjysma e 3.000.000 lituanezëve jetojnë jashtë vijave kufizuese të ish provincave balltike.

Lituanezët dhe letonezët e ndiejnë ngazëllimin e ndërgjegjes kombëtare. Ata duan të paraqiten përpara botës si kombe të pavarura. Nëse veprimet e ndërmarra për ta arritur këtë varen nga pronarët e huaj të tokës, forca dhe dinjiteti i të cilëve në këtë mënyrë do të rritej, apo nëse vetë populli do ta marrë këtë në dorë, kjo mbetet për t'u parë. Por një gjë është e sigurtë: deri sa kushtet bujqësore të ndryshojnë në mënyrë rrënjësore, qenia politike e shtetit, praktikisht, nuk duket të premtojë gjë as për lituanezët as për estimezët dhe as për letonezët.

## UGRO - FINËT

Njëmijë e pesëqind vjet më parë, ugro-finët pushtuan gjysmën e pjesës veriore të Rrafshnaltës Ruse. Fiset sllave, duke përparuar prej jugut, u pykëzuan duke u ndarë në grupe të ndryshme, disa për në lindje, por pjesa më e madhe drejt veripërendimit në drejtim të Gjirit të Bothnias. Numri i tyre është zvogëluar vazhdimisht në rrjedhën e përzierjes me sllavët.

Në lindje janë gjetur, tanimë, ngulimet e rralla të vogulsve,[44] të cilët flasin një dialekt të veçantë; të keremisianëve[45] në Vollgë, të tregtarëve mendjehollë permianë dhe më të rëndësishmëve mordvinianëve[46]. Identiteti i 4.000 samoyedëve,[47] të mbetur prej një populli që u përhap me shpejtësi dhe, po ashtu, u zhduk me shpejtësi, është diçka që ende nuk dihet.

Në perëndim estonezët e Estonisë, khoudet rreth Novgoradit dhe kareliansët[48] në veri dhe në jug të Petrogradit, historikisht, paraqesin një interes të madh.

## FINLANDEZËT

Populli më i madh në numër dhe më i qytetëruar i finlandezo-ugrianësve, duke mos llogaritur finlandezo-ugrianët magjarë, janë ata të cilët e quajnë veten e tyre suomi,[49] por Europa i njeh me emrin e përgjithshëm: Finlandezë.

Vendi i tyre, Finlanda, ka një sipërfaqe prej rreth 205.000 kilometrash katrorë, ishuj dhe liqen të mëdhenj, të vendosur midis Gjirit të Finlandës dhe Bothnias dhe gjendet midis 60° dhe 70° në

---

[44] *Voguls-Mansi* – janë grup etnik i rrezikshëm që jeton në Khantia – Mansia, një rajon autonom brenda Federatës Ruse, së bashku me khantët. Në Khantia-Mansia, gjuhëve Khanti dhe Mansi u është dhënë i njëjti status zyrtar me atë të gjuhës ruse. Gjuha e tyre i takon familjes së gjuhëve fino-ugrike.

[45] *Cheremissians*, votiakët janë një fis prej afro një çerek milioni njerëzish që banojnë, kryesisht, në pjesën juglindore të Viatkës. Gjuha e tyre tregon se ata janë cheremissians ose tcheremissians ose cheremis, të cilët e quajnë vetveten Man, banorë të brigjeve të Vollgës më shumë fqinjë me Kazanin. Ata janë të butë dhe të ndershëm, por nuk janë as aktivë e as të zgjuar.

[46] *Mordvinianët* ishin një fis fino-ugrik që jetonte në territorin midis lumenjve Oka dhe Klayma. Emri mund të jetë i lidhur me fjalën *mesh,* që do të thotë "bletë" në gjuhën moksha.

[47] *Samoyedët* ose njerëzit *Nenets* janë popuj vendas në Rusi. Sipas regjistrimeve të fundit të vitit 2002, ekzistojnë 41.302 të tillë në Federatën Ruse. Emri i tyre i vjetër është Khasova, Samoyeds, Yuraks, Yurak Samoyeds.

[48] *Karelians*, banorë vendas të Karelias, një rajon në lindje të Finlandës në pjesën kufitare me Rusinë.

[49] *Suomi* - Emri finlandez për Finlandën eshtë *Suomi*, ndërsa suedezët e quajnë *Finland*.

gjerësi veriore. Në shekullin e dymbëdhjetë ajo u pushtua dhe banorët vendas u shndërruan në të krishterë, kryesisht prej Peshkopit Henri, një njeri që merrej për anglez, i cili, pasi u vra në luftë, u kanonizua dhe u njoh si Shën Henri, duke u kthyer në shenjtorin mbrojtës të finlandezëve. Që atëherë e deri në vitin që kaloi atyre kurrë nuk iu është njohur pavarësia. E luftuar vazhdimisht si prej Suedisë, ashtu edhe prej Rusisë, ajo bashkë me Ishujt Alands u bë një Principatë e Madhe, gjysmë e pavarur, në fund të vitit 1809. Kundërshtimi kokëfortë i tyre ishte përherë pengesa kryesore për t'u shpëtuar përpjekjeve për rusifikim. Në dhjetor të viti 1917, Kuvendi i Finlandës e deklaroi vendin republikë të pavarur, e cila, si e tillë, ka gëzuar njohjen nga Rusia, Suedia, Norvegjia, Franca, Spanja, Danimarka dhe Gjermania.

Në përgjithësi, finlandezët janë të shkurtër, kanë fytyra të rrafshta, kokë rrumbullake, eshtrat e fytyrës të dala, sy jo fort të përqendruar, mjekrra të rralla, qime me ngjyra të ndryshme dhe çehre jo të qartë. Arsimimi është shumë i përparuar. Tre përqind e popullsisë janë të varfër.

Përveç 50.000 besimtarëve të Kishës Ortodokse të Lindjes dhe më pak se një mijë katolikë romakë, pjesa tjetër e 3.500.000 banorëve janë protestantë luterianë. Midis tyre 400.000 janë suedezë, të cilët predominojnë në vijën bregdetare. Helsingfors është një qytet suedez. Pa përfshirë magjarët, në Europë duhet të jenë 4.500.000 finlandezo-Ugrians.

## LAPËT

Lapët janë figura prekëse për të huajt. Ndonëse janë të afërt me finlandezët, ata dhe paraardhësit e tyre të lashtë, në bredhjet e tyre nuk kanë njohur kurrë ndonjë pjesë tjetër të botës me përjashtim të tundrës, të zhveshur, pa pemë e të shkretuar. Si rrjedhojë ata janë jo vetëm shkurtabiqë në trup, por edhe mendjeshkurtër.

Mesatarja e tyre trupore shkon vetëm deri në një metër e gjysmë lartësi. Fytyrat e tyre, edhe kur janë të rinj, janë të fishkura, duken të vjetër, të pazhvilluar dhe të deformuar. Nuk ka hije ngjyre në sytë dhe as në flokët e tyre, madje as në fytyrë dhe nuk ka ndonjë tipar që t'i dallojë, pasi format e tyre janë aq të morishme. Thuhet se ata janë njerëzit më kokërrumbullakë në Europë.

Disa pak prej tyre që jetojnë përgjatë lumenjve ose brigjeve të detit, janë peshkatarë ose mbarështues blegtorie, por më shumë ushqimi, zanati dhe mendimi i tyre varet nga drerët e veriut, të cilët duket se kanë ardhur në këtë botë për ta dhe këta për drerët. Në Norvegji ata janë 17.000, në Suedi 7.000 dhe në Rusi sa dyfishi i të dyjave. Numri i tyre po bie me shpejtësi, ndërsa ai pak qytetërim që ka arritur deri tek ata nuk është aq sa për t'u përmendur. Ata që jetojnë në Rusi llogariten të jenë ortodoksë të lindjes, ndërsa ata të Skandinavisë janë protestantë. Megjithatë, askush nuk e di se kur këta njerëz të fshehur i kanë braktisur besimin dhe praktikat pagane.

Fjala *lap* mendohet të jetë fjalë suedeze dhe do të thotë *magjistar*, por të tjerë mendojmë se ajo fjalë rrjedh nga finlandishtja, *lapa* që do të thotë "*njerëzit e fundit të tokës*". Të njohur prej kohësh si magjistarë dhe shtriganë, ata shfaqen në përrallat norvegjeze si njerëz të aftë në artin e zi.

Fotografi nga Borg Mesch
Lapët, njerëzit me kokët më të rrumbullakta në Europë

Për shekuj të tërë ata i kanë bërë shtëpitë në tundrat e shkreta pa asnjë pemë, përherë të ngrira të Norvegjisë, të Suedisë dhe të Rusisë. Si rezulat i kësaj, janë, përgjithësisht, shkurtabiqë dhe mendjeshkurtër. Mesatarja e tyre nuk e kalon një metër e gjysmë gjatësi, madje, edhe si fëmijë ata kanë forma të shëmtuara me fytyrë të fishkur, që me zor u dallohet mosha.

## NJERËZIT E KAUKAZIT

Njerëzit e Kaukazit paraqesin një objekt studimi sa të habitshëm, aq edhe magjepsës. Çdo përpjekje për t'i klasifikuar ose, madje, edhe për t'i diskutuar në një hapësirë të ngushtë, është e kotë. Shifra zyrtare që japin rusët, i vlerësojnë ata të jenë 5.000.000 arianë, 50.000 sirianoarabë, 1.900.000 uralo-altaikë dhe 2.500.000 "kaukazianë". Termi i fundit në këtë lidhje do të thotë i "papërshkrueshëm." Aty ka një shpërpjesëtim gjinor, që paraqitet me 91 gra për çdo 100 burra.

Duke u nisur nga maja e Malit Ebruz sipër një shkëmbi që është afro 900 metra më i lartë se Mount Blant, kemi, në veriperëndim 200.000 cirkasianët[50]. Ata kanë tipare fizike të shkëlqyera si burrat edhe të gratë, myslimanë pa ligje dhe pa gjuhë të shkruar, mikëpritës deri në pafundësi, njerëz që i nderojnë më të moshuarit, që nuk e njohin vjedhjen, por që te vjedhja zbulojnë turpin, ku pavarësia vetjake dhe ajo fisnore janë një pasion. Gratë vlerësohen vetëm kur shiten dhe blihen. Tregtia e skllaveve cirkasiane nuk përbën ndonjë ndjenjë turpi as për shitësit dhe as për blerësit e tyre, pasi ato që kur janë vajza, rriten me kujdesin për një vend në harem.

Në lindje 600.000 lesghianët,[51] banorët "më të hershëm" të Dagestanit[52] janë një përzierje fisesh me një numër të barabartë dialektesh, ushtrues të islamit, guximtarë deri në çmenduri, të durueshëm deri në mosdhënie, me shtat të fuqishëm, të çdo lloj ngjyre syri dhe floku, me larminë më të madhe të kafkës, këmbëngulës për

---

[50] *Circassians* – Termi *Circassians* është një term perëndimor që rrjedh prej turqishtes çerkez, dhe nuk është një vetemërtim i ndonjë populli. Disa herë ky emër është përdorur pa dallim për tërë popujt që jetojnë në veri të Kaukazit. Më shumë ai u referohet gjithë njerëzve të Kaukazit Veriperëndimor: adaygët, abkazët dhe ubykhët e humbur tashmë, deri te përfshirja e çeçenëve lindorë dhe e popujve të Dagestanit. Më qartë emri i referohet atij grupi popujsh që banonin me territoret e Ciracassias dhe ata që e quajnë veten *adyghes*.

[51] *Lesghianset (Dagestan)* të quajtur, gjithashtu, *lezgin, lezgi, lezgis, lezgs* dhe *lezgians* janë një grup etnik, i cili jeton, kryesisht, në jug të Dagestanit dhe në veri të Azerbajxhanit dhe që flasin gjuhën Lezgi. Termi ende godet një kordë në zemrat e shumë rusëve për famën e tyre në qëndresën ndaj pushtimit rus për më shumë se një gjysmë shekulli në shekullin XIX. Që prej vitit 1990 ata përpiqen të fitojnë pavarësinë e tyre.

[52] *Republika e Dagestanit* është një subjekt federal i Federatës Ruse (republikë). Dagestani është republika më e madhe e Rusisë në pjesën veriore të Kaukazit si në sipërfaqe, ashtu dhe në popullsi.

të drejtat, një popull i mishëruar në udhëheqësin e tyre Shamilin, i cili i bëri rezistencë Rusisë, që zgjati 25 vjet.

Në juglindje gjenden 270.000 çeçenë të egër dhe të paepur, me një paraqitje madhështore, bujarë dhe miqësorë, me një fe të një përzierje të veçantë midis islamit dhe krishterimit, një popull shumë i ngjashëm me cirkasianët.

Drejtpërdrejt në jug të Malit Elbruz, në shkrepat e të cilit qe lidhur Prometeu, jetojnë 1.350.000 gjeorgjianë, populli më interesant, i cili pretendon se rrjedh prej Togarmahut,[53] stërnipi i Noahut,[54] të shndërruar në të krishterë aty rreth vitit 330 nga një murgeshë e quajtur Nuna. Ata gjithmonë, pavarësisht nga pushtimet dhe përndjekja që kanë përjetuar, kanë mbetur të patundur në fenë e tyre. Në vitin 1799 ata dhe mbreti i tyre i fundit u bënë nështetas rusë si e vetmja mënyrë për të shpëtuar prej persianëve. Prejardhja dhe gjuha e tyre paraqesin probleme të pazgjidhura. Ndoshta ata nuk janë indoeuropianë, por me siguri nuk janë as uralo-altaikë. Fizikisht ata janë tipat më të pastër kaukazianë me gratë të shquara për bukurinë e tyre hijerëndë.

Në Gjeorgji gjendej Kolçisi pjellor, toka e Medeas dhe e bashkëleshit të artë, vendi i Jasonit[55] dhe Argos[56], të vlerësuara prej shumë etnologëve si vendi prej nga rrjedhin grekët.

---

[53] *Togermah* në Torah është i radhitur në listën gjeneologjike të kombeve si i biri i të quajturit Gomer dhe stërnip i Jafethit. Tradicionalisht ai përmendet si paraardhës i popujve turqishtfolës.

[54] Noah - *Noah* ose *Nóach* ("Prehje"). I biri i Lamehut dhe stërnip i Methuselahut ndërtoi një varkë për të mbrojtur familjen e tij dhe përzgjodhi disa lloje kafshësh nga përmbytja, reshjet e përgjithshme. Historia e jetës së tij është treguar në Dhjatën e Vjetër dhe në Kuran. Sipas asaj që mësojmë prej Dhjatës së Vjetër, ai jetoi pesëqind vjet. Ai dhe e shoqja bënë tre djem, Sem ose Shem, Ham dhe Japheth.

[55] *Jason* (Greqisht) është një hero i mitologjisë greke. Babai i tij ishte Aesoni mbreti i ligjshëm i Iolkusit. Emri i tij i vërtetë ishte Diomedes dhe ai e ndërroi atë duke u quajtur Jason (që do të thotë shërues ose doktor) pasi kishte studiuar efektin shërues të bimëve mjekësore nën drejtimin e centaurit Cheiron.

[56] *Argo* – në mitologjinë greke ishte anija, në të cilën Jason dhe argonautët lundruan nga Iolcus për të rigjetur lëkurën e dashit të artë. Argo ishte ndërtuar prej Argusit, i biri Friksusit dhe kishte marrë kështu emrin e ndërtuesit të vet. Argo dhe ekuipazhi i saj mbroheshin prej perëndeshës Hera.

## ARMENËT

Prania e armenëve në çdo vend, e vënë re që prej lashtësisë dhe e imponuar prej vuajtjeve, dikton përfshirjen e tyre midis racave të Europës. Ata i takojnë degës iraniane të familjes indoeuropiane.

Në hartë tani shquhet rajoni aziatik i banuar nga një numër më i madh armenësh; ajo të jep, gjithashtu, një ide të përgjithshme të gjendjes dhe shtrirjen e mbretërisë së saj të lashtë. Vetëm në një pjesë të vogël të rajonit tani armenët përbëjnë shumicën e popullsisë, e cila popullohet, në më të shumtën, nga turqit, kurdët, kaldeanët[57], persianët, sirianët dhe nga beduinët[58].

Ata pretendojnë se janë populli më i vjetër i botës. Emri i tyre kombëtar është Haig[59], nga *Haig*, stërgjyshi i tyre tradicional, një stërstërnip i Noahut. Vendi i tyre është dera e hapur dhe rrugëkalimi midis Lindjes dhe Perëndimit. Ai vend ka qenë shkelur prej asirianëve,[60]

---

[57] *Chaldeane-asyrians* (ose kaldo-asirianët) janë një popull semit që jetojnë sot në veri të Irakut në juglindje të Turqisë dhe në veriperëndim të Iranit. Historikisht ata gjenden të përqendruar rreth qytetit biblik Nineveh, i njohur sot me emrin Tel Kaif, afër Mosulit. Ata i paraprinë në kohë pushtimit islamik të rajonit, duke qenë pasardhës të banorëve të hershëm të Mesopotamisë, të njohur si Bet–Nahrain në gjuhën siriane. Ata flasin një gjuhë të njohur me emrin Suriak, e cila i ka rrënjët në aramaikishten e lashtë dhe përdorin alfabet sirian. Edhe sot më se 750.000 vetë e flasin atë gjuhë në Irak.

[58] *Beduine* – rrjedh prej arabishtes *badaëi* (një emër i përgjithshëm për një banor – shkretëtire, është një term përgjithësisht i përdorur për grupet arabe endacake, të cilat janë gjetur, thuajse, nëpër tërë brezin e shkretëtirës të shtrirë nga brigjet Sahariane të Atlantikut nëpërmjet Shkretëtirës Perëndimore, Sinai dhe Negev drejt brigjeve lindore të shkretëtirës arabike. Ajo është përdorur, rast pas rasti, edhe për t'iu referuar grupeve joarabe, veçanërisht atyre Beja të brigjeve afrikane të Detit të Kuq.

[59] *Haig – Patriark* ( Nga Bibla) Në fillim Patriarku ishte një njeri, i cili ushtronte autoritet autokratik si një *pater familias* mbi një familje të madhe. Një sistem i tillë i drejtimit të familjes prej burrave më të mëdhenj është quajtur partiarkat. Ky është një togfjalësh greke, i përbërë prej fjalëve (pater), që do të thotë baba dhe, (arkon), që do të thotë udhëheqës, krye-udhëheqës, mbret etj. Abrahamit, Isakut dhe Jakobit u referohen si tre patriarkët e judaizmit dhe periudha në të cilën jetonin, është quajtur Era e Patriarkatit.

[60] *Asirianët* – me emrin Assyria në kohët e historisë së hershme thirrej rajoni i Lumit Tigër i Epërm, që e kishte marrë emrin prej kryeqytetit të tij Ashur. Më vonë, si komb dhe perandorí ata përfshinë gjysmën veriore të Mesopotamisë, ndërsa gjysma jugore ishte Babilonia.

medesëve,[61] persianëve, grekëve, parthianëve,[62] romakëve, bizantinëve, mongolëve, saraçenëve, selxhukëve[63] dhe turqve osman secili sipas radhës, duke luftuar për ta zotëruar atë.

Në kohën e lindjes së Krishtit, Armenët ishin Parses,[64] adhurues të zjarrit, pasues të Zoroastrës,[65] por fill pas kryqëzimit një pjesë e tyre u bënë të krishterë. Predikimet e Shën Gregorit, të Përndritshmit, e bindën mbretin e tyre, Tiridates,[66] që bashkë me popullin e vet të pranonte pagëzimin dhe të shndërroheshin në të krishterë aty nga

---

[61] *Medesët* ishin populli iranian me origjinë indoeuropiane, që jetonin në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Iranit të sotëm. Që prej shekullit të gjashtë para erës së re (përpara pushtimit persian), Medea arriti të themelonte një perandori që shtrihej nga Arani (sot republika e Azerbajxhanit) deri në Azinë Qendrore dhe në Afganistan. Popullsia e sotme (kurdët, folësit e persishtes, azerët) e pjesës perëndimore të Pllajës Iraniane e quajnë veten pasardhës të medesëve të lashtë. Gjuha e tyre është, thuajse, e panjohur, por pa dyshim e njëjtë me atë të Avestanit dhe të Skythëve.

[62] *Parthians* – Perandoria Parthiane ishte forca mbizotëruese në pllajën iraniane, duke filluar nga fundi i shekullit të tretë para erës së re dhe, përveç disa ndërprerjeve të shkurtra në kohë, ajo gjithmonë e ka kontrolluar Mesopotaminë që prej vitit 190 para erës së re deri në vitin 224 të erës së re. Parthia ishte armiku kryesor i Perandorisë Romake në Lindje dhe ishte ajo që ia kufizoi Romës zgjerimin përtej Kapadokjas në Anadollin qendror.

[63] *Seljuks* – Selxhukët, në turqisht *Selçuk*; ishin një degë e Oghuz Turqve dhe një dinasti që pushtoi pjesë të Azisë Qendrore dhe të Lindjes së Mesme nga shekulli XI deri në shekullin XIV. Selxhukët emigruan nga provincat veriore iraniane në Azinë Qendrore për në brendësi të Iranit, i njohur më parë si Persia, duke luftuar dhe duke pushtuar rajone të ndryshme të Iranit në rrugën e tyre për në Transoksianë. Selxhuket e kthyer në persianë njihen si stërgjyshërit e turqve perëndimorë, banorët e sotëm të Turqisë, Turkmenistanit, Uzbekistanit.

[64] *Parsees* – një person nga Parsi (fjalë e mesme e fjalës persiane – fars) një rajon brenda kufijve gjeografikë të Iranit. Ai është, thuajse, i tëri atdheu i popullit *persian*. Fjala *Persia* vetë rrjedh prej fjalës *Persis*, forma greke e fjalës *Pars.*

[65] *Zoroaster - Zarathushtra* (*Zara¸uštra*), zakonisht e përdorur sipas variantit grek *Zoroaster*, ishte një profet iranian dhe themelues i Zoroastrianizmit, i cili u bë feja kombëtare e Perandorsë së Persisë nga koha e *Akaemenidaes* deri në mbylljen e periudhës së *Sassanidit*. Zoroaster ishte, ndoshta, i lindur në verilindje të Iranit, ndonëse thuhet se ai mund të ketë ardhur prej Balkit në kohët e sotme një vend në Afganistan.

[66] *Tiridates* - Mbreti i Armenisë (286-344), i njohur, gjithashtu, si Tiridatesi i Madh. Ai mbahet mend si mbret luftëtar me një fuqi fizike të jashtëzakonshme. Ishte aleat i Romës. Ai luftoi shumë kundër Persisë, duke rifituar kontroll mbi Mesopotaminë dhe Atrpatakan. Në fillim të sundimit të tij ai ishte një përndjekës i egër i të krishterëvë. Ai e arrestoi Shën Gregorin e Përndritshëm. Më pas urdhëroi vrasjen e murgeshave të virgjëra Gayane dhe Hripsime. Nga viti 300 ai u kthye nga përndjekës në mbrojtës të të krishterëve. Ai liroi Shën Gregorin, i cili më pas e pagëzoi atë. Në vitin 1301 tiridates e shpalli krishterimin se fenë e vetme në Armeni duke e kthyer atë vend në shtetin e parë të krishterë në botë.

fundi i shekullit të tretë, duke paradatuar kështu prej disa vitesh kthimin në fenë e Konstandinit. Që prej asaj kohe, armenët ishin kombi i parë që do ta pranonte krishterimin, mbreti i tyre u bë i pari mbret Sovran i Krishterë, ndërsa Kisha Gregoriane Armene mbeti Kisha më e vjetër kombëtare.

Në shekullin e katërt, Mesrob[67] shpiku ose përshtati nga greqishtja alfabetin armen, i cili është ende edhe sot në përdorim të përditshëm. Ai, gjithashtu, filloi përkthimin e Biblës që u përfundua në vitin 410. Karakteri fetar që nuk humbi kurrë është pasqyruar në letërsinë armene.

Që prej shekullit të gjashtë, armenët kurrë nuk kanë njohur pavarësi. Në kohë të ndryshme ata përjetuan periudha qetësie, por duke qenë qendër sulmi popujsh gjakatarë dhe grabitqarë dhe, të gjetur pa ndonjë mbrojtje ose siguri të çfarëdo lloji, pasuria dhe jetët e tyre në rrjedhat e njëmijë e katërqind vjetëve vazhduan të vareshin në një fije floku. Edhe përpara se të vinin turqit, nuk ka pasur ndonjë lloj mizërie të cilën ata të mos e kishin provuar.

Në mprehtësinë e mentalitetit dhe në mënyrën e jetesës ata ishin më lart se sundimtarët e tyre. Me një përkushtim që s'kishte as vend as kohë që t'ia kalonte, ata mbetën tërë jetën të palëkundur në fenë e tyre të krishterë në rrjedhën shekullore të therorizimit.

Ka pasur një emigracion të gjatë nga Armenia drejt Konstandinopojës dhe perëndimit dhe, së fundi, drejt Shteteve të Bashkuara. Nuk është i vogël numri i atyre që kanë grumbulluar pasuri të madhe si tregtarë dhe bankierë. Më shumë se një prej tyre kanë shërbyer si ministra të financave të sulltanit. Shumë prej tyre janë mjeshtër të artizanatit, arkitektë dhe inxhinierë shumë të zotë.

Një bashkësi armenësh dallohet menjëherë nga dashuria që shfaq për arsimin. Pranë çdo kishe armene gjendet një shkollë. Studenët armenë shquhen në matematikë.

Më të shumtët janë të zeshkët, me flokë të zeza e të dendura, me ballë hije rëndë, me hundë të plotë, me trajta të mbushura dhe muskuloze, por mes tyre gjenden edhe forma të pafund në larmi, në paraqitje dhe në tipare. Jo rrallë mund të shihet një grua armene me

---

[67] *Mesrob* – shpikësi i alfabetit armen.

qerpikë të lyer, me tipare të skalitura dhe me bukuri italiane si të Madonës; ose një burrë armenas i gjatë, i shkathët, i pashëm, me pjesë të rregullta përpjestimore të trupit, një model i gatshëm për një skulptor.

Në bisedë të zakonshme, gjuha armene duket, shpesh, si një kërrkëllinë. Ajo është e ashpër në dëgjim, por kur e dëgjon atë të shqiptuar prej një predikuesi gojtar siç është Peshkopi Nerses, ajo tingëllon madhështore dhe imponuese si furtuna midis shkrepave.

Masakrat e katër pesë viteve të fundit dhe dëbimi i qindra mijëra viktimave të pashpresa, të gjitha të bëra me miratimin e Berlinit, kanë qenë përvojat më të tmerrshme, madje, edhe për vetë jetën tragjike me të cilën janë mësuar armenët. Provat e pandëshkuara të mizërive të paraqitura në raportin e Komisionit Bryce[68] mbi teatrin e luftës, dhe dëshmia e Henri Morgenthaut, ish ambasador i SHBA-së në Armeni, përbëjnë një ndër aktakuzat më të rënda të bëra ndaj turqve të drejtuar prej prusianëve në historinë e njerëzimit.

## TURKO–TARTARËT

Turko-tartarët në Rusi numërojnë rreth 4.700.000 vetë, në një numër të madh të mbetur nga Perandoria e së Keqes e Hordhisë së Artë, që e mbajti Rusia të nënshtruar nga viti 1237 deri në vitin 1481 dhe prej Khanatit të Krimesë.

Tipi tartar i turkut osmanlli është modifikuar jashtëzakonisht shumë gjatë pesë shekujve të fundit, për shkak se haremet e tyre kanë qenë mbushur me gra nga çdo vend. Prania e të krishterëve dhe e hebrenjve aty e kanë ndryshuar së tepërmi gjakun e turqve.

Bakshirët trokë, kara-kirgizët hundëçipë dhe kirgiz-kazakët, klamukët veshllapushë, kiphakët e Kazanit si, edhe më aktivët, nogais,[69]

[68] *Bryce Commission*. Vlerësimi për armenët e vrarë midis viteve 1914–1923 gjatë asaj periudhe të njohur si genocidi armen dhe që shoqëroi pavarësinë e Turqisë, është një subjekt kontradiktor. Mendohet se gjatë kësaj masakre humbën jetën 600.000 vetë sipas historianëve turq, ndërsa 1.2 deri në 1.5 milionë sipas komunitetit ndërkombëtar. Komisioni Bryce ka dhënë një vlerësim për këtë.

[69] *Nogais* – *Nogai* e shqiptuar gjithashtu *Nogay, Noghai* dhe shpesh të quajtur mongolët kaukazianë (duke iu referuar pozitës gjeografike në malet e Kaukazit dhe jo përkatësisë etnike të tyre) janë popull turk dhe një grup etnik i rëndësishëm në rajonin e Dagestanit, të cilët flasin gjuhën nogale turke. Ata janë të lidhur me tatarët e Krimesë.

janë mposhtur dhe zbutur. Një pjesë janë myslimanë, disa budistë, disa adhurojnë shejtanin, disa janë shtegtarë, disa të palëvizshëm. Interesi që ngjallin ata më shumë ka të bëjë me antropologjinë. Për etnologët ata janë njerëz që na kujtojnë një të kaluar të pamëshirshme.

Turq që flasin për tregti, fe dhe politikë në rrethinat e Konstandinopojës

## RUMUNËT

Është një fakt i habitshëm që, ngjitur me Detin e Zi dhe në gojën e Danubit, të rrethuar prej hungarezëve të fuqishëm dhe popujve sllavë, të ndarë prej Italisë dhe madje prej të gjitha gjërave italiane, në një largësi prej më se 800 kilometrash dhe njëmijë e gjashtëqind vjetësh në kohë, ne gjejmë, në fjalët e Ubicinit:[70] "Një popull kompakt dhe të papërzier, tiparet e të cilit siç janë: gjuha, monumentet, kostumet dhe vetë emri, tregojnë prejardhjen e tij italiane."

Dy shprehje të një doracaku të mirënjohur përmbledhin lidhjet e Dacias së lashtë, Rumanisë moderne, me Romën: "Në vitin 107

[70] *Tomas Ubicini*, një misionar françeskan në Levant. I lindur në Novara, ai mori famën e mbrojtësit të konventës së françeskanëve në Jeruzalem; ishte njohës i hebraishtes, kaldeishtes, sirishtes, arabishtes dhe gjuhës koptike. Ka botuar libra në shumë gjuhë dhe ka dhënë mësime në shumë prej tyre. Fjalori i tij syro–arabo– latin u botua në vitin 636, disa vjet pas vdekjes së tij.

Dacia përbën një provincë." "Në vitin 274 Dacia u dorëzohet barbarëve."

E para na kujton vendbanimet e mijëra familjeve romake që flisnin gjuhën universale "*lingua rustica*" (gjuha fshatare e marrë prej ushtarëve romakë dhe ngritja e mirëqenies që shkaktoi ajo koloni romake e begatshme që do të quhej, "Dacia Felix"). E dyta na kujton braktisjen e Dakias tek ai zinxhir i pashkëputur i të këqiave dhe i fatkeqësive nga të cilat popujt nuk ishin çliruar deri në mesin e shekullit të kaluar.

Sido që të ketë ndodhur, e tillë ishte fuqia e gjuhës dhe e qytetërimit romak dhe e tillë ishte këmbëngulja e dakëve për të vijuar praninë e tyre deri tek rumunët.

Emri "Vllah", me të cilin ata janë njohur gjerësisht deri vonë jashtë vendit të tyre është përkthimi sllav i emrit "Rumun" emër të cilin fshatarët dakë e përdornin për veten e tyre që do të thotë, gjithashtu, *i fuqishëm, i fortë*. Bashkëpatriotët e tyre, të cilët popullojnë vargmalet e Pindit në Greqi janë quajtur përherë si Kutzo-Vlleh ose Lame-Vlleh.

E prapëseprapë, ndërsa rumunët janë latinë në gjithçka tjetër, gjeografia i shpërbleu ata që të ishin lajmëtarët e Kishës Ortodokse të Lindjes.

Krenaria për racën e tyre është një karakteristikë e rumunëve.

Gjashtëmbëdhjetë shekuj më parë rumunët themeluan koloninë e tyre të begatshme përtej Danubit, të njohur si "*Dacia Feliks*".

Më shumë se një herë, kur pushtuesit e mbanin vendin e tyre të nënshtruar për breza të tërë, populli gjeti strehë matanë Danubit ose nëpër male. Historiani i tyre Kogalnichamo konstaton: "Rumunët nuk do të merrnin gra të një kombi tjetër", dhe, me kënaqësi, citon Gibonin[71] të ketë thënë: "Vllehtë janë të rrethuar prej barbarëve, pa u përzier me ta."

Pas pushtimit të fundit tartar, në shekullin e trembëdhjetë, kur nomadët, të ngopur me masakra dhe me plaçka të vjedhura, qenë tërhequr në drejtim të lindjes, njerëzit dalngadalë u kthyen dhe u vendosën në krahinën e Vllahisë në Danub dhe në Moldavi midis Karpateve dhe Pruthit. Që të dyja këto vende qenë pushtuar prej turqve dyqind vjet më vonë. Qeveritarët turq, të njohur me emrin gospodar, i shfrytëzuan krahinat tyre.

Zgjimi intelektual kombëtar, që ndodhi njëqind vjet më parë, e përshpejtoi çlirimin e tyre. Europa u garantoi dy krahinave autonomi në vitin 1856. Tre vjet më vonë ata u bashkuan në atë që u quajt Prinicipata e Rumanisë. Emërtimi i Karolit, një princ Hohenzollern si sundimtar i ri qe miratuar me një votim popullor, ku morën pjesë 685.069 vetë, të cilët votuan "pro" dhe 224 "kundër". Zgjedhja e bërë ishte e kënaqshme. Princ deri në vitin 1881 dhe pastaj mbret deri më 1914, ai dhe mbretëresha, "Carmen Sylva[72]" e merituan dhe e gëzuan dashurinë e njerëzve të tyre. Mbretëresha e tashme Maria është një shkrimtare, patriote dhe e hijshme.

Në aleancë me Rusinë, Rumania mori pjesë fuqimisht në luftën Ruso-Turke të viteve 1877-8 për të cilën ajo qe ndëshkuar keq duke u

---

[71] *Eduard Gibbon* (1737–1794), historian anglez, autor i librit historik "Tatëpjeta dhe rënia e Perandorisë Romake". Në moshën 15 vjeçare shkoi në Oksford, por u detyrua të ikte për shkak të shndërrimit në katolicizmin romak. I ati e dërgoi në Lausanne (1753), ku u rikthye edhe një herë në protestanti. Ai është një ndër historianët më të famshëm të kohës së vet. Vepra e tij është një prej veprave të pakta historike të kohëve moderne, e cila mund të krahasohet me veprat klasike të Herodotit, Thykydides dhe Tacitus si në histori, ashtu edhe në letërsi.

detyruar që t'ia dorëzojë Besarabinë Rusisë në shkëmbim të një cope "tokë malore, moçalore dhe stepë shterpë" të quajtur Dobrudja. Një pjesë edhe më e madhe iu mor gjatë Luftës Ballkanike të vitit 1913.

Dobrudja, e vendosur midis Danubit të Ulët dhe Detit të Zi ka mundësi zhvillimi dhe rëndësi ushtarake. Turqit, tartarët dhe çerkezët janë të panumërt në popullsinë e saj të përzier.

Në Rumani gjendet një numër i madh të vendosurish hungarezë, gjermanë, bullgarë dhe serbë. E tërë popullsia është 7.508.000 banorë. Në krahinat ngjitur me të, si: Besarabia, Bukovina dhe Transilvania mbizotërojnë rumunët. Shumë të tjerë gjenden në vende, si: Bullgaria, Greqia, Hungaria dhe Serbia. Numri i tyre i përgjithshëm, brenda dhe jashtë mbretërisë, arrin përafërsisht tek 13.000.000.

Shtesa e popullsisë me meshkuj ndaj femrave është më e madhe në Rumani se sa në ndonjë vend tjetër të Europës, përveç Greqisë. Një tendencë e tillë vihet re te të gjithë greko-latinët.

Rumunët kanë një prirje të veçantë për të folur gjuhën frënge. Ata nuk ndihen aspak keq kur dëgjojnë se vendi i tyre thirret me emrin "*Franca Lindore*", ndërkohë që atyre vetë u pëlqen ta thërrasin kryeqytetin e tyre, Bukureshtin, "*Parisi i Lindjes*".

Rumania, ashtu si Belgjika, Mali i Zi dhe Serbia, ka pjesën e vet në tragjedinë që ndodhi në çastet e fundit të luftës. E rrethuar prej armiqsh, e mbetur veç siç ka qenë gjithmonë në luftë të pandrprerë, ajo vetëm sa i pa të shumëfishuara tmerret e humbjes duke iu nënshtruar për një farë kohe pushtuesve të vet.

## RACAT E GADISHULLIT TË BALLKANIT

Gadishulli i Ballkanit shtrihet në pjesën juglindore të Europës. Ai e merr emrin prej Maleve Ballkane që janë tipari më qendror dhe i veçantë i tij. Kufijtë e tij veriorë ndjekin rrugën natyrore përgjatë Lumit Danub prej nga mijërat e të shpëngulurve, kohë pas kohe, merrnin drejtimin drejt jugut të pasur me fusha të gjera pjellore. Drejt perëndimit dhe jugut përvijohen vargmalet që ofrojnë mundësi banimi ose strehë në pllajat e tyre të kufizuara duke birësuar bashkësi të tëra të veçanta.

Nuk ka vend tjetër në Europë me një sipërfaqe të njëjtë prej 185.000 milje katrorë i cili të na japë një shumëllojshmëri kaq të madhe sa në format natyrore, sa në burimet e jetesës, aq edhe në larminë e njerëzve që e popullojnë atë.

Banorët e gadishullit mund të bashkëjetojnë vetëm nëse ata i përkasin të njëjtit popull, që t'i frymëzojë në ndjenja të përbashkëta ose nëse janë të tërë nën një pushtet të plotfuqishëm, të cilin nuk e kundërshtojnë dot. Me aq sa na mëson historia, asnjëherë dhe në asnjë kohë nuk ka jetuar ndonjë popull i bashkuar me të. Rrallë dhe vetëm për një farë kohe një fuqi e tillë ka mundur t'i qeverisë ata.

Si përherë, Gadishulli i Ballkanit është një vorbull racash, popujsh, gjuhësh, fesh, dhe i të gjitha llojeve të ambicjeve dhe pasioneve që i përfytyron njeriu, duke u munduar me çdo mjet që të shkallmojnë njëri - tjetrin.

Gadishulli i Ballkanit përfshin turqit, shqiptarët, grekët, bullgarët, serbët dhe malazezët.

Fotografi nga Erdelyl

Në venat e saj rrjedh gjaku i shumë racave, të cilat janë përzier pas pushtimeve të njëpasnjëshme në Ballkan.

Kufijtë politikë të këtyre shteteve përkojnë, vetëm në mënyrë të turbullt, me kufijtë e racave dhe të gjuhëve. Në vend të kësaj, kudo ka një shtrirje të brezit kufitar mbi tokën e fqinjit, ku gjuhët shkelin mbi njëra-tjetrën, ku vendet që janë bashkëngjitur parashtrojnë kërkesa të tepruara territoriale, por, shpesh të drejta, dhe ku shumë prej banorëve vetë nuk e dinë mirë se kujt i takojnë nga ana racore ose kujt duhet t'i takojnë politikisht. Për rrjedhojë ndër vite është ndërmarrë një propagandë aktive dhe janë vënë në lojë shuma të mëdha parash, pikërisht, për t'u dhënë rrugë këtyre prirjeve.

Pas pushtimeve barbare nuk ekzistojnë më raca të papërziera. Veçanërisht kjo është e vërtetë në Gadishullin e Ballkanit, ku pastërtia racore është vetëm pjellë e fantazisë.

## TURQIT OSMANË

Nuk ka jetë të hershme të ndonjë populli tjetër lindor aq të mirënjohur sa ajo e turqve osmanë. Të udhëhequr nga Ertogrul, një prijës tartar, aty nga viti 1230 gati katërqind familje pagane shtegtare lakuan rrugën e tyre prej endacakësh drejt Azisë së Vogël. Me pushtimin e Xhingiz Khanit,[73] Azia e Vogël në atë kohë qe copëtuar në një numër të pafund shtetesh të vockla dhe krahina feudale, prej të cilave më i rëndësishmi ishte Sulltanati i Selxhukëve, i Ikonumit[74] ose i Rumit, sado që edhe ai vetë po jepte shpirt.

Shndërrimin vullnetar në islam dhe në aleancën besnike me Sulltan Ala-Eddin-in ata e panë si mjetin me të cilin do të rritnin, në mënyrë të rrufeshme, fuqinë dhe prestigjin e tyre. Renegatë myslimanë,

---

[73] Jenghiz Khan – Xhingiz Khan (1155-1227). I lindur si Tem-ûzhin, ai ishte një Khan i Madh dhe udhëheqës ushtarak, i cili bashkoi fiset mongole dhe themeloi Perandorinë Mongole (1206-1368). Eshtë vlerësuar si një prej udhëheqësve ushtarakë më të shkëlqyer në historinë e botës, por kujtohet edhe për trashëgiminë e tij të shkatërrimeve të bëra gjatë pushtimeve të tij.

[74] *Iconium - Konya* (gjithashtu *Koniah, Konieh, Konia* dhe *Qunia*) historikisht e njohur si *Iconium*, është një qytet në Turqi në pllajën qendrore të Anadollit. Ajo ka një popullsi prej 742.690 banorësh (në vitin 2000) dhe është kryeqytet i Vilajetit të Konjës. Konja është një qytet i lashtë i vizituar prej Shën Palit. Nga viti 1097 deri në vitin 1243 ishte kryeqytet i Selxhukëve.

të krishterë e hebrenj vërshuan për te tendat e tyre. Në vitin 1281, Osmani[75] ose Othmani, ia doli të bëhej udhëheqësi i tyre më i suksesshëm. Emri i tij që do të thotë "Kockëthyesi" ishte ogur i bardhë për pasuesit e tij të egër.

Me vdekjen e Ala-Eddinit, i fundit i Selxhukëve, mbretëria e tij u shpërbë. Osmani ia doli që t'i pushtonte që të gjitha copëzat e dala nga kjo shpërbërje dhe e shpalli veten "Padishahu Ali Osman", sundimtari i otomanëve. Që atëherë pasuesit e tij e quajtën veten otomanë, duke e konsideruar emrin "turk" një emër fyes, barbar, i vënë prej arabëve dhe europianëve në përgjithësi. Arabët, të cilët i përbuznin turqit, ia kishin vënë këtë emër me qëllim.

Shtrirja graduale e Perandorisë Osmane u bë falë sundimit të shtatë sulltanëve të parë, secili prej tyre vinte si i biri i sulltanit paraardhës, që të gjithë shkatërrimtarë të pamëshirshëm. I shtati, Muhameti i Dytë, "*Fatihu*", që do të thotë "*Pushtuesi*", e pushtoi Konstandinopojën në vitin 1453. Pushtimet e vazhdueshme të mëpastajme, që u shtrinë nga Persia deri në brigjet e Atlantikut dhe te Ngushtica e Bab-el-Mandebit e tmerruan Europën. Libri i lutjeve-angleze i atyre kohëve në "përmbledhjen e vet të së Premtes së Mirë", lutej kundër "turqve".

Edhe pas tërheqjes së vazhdueshme që bëri pas humbjes së pësuar në Vjenë prej polakut John Sobieski[76] në vitin 1683, perandoria e turqve osmanë prapëseprapë zinte në atë kohë një sipërfaqe më të madhe se Azia e Vogël.

Megjithëse nuk ekziston ndonjë evidencë e saktë, nën skeptrin e Sulltanit besohet të jenë jo më shumë se 20.000.000 njerëz, prej të cilëve rreth tre të pestat llogariten si turq osmanë. Numri i osmanëve të pastër, pjesëtar të grupit të familjes uralo-altaike, gjithsesi është i vogël.

---

[75] *Osman – Dinastia e Osmanllive* e sundoi Perandorinë Osmane nga viti 1281 deri në vitin 1923, duke filluar me Osmanin I (duke mos llogaritur babanë e tij Ertuìrul), ndonëse dinastia nuk ishte shpallur deri në vitin 1383 kur Murati I e shpalli veten sulltan. Përpara kësaj, ky fis/dinasti mund të ketë qenë njohur si Sõ"ût, por ishte riemëruar Osmanli në nderim të Osmanit.

[76] *John Sobieski* (1629-1696) ishte mbreti i Komunuelthit Polako-Lituanez nga viti 1674 deri në vitin 1696. Ai kishte fituar famë si komandant i shquar ushtarak në luftërat kundër Perandorisë Osmane, tartarëve, moskovit, kazakëve dhe Suedisë.

Haremi, i rimbushur vazhdimisht me gra të marra nga çdo komb dhe shtimi i pandeprerë i mohuesve të fesë së krishterë dhe asaj hebreje ua kanë ndryshuar gjakun dhe ua ka transformuar tipin e tyre tartar. Shumica e vezirëve të mëdhenj, e pashallarëve dhe e krerëve të marinës, gjatë pesëqind vjetëve të para të sundimit të tyre, qenë me prejardhje të krishterë ose hebreje.

Ata pak turq të pandryshyar, qofshin pashallarë ose fshatarë, sado me pamje madhështore dhe dinjitoze që të paraqiten, mbeten konservatorë dhe përbuzës ndaj çdo gjëje të huaj. "Turqit e rinj" i pëlqejnë zakonet europiane dhe bëjnë sikur i duan idetë europiane, por manifestojnë pak nga virtytet e perëndimit. Turku, kur fiton, është, në përgjithësi, i pamëshirshëm në ushtrimin e forcës siç është i mjerë dhe i padëmshëm kur mposhtet.

Administrata osmane është një administratë që gjithmonë konsumon dhe asnjëherë nuk prodhon, përkundrazi ajo është një pengesë ndaj përparimit. Qeveria, e cila mbështetet vetëm te forca, ka përdorur të gjitha mjetet, sado të pamëshirshme të jenë ato, për t'i zgjatur jetën vetes. Ajo nuk është stepur përpara asnjë lloj masakre ose zhdukjeje masive. Qindra vjet më parë ajo pranoi si ngjyrë të flamurit të vet gjakun, dhe titulli zyrtar për Sulltanin është "Hounkiar" ose Vrasës i Njerëzve.

## SHQIPTARËT

Shqiptarët zënë një territor në lindje të Adriatikut, që i korrespondon afërsisht Epirit të Lashtë dhe Ilirisë Jugore. Origjina dhe gjuha e tyre paraqet shumë vështirësi. Profesor Ripley beson se "ata i kanë rrënjët në vendin e tyre". Dr.Deniker[77] i quan ata "një racë e veçantë adriatikase ose dinarike". Është e pranueshme që t'i shohim ata si popullin më të vjetër të Europës juglindore, pasardhës të Pellazgëve.

---

[77] *Dr. Joseph Deniker* (1852 – 1918), natyralist francez dhe antropolog i njohur, kryesisht, për përpjekjet e tij për të paraqitur harta shumë të detajuara të racave të Europës. Ai studioi në institutin teknik të Shën Petërsburgut. Hartat e tij për Racat e Europës kanë qenë pika referimi për shumë studiues të kësaj fushe.

Gjuha e tyre mendohet të jetë e vetmja gjuhë që ka mbijetuar nga grupi i gjuhëve të lashta trako-ilire. Fjalori i gjuhës së tyre është i ngarkuar me shumë fjalë greke, latine, italiane, sllave dhe turke, por gramatika mbetet tërësisht e veçantë.

Shqiptarët shfaqin rezistencë të jashtëzakonshme në ruajtjen e racës së tyre. Bashkësitë shqiptare në Itali dhe në Siçili, të cilat datojnë të jenë aty që në shekullin e pesëmbëdhjetë, të përbërë prej një popullsie prej më se 200.000 frymësh, janë përzier fare pak me italianët dhe në një shkallë të lakmueshme vazhdojnë të ruajnë gjuhën dhe zakonet e tyre. Po kështu, por në një masë më të vogël, shfaqen 200.000 shqiptarët e tjerë që gjenden në Greqi.

Përçmimi ndaj të huajve dhe krenaria për lashtësinë e vet, ndonëse nuk e dinë aq mirë se kush janë të parët e tyre, i mbajnë ata të veçuar. Kjo krenari e thellë dhe jeta e tyre malore kanë edukuar tek ata një dashuri pasionante për pavarësinë. Grote[78] i përshkruan si të varfër, të etur, të egër dhe të frikshëm në betejë. Askund tjetër gruaja nuk është aq e sigurtë sa në malet e tyre të ashpra.

Të njohur prej të huajve si Albanian, njerëzit e tokës-dëborë, ata e quajnë veten shqiptarë, ose malësorë. Në vendin e tyre dhe jashtë tij numërojnë rreth 1.500.000. Midis fiseve të shumta të tyre, katolikët e Mirditës, të cilët nuk lënë këmbë myslimani të shkelë në rrethinën e tyre, janë më të rëndësishmit dhe më të fuqishmit.

Lumi i Shkumbinit përgjatë rrjedhës së të cilit ende mund të shkohet pas gjurmëve të Rrugës Romake Egnatia, e ndan Shqipërinë në dy pjesë, në drejtim të veriut, Gegët Katolikë Romakë; në drejtim të jugut Toskët e Kishës Ortodokse Greke. Të parët përdorin alfabet[79] latin, ndërsa të dytët atë grek. Ata nuk kanë alfabet të tyre, megjithëse janë bërë shumë përpjekje, disa prej të cilave shumë interesante, për ta mbushur këtë boshllëk. Të paktën gjysma e shqiptarëve janë myslimanë. Ky është rezultat i pushtimit, i cili i detyronte ose të hiqnin dorë nga krishtrimi, ose të emigronin.

---

[78] *George Grote* (1794 – 1871) ishte një historian klasik anglez.

[79] Këtu autori duket se është i panjohur me Kongresin e Manastirit, i cili unifikoi alfabetin shqip (shën. i përkth.).

Gjergj Kastrioti ose Skënderbeu, i cili i mundi turqit gjatë njëzet vjetëve, është heroi i tyre kombëtar. Marko Boçari, për të cilin shkruante natën në tendën e tij Fitz- Greene Halleck ishte, gjithashtu, shqiptar. I tillë ishte Muhamet Ali Pashai,[80] figura myslimane më e shquar e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Mjeshtëria europiane për të bërë shtete nuk e ka parë kurrë ndonjëherë veten në pozita më qesharake se kur e caktoi të ndruajturin Princ Vidi, në vitin 1913, si mbret të shqiptarëve.

Një vashë e maleve shqiptare

Gruaja shqiptare është më fatlume se sa shumë simotra të saj të Gadishullit të Ballkanit. Ajo është e nderuar dhe e respektuar prej trimave dhe askund tjetër në Europë nuk gjenden gra që udhëtojnë vetëm, me më pak rrezik se mos dikush u bie në qafë, se në atë të ashtuquajturin vend "pa ligje", Shqipëri.

[80] *Muhamet Ali* u lind në Kavalla në vitin 1769. Ai shkoi në Egjipt si oficer me trupat shqiptare, të cilat morën pjesë në fushatën ushtarake të organizuar nga anglezët dhe otomanët kundër pushtimit francez të Egjiptit. Arriti të bëhej sundimtar i Egjiptit në saj të trimërisë së tij dhe trupave shqiptare që i kishte me vete, duke themeluar monarkinë egjiptiane. Ai njihet si Babai i Egjiptit.

Trimi nga Shkodra

Shqiptari është një figurë piktoreske. Ai e quan veten "*Bir i shqipes së maleve*" dhe, ndonëse është i rrethuar prej armiqsh, ia ka dalë që, në një masë të habitshme, të ruajë nëpër shekuj paprekshmërinë e tij racore. Në veprimet e tij ai udhëhiqet prej një kodi fisnor tepër të rreptë.

## GREKËT

Një hartë e vendbanimeve greke, ashtu siç ekzistonte gjashtë shekuj para Krishtit, do të shërbente si një hartë për të treguar ku banojnë ata edhe sot. Kolonizatorët e tyre në jug të Francës dhe të Italisë janë kthyer në francezë dhe italianë. Kurse, Greqia e pesëqind vjetëve para Krishtit përkon me të sotmen.

Rrebeshet e pushtimeve kanë përmbytur edhe Greqinë - gotët, venedikasit, lombardët, francezët, gjermanët, otomanët, shqiptarët, vllehtë, shumë prej tyre kanë mbetur aty përgjithmonë. Konstandini

Porhyrogenitus[81] ka shkruar: Në shekullin e dhjetë, "tërë Grekët u bënë sllavë". Henri De Valencies në shekullin e trembëdhjetë mendonte se Greqia ishte bërë Franceze. Follmerayer[82] në shekullin e nëntëmbëdhjetë deklaronte se "Grekëve zor t'u ketë mbetur ndonjë pikë gjaku i vërtetë grek në damarët e tyre". Një popull i nënshtruar që kur u pushtua prej romakëve; tre shekuj bujkrobër të Europës Perëndimore, tre shekuj të tjerë skllavë të turqve, grekët kanë njohur liri vetëm pas atyre shtatë vjetëve të tmerrit që ne i njohim si "Revolucioni Grek" (1821-1828).

Prapëseprapë qytetërimi i tyre ia doli që të depërtonte në Perandorinë Romake të Lindjes duke i dhënë kështu, pas shtatë shekujsh, emrin Perandoria Greke ose Bizantine. Deri në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të gjithë të krishterët e nënshtruar prej turqve në gadishull njiheshin si grekë. Gjuha e tyre e pavdekshme u përdor në shërbesat e përditshme fetare në kishë, siç përdoret edhe sot, ndonëse në një formë të shtrembëruar dhe të korruptuar prej grekëve kudo që janë.

Edhe përkundër shpopullimit dhe thuajse përzierjes së elementëve të huaj, grekët mbetën të njëjtë në tiparet fizike, në mënyrën e jetesës, në punët që bëjnë, në karakteristikat vetjake dhe në shijet. Fytyra e grekut ende mban çehre ngjyrë ulliri, flokë të zinj dhe të dendur, sy të zinj e të shndritshëm, pamje të lehtë e të shkathët. Rrallë i takon njeriut që të shohë një grek me çehre të çelur dhe me flokë të rrallë.

Shtëpia e tij ende gjendet në det. Tregtia detare në Detin e Zi dhe në Mesdhe vazhdon të jetë në duart e tyre. Në vitin 1916, prej 2658

---

[81] *Konstandin Porhyregonitus - Constantine VII (905 – 959)* ishte i biri i Perandorit të Bizantit Leo VI dhe nip i Aleksandrit II, i famshëm për dy librat e tij përshkrues *De Administrando Impero* dhe *De Ceremoniis.*

[82] *Follmerayer - Jakob Philipp Fallmerayer* (1790 – 1861) ishte një udhëtar austriak dhe hulumtues i historisë, i njohur më së miri për mendimet e tij në lidhje me etnologjinë e grekëve modernë. Ai studioi gjuhët semitike, më pas greqishten moderne, persiane dhe atë turke. Kontributi i tij mbi historinë mesjetare të Greqisë është i një rëndësie të madhe dhe, megjithëse teoria e tij që grekët e sotëm janë ose me origjinë shqiptare ose sllave dhe vështirë se kanë ndonjë pikë gjaku grek në venat e tyre, nuk ka qenë pranuar në tërësinë e saj prej hulumtuesve të tjerë, ajo ka shërbyer për të modifikuar opinionet e ndryshme, madje edhe ato të kundërshtarëve të tij më të mëdhenj.

avulloreve që hynin në Pire, 2.494 prej tyre mbanin flamur grek. Anijet e vogla lundruese të një mesatareje prej 250 tonësh janë të panumërta gjatë tërë Levantit.

Fotografi nga Francis P.Farquhar

Një grup fshatarësh grekë në Rajonin e Parnasusit, pasardhës të atyre që dy mijë vjet më parë u bënë mbrojtës të artit, të kulturës dhe të shkencës botërore. Këta fshatarë, të pagdhendur në pamje, por miqësorë dhe mikpritës, trashëgojnë një të kaluar të lavdishme.

Greku është tregtar ambicioz me shpirt nismëtar, i kursyer dhe i zellshëm. Shumë prej bankave të Europës së Jugut janë greke. Si në kohët e lashta, ashtu edhe në ato moderne, argëtimi ose "puna kryesore" për të mbetet politika. E megjithatë, Greqia moderne nuk na ka dhënë qoftë edhe një burrë shteti të vetëm me përjashtim të Venizellosit. Edhe ai ishte nga Kreta.

Në këto çaste të fundit të luftës, popujt nuk mund të bëhen përgjegjës për të metat dhe gabimet e qeverive të tyre. Ata jetojnë nën një sistem mbretëror që u ka mbetur në dorë falë shtytjes së ushtruar nga ana e Fuqive të Mëdha pas atij revolucioni të suksesshëm të viti 1821-28 dhe në kundërshtim me dëshirat dhe instinktet e tyre. Që prej asaj kohe ata humbën një rast në luftën botërore për të dhënë

ndihmësen e vet për lirinë dhe humanizmin, aq sa edhe për veten e tyre – një rast që, si i tillë, ndoshta nuk u vjen në dorë kurrë më. Mbreti i tyre, një simpatizues i gjermanëve, që kur u shfronëzua, ia ka dalë që të bllokojë dëshirën kombëtare dhe të zhgënjejë gjithë aspiratat e tyre.

Si rrjedhojë e Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913, mbretërisë iu shtuan rreth 1.400.000 grekë ish të nënshtruar nga Turqia. Pak më vonë Kreta iu bashkua Greqisë. Tani popullsia e saj është 5.000.000 banorë. Numri i meshkujve ndaj femrave në Greqi është më i larti në Europë.

## BULLGARËT

Bullgarët kanë prejardhje finlandezo – ugriane. Ky emër rrjedh prej lumit Vollga, në të cilin mbretëria e hershme e Bullgarisë së madhe u rrit aty nga shekulli i pestë. Që nga Vollga, Khani i tyre udhëhoqi disa prej kalorësve të tij të egër në vitin 679. Ata e kaluan Danubin dhe i mposhtën sllavët në anën jugure të bregut të lumit. Të paktë në numër ata, gradualisht, u shkrinë me banorët sllavë. Kur në shekullin e nëntë ata u krishteruan prej misionarëve grekë, shenjtorëve Ciril dhe Metodius[93], përzierja e tyre u bë fakt i kryer.

Emri bullgar mbeti, por gjuha, institucionet, zakonet dhe vetë popullsia u kthye në sllave. Bullgarët me të drejtë njihen si sllavë. Ata e nënshtruan tërë pjesën veriore të gadishullit prej Detit të Zi deri në Adriatik. Më vonë mbretëria e tyre u nda në dy pjesë, që të dyja për t'u përmbysur më pas nga Perandorët e Bizantit. Një rebelim i suksesshëm u dha mundësinë që të themelonin një perandori më të madhe dhe më të fuqishme, në të cilën mbretëroi më së miri me mençuri Cari i tyre më i madh, Asen II.[84]

---

[83] *Cyril & Methodius* – dy vëllezër të lindur në rajonin sllav të rrethinës së Selanikut në Perandorinë Bizantine në shekullin IX, të cilët u bënë misionarë të krishterimit në Moravinë e Madhe. Në vitin 862, ata u ftuan nga princi Rastislav për të propaganduar krishterimin në gjuhën sllave në Moravinë e Madhe, gjë që e bënë deri sa vdiqën, Cyrili në Romë në vitin 869 dhe Methodius në Moravinë e Madhe në vitin 885. Për qëllimet e misonit të tyre ata shpikën Alfabetin Glagolitik për ta përdorur për dorëshkrimet sllave, përpara se sa të zhvillohej ciriliku, një alfabet që rrodhi nga ai glagolitik dhe nga ai grek që, me modofikime të vogla, është ende në përdorim në një numër gjuhësh sllave.

[84] *Cari Asen II* – Cari Ivan Asen II (*Ioan Asen II*) 1218-1241 Car i Bullgarisë, i biri e

Më tej pasoi rënia. Bullgarët i paguan haraç mbretit të serbëve, Dushanit. Turqit osmanë e detyruan mbretin e fundit të bullgarëve të bëhej vasal i sulltanit dhe t'ia dërgonte motrën e tij në harem. Që aty filluan pesë shekujt e një sundimi turk të papërshkrueshëm. Shumë bullgarë u kthyen në myslimanë, ata dhe pasardhësit e tyre do të njiheshin si pomakë. Shumë prej tyre u arratisën. Në vitet 1877-1878 gjatë Luftës Ruso-Turke, Rusia e çliroi Bullgarinë.

Ky shtet i çliruar u quajt Principata e Bullgarisë dhe përfshiu vetëm rajonin verior të gadishullit. Shtatë vjet më vonë, pas një revolucioni popullor, asaj iu shtua Provinca Lindore e Rumelisë, Jugu i Ballkanit. Me vendim të Fuqive të Mëdha, Bullgaria, ndonëse e çliruar, mbeti të paguante haraç ndaj sulltanit si shtet vasal i tij. Në vitin 1908 ajo u shpall shtet i pavarur dhe princi e shpalli vetveten "Car i të gjithë Bullgarëve".

Shumë bullgarë, grekë dhe serbë prapëseprapë mbetën nën zgjedhën turke. Për t'i çliruar fshatarët e tyre dhe vëllezërit e një feje, u bashkuan Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia, të cilat bënë një luftë të përbashkët të suksesshme kundër Turqve në vitin 1912. Për herë të parë katër shtetet e krishtera ballkanike vepruan së bashku.

Ai bashkim shtetesh nuk zgjati shumë. Secila palë paraqiti kërkesa të tepruara në lidhje me kombësinë e njerëzve që kishin çliruar. Në Maqedoni, mbretëronte një rrëmujë në përcaktimin e racave, prandaj pretendimet e tyre morën karakter të dhunshëm. Sundimi i gjatë turk ua kishte hequr ndjenjat kombëtare të sapoçliruarve. Shumë prej tyre nuk e dinin nëse ishin bullgarë, grekë apo serbë.

Në vitin 1913, papritur dhe pa paralajmëruar, Bullgaria sulmoi aleatët e saj Greqinë dhe Serbinë, por pësoi humbje të plotë. Në vitin 1915, tërësisht moskokëçarëse ndaj çështjeve botërore, ajo iu bashkua Fuqive Teutonike duke besuar se suksesi i tyre ishte i sigurtë dhe që

---

Asenit, themelues i Perandorisë së Dytë Bullgare. Nën sundimin e Asenit, perandoria do të bëhej forca sunduese në Ballkan. Pas vdekjes së të atit në vitin 1207, kushëriri i Ioanit, Borili, e uzurpoi fronin dhe e detyroi atë që të arratisej në principatën Ruse të Galich-Volinias. Me mbështetjen e tij Ioan Asen u kthye në Bullgari në vitin 1218, për të rrëzuar me sukses kushëririn e tij dhe të kurorëzohej si Car. Ai i shtoi perandorisë Epirin, Maqedoninë dhe më të shumtat toka të Shqipërisë dhe të Serbrisë. Pas Betejës së Klokotnicës, Bullgaria Mesjetare u bë vendi më i madh i Gadishullit të Ballkanit.

andej ajo do të përparonte në plotësimin e ëndërrave të veta. Në vitin 1918, duke e ndier humbjen e pashmangshme, ajo i braktisi aleatët e vet në fushëbetejë dhe bëri paqe.

Në ngjarjet e vajtueshme të gjashtë viteve të fundit, duhet bërë dallimi midis bullgarëve dhe princit të tyre të paskrupullt gjerman që njihej si cari i tyre. Populli i thjeshtë iu nënshtrua dhe e ndoqi pas atë, por as nuk ndërmorën as ndoshta nuk e dëshiruan politikën torturuese, të turpshme të sundmitarit të tyre. Në vitin 1917 bullgarët përbënin tre të katërtat e 5.518.000 banorëve të vendit, praktikisht të tëra bashkësitë e Kishës Ortodokse të Lindjes. Më shumë se 700.000 turq dhe pomakë po shkriheshin me shpejtësi.

Gjuha bullgare është vlerësuar si "më e lashta dhe më modernja gjuhë sllave." Gramatika tregon tendenca moderne, por themeli gjuhësor ka afërsi të madhe me dialektin më të vjetër të shkruar të sllavishtes, me atë të kishës.

Numri i lindjeve në vitin 1910 ishte dyzet e një për çdo njëmijë frymë. Në vitin 1911 epërsia e lindjeve mbi vdekjet ishte 18.35 për 100 vetë – një epërsi më e madhe se në çdo vend tjetër të Europës.

Bullgarët janë një popull i guximshëm, praktik dhe i zellshëm. Ndërkohë që nuk janë aq të gjallë ose emocional, bie në sy afeksioni i tyre prindëror. Materialistë më shumë se idealistë, ata gjithsesi e vlerësojnë arsimimin për vajzat e tyre, aq sa edhe për djemtë.

## SERBËT

Serbët në fillim shfaqen si një konfederatë e fiseve sllave, të cilët së bashku me sojin e vet, kroatët, popullonin shpatin verior të Karpateve. Në shekullin e shtatë këto të dyja, krah për krah, zunë tërë perëndimin dhe veriperëndimin e gadishullit. Të dyja e njohën Bizantin si kryezot të tyre.

Serbët u shpërndanë gjerë e gjatë mbi Serbinë e sotme, veriun e Shqipërisë, mbi Malin e Zi, Bosnjën, Hercegovinën dhe, ndoshta, edhe më lart në veri. Kroatët u shtrinë drejt veriperëndimit.

Të krishteruar më parë se sa ndonjë fis tjetër sllav, puna e solli që serbët të jetonin në lindje nën Kishën Ortodokse, ndërsa kroatët në perëndim nën Kishën Romake. Grindjet e brendshme e vonuan

zhvillimin e tyre. Duke qenë herë vasalë të Bullgarisë herë të Bizantit, ata nuk arritën të gëzonin pavarësi deri në shekullin e dymbëdhjetë.

Edhe pse Mbretëria Serbe zgjati më pak se treqind vjet, vetëm dy prej carëve të saj u bënë të famshëm, Car Dushani i Madh[85] dhe Llazari.[86]

I ndihmuar nga e shoqja, një grua e zonja bullgare, caresha Helenë, Dushani e bashkoi, thuajse tërë gadishullin, në një përpjekje për të shpartalluar pushtetin e frikshëm turk, por vdiq papritur në një marshim të ndërmarrë drejt Konstandinopojës. Në qëllimet e tij të larta dhe në aftësitë e treguara si ligjvënës, diplomat dhe luftëtar, ky car mbetet një prej figurave më të mëdha të mesjetës.

Fotografi nga Frederik Mur
Fshatarë serbë të Jugosllavisë

---

[85] *Cari Stefan Uroš IV Dušan Silni* (I Madh) (1308 – 1355) ishte mbret serb (1331-1346) dhe Car (1346-1355). Car Dushani ishte i vetmi car i vërtetë i Serbisë; ai e krijoi dhe e sundoi Perandorinë Serbe.

[86] *Princi Llazar Hrebeljanovi* (1329-15 qershor 1389) i njohur gjithashtu si Car Llazari, luftoi dhe u vra në Betejën e Kosovës me emrin e së cilës lidhet pazgjidhshmërisht edhe emri i tij. Ai është figurë mitike serbe dhe një shenjt i Kishës Ortodokse Serbe .

Ka pasur një dëshirë të hershme të udhëheqësve kroatë, sllovenë e po ashtu të Mbretërisë së Serbisë që t'i bashkonin vendet e tyre. Programi i këtyre komb-ndërtuesve përfshin bashkimin në një shtet të vetëm të kroatëve, sllovenëve, dalmatëve, boshnjakëve, helvátëve, malazezëve dhe të serbëve. Një prej pengesave kryesore në rrugën e ndërtimit të një federate të tillë është armiqësia fetare e shfaqur ndaj njëri-tjetrit prej adhuruesve të Kishës Ortodokse të Lindjes, katolikëve romakë të Perëndimit dhe myslimanëve. Megjithatë ka faktorë të fuqishëm, të cilët e favorizojnë bashkëpunimin. Ata janë popuj të një race dhe të rrethuar nga të huajt. Mbetet për t'u parë nëse lidhjet racore dhe gjuhësore do të mjaftojnë për të mposhtur forcat shkatërrimtare të xhelozisë së brendshme politike dhe të armiqësive fetare. Një tjetër vështirësi serioze, me të cilën një burrë shteti i Jugosllavisë do të ballafaqohej, është mungesa e përvojës në praktikën e ndërtimit të shtetit dhe mungesa e përvojës së popujve të tyre për vetëqeverisje.

Llazari zëvendësoi Dushanin, por dështoi. Ai u gjet i tradhëtuar dhe u mposht në betejën e Kosovës në vitin 1389 në Pllajën e Amselit. Serbia u mund, por me shpirt të pathyer rezistoi edhe shtatëdhjetë vjet më vonë deri kur u kthye në një pashallëk të sulltanit pas rënies së Kostandinopojës. Haidukët, Robin Hudët e gadishullit, e mbajtën gjallë luftën kundër turqve nëpër male dhe pyje. Në vitin 1804, të udhëhequr nga Karagjorgji, një bari derrash, populli serb u ngrit në masë. Pas njëzet e pesë vjetë luftimesh të përgjakshme, sulltani ua njohu autonominë në Traktatin Ruso – Turk të Adrianopolit. Një udhëheqës i ri serb, Obranoviçi po dilte tanimë në skenë.

Rivaliteti mizor i familjeve të Karagjergjoviçëve dhe të Obranoviçëve, edhe pse nuk u shoqërua me luftë civile, e lau në gjak historinë e Serbisë. Tre prej të parit dhe pesë prej të dytit e kanë sunduar atë vend. Obranoviçët u zhdukën në vitin 1903.

Lufta ruso-turke e viteve 1877-1878 solli pavarësinë e plotë të Serbisë, e cila e shpalli veten mbretëri katër vite më vonë. E xhindosur nga bashkimi i Bullgarisë me Rumelinë Lindore, në vitin 1885, Serbia u deklaroi luftë atyre, por u mund keq në Slivnicë. Më e vlefshme ishte Lufta Ballkanike e vitit 1912 kur Serbia bashkë me Bullgarinë, Greqinë dhe Malin e Zi i çliruan të krishterët e nënshtruar prej

otomanëve. Në Luftën Ballkanike të një viti më vonë ajo u bë fitimtare ndaj sulmeve Bullgare.

Historia e ultimatumit të Austrisë për tri pushtime të territoreve serbe prej saj, çdo herë të zmprasur, dhe prej rezistencës së saj të dëshpëruar ndaj ushtrive të kombinuara austriake, bullgare dhe gjermane, formon një kapitull qenësor të luftës që sapo ka mbaruar.

Mbretëria është e banuar prej 4.616.00 frymëve. Ajo është Piemonti i konfederatës së sapoformuar Jugosllave. Numri i serbëve që jetonin nën ish Perandorinë Austro – Hungareze, ndoshta, mund të kapë shifrën 500.000 banorë, në një numër të madh pasardhës të të larguarve nga Kosova. Profesori Pupin, një shpikës dhe edukator, është serb. Po të mos kishte vrazhdësinë që e karakterizon, gjuha serbe do të ishte, thuajse, e përsosur për poezinë dhe muzikën. Çeku Shafarik thotë: Kënga serbe të kujton tonin e violinës, sllavishtja e vjetër atë të organos, polonishtja atë të kitarës. Sllavishtja e vjetër tingëllon si zhurma e rrjedhës së shpejtë të një përroi, polonishtja si stërkalat e një kroi, serbishtja si fështëritja e qetë e një rrëkeje në një luginë.

Pak prej tyre shumë të pasur, asnjë shumë i varfër, shumë pak të njohur para vitit 1914, çdo familje në zotërim të një copë toke, sado e vogël qoftë ajo, demokratikë deri në pafundësi, të dashuruar pas ish Mbretëreshës Natali, sepse "ajo endej nëpër rrugë kryeshtruar me flokë të lëshuara", të gjallë e të shpejtë në lëvizje, të padyshimtë dhe krahëhapur, ata ngjajnë me belgët në vuajtje, në heroizëm dhe në lavdi. Jashtë asaj furre të brendshme djegëse, serbët janë duke u shfaqur si një popull që meriton besim, të palëkundur, të sigurt.

## MALAZEZËT

Sipas legjendës sllave, i plotfuqishmi, kur po i jepte formën tokës, mbante me vete një çantë të madhe të mbushur me male, të cilën ai po e mbillte njësoj si bujqit që mbjellin farën. Në lindje të Adriatikut, thesi i shqye, malet u derdhën nga thesi, zunë rrënjë dhe prodhuan masivet e thepisura të Cerna Gorës, Malit të Zi ose Monte Negros.

Malazezët si popull janë mishërimi i heroizmit dhe i lirisë. Pasi mbretëria e tyre u shkatërrua në Kosovë, një dorë serbësh të cilët as emigruan dhe as u nënshtruan u strehuan në këto male. Të shkëputur

tërësisht nga ndonjë ndihmë nga jashtë, të rrethuar prej turqve osmanë, shumë herë të sulmuar prej armiqsh në dukje të pabërballueshëm, të cilët ata përherë i mundën, duke përbuzur, madje, edhe besnikërinë ndaj turqve ose të ndonjë fuqie tjetër, nga viti 1389 deri në vitin 1916 ata ia dolën të ruanin me vështirësi pavarësinë e tyre.

Qëndresa ndaj turqve ishte motivi kryesor i jetës së tyre politike dhe shoqërore. Sunduesi i tyre ishte *vladika* ose peshkopi i tyre për shkak se si shenjtëri, ai do të ishte i paprekshëm nga sulmet e myslimanëve ose të bakshisheve të ofruara. Në vitin 1851 edhe aty froni u bë i trashëgueshëm.

Sulltani, gjithashtu, ua njohu atyre zyrtarisht pavarësinë në vitin 1799. Këtë e bëri e tërë Europa shtatëdhjetë e nëntë vjet më vonë.

Ky shtet i vockël, pasi qëndroi për shekuj të tërë si fanar drejtues në Gadishullin e Ballkanit, qe pushtuar për një farë kohe prej Fuqive Teutonike në vitin 1916.

Ka gjithsej 400.000 malazezë. Ata janë trupgjatë, shpatullgjerë dhe të gjallë. Karakteristikat e tyre janë ato të malësorëve që e duan lirinë, të cilët kanë jetuar të ndarë dhe mosbesues. Gratë e tyre janë të guximshme, besnike dhe të paepura siç mund të jenë vetëm ato. "Fjala e malazezit nuk është thyer kurrë". Elena, bija e Mbretit Nikolla I është gruaja e Viktor Emanuelit të Dytë dhe Mbretëreshë e Italisë.

## JUGOSLLAVIA

Bashkimi i të gjithë sllavëve të jugut ka qenë një aspiratë e hershme e udhëheqësve të kroatëve dhe të sllovenëve, si dhe të Mbretërisë së Serbisë. Ata donin që të përfshinin boshnjakët, helvatët, kroatët, sllavonët, dalmatët dhe sllovenët, ish vende vasale të Austro-Hungarisë ose edhe më parë të nënshtruara nga Turqia, si dhe shtetet, si Serbia dhe Bullgaria.

Lufta botërore e ka rritur oreksin e saj, me përjashtim të asaj që ajo nuk e lakmon më Bullgarinë. Kur Bullgaria bëri aleancë me Turqinë e cila ndër shekuj i kishte nëpërkëmbur sllavët duke dërguar ushtrinë e saj që të ushtronte tërë ashpërsinë mbi serbët, u pa si shkelëse e ndjenjave sllave më shumë se sa si një rreshtim i saj i thjeshtë në krah të armiqve të përbashkët, Fuqive të Boshtit.

Një pengesë e madhe në rrugën e bashkimit federal është dallimi midis kishave të tyre. Shumica e jugo-sllavëve janë Ortodoksë të Lindjes, të tjerët, përveç muslimanëve, janë Katolikë Romakë.

Jugosllavë në kostume popullore

Këta janë banorë të brigjeve lindore të Adriatikut të cilët më parë kanë qenë të pushtuar nga Austro – Hungaria. Ata janë të lidhur fort me interesa të përbashkëta me vëllezërit e tyre në Mbretërinë e Serbisë dhe kanë të njejtën dashuri për romancat, poezinë dhe muzikën, të njejtën krenari për racën, janë njësoj supersticioz dhe ushtrojnë thuajse të njëtat zakone.

Kisha Romake i ka lejuar dalmatët, sllavonët dhe kroatët katolikë, thuajse në mënyrë të pandërprerë që kur ata u shndërruan në atë fe, që të përdorin gjuhën sllave në vend të liturgjisë latine dhe të përdornin alfabetin sllav Glagolithik ose Cirilik. Kundër këtij zakoni ka patur protesta të huaja, më së shumti gjatë breznive të fundit, të mbështetura në arsyetime politike. Megjithatë, një përpjekje, për të imponuar ritualin latin ndoshta do t'i vërviste jugosllavët në Kishën Ortodokse të Lindjes. Një pengesë tjetër që i del bashkimit federal është mungesa e përvojës për vetëqeverisje që ekziston tek disa grupe të caktuara. Me përjashtim të malazezëve dhe serbëve, në pjesën më të madhe të Serbisë Mbretërore, të gjitha grupet e tjera kanë qenë nën dominimin e mallkuar të sunduesve të huaj që zëvendësonin njëri - tjetrin, më së

shumti turqit, austriakët dhe hungarëzët që prej Mesjetës. Nga tërë sistemet, ai federal, është më i vështiri dhe më kompleksi pasi kërkon shkallën më të lartë jo vetëm të mjeshtërisë qeverisëse por edhe të vetëpërshtatjes dhe vetëkontrollit. Prapëseprapë, mbi një anije të tillë shtetërore do të hipin këta detarë pa përvojë dhe t'i hyjnë detit me dallgë e furtunë.

Për shumicën e këtyre popujve, idea e bashkimit është një gjë e re, e cila deri vonë ka zbavitur vetëm një masë njerëzish ëndërrimtarë të cilët, ndërkohë që ishin për vete të nënshtruar ndaj turqve dhe austro-hungarezëve, me zor besonin në mundësinë e realizimit të ëndërrës së tyre. Madje edhe tani, jo të gjitha grupet e duan bashkimin. Sllovenët, bie fjala, nuk janë aq të ngazëllyer për këtë. Në disa pikpamje, situata është e ngjashme me atë të trembëdhjetë shteteve të Amerikës pas revolucionit dhe përpara pranimit të Kushtetutës.

Bashkëpunimin e favorizojnë faktorë të fuqishëm. Popujt, nga ana racore janë një, të ballafaquar gjithandej me të huajt. Megjithë dallimet që kanë midis tyre, ata zotërojnë një gjuhë të përbashkët, atë serbe, të kuptueshme për të gjithë. Megjithëse e një shkalle më të ulët se sllovenishtja, ajo flitet prej shumicës së njerëzve si gjuha letrare e kroatëve, boshnjakëve, helvatëve, sllavonianëve, serbëve dhe pjesërisht e dalmatëve. Lidhjet e racave dhe gjuhëve janë të fuqishme.

Praktikisht aty mungon trashëgimia e armiqësive. Është i njohur fakti që kushdo prej tyre që luftoi nën gradat e Austro Hungarisë e bëri atë nën detyrimin ushtarak. Ekziston gjithashtu mirënjohja për udhëheqjen natyrale të serbëve të ekzekutuar.

Një faktor imponues është vetëdija që deri sa të arrihet uniteti, ekzistenca politike e çdonjerit prej tyre është shumë e pasigurtë.

Në përpjkekjet e jugo-sllavëve për të sunduar vetveten vetëm në një mënyrë pozitive, atyre iu jepet mundësia që të gëzojnë simpatinë dhe durimin e të gjithë atyre që besojnë në vetëqeverisjen e popujve.

## BOSHNJAKËT

Për kufijtë e provincës së bregdetit lindor të Adriatikut përgjegjës është manipulimi politik rrënjët e të cilit datojnë më parë se të zbulohej Amerika. Banorët, të nënshtruar deri vonë nga Austro-Hungaria, janë

boshnjakë, helvatë, kroatë, dalmatë, sllavonë dhe slloven – një potpuri shushatëse popujsh sllavë midis të cilëve gjenden edhe pak hebrenj dhe ndonjë i huaj.

Hercegovinaset në Raguzë, Dalmaci.

Këto gra janë nga më piktoresket që mund të shihen në Raguzë. Ato veshin bluza të gjata të leshta, të bardha, ose blu të zeza, mbi veshjet e trasha të bardha dhe përparse të leshta të rënda me shumë ngjyra të shndritshme si të ishin qylyma të vegjël orientalë. Kapelet e tyre magjepsëse janë mbulesa të bardha të qëndisura, të varura nga kapse të kuqe të vogla me gjilpëra floriri dhe kërcejnë në ditë festash me kumakë.

Boshnjakët, të quajtur kështu prej Lumit Bosnja, janë serbë dhe kroatë të cilët për një farë kohe u sunduan nga një mbretëri e vogël e pafuqishme nën një sundimar të quajtur Ban. Ata janë të tërhequr fort nga simpatia dhe interesat ndaj të afërmve të tyre në Serbinë Mbretërore. Në kryeqytetin e tyre, Sarajevë, në datën 28 korrik 1914 ndodhi vrasja

e Princit të Kurorës së Austrisë dhe gruas së tij, Dukeshës së Hohenbergut[87] e cila shënoi fillimin e Luftës Europiane.

## HELVATËT

Helvatët ose hercegovinasit, të cilët janë serbë dhe kroatë, janë emëruar në përshtatje me rajonin e tyre duke qenë të ndarë nga Bosnja për përparësinë e Hercogut ose Arkidukës.

Fotografi nga Pauline H.Dederer
Grua kanaleze në Raguzë

[87] *Duke i Hohenbergut, – Arqiduka Franz Ferdinand Karl Ludëig Joseph i Austrisë* (nganjëherë i njohur si Francis Ferdinand) (18 dhjetor 1863 – 28 qershor 1914) qe lindur në Grac të Austrisë dhe ishte Arqiduke i Habsburgëve të Austrisë dhe trashëgimtar i fronit austro-hungarez.Vrasja e tij prej Gavrillo Principit më datën 28 qershor 1914 në Sarajevë, në Bosnjë Hercegovinën e aneksuar prej austriakëve, përshpejtoi shpalljen e luftës nga Austria, duke i tërhequr këmbëzën Luftës së Parë Botërore.

Gruaja nga Lugina e Kanalit mund të dallohet nga skufja e bardhë si bora dhe e ngrirë, si dhe nga fustanet e zeza, të leshta. Çantat e tregut me ngjyra të hapura që ato mbajnë, i shtojnë notat ngazëllyese kostumit të tyre. Populli i Raguzës jeton me lavdinë e së të kaluarës kur qyteti i tyre ishte republikë e pavarur dhe tregtia shtrihej deri matanë detit. Aty ka lindur edhe fjala "argosy" që do të thotë anije e madhe tregtare e Raguzës.

## KROATËT

Kroatët kanë qenë shpirtërisht të lidhur për një periudhë të gjatë kohore me serbët me të cilët ngjajnë aq shumë. Në vitin 1908, sovrani Austro-Hungarez e mori provincën turke të Bosnjës dhe Hercegovinës, nëntëdhjetë e tetë për qind e banorëve të të cilëve ishin serbë dhe kroatë. Në atë rajon nuk ekziston një njëtrajtshmëri e tillë. Dyzet e dy për qind janë Ortodoksë të lindjes, që e thërrasin veten serbë; njëzet e tetë për qind katolikë romakë që vetëthiren helvatë dhe njëzet përqind muslimanë që e dinë veten për turq.

Fotografi nga: Erdelyi
Burra kroatë të veshur me kostume popullore.

Serbët dhe kroatët vijnë nga e njëjta degë e racës sllave. Dallimi kryesor midis tyre është feja, dhe në një masë më të vogël edhe gjuha. Gjuha e tyre letrare është e njëjtë, po të lemë mënjanë faktin që kroatët përdorin alfabet latin ndërsa serbët një formë të modifikuar të alfabetiti cirilik ose rus.

Fotografi nga Erdelyi
Një çift kroatësh.

Rrobat e tyre janë aq të kushtueshme sa ç'mund t'i blejë kuleta e tyre por shpesh ato janë të hijshme të pasura dhe të shndritshme.

Gjatë viteve të fundit kroatët dhe sllovenët kanë emigruar drejt Amerikës më shpejt se ndonjë popull tjetër në Europë përveç hebrenjve dhe sllovakëve.

Kohë korrjesh në Kroaci

## DALMATËT

Dalmatët zënë një rrip toke të ngushtë malor, anës bregdetit dhe ishujve në lindje të Adriatikut. Ata shpesh thirren pagani ose paganët si tallje ose përqeshje ndaj tyre meqë janë sllavët e fundit që e përqafuan krishterimin. Duke emigruar në numër të madh ata, me shpejtësi, e bënë për vete popullin vendas duke ia ruajtur karakteristikat e veta. Pikërisht ashtu sikundër sllavët i dhanë emrin vllehve prej rumunëve latinfolës, kështu pushtuesit sllavë të Dalmacisë e thirrën popullin e latinizuar që e gjetën aty, vllah, ose mavro-vllah që do të thotë vllehtë e zinj. Në rropullinë e gjuhës Morlach,[88] një variant i çoroditur i mavro-vllehve, është bërë termi me të cilin sllavët dalmatë njihen gjerësisht në gjuhën angleze.

Dalmatika ose manteli i gjerë ceremonial, i veshur prej klerikëve të krishterë romakë në zyrat e tyre të shenjta, si dhe prej sundimtarëve në çastet e kurorëzimit, qe paraqitur në Romën e shekullit të dytë nga Dalmacia dhe përdorej vetëm prej fisnikëve.

Dalmacia, është si një pupël e hollë e shtrirë midis Venecias dhe Hungarisë, por që nuk përjetoi kurrë vetëdie kombëtare. Gjatë dy shekujve të fundit ajo, në mënyrë të ndryshueshme, ka rënë nën zotërimin herë të Venecias, herë të Francës dhe herë të Austrisë. Ajo i ka dhënë Austrisë shumë prej detarëve më të mirë.

---

[88] *Morlach - Morlachs* (Në greqisht: *Mavrovlachi* ose *Mauro-Vlachs*, që do të thotë vllehtë e "zinj"; në latinisht: *Nigri Latini*) ishin një popullsi çobane vllahe që jetonte në Alpet Dinarike (perëndimi i Ballkanit), në lëvizje të përhershme për të gjetur kullota më të mira për tufat e tyre të deleve. Është e mundur që ata të ishin ilirë të romanizuar, dakë ose thrakë të romanizuar.

Fotografi nga Pauline H. Dederer
Një fshatar dalmat duke dalë nga porta Ploçe e Raguzës.

Deri në vitin 1808 Raguza, qyteti më krenar i bregdetit dalmat, e ruajti pavarësinë e vet, por në shumë raste gjatë mesjetës ajo ra nën mbrojtjen e Venecias, të Hungarisë dhe të Turqisë. Luani me krahë i Shën Markut përmbi portën hyrëse, dëshmon ndikimin e Venecias. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë Napoleoni e aneksoi Raguzën pas themelimit të sapodeklaruar të "Mbretërisë së Ilirisë." Që nga viti 1814 deri në kohët e sotme qyteti ka qenë nën zotërimin austriak.

Hercegovinaset në Raguzë, Dalmaci

Këto gra janë nga më piktoresket që mund të shihen në Raguzë. Ato veshin bluza të gjata të leshta, të bardha, ose blu të zeza, mbi veshjet e trasha të bardha dhe përparëse të leshta të rënda me shumë ngjyra të shndritshme si të ishin qylyma të vegjël orientalë. Kapelet e tyre magjepëse janë mbulesa të bardha të qëndisura, të varura nga kapse të kuqe të vogla me gjilpëra floriri dhe kërcejnë në ditë festash me kumakë.

## SLLOVENËT OSE UENDËT

Sllovenët ose Uendët janë gjetur jashtë Gadishullit të Ballkanit në ish Krahinat Austriake të Karinthias, Karniolës dhe Styrias.

Zakonet dhe qëllimet e tyre dallohen shumë nga ato të kroatëve dhe të sllavonëve, të cilët janë më të afërmit e tyre. Të përzier në mënyrë

të vazhdueshme me anë të martesave, si me gjermanët, hungarezët dhe me italianët, ndodh që, deri tani vonë, pak janë merakosur për çështje racore. Ata janë të zellshëm, të ardhur si njerëz, të prirur që të rezistojnë pak ose të ankohen. Ndoshta, si rrjedhojë e kësaj, austriakët i trajtuan në mënyrë më të përmbajtur, ndryshe nga tërë sllavët tjerë të nënshtruar. Ata nga ana numerike janë 1.350.000. Janë të krishterë katolikë dhe përdorin alfabetin latin.

## SLLAVONËT

Sllavonët janë një popull që e kanë përvetësuar emrin etnik të racës së tyre nga fqinjët veriorë të kroatëve. Në vitin 1840 hungarezët u imponuan atyre gjuhën magjare si gjuhë zyrtare. Pas kësaj urrejtja e brendshme ndaj të gjitha gjërave hungareze shpërtheu si një flakë. Kryengritja shpërtheu në çdo anë të vendit.

Pas vitit 1868 kroato-sllavonët iu gëzuan nderit të pakuptimtë të të quajturit Mbretëria Kroato-Sllavone, e kontrolluar drejtpërsëdrejti nga Hungaria. Bani ose mbreti i tyre emërohej prej andej dhe që andej shkarkohej sa herë që t'ia donte puna Hungarisë. Një kuvend kombëtar mbahej formalisht dhe e kishte rreptësisht të ndaluar të merrej me çështje të tjera veç atyre vendore. Çdo dekret i lëshuar kërkonte miratim nga ana e Ministrit Austro-Hungarez të ngarkuar për Kroacinë dhe Sllavoninë, i cili ishte anëtar i kabinetit Hungarez. Kjo "Mbretëri" e kurdisur e Kroato-Sllavonëve ishte mënyra më e mirë për të vërtetuar krenarinë dhe epërsinë e imponuar ndaj popujve të shtypur. Përkohësisht e sukseshme, në fund ajo i xhindosi banorët sapo ata kuptuan se sa me besim të madh e kishin ngrënë sapunin për djathë.

## ÇEKOSLLOVAKIA

Mbretëria Austro-Hungareze, ishte një krijesë e habitshme edhe si sistem edhe si përbërje etnike e banorëve të saj. Një përqasje ndaj metodave të saj do të hidhte pak dritë mbi kushtet e sotme dhe të ardhshme.

Austro-Hungaria përbëhej nga dy pjesë të barabarta dhe të pavarura, Austria dhe Hungaria. Në vitin 1910, në Austri ishin 9.950.000

austriakë-gjermanë dhe 18.243.000 tjerë jogjermanë, kryesisht sllavë. Në vitin 1910, në Hungari kishte 10.051.000 magjarë, ndërsa 10.836.000 ishin magjarë të racave të ndryshme.

Gjermanët, ndonëse jo më shumë se një e treta e popullsisë, sundonin, sikundër edhe magjarët, ndonëse përbënin më pak se gjysmën e popullsisë. Për të mbajtur këtë epërsi të këtyre dy minoriteteve ata kishin futur në dorën e tyre tërë politikën e brendshme dhe kishin kontroll, thuajse të plotë, mbi atë të jashtme të Austro – Hungarisë.

Austriakët-gjermanë dhe magjarët përherë e kishin inat njëri-tjetrin. Një austriak ishte një i huaj në Buda-Pest, siç ishte i huaj një magjar në Vjenë. Por të dyja palët e dinin se shpëtimi i tyre politik varej më shumë në aleancën midis tyre. Për austriakët, në mënyrë të veçantë, kjo ishte një domosdoshmëri absolute. Epërisa e secilit, e përshkruar shkurt, varej nga kohëzgjatja e mbajtjes në dorë të pushtetit dhe nga zgjuarsia superiore në mashtrime.

Por gjithmonë ai do të llogariste xhelozinë në ndarjen midis kombeve sllave, një gjë që nxitej gjithmonë midis tyre. Më shumë se një herë ndonjëri prej kombeve sllave të nënshtruara i është afruar qëllimeve të veta, por është penguar vetëm prej kundërshimit të sllavëve të tjerë ose prej mosmarrëveshjeve midis tyre.

Përçarja e Perandorisë Austro-Hungareze, i la magjarët, thuajse, tërësisht në të njëjtën pozitë siç ishin më përpara, por e çau Austrinë në shumë pjesë. Austriakët gjermanë prapëseprapë ia dolën që të formonin një trup kompakt për vete, por popujt e nënshtruar sllavë u përçanë secili për vete për të arritur qëllimet e tyre kombëtare.

Gjermanët popullojnë një territor të gjerë që shtrihet prej Zvicrës në jug të Bavarisë deri pak më në lindje të Vienës; gjithashtu një rrip i populluar prej gjermanësh gati i rrethon çekët, ndërkohë që enklavat gjermane pikëzojnë si ishuj në mes të fqinjëve magjarë dhe sllavë.

Përkundër përdorimit të shpeshtë, të emërtimit "austriak" nuk duhet të harrohet asnjëherë se kjo fjalë nuk ka pasur kurrë përmbajtjen e fjalës "komb" dhe as që përfaqëson një koncept të tillë. Ky është një

term i përshtatshëm, i dallueshëm dhe i lehtë për t'u përdorur nëse themi se austriakët gjermanë kanë simpati të madhe ndaj gjermanëve të ish Perandorisë Gjermane dhe do të bashkoheshin më së fundi me ta.

Ish sllavët e jugut ose jugosllavët, të pushtuar nga Austro-Hungaria, ku përfshihen boshnjakët, helvatët, kroatët, sllavonët, dalmatët dhe sllovenët, janë përshkruar midis racave të Jugosllavisë ku ata gjenden të vendosur gjeografikisht. Popujt e tjerë sllavë, ish të pushtuar nga Austria janë çekët, moravianët, sllovakët dhe ruthenianët.

Çekët së bashku me Sllovakët dhe me Moravianët janë tani të njohur prej Shteteve të Bashkuara dhe prej Aleatëve të Antantës si vende që formojnë kombin e pavarur çekosllovak. Në hartë njeriu mund të vërë re zonën e gjerë të populluar prej gjermanëve dhe magjarëve, e cila i ndan Çekosllovakët nga Jugosllavët.

## ÇEKËT

Çekët ose Bohemët janë më të largëtit sllavë në perëndim, të rrethuar nga të gjitha anët përveç asaj lindore, prej një popullsie gjermane. Bohemia, ky emër i quajtur çek në sllavisht e merr emrin e saj prej Boi, një popull kelt, i cili një herë e një kohë e pushtoi vendin dhe më vonë u zëvendësua prej fisesh të ndryshme gjermane. Shumë më vonë, aty zunë vend çekët, ndoshta, gjatë pushtimit të madh sllav të shekullit të gjashtë.

Fisnikët çekë ose pronarët e tokave iu përshtatën shpejt mënyrave të sjelljes gjermane dhe filluan të flisnin vetëm gjermanisht. Të krishteruar prej Shenjtit Methodius, klasat e mesme u bënë lajmëtarët e Kishës Ortodokse Lindore, rituali i së cilës, në çdo vend ku praktikohej, kryhej në gjuhën amtare të popullit që e mbante atë. Kur pas kësaj, ata u shndërruan në Katolikë Romakë, ritualin e vjetër sllav dhe alfabetin cirilik në shërbesat fetare e zëvendësoi latinishtja.

Gjuha çeke, e përjashtuar kështu nga kisha prej latinishtes dhe prej shoqërisë gjermane, mbeti e ruajtur vetëm në trashëgiminë e popullit të thjeshtë. Për sa kohë që Bohemia qëndroi si një shtet i pavarur, as përpjekjet e vendosura për t'i bindur të hiqnin dorë prej saj dhe as përndjekja e pamëshirshme e ushtruar mbi ta nuk mundi t'i bënte të dorëzoheshin.

Fshatarë çekë në Amerikë

Burra dhe gra me kostume popullore të vendit të tyre në një kamp mobilizimi për çekët dhe për sllovakët në *Connecticut*, SHBA.

Mijëra vetë nga Bohemia, Moravia dhe Sllovakia, të cilët kishin ardhur në Amerikë për të jetuar në paqe, vunë peng jetën, fatin dhe nderin e tyre për të ndihmuar aleatët që të hidhnin poshtë autokracinë shtypëse të Habsburgëve dhe të Hohenzollarnëve, të cilët i kishin shtypur popujt liridashës të Europës për shekuj me radhë. Me t'u shpallur komb i ri, të gjitha zonjushat e reja të Pragës e bënë modë që të visheshin me kostume fshatare vendase. Shumë prej deputetëve të parlamentit u veshën me rroba tradicionale popullore kur u mblodhën për të ndjekur betimin e Presidentit Masaryk.

Kur Bohemia u kthye në një provincë austriake, tërë librat në çekisht, si dhe dorëshkrimet qenë djegur, ndërsa përdorimi i çekishtes me shkrim në shkolla u ndalua nën masa të rënda ndëshkuese. Por çekët këmbëngulën duke treguar një përkushtim të zjarrtë ndaj mbrojtjes së gjuhës së tyre amtare. Gjuha dhe kombi u bënë sinonime të njëra-tjetrës. Ato u njësuan në një fjalë: *jazyk*.[89] Ishte gjuha ajo që e mbajti gjallë kombin dhe e shpëtoi nga zhdukja.Veç kësaj, ajo i dha poezisë së hershme një pasuri të tillë gjuhësore që nuk gjendet te sllavët e tjerë.

[89] *yazyk* - gjuhë

Fotografi nga Oundervud – Oundervud
Kryeqyteti i vjetër i një kombi të ri – Praga

Kështjella Mbretërore dhe Katedralja e Shën Vitusit. Gurin e parë të këtij pallati e pati vënë Karli IV në vitin 1344. Pallati ka 711 dhoma dhe tri salla të mëdha. Ai ishte vendbanimi i sundimtarëve të Bohemisë deri në vitin 1620 kur mbretëria u shtyp në një betejë të quajtur Bela Hora (Kodra e Bardhë), një pllajë në rrethinë të qytetit. Që prej asaj kohe çekët në Bohemi kanë qenë, në mënyrë të vazhdueshme, në kërkim të rimarrjes së lirisë. Ata janë përpjekur, me çdo mënyrë, që ta bëjnë çështjen e tyre të njohur. Gjashtëdhjetë vjetë më parë, ishte Praga vendi ku mori jetë Shoqata Sokol, ose Shoqata e Gjimnastikës, me qëllimin e pashpallur për të hequr qafe zgjedhën austriake.

Qenia politike e çekëve ngjan në një shkallë të habitshme me atë të racës së vet të afërt, të polakëve. Në të dyja del në pah prania e popullit të thjeshtë, patriot, të fortë dhe të paepur. Në të dy këta popuj vihet re besnikëria, një besnikëri jo e detyrueshme, me një fisnikëri tejet të pasur që i trazonte mbretërit.



Fotografi nga Oundervud – Oundervud
Sokoli në Pragë: Një shoqëri gjimnastikore, e cila ndihmoi në krijimin e një kombi.

Këta burra, njëmbëdhjetë mijë në numër, bënin sikur po jepnin shfaqje gjimnastikore. Në të vërtetë ata po përgatiteshin që të luftonin kundër Austrisë, sapo t'u vinte çasti i duhur. Sokoli ose Shoqëria Gjimnastikore, qe formuar gjashtëdhjetë vjet më parë, për t'u përgatitur fshehtas për revolucion. Anëtarët e shoqërisë ishin vërtetë të interesuar për atletikën, por qëllimi kryesor i tyre ishte të mbanin një shoqatë me burra, të cilët ishin të zotë që të luftonin.

Në fillim të Luftës së Madhe, Austria i mori çekosllovakët në ushtri me shpejtësinë më të madhe të mundshme, duke i dërguar në transhetë e vijës së parë të frontit, në mënyrë që të ishin të parët që do të vriteshin. Rreth 50 % e tyre u vranë. Çdo revolucionar çek ose sllovak ishte armik i betuar i Austrisë. Kjo bëri që dhjetëra mijëra prej tyre të dorëzoheshin dhe të shkonin pas italianëve, rusëve dhe aleatëve në Ballkan. Ata rrokën armët kundër Austrisë. Shumë regjimente të Çekisë dhe të Sllovakisë, u bashkuan me trupat e vendeve të Antantës dhe të Shteteve të Bashkuara për të luftuar kundër Austrisë dhe Gjermanisë. Sokoli, i cili e quante veten shoqatë atletike, ishte në të

vërtetë një organizatë revolucionare ushtarake, ku, në fillim të luftës bënin pjesë rreth 300.000 burra. Ata e arritën qëllimin duke u bërë një prej forcave kryesore që solli rënien e Austrisë e, për rrjedhojë, atë të Gjermanisë.

Patriotizmi i tyre duket se i nënshtrohej interesave të klasës që i takonte ose edhe vetë atyre. Nga ana tjetër, çekët e thjeshtë kishin një shpirt edhe më të pavarur. Ata ishte vështirë t'i frikësoje dhe, ndonjëherë, kishin aftësinë që t'i detyronin fisnikët t'i ndiqnin në vend që të ishin në krye të tyre.

Romanca çeke gjen shprehje në figurën e vet më të madhe, Jan Husin[90]; në udhëheqësen e verbër e të papushtueshme të Zizkës; në ngatërresat, në heroizmin e kotë të luftërave husite; në Komeniusin[91], një prej mësuesve më të shquar të historisë, autor i "Botës së Dukshme", i pari libër i ilustruar për fëmijë dhe i pari në Universitetin e Pragës, shkolla më e respektuar në Europën Qendrore.

Gjeniu i lig[92] i çekëve ishte për shumë kohë Dera e Habsburgëve.[93] Ndonëse më vonë e pranishme sa për emër, mbretëria e tyre qe

---

[90] *Jan Husi - Jan Hus* (lindur në vitin 1369 në Boheminë Jugore dhe vdekur në vitin 1415 në Konstancë) ishte një udhëheqës, mendimtar dhe reformator fetar. Ai mori nismën e një lëvizjeje fetare bazuar në idetë e Xhon Uyklifit. Pasuesit e tij u bënë të njohur si husitët. Kisha katolike nuk ia fali një kryengritje të tillë dhe Husi u shkishërua në vitin 1411, u dënua prej Këshillit të Konstancës dhe u dogj në turrën e druve. Ai njihet si pararendës i lëvizjes protestante dhe zë vend të gjerë në histroinë e letërsisë çeke, veçanërisht për futjen e theksit *háek* në shqiptimin e gjuhës çeke. Sot një statujë e tij ngrihet në sheshin e vjetër të Pragës, *Staromstské námstí*.

[91] *Comenius - Jan Amos Komenský* (i latinizuar Comenius) (28 mars 1592 në Moravi, tani Republika Çeke – 15 nëntor1670, Amsterdam, Hollandë) ishte një mësues çek, shkrimtar dhe edukator i njohur si *Mësues i Kombit*. Ai ishte peshkop protestant moravian, një refugjat fetar, një europian i madh dhe një besimtar i veprimeve pa dhunë.

[92] *The Evil Genius* (Gjeniu i së Keqes) siç e nënkupton edhe vetë emri, gjeni jashtëzakonisht i zgjuar, i cili zgjedh ta përdorë këtë zgjuarsi më shumë për ligësi se sa për qëllime të mira. Për t'u quajtur Gjeniu i së Keqes, dikush duhet të përdorë dhelpërinë për të krijuar komplotin e plotë që shkakton rrënim dhe shkatërrim që shkojnë deri në krim.

[93] *Habsburgs – Perandoria e Shenjtë Romake* (në gjermanisht *Heiliges Römisches Reich*, në latinisht *Sacrum Romanum Imperium*), ishte një përzierje politike e tokave të Europës Qendrore në Mesjetë dhe në periudhën e hershme moderne. E dalë nga pjesa lindore e mbretërisë franke pas ndarjes në Traktatin e Verdumit në vitin 843, ajo zgjati thuajse një mijëvjeçar, derisa u shpërbë në vitin 1806. Që nga shekulli XVIII ajo shtrihej në pjesën më të madhe të Gjermanisë, Çekisë, Austrisë, Lihtenshtejnit, Sllovenisë, Belgjikës dhe Luksemburgut, si dhe në pjesë të mëdha të Polonisë dhe në një pjesë të vogël të Hollandës. Më parë ajo kishte përfshirë brenda vetes tërë Hollandën dhe Zvicrën dhe pjesë të Francës dhe të Italisë.

fundosur në betejën e Malit të Bardhë në vitin 1620, duke mundur të shpëtonte vetëm emrin midis titujve të Perandorisë Austriake.

Historia mbretërore e Bohemisë preku dy herë Anglinë në një mënyrë tejet interesante. Një herë me anë të Mbretit Bohem, Ferdinantit, i cili e humbi fronin mbretëror në Malin e Bardhë pas të cilit erdhi Xhorxhi I, i pari sundimtar anglez i Derës së Hanoverit. Krifa e Princit të Uellsit, me tri pendët e veta dhe me devizën "Ich Dien",[94] ishte mbajtur më parë prej Mbretërve Bohemë. Pas fitores së madhe të Crécy [95] në vitin 1346, kjo krifë qe marrë prej Eduardit, Princi i Zi, pranë trupit të Mbretit të Verbër të Bohemëve, Xhonit, i cili ra në fushën e betejës dhe që prej asaj kohe ajo u bë krifa e trashëgimtarit të kurorës Angleze.

Në ish Mbretërinë e Bohemisë gjenden rreth 7.000.000 banorë. Afërisht një e pesta e tyre janë çekë ndërsa të tjerët gjermanë. Shumë çekë të tjerë jetojnë në Silezine Austriake dhe Prusiane midis moravianëve dhe sllovakëve, si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktet e fundit heroike të çeko-sllovakëve në Siberi, Rusi, Francë dhe Itali fituan admirimin e botës dhe u bënë faktor jo i vogël që aleatët e Atlantës të fitonin dhe të njihej pavarësia e Çekosllovakisë.

---

[94] *Ich Dien – Pendët e Princit të Uellsit,* është simboli heraldik i Princit të Uellsit. Ai përbëhet prej tri pendësh të bardha pas një kurore të artë. Një shirit në anën e poshtme mban móton *Ich Dien*, që në gjermanisht do të thotë: "*Unë shërbej.*" Simboli mendohet se ekziston që me Eduardin, Princin e Zi. Sipas legjendës, Princi i Zi u pajis me armë prej Mbretit John të Bohemisë, kundër të cilit ai luftoi në Betejën e Grecyt. Pas betejës, princi shkoi te trupi i mbretit të vdekur (të cilin e admironte për trimërinë e tij) duke marrë përkrenaren që ishte përvijuar me pendë struci. Pendët dhe deviza e mbretit të vdekur përbënë simbolin e ri të princit dhe u përdorën prej Princave të mëvonshëm të Uellsit.

[95] *Crécy – Beteja e Crécyt* ndodhi më 26 gusht 1346 afër Crécy – en – Ponthieu në Somme departiment në veri të Francës dhe ishte një prej ndeshjeve përcaktuese ndërmjet ushtrive që luftonin që prej njëqind vjetësh. Për shkak të armëve të reja dhe të taktikave që u përdorën, kjo betejë është parë prej shumë historianëve si fillimi i fundit të kavalerisë, për shkak se gjatë rrjedhës së betejës shumë prej të burgosurve dhe të plagosurve ishin shpërndarë në kundërshtim me kodin e luftës dhe kavaleria e famshme nuk ishte më një kavaleri që nuk mposhtej prej këmbësorisë. Trualli i betejës është ruajtur dhe mund të shihet edhe sot prej një kulle të ngritur enkas për këtë qëllim.

## MORAVIANËT

Moravianët, të përqendruar në Moravë, popullojnë një pllajë me madhësi sa Masaçusët, e shtrirë në jug të Çekisë dhe të Sllovakisë. Edhe ata u krishteruan prej Shenjtit Methodius. Në shekullin e nëntë mbretëria e tyre, e cila mori Urdhrin dhe Draven, ishte tejmbushur me magjarë.

Fotografi nga A.W.Kutler
Fshatarë moravianë në rrethinat e Presburgut

Fundet e shkurtëra dhe çizmet Uellington duket të jenë të modës këtu. Vini re pantallonat e bëra me kujdes dhe kapelën e qendisur me flori të këtij burri. Moravianët gjenden në rrethinat e Lumit Morava në një pllajë në jug të Çekisë dhe të Sllovakisë sa sipërfaqja e Masaçusets.

Dishepujt e Jan Husit themeluan Vëllazërinë Moraviane, e cila për një kohë të gjatë, u bë forcë fetare në Bohemi dhe në Poloni. Të shkatërruar, thuasje, tërësisht nga një luftë që zgjati tridhetë vjet, ata pak të mbijetuar që mbetën, ikën dhe gjetën strehë në Saksoni. Por edhe aty u përndoqën. Shumë prej tyre u detyruan që të emigronin në Xhorxhia, në Amerikë. Xhon Uesli ra në kontakt me ta dhe prej ndikimit dhe bindjes së tyre shembullore, ai dhe vëllai i tij Çarli, hynë në atë urdhër fetar. Ata qenë të parët që këmbëngulën në shndërrimin e të pafeve në besimtarë, si detyrë parësore e kishës. Që atëherë, ata u bënë të shquar në punët e misionarëve. Në Moravi, vëllazëria thuajse është zhdukur. Vetëm katër përqind të mëse 1.700.000 marovianëve nuk janë katolikë romakë. Të zellshëm, guximtarë, të zgjuar, të dashuruar me lirinë, ata përherë e kanë ndier shtypjen e sundimit austriak, ndaj edhe e meritojnë lirinë që tani duket të jetë e tyre.

## SLLOVAKËT

Sllovakët gjenden më shumë në krahinat në veri të Hungarisë. Në lindje ata përzihen me ruthenianët, ndërsa në perëndim me çekët, te të cilët janë mësuar të varen për çdo gjë. Ata janë një popull i vjetër, paqësor. Duke mos pasur kishë kombëtare, duke mos njohur as pavarësi deri në vitin 1918, ata trashëgojnë pak tradita, por shumë këngë popullore. Fisnikët e tyre janë tërësisht të magjarizuar.

Deri vonë, tregtarët sllovakë dhe klasa e mesme, në përgjithësi, kishin dëshirë të merreshin për gjermanë. Por popujt përherë i kanë bërë ballë kontrollit të huaj. Përkundër ndarjes së saj, thuajse, si me thikë në dialekte, ata gjithmonë kanë mbajtur gjallë gjuhën e tyre, të vetmen lidhje që i bashkon. Magjarët i trajtojnë ata me një neveri brutale. Shumë prej tyre kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara. Të gjithë së bashku arrijnë një numër prej 2.500.000 vetësh.

Gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, tek sllovakët ka pasur një zgjim të dukshëm të ndjenjave arsimore dhe kombëtare. Duke flakur tej mospërfilljen ndaj sundimit të huaj, ata i kanë hyrë, tashmë, rrugës së njohjes së vlerave të veta kombëtare.

## RUTHENËT

Ruthenë, që do të thotë Rus, ishte emri i vënë prej austriakëve, atyre popujve që qenë vetënënshtruar siç janë Rusët e Vegjël. Ka më shumë se 3.500.000 ruthenë në krahinën austriake të Galicisë dhe Bukovinës, territore të marra nga Polonia. Në Bukovinë ata thirren huzulianë. Vetëm në disa pak gjëra ndryshojnë nga rusët e Rusisë së Vogël. Në Galici ata përbëjnë, afërsisht, gjysmën e banorëve, duke pasur një aristrokaci, e cila ka ose përkatësi polake ose është klasë e mesme gjermane ose një pjesë hebreje.

Ndonëse janë katolikë romakë, ata përdorin liturgji sllave dhe shkojnë në ceremoni të Kishës Ortodokse të Lindjes. Nën sundimin austriak ata janë të qetë dhe, në përgjithësi manifestojnë pak simpati për çekosllovakët dhe për polakët. Ata e lidhin veten natyrshëm me të afërmit e tyre më të afërt, ukrainasit ose rusët e vegjël. Janë të mirënjohur në Shtetet e Bashkuara për zellin dhe zgjuarsinë. Ruthenasi, Zelkievski, patriot dhe luftëtar ishte Chevalier Bayard[96] i Sllavëve.

## MAGJARËT

Magjarët janë racë mbizotëruese në Hungari, si dhe themelues të Mbretërisë Fino-Ugrianase të cilët u shfaqen për herë të parë në Europë si një hordhi shtegtare në shekullin e nëntë duke shtypur Mbretërinë Moldaviane dhe duke i rrëmbyer territoret që ishin në zotërim të saj. Prej kësaj qendre ata mësynë egërsisht mbi Europë, duke shkaktuar një terror të përgjithshëm mbi të për më se gjashtëdhjetë vjet. Pastaj një disfatë e pësuar në Augsburg prej Perandorit Gjerman Oto, paraqet izolimin e tyre midis armiqve të racave dhe të feve të ndryshme, të cilët ishin më të qytetëruar dhe më të fuqishëm se ata vetë.

Magjarët, në vend që të përpiqen t'i bashkojnë popujt me gjak të ndryshëm që banojnë brenda kufijve të shtetit të tyre, ndjekin politikën e trajtimit të të gjithë njerëzve që nuk kanë të njejtën prejardhje me ta,

[96] *Chavalier Bayard* (1475-1524) kalorës francez dhe hero kombëtar i njohur për guximin e tij. Ai u bë tipi i shquar i kalorësit dhe është i njohur si kalorës *sans peur et sans reproche* (që nuk ka as frikë e as turp).

si raca të nënshtruara duke u lënë atyre, thuajse, tërë barrën e taksave. Si rrjedhojë, ata ballafaqohen, herë pas here, me revoltat e tyre.

Fotografi nga Erdelyi
Gra vendase në një fshat magjar

Vlerësimet politike duket se kanë qenë bazë për caktimin e udhëheqësve të tyre, për përshtatjen ndaj krishterimit, si dhe për hyrjen në Kishën Romake. Si sovranë të zgjuar që ishin, ata e qetësuan vendin dhe lejuan hyrjen e shumë emigrantëve. Në shumë raste atyre u dhanë edhe privilegje. Të gjthë jomagjarët, vendas ose të huaj trajtoheshin si raca të nënshtruara, mbi të cilët rëndonin më të shumtat e taksave. Sistemi i taksave u ndryshua me kalimin e kohës, por parimi i racës më të dobët vazhdon të ruhet ende me forcë.

Magjarët e quajnë Buallin e Artë[97] të dhënë prej Stefanit II, shtatë vjet pas Magna Kartës,[98] si dokumentin që përfaqëson shpalljen më të hershme të të drejtave kushtetuese në Europën kontinentale. Ai pohon privilegjet e jashtëzakonshme të baronëve të mëdhenj, pasuria e madhe dhe fuqia e të cilëve më vonë, madje, edhe kur vendi u sundua nga mbretër shumë të aftë, u bë shkaku që e zhyti kombin në anarki, duke sjellë rënjen e numrit të bujkrobërve.

Magjarët ishin, për më shumë se një shekull, mburoja e krishterimit kundër turqve osmanë. Udhëheqësi i tyre i famshëm Huniadi u quajt "mishërimi i kalorësisë së krishterë". Ata kurrë nuk e kanë marrë më veten nga humbja shkatërrimtare që u shkaktuan turqit në Mohacs,[99] në vitin 1526.

Kushtet e tyre të përgjithshme nuk u përmirësuan për shkak të grindjeve të thella në të cilat i krodhi reformimi magjarët, midis të cilëve për një farë kohe, protestantizmi u bë feja mbizotëruese. Me martesën e një princeshe magjare me një arkidukë austriak, trashëgimia kaloi te Dera e Hapsburgëve, ku magjarët shpejt e panë veten të trajtuar si racë e nënshtruar.

Pakënaqësia arriti deri aty sa të nxiste revolta të drejtuara nga Louis Kossuthi.[100] Më pas ky i fundit dhe shpura e tij u mundën dhe

[97] *Golden Bull – Demi i Artë* i vitit 1356, ishte një dekret i lëshuar prej Raishtagut në Nuremberg, i drejtuar prej Perandorit Karli IV, Perandori i Shenjtë Roman, i cili fiksoi për një periudhë prej më shumë se katërqind vjetësh një aspekt të rëndësishëm të strukturës kushtetuese të Perandorisë së Shenjtë Romake. Ai mori emrin "Demi i Artë" për shkak të vulës së artë që u përdor mbi atë dokument.

[98] *Magna Carta* – Nga latinishtja, *Karta e Madhe*, fjalë për fjalë, *Letra e Madhe*, është një kartë e vitit 1215, e cila kufizon pushtetin e Monarkëve Anglezë, veçanërisht të Mbretit John, nga sundimi absolut. Magna Karta erdhi si rezultat i mospajtimit ndërmjet Papës e Mbretit John dhe baronëve të tij mbi të drejtat e mbretit. Magna Karta kërkonte që mbreti të hiqte dorë nga disa të drejta të caktuara dhe të respektonte procedura ligjore, si dhe të pranonte që vullneti i mbretit t'i nënshtrohej ligjit. Magna Karta është vlerësuar, gjerësisht, si hapi i parë në procesin e gjatë historik që çoi në shtetin e së drejtës dhe në respektimin e kushtetutës.

[99] *The Battle of Mohács - Beteja e Mohacs* (në hungarisht *mohácsi csata* ose *mohácsi vész)* u zhvillua në datën 29 gusht 1516 ndërmjet ushtrisë hungareze të drejtuar prej Luisit II dhe ushtrisë osmane të drejtuar prej Sulltan Sylejmanit, i njohur si Madhështori. Hungarezët kishin kohë që njiheshin si kundërshtarë të myslimanëve dhe "*Mburojë e Krishterimit*" për Europën.

[100] *Lajos (Louis) Kossuth* (1802-1894) ishte një jurist dhe politikan i shquar hungarez dhe për një kohë të gjatë regjent.

kërkuan strehë në Turqi. Rusia dhe Austria së bashku nuk ia dolën që të detyronin Turqinë të shkelte ligjet e saj të mikëpritjes dhe t'i dorëzonte ata. Këtë fakt magjarët e kanë kujtuar gjithmonë me mirënjohje. Në luftën ruso-turke të viteve 1877-1878, shumë delegacione magjarësh vizitonin Stambollin për të shprehur miqësinë e tyre ndaj farefisit të vet të një gjaku, ndaj turqve osmanë.

Fotografi nga Erdelyi
Një shtëpi magjare

Nënkresat, në sfond, janë tipare të njohura të shtëpive të të pasurve në Hungari. Ato përbëjnë njërën prej gjërave më të rëndësishme të pajës së nuses; edhe fëmijët e vegjël rrethohen me nënkresa të mëdha.

Në vitin 1910 në Hungari kishte 10.051.000 magjarë kundrejt 5.380.000 sllavësh të ndryshëm, ndërmjet 2.949.000 rumunësh, 2.037.000 gjermanësh, 275.000 romësh dhe 105.000 pjesëtarë racash të tjera të përziera.

Me një të parë të hartës zbulohet se sa ogurzeza janë ndikimet raciale që i rrethojnë magjarët. Në perëndim janë gjermanët. Enklavat

gjermane gjenden gjithashtu bash në zemër të popullsisë magjare; në veri gjënden çeko-sllovakët, në lindje, rumunët, ndërsa në jug, jugosllavët – dhe të gjithë njësoj tërheqin si magnet komunitetet e një gjaku që ende gjenden nën sundimin magjar.

Foto Nga A.W. Kutler
Fshatare hungareze në veriperëndim të Budapestit

Çdo kostum vajzash në Hungari ka një prerje, qepje dhe qëndisje të tillë të veçantë, që përfaqëson krahinën nga vijnë ato që e mbajnë.

Fisnikët magjarë janë varfëruar për shkak të taksave të larta mbi tokën, ndërkohë që gjermanët dhe hebrenjtë përbëjnë numrin kryesor të punëdhënësve. Ata zhvillojnë tregtinë në një kohë që hebrenjtë, në mënyrë të veçantë, kontrollojnë shtypin.

Përveç finlandezëve, magjarët janë i vetmi popull fino-ugrian i europianizuar tërësisht.

## POLAKËT

Pranë e pranë me rusët, me të cilët ata kanë qenë dhe mbeten kundërshtarë të përhershëm, polakët nga ana numerike përbëjnë një ndër pjesët më të rëndësishme të popullsisë sllave. Polonia ishte vendi ku sllavët u vendosën në shekullin e dhjetë.

Me trupa mesatarë, me kokë rrumbullake dhe me faqe të shëndetshme, më shumë bjondë se sa brunë, pamja e tyre fizike ka ndryshuar fare pak. Klasa punëtore, e cila përbën nëntë të dhjetat e kombit ka qenë përherë punëtore, e kursyer, e qëndrueshme, e përmbajtur më shumë se sa e përkorë, patriote e jashtëzakonshme. Këto cilësi i dallojnë edhe mijëra polakë në Shtetet e Bashkuara. Szlacta[101] i tyre ose fisnikët e kanë treguar veten që janë të rrëmbyer, të guximshëm deri në rrufeshmëri, kalorisiakë, të panënshtruar, emocionalë, artistikë.

Gjatë periudhës së formimit, Polonia qe fuqizuar falë dinastisë së lituanezit të Madh Jagellon,[102] Vladisllavit të Dytë Polak – një pinjoll i princave, i pakrahasueshëm në aftësitë e tij konstruktive. Bashkimi me lituanezët e dyfishoi popullsinë, si dhe burimet natyrore. Së bashku ata i shkatërruan Kalorësit Teutonikë në Tannenberg në vitin 1410 dhe, një gjysmë shekulli më vonë në paqen e Thornit,[103] i shtynë ata në lindje të Vistulës. Tokat polake në Balltik së bashku me Danzingun dhe me Marienbergun qenë përmirësuar. Principata e Mazovisë, qendër e së cilës ishte Varshava, për pesë shekuj e pavarur, iu bashkua

---

[101] *Szlachta* ka të bëjë me klasën e fisnikëve nën Mbretërinë e Polonisë, Dukës së Madh të Lituanisë (që prej vitit 1569 brenda Komunuelthit Polako – Lituanez) dhe në territoret brenda kontrollit të tyre (Ruthenia, Prusia Mbretërore). Fisnikëria u ngrit në Mesjetën e vonë dhe ekzistoi nga shekulli i 18 dhe 19. Tradicionalisht, pjestar të saj ishin pronarë tokash. Dallimet e fisnikëve ranë zyrtarisht me miratimin e Kushtetutës së Polonisë në vitin 1921.

[102] *Jagellon,* Vladislavus IV Vasa i Polonisë (1595-1648), ishte i biri i Zigmundit të Tretë të Polonisë (1566-1632) prej derës së Vasajve dhe e ëma quhej Austriaczka (e njohur gjithashtu si Ana e Austrisë ose Ana *Habsbur|anka,* 1566-1632). Ai mbretëroi si Mbret i Komunuelthit Lituano-Polak nga viti 1632 deri në vitin 1648.

[103] *Paqja e Thornit,* ose Paqja e Dytë e Torunit, ishte një traktat paqeje i nënshkruar në datën 19 tetor 1466 në ToruD ndërmjet Polonisë dhe Urdhrit Teutonik, duke i dhënë fund të ashtuquajturës Lufta Trembëdhjetëvjeçare e viteve 1454-1466.

vullnetarisht mbretërisë, e cila disa vite më vonë përfshiu Europën nga Balltiku deri në Detin e Zi. Lëvizja në periudhën e Reformacionit, e shoqëruar me dyshimin se mos ishin me origjinë gjermane, e trazoi vendin vetëm për një farë kohe.

Aftësia dobiprurëse e mbretërisë, cilësitë e mahnitshme të popullit dhe zhvillimi, tashmë i arritur, duket se jepte siguri për një shtet polak të fortë, të madh dhe jetëgjatë.

Prapëseprapë zhgënjimi e ndjek atë popull në çdo faqe të historisë së tij. Janë pasazhe të tëra të shkëlqyera ngjarjesh historike të këtij

Ilustrime nga shërbimi i shtypit
Polakët në funeralin e një e prelati të famshëm amerikan

Kapelet e rrafshta e dallojnë uniformën e ushtarëve polakë, ndërkohë që polaku i shquar, Injac Paderevski e udhëheq këtë kontigjent të bashkëvendasve të tij, të cilët po i ofrojnë nderimet e fundit Kardinalit Farley. Mijëra polakë në Amerikë, të cilët nuk janë natyralizuar ende, prandaj dhe nuk thirren nën armë, dolën vullnetarë për të shërbyer kundër gjermanëve dhe u stërvitën në një kamp mobilizimi afër Ujëvarave të Niagarës. Në frontin perëndimor Legjioni Polak ndau nderin e luftës me Legjionin e famshëm francez.

populli që në fakt nuk sjellin ezultatet e duhura. Askund tjetër nuk ka kaq shumë guxim të shkuar kot. Hendeku po zgjerohej, përherë e më shumë, ndërmjet fisnikëve dhe popullit të thjeshtë. Ishte populli ai që i mbante të tëra në kurriz. Fisnikët, si njëri dhe tjetri, ndonëse zotëronin tërë pronat dhe pushtetin, prapëseprapë nuk kishin as ndjenjën më të vogël të detyrimeve dhe të përgjegjësisë. Trima në beteja, ata ishin gati të luftonin për vendin vetëm kur e donte puna.

Sistemi i qeverisjes ishte një sistem tejet oligarkik. Ngjitja deri te froni, i cili nuk kishte ndonjë pushtet, bëhej me zgjedhje si për vendasit, edhe për të huajt në mënyrë të barabartë. Çdo zgjedhje ishte një orgji trazirash dhe mashtrimesh. Froni qe vënë dy herë në ankand. Vetoja e njëanshme e zbatuar që nga viti 1652 ku vota "kundër" e një pjesëtari të vetëm të kuvendit prishte çdo akt ose të tëra aktet ligjore të miratuara nga pjesa tjetër, kulmoi në një anarki, e cila më në fund gati sa nuk solli shkatërrimin e plotë të Polonisë.

Dhe prapëseprapë kriminelët aventurierë të klasave të privilegjuara nuk u lodhën që të zbusnin padrejtësinë që po i bëhej Polonisë me copëtimin e saj të viteve 1773, 1793, dhe në 1795 prej Prusisë, Rusisë dhe Austrisë. Duhet shënuar që copëtimi i parë qe konfirmuar prej Kuvendit Polak, në të cilin afërsisht gjysma e anëtarëve të tij patën marrë ryshfete paraprake nga të huajt.

Rezistenca e vonuar heroike e Koscioszkos,[104] e një dore fisnikësh dhe e njerëzve të thjeshtë të xhindosur mbuloi me lavdi rënien e shtetit, të cilin disa historianë, të ngatërruar prej farsës së zgjedhjeve, ende e quajnë "Republika" e Polonisë.

Prej këtij copëtimi Rusia mori një hapësirë prej afro 300 km katrore të populluar prej 6.000.000 banorë; Austria 73.350 km katrorë me një popullsi prej 2.500.000 banorësh, ndërsa Prusia 92.910 km katrorë me një popullsi prej 2.500.000 banorësh.

---

[104] *Kosciuszko – Tadeush Kosciuszko* u lind në Poloni me 4 shkurt 1746. Ai kreu studime inxhinierike në Paris. Më pas shkoi në SHBA në vitin 1776, ku u tregua inxhinier i zoti. Aty ai u shërbeu kolonive amerikane në luftën e tyre për pavarësi. Në tetor të vitit 1776, Kosciuszkou u punësua si inxhinier prej Kongresit Kontinental dhe filloi punën e tij të shquar në fortifikimin e fushave të betejave, shumë prej të cilave u kthyen në pika kthese në luftën e amerikanëve për pavarësi nga Britania.

Polakët që ranë nën pushtetin austriak, u trajtuan kryesisht mirë. Fakti që ata ishin të krishterë romakë i ruajti nga urrejtja fetare. Ndërsa rusët nuk lanë gjë pa bërë dhe formë pa përdorur për t'i rusifikuar ata. Ata që mbetën nën Prusinë, ishin për të ardhur keq më shumë se tërë të tjerët. Në përpjekjet për t'i gjermanizuar, nuk u la mizori pa u përdorur mbi ta pa dallim moshe, klase ose gjinie.

Polonia i ka dhuruar pasuri të mëdha muzikës, artit dhe letërsisë botërore. Vallet kombëtare, polkat dhe mazurkat shoqërohen gjithmonë me të kënduar. Koperniku[105] është emri më i madh i Polonisë. Sienkiëicz, viktimë e luftës botërore, prej shumëkujt vlerësohet si shkrimtari më i shkëlqyer i ditës. Ai dhe Paderevski janë polakë.

E zënë ngushtë si midis dy gurëve të mullirit, nga njëra anë Prusia dhe nga ana tjetër Rusia, si dhe e shtyrë nga ushtria Austro-Hungareze, Polonia gjatë luftës botërore pësoi një dëmtim të tillë, që tejkaloi imagjinatën e atyre, që nuk i kanë parë skenat e grabitjeve, plaçkitjeve, zjarrvënieve dhe të shkatërrimeve të pashoqe.

Dëmshpërblimi i një Polonie të ribashkuar ndaj njerëzve të saj të thjeshtë e besnikë do të ishte midis gjërave më të vlefshme që mund të bënin aleatët.

Një prej problemeve më të vështira me të cilin do të ballafaqohen udhëheqësit e këtij kombi të kthyer në jetë, do të jetë ai që ka të bëjë me hebrenjtë. Në territorin e Polonisë ka miliona hebrenj. Është pranuar, tashmë, nga të gjithë burrat e mençur të këtij vendi se vetëm me përpjekje të mëdha dhe me sakrifica nga të dyja palët si nga polakët, edhe nga hebrenjtë mund të arrihet një zgjidhje e kënaqshme.

---

[105] Nicolaus Copernicus (Nikolai Kopernik). *Koperniku* lindi në vitin 1473 në Torun, Poloni. Ai shpiku teorinë që Dielli dhe jo Toka qëndron në qendër të universit. Mbaroi studimet në Universitetin Krakov në Poloni dhe më pas në Padova në Itali ku studioi mjekësi, greqishten e lashtë, matematikë dhe shkenca. Po ashtu u diplomua në drejtësi. Mótoja e tij ishte: "Më në fund ne do ta vendosim Diellin vetë në qendër të Universit". E gjithë kjo na sugjerohet nga ky varg ngjarjesh, si dhe nga harmonia e gjithë Universit, nëse ballafaqohemi vetëm me faktet, siç thuhet, "me dy sytë hapur". Vdiq në 24 maj 1543.

## HEBRENJTË

Në Harkun e titusit në Romë, në një reliev të thellë, janë gdhendur ushtarë me kurora dafine duke mbajtur një shandan shtatëdegësh. Kjo përfaqëson Shandanin e Artë i cili, njëherë e një kohë, ndriçoi Vendin e Shenjtë në Tempullin e Jeruzalemit dhe që ishte mbajtur drejtpërsëdrejti përpara pushtuesit Titus në triumfin e tij. Harku përkujton pushtimin e Judeas në vitin 70 dhe shkatërrimin e Tempullit. Ai përkon me kohën kur ndodhi shpërndarja e parë e hebrenjve. Individë të caktuar ishin vendosur, tashmë, në çdo qytet të perandorisë, por ende nuk kishte ndodhur ndonjë eksod. Tani, që nga ky çast, të mbetur pa qendrën e tyre fetare, fillon rruga e pafund e ecejakeve. Harku nuk duket aq shumë një monument i kushtuar një perandori të vdekur se sa një vend ku të kujtohet përjetësisht një racë e shpërndarë, por e pavdekshme.

Gjashtëdhjetë vjet pas vdekjes së Titusit, i tërë Jerusalemi u kalërua dhe çifutët erdhën në atë gjendje, saqë harruan t'i afroheshin edhe dhembjes edhe vdekjes që i kishte pllakosur. Pikërisht emri i qytetit të shenjtë ishte përshkruar si koloni e pafe e ngulur në truallin e tij që quhej Aelia Kapitolina[106]. Qindra mijëra kishin marrë fund në fushëbetejë, në masakra dhe uria. I kthyer, tashmë, në një popull pa kryeqytet, pa atdhe dhe pa faltore, kush mundi të shpëtonte, mori rrugët e largëta të panjohura anë e kënd asaj bote, aq sa njihej atëherë. Libri vjetor i hebrenjve llogarit të ketë, vetëm në Europë, 10.000.000 prej tyre; Në SHBA 3.000.000 dhe 1.000.000 të tjerë të shpërndarë anë e mbanë botës. Në këtë pikturë të famshme, të riprodhuar nga artisti zviceran Burnard, tregohen dy prej dishepujve, Pjetri dhe Gjoni duke nxituar për te Sephulura[107]. Piktura gjendet në Muzeun e Luksemburgut në Paris.

---

[106] *Aelia Capitolina* - Qytet i themeluar në vitin 135 prej romakëve mbi rrënojat e Jeruzalemit, i cili ishte shkatërruar prej forcave të Titusit në vitin 70. Ai e ka marrë këtë emër pas Revoltës së Dytë Hebreje (132-135) në nderim të perandorit Hadrian (emri fisnor i të cilit ishte Aelius) si dhe prej Hyjnisë së Capitolinës Triad (Jupiteri, Junnona dhe Minerva). Një faltore kushtuar Jupiterit është ndërtuar në Tempullin Mount.

[107] *Sepulchre* – Kisha e Varrit të Shenjtë të Krishtit e quajtur *Kisha e Ringjalljes* ose e *Anastasi*t gjendet sot brenda mureve të Jerusalemit të Vjetër. Trualli i kishës gjendet mbi

Pikturë nga Eugene Burnard
Tipa hebré

Roma i quajti hebrenjtë rebelë të rrezikshëm që duhen shtypur. Pasi u kthyen në një popull të pafuqishëm në vendin e tyre ata u lejuan që të jetonin dhe të zhvilloheshin siç u pëlqente. Mishna[108] ose Ligji Gojor, themeli i Talmudit[109] qe zhvilluar tashmë. Ndërkohë një mësues

vendin më të nderuar prej shumicës së krishterëve, Golgota, Kodra e Kalvarit ku Dhjata e Re thotë se ishte kryqëzuar Krishti. Thuhet, po ashtu, se ajo përmban vendin ku Jezusi ishte varrosur (*sepulchre*). Kisha ka qenë një vend i rëndësishëm peligrinazhi që prej shekullit të katërt. Sot ajo shërben si qendër e Patriarkut Ortodoks të Jeruzalemit.

[108] *Mishna* - (m-sh´ne), në judaizëm, koleksion i kodifikuar i Ligjit Gojor – interpetime ligjore të pjesëve të librave biblikë të Eksodit, të Levitikusit, të Numrave dhe të Deuteronomisë, si dhe materialeve tjera ligjore. Së bashku me komentuesit e Gemarës ose Amoraikunisit, Mishna përbën Talmudin.

[109] *Talmudi - Talmud* (êÜÞÕÓ) konsiderohet një libër autoritar i diskutimeve në gjuhën hebraike për ligjin, moralin, zakonet, legjendat dhe për historitë hebraike. Ai është një burim themelor i legjislacionit, i zakoneve, i rasteve historike dhe i këshillave. Talmudi ka dy komponentë - Mishnah (megjithëse termi Talmud dhe Gemara përdoren ndërthorazi). Ai zgjerohet në shkrimet e mëparshme të Torahut, në përgjithësi, dhe në Mishnah, në veçanti, dhe është baza për të gjitha kodet tjera të ligjit hebre dhe shumë prej literaturës hebraike.

i mrekullueshëm, Mar Samuel,[110] përpunoi deri në detajin më të vogël një parim, i cili kishte për qëllim që të kontrollonte sjelljen dhe qëndrimin e tyre. Ai mësoi që kudo "ligji i qeverisë ishte ligji i detyrueshëm" dhe se ishte detyrë e tyre fetare jo prej përshtatshmërisë, por prej detyrimeve fetare që t'i njihnin dhe t'u bindeshin, aq sa të ishte e mundur, ligjeve të vendit ku gjendeshin. Ata duhej, madje, të faleshin për paqen e vendit ku do të banonin.

Kështu, përshtatja e tyre ndaj çdo zakoni dhe çdo rregulli do të bëhej e detyrueshme. Kjo kishte sjellë bindjen e kësaj race, e cila përkulet, por kurrë nuk thyhet. Për Graetzin, historianin më të shquar të hebrenjve, judaizmi ka zotëruar "aftësinë e ekzistencës në një vend të huaj." Edhe pse ka kaluar nëpër fatkeqësi dhe vuajtje të pakrahasueshme me ndonjë popull tjetër, ata ia kanë dalë që të mbijetojnë ndër shekuj.

Ushtrimi, sa për sy e faqe, i krishterimit përpara Europës i ndau vetë hebrenjtë në dysh. Për të moshuarit e paditur dhe brutalë çdo dorë hebreje dukej e ngjyer me të kuqen e gjakut të Krishtit. Që vetë Jezusi dhe apostujt ishin hebrenj, disa herë është mohuar. Nën maskën e besimit të thellë, çdo pasion i ndyrë dhe çdo lloj keqtrajtimi u ushtrua mbi hebrenjtë. Ligji ishte ndaj tyre më i pamëshirshëm se sa vetë turmat e verbëra. Ndodhte nganjëherë që ata të trajtoheshin me më pak ashpërsi për shkak të rrethanave të caktuara si, bie fjala, në Itali, kur këtë e donte Papa ose ndonjëherë ndonjë sovran i madhërishëm si Charlemagne,[111] i cili do të shfaqej si miku i tyre i hapur. Përsëri, me

---

[110] *Mar Samuel* – Samueli i Nehardeas, zakonisht i quajtur Marr Samuel ose Yarhinai (165-257), ishte një Rabi babilonas i lindur në Nahardea. Ai shoqërohet nga fama e bashkëkohësit të tij të madh Rab (Abba Araka). Përveç njohjes së ligjeve tradicionale, ai ishte i famshëm për arritjet e tij shkencore. Në veçanti njohuritë e tij për astronominë ishin të thella dhe ai ishte një ndër të parët që përpiloi kalendarin vjetor hebre, duke i hapur rrugë përllogaritjeve të kohës. Fama e tij qëndron edhe te përshtatja e jetës së hebrenjve në diasporë ndaj ligjit ku ishin vendosur. Rregullat e shtetit, kudo që të gjendesh, janë të detyrueshme, ishte parimi, të cilin e predikonte ai te bashkëkombasit e vet.

[111] *Charlemagne* (742 ose 747-814), Çarli i Madh, në gjermanisht *Karl der Große,* në latinisht *Carolus Magnus*, ishte mbret i frankëve në vitet 771-814, mbret i Lombardisë që prej vitit 774 dhe përtëritës i Perandorisë Perëndimore. Roli tij i dyfishtë si Perandor August dhe mbret na jep lidhjen historike midis dinjitetit perandorak dhe mbretërisë franke dhe më vonë Gjermanisë. Sot të dyja, Franca edhe Gjermania, e shohin atë si figurë themeluese e vendeve të tyre respektive.

përjashtime të rralla, fatet e tyre të pandryshueshme u përcollën nga padrejtësia, përndjekja dhe nga dëbimet e përhershme, që nga koha e Konstandinit e deri në kohët moderne. Megjithatë, ligjet e ashpra myslimane nuk zbatoheshin aq ashpër ndaj tyre. Kështu ata ndanin mirëqenien e shkëlqyeshme të Murëve[112] në Spanjë derisa një ditë të dy palët u dëbuan që aty.

Libri Vjetor i Hebrenjve numëron sot rreth 10.000.000 prej tyre në Europë, 3.000.000 në Shtetet e Bashkuara, dhe 1.000.000 në pjesën tjetër të botës. Ai llogarit 100.000 në Francë, 106.000 në Hollandë, 230.000 në Rumani, 257.000 në Mbretërinë e Bashkuar, 615.000 në Gjermani, 1.300.000 në atë çfarë ishte ish Austro-Hungaria dhe 700.000 në Rusi. Në Danimarkë, Norvegji, Suedi, Portugali dhe Spanjë ka krahasimisht më pak.

Numri i madh i tyre në Rusi më shumë mund të gjurmohet te Kazimiri i Madh[113], mbreti polak. E pëlqyera e tij Esteri, një hebre e përkushtuar siç ishte emri i saj në Bibel, e bindi Kazimirin që t'u ofronte hebrenjve strehim në Poloni. Hebrenjtë u shumëfishuan, veçanërisht, në atë pjesë të Polonisë të cilën rusët e shtinë në dorë në tri copëtimet dhe në të cilën me kufijtë shpesh të ndryshueshëm përbënte anën ruse. Bashkë me vdekjen e Kazimirit në vitin 1370 vdiq edhe zemërgjerësia ndaj tyre. Vendin e saj shpesh e zunë britmat e egra "hep, hep"! me të cilat fillonte pogromi. Pogromi është një masakër e organizuar dhe "hep" mendohet se rrjedh nga germat fillestare të fjalëve "*Hierosolyma est perdita*".[114]

---

[112] Maurët *(Moors)* ishin banorë myslimanë mesjetarë të al-Andaluz (Gadishullit Iberik), ku përfshihej Spanja e sotme dhe Portugalia), si dhe Magrebi. Kultura e tyre shpesh njihet emrin "murish".

[113] *Kazimiri i Madh* (1310-1370), i biri i Ladslauas së Shkurtër dhe i vetmi mbret polak me titullin "i Madh". Ai bëri ribashkimin e shtetit që nën sundimin e tij u dyfishua duke i dhënë rëndësi të madhe zhvillimit ekonomik. Thuhet se ai e gjeti Poloninë të ndërtuar me drurë dhe e la të ndërtuar me gurë. Në vitin 1364 ai themeloi Akademinë e Krakovit, i pari universitet polak.

[114] *"Hierosylma Est Perdita" - Jeruzalemi është shkatërruar*, është shenjë e luftës kundër hebrenjve. "Hep! Hep!" ishte një thirrje e turmave antisemitike e bërë prej kryqëzuesve që formohej prej tri germave të para të fjalëve të kësaj fraze latine *Hierosylma Est Perdita*. Thuhet po ashtu se kjo ishte një thirrje e njohur e përdorur në raste feste për t'iu gëzuar mposhtjes së Jeruzalemit nga Roma, në të cilën një njeri do t'i hidhte këto fjalë, ndërsa tjerët do të përgjigjeshin, "Urra".

Flakët, nëpër të cilat kanë kaluar hebrenjtë, vetëm sa e intensifikuan përkushtimin e tyre të shquar shtëpiak e racor. Nuk ka pozitë nderi ku njeriu të mos gjejë një hebre. Nuk ka lartësi të shquara – politike, diplomatike, financiare, dramatike, artistike, letrare – në të cilat bijtë dhe bijat e Izraelit të mos kenë arritur.

## ROMËT

Romët i gjejmë, fillimisht në ishujt grekë dhe në Greqinë kontinentale në fillimet e shekullit të katërmbëdhjetë. Nuk ka ndonjë shpjegim të qartë për arritjen e tyre, nga erdhën ose si erdhën aty. Pas kësaj ata gjenden si endacakë nëpër Gadishullin e Ballkanit duke mos u vendosur askund me përjashtim të një numri të madh, të cilët u kapën në rrugë dhe u kthyen në bujkrobër ose skllevër.

Në vitin 1417 ata shfaqen në Europën Perëndimore duke manifestuar një sjellje të çuditshme dhe morën emrin ciganë. Duke vënë re natyrën e tyre, Zigmundi, mbreti i Hungarisë dhe Perandori Gjerman u dhanë leje që të shkonin kudo që donin brenda sundimit të mbretit. Popullsia pritëse e tyre u porosit që të silleshin mirë me ta dhe u ndalua çdo lloj ndërhyrjeje ndaj tyre. Pak më vonë grupet endacake arritën në Itali, Francë dhe në Ishujt Britanikë.

Meqë besohej se kanë ardhur nga Egjipti, atyre iu vu emri anglez xhipsis, evgjit. Francezët u vunë emrin e tyre, bohemë, duke menduar se e kishin origjinën nga Bohemia. Ata e thërrisnin veten e tyre rom, që mendohet se do të thotë "i guximshëm". Ky emër ndoshta është marrë rrugës në kalimin nëpër Europën Juglindore. Midis tyre ka dhe shumë emra të tjerë: hagarenes, fëmijët e Hagarit; saraçenas, si prej Arabisë dhe anthigani ose " *Lule-mos-prek*" nga një sekt heretik në Azinë e Vogël.

Ligje të rrepta i kanë vështirësuar dhe, madje, disa herë i kanë ndaluar tërësisht ecejaket e tyre të mëparshme. Shumica e romëve tani jetojnë në shtëpi, megjithëse ende ka prej tyre që shfaqin prirjen e mëparshme. Edhe pse gjenden në çdo vend, mbeten të pallogaritur asgjëkundi. Ata ndoshta nuk janë më shumë se 700.000 në tërë Europën prej të cilëve tri të katërtat janë të vendosur në Hungari, Rumani dhe

në Gadishullin e Ballkanit, ku gëzojnë të njëjtat të drejta qytetare sikundër edhe banorët e tjerë. Pa atdhe, pa traditë dhe pa fe të tyren, ata janë gati të ushtrojnë çfarë t'u dalë përpara.

Romët kanë pamje të ashpër, me flokë të zeza, shpesh, të mëndafshta; sy të zinj, të gjerë me shkëlqim; dhëmbë të përsosur të rregullt dhe të bardhë dhe një çehre të plotë të përflakur, e cila me kohë bëhet e kuqërremtë. Gratë e tyre, kur janë të reja, shpesh zotërojnë një bukuri mahnitëse, por që venitet shumë shpejt. Liria e shfrenuar e racës së tyre gjen shprehjen e vet më të plotë në muzikë dhe në valle. Kompozitori i famshëm, List, i përshkruan romët si "origjina e muzikës kombëtare hungareze". Shumë prej balladave më popullore rumune, serbe dhe bullgare dhe meloditë rrjedhin prej romëve.

Interesi kryesor për romët qëndron te gjuha e tyre. Nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë tre studjues, duke punuar secili më vete dhe pa e njohur njëri - tjetrin, zbuluan se ky "zhargon" është një gjuhë primitive indoeuropiane tashmë e pafolur ndokund dhe pa ndonjë traditë të shkruari. E bastarduar dhe e përzier siç është, ajo prapëseprapë është ruajtur në rrjedhën e viteve në buzët e një populli misterioz endacak e të panjohur. Një gjurmues i shquar oriental Dr.Paspati beson se romanishtja ishte një motër e sanskrishtes dhe se evgjitët ose romët, janë raca më e vjetër indoeuropiane në Europë.



Fotografi nga A.W.Kutler
Romët, endacakët e çdo vendi.

Prej nga vijnë dhe për ku shkojnë është një mëdyshje jo vetëm për banorët në qytetin ose në vendin ku ata kalojnë, por edhe për vetë ata. Origjina e tyre ka humbur në misteret e legjendave dhe të traditave të tyre. Ata gjenden kudo në tërë Europën, më shumë në Ballkan, në Hungari dhe në Spanjë. Ai që magjepset pas subjektit romantik të romëve, mund të gjejë plot gjëra në faqet e "Lavengros"[115] së Xhorxh Borrout dhe "Romay Rye"[116] që tregojnë, përse këta endacake janë kaq tërheqës. Burri në fotografi mban një shkop me kokë të zbukuruar me argjend, të cilin e përdor kur del në rrugë. Palltoja e tij është stolisur me pulla argjendi të shumta.

## GJERMANËT

Emri "gjerman" gjatë këtyre viteve të fundit është nxirë aq shumë dhe është hedhur aq shumë baltë mbi të, prej vetë bijve të tij, sa që rrezikohet të mos e marrë kurrë më vendin që ka pasur. Përpara se militarizmi ta shkatërronte idealizmin, përpara se virusi prusian ta helmonte shpirtin gjerman, nuk ka pasur ndonjë degë kërkimesh, arti, shkence ose letërsie, në të cilën gjermanët të mos jenë shquar. Por sot, bota e panjohur mirë me ta mendon se poetët, filozofët, si dhe reformat e mëdha të Gjermanisë i takojnë së kaluarës.

E njëjta masë gjermanësh ka zënë të njëjtën hapësirë territoriale që nga periudha e paradatuar e epokës së krishterë. Megjithëse kanë përthithur shumë elementë sllavë, ata mbeten një popull më pak i përzier se sa italianët dhe francezët.

Numri i banorëve të Perandorisë Gjermane në regjistrimin e fundit të popullatës, përfshirë edhe 1.807.000 banorët e Alcasit e të Lorenës

---

[115] "Lavengro *Lavengro*" *ishte një emër i përdorur për* Xhorxh Borroun, shkrimtarin që përshkroi jetën e romëve. Kjo fjalë do të thotë, në gjuhën e romëve, "gjuhëtar".

[116] *Romay Rye*, romët, shqiptuar *"rahma"*. Së bashku me popullin shumë të afërt me ta *"sinti"* janë të njohur njësoj si edhe xhipsit në anglisht. Ata, tradicionalisht, janë popull endacak që e ka origjinën në veriun e Indisë, por që sot jetojnë në të gjithë botën më shumë në Europë. Ata flasin një farë forme të *Romanit*, një gjuhë e afërt me gjuhët indoeuropiane të Europës, të veriut të Indisë dhe të Pakistanit por zakonisht flasin gjuhën e vendit ku jetojnë. Antropologjia moderne i lidh romanët me *punaxhabët* dhe me *pothoharët* të folura në veriun e Indisë dhe në Pakistan.

dhe atë të 1.260.000 banorëve të huaj, kap shifrën 64.926.000. Po të heqim të huajt, popullin e Alcasit e Lorenës dhe 3.500.000 sllavët shumica e të cilëve janë polakë, atëherë mbeten rreth 58.00.000 gjermanë. Të afërt me ta dhe shumë të lidhur janë edhe 10.000.000 austriako - gjermanë dhe rreth 300.000 të tjerë në Luksemburg dhe në Lihtenshtain. Të gjithë së bashku përbëjnë popullsinë gjermane prej 70.000.000 vetësh të Europës Qendrore.

Dallimi midis gjermanëve të ultësirës, banorë të tokave të ulëta dhe gjermanëve të tokave të larta, banorë të zonave më jugore, në një terren më të lartë, dikur tregonte format e gjuhës dhe të shprehjes letrare.

Më shumë se çdo racë tjetër në Europë, gjermanët në Gjermani janë kryqëzuar ndërmjet tyre. Si rrjedhojë ata kanë zhvilluar tipare, të cilat në popuj më të vegjël do të quheshin vetëkënaqësi të tejskajshme provinciale, ndjenjë e superioritetit ndaj kombeve të tjera dhe paaftësi e dukshme kolonizuese. Ndërkohë ata bëhen kolonizatorë të mirë nën flamurin e të tjerëve, pasi si kolonizatorë nën flamurin e tyre kanë dështuar keqas.

Edhe pse qeveria i ka nxitur që të emigronin drejt kolonive të veta, gjermanët nuk kanë dashur ta bëjnë këtë përveç në rastet kur janë caktuar funksionarë shtetërorë ose ushtarakë. Në vitin 1914, në më shumë se 1.650.000 kilometra katrorë të zotërimeve koloniale gjermane ka pasur më pak se 25.000 banorë të bardhë, përfshirë këtu edhe të kombeve të tjera. Duhet theksuar se trajtimi i vendasve të kolonizuar nga ana e gjermanëve rrallë qëllon të jetë i mirë. Në përgjithësi ata tregohen jonjerëzorë dhe brutalë ndaj tyre.

Sidoqoftë, nisma gjermane dhe kushtet e pakënaqshme kanë bërë që në të shkuarën mijëra prej tyre të shpërndahen anë e mbanë botës. Në SHBA ata janë më shumë se 2.500.000, të gjithë të lindur në Gjermani shumica e të cilëve qytetarë të vlefshëm dhe të besueshëm amerikanë. Në Hungari gjenden mbi 2.000.000, ndërsa në Rusi 1.500.000, banorë të hershëm të atyre vendeve. Në Amerikën e Jugut ka më shumë se 500.000 gjermanë.

Në vitin 1914, gjermanë ose me origjinë gjermane ishin Dyert Mbretërore të Austro-Hungarisë, Belgjikës, Bullgarisë, Danimarkës dhe të Perandorisë Gjermane dhe secila prej 25 shteteve, me përjashtim

të dinastisë sllave të dy Meklenburgëve; Britania e Madhe, Greqia, Hollanda, Lihtenshtejni, Luksemburgu, Norvegjia, Rumania, Rusia dhe Suedia. Në Britaninë e Madhe, Dera Mbretërore e anglizuar prej kohësh prej shpalljes mbretërore në vitin 1917 e ndryshoi titullin nga "*Dera e Saxe-Coburg and Gotha*"[1] në *"Dera e Uindsorit"*. Në Belgjikë dhe në Rumani sundimtarët e identifikonin veten me popujt e tyre. Monarkët që nuk ekzistojnë më si të tillë të Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe të Rusisë janë ose në arrati ose të vdekur.

Deri në vitin 1871 termi gjerman ishte një shprehje etnike ose gjeografike pa ndonjë kuptim kombëtar. Nuk ka pasur kurrë një komb të vërtetë gjerman. Në vend të kësaj ka pasur gjithmonë një numër të papërcaktuar njësish politike-mbretërish, dukësh, qytetesh të lira, pak të lidhura ose të palidhura fare – të cilat në të gjitha luftërat europiane zakonisht merrnin anën e kundërt. Numri i njësive të tilla, gradualisht, u zvogëlua duke arritur deri te numri njëzet e pesë. Kjo ishte një trashëgimi e sistemit fisnor, shpesh i vajtuar prej patriotëve gjermanë dhe prej burrave të shtetit. Duke vepruar së bashku për herë të parë në luftën e vitit 1870-71, ata ia dolën të sfidonin Francën Perandorake.

Shpallja e Perandorisë në datën 18 janar 1871 në Versajë, në dhomën e fronit të Luigjit XIV, këtij armiku dredharak të racës gjermane, u bë në mënyrë shumë mbresëlënëse. Dukej se bashkimi gjerman ishte arritur. Në datën 16 prill sovranët e gjashtë shteteve më të mëdha gjermane i siguruan perandorisë një kushtetutë, në bërjen e së cilës popujt nuk morën pjesë. Kjo kushtetutë i jepte Prusisë dhe mbretit të saj Hohenzollern pozita supreme në Gjermani. Kushtetuta në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshonte pa pëlqimin e Mbretit të Prusisë, i cili ishte edhe Perandori Gjerman, veç në rast revolucioni.

Revolucioni ishte tashmë punë e kryer. Por popujt dhe racat mbeten edhe pse fronet dhe perandoritë bien e ngrihen. Pas qetësimit të trazirave dhe korrigjimit të gabimeve dhe fajeve të bëra, prapëseprapë në qendër të kontinentit do të ekzistojë përsëri ai grup etnik homogjen gjerman prej 70.000.000 vetësh. Për shkak të poshtërsive të këtyre katër pesë viteve të fundit, ky grup nuk mund të besohet deri sa të dëshmojë pendim jo vetëm për disa ditë ose muaj, por për një brez të tërë, në mos edhe për më shumë me veprime të tilla që lypset të bëjë një komb që të quhet i tillë.

Republika sllave Çekosllovake që po lindte, Polonia, ndoshta edhe Lituania në lindje të Gjermanisë, si dhe ajo e Jugosllavisë në jug mund të gërryheshin fare lehtë nga pakënaqësitë dhe nga xhelozitë reciproke prej makinacioneve të klasës janker të prusianëve. Prej këtej do të krijohej, pikërisht, në zemër të Europës një tjetër vullkan politik, përherë në shpërthim, shumë i ngjashëm me atë që e mbante Ballkanin në trazirë të përhershme përpara luftës. Deri sa prej gjermanëve të mos iu kërkohen garancitë e nevojshme për sjelljen e duhur, që ata kurrë as të mos t'u shmangen as t'u dredhojnë detyrimeve, bota po i dorëzon këtyre racave të drejtën që të zgjedhin, që do të thotë të bëhen pre e menjëhershme e njerëzve, të cilët nuk njohin as drejtësi, as nder as mëshirë në marrëdhëniet me njerëzimin.

Në grupin gjerman palët që duhen veçuar janë prusianët, bavarezët dhe saksonët dhe tri qytetet e lira: Lubecku, Hamburgu dhe Bremeni.

Qytetet e lira ishin faktori më i rëndësishëm në shpërndarjen e ndikimit gjerman gjatë Mesjetës. Këto lidheshin me njëri - tjetrin për mbrojtje të ndërsjellë të nëntëdhjetë qyteteve kryesore tregtare midis Rinit dhe Novgorodit. Kjo shoqatë e quajtur Lidhja Hanseatike[118] ose Lidhja e Shoqërive të esnafëve që nga viti 1241 për më shumë se katërqind vjet i mbrojti të drejtat e tregtisë duke ruajtur epërsinë në Europën Veriore. Në kushte normale, interesat detare dhe tregtare të Lubeckut, Bremenit dhe Hamburgut do të ishin të pamatshme. Qytetarët, krenarë për traditën e tyre vetëqeverisëse, janë demokratë në ndjenja.

Saksonët janë thuajse, teutonik të pastër në prejardhje me pak përzierje sllave. Ata zënë njërën prej pjesëve më pjellore të Gjermanisë. Më parë ata ishin të njohur për shpirtin e tyre të pavarur. Për tridhjetë e tre vjetë ata luftuan me këmbëngulje kundër Charlemagneve, të cilët më në fund, i pushtuan dhe i kristianizuan. Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, në mënyrë të pandërprerë, përparuan në të drejtat e tyre kushtetuese derisa prusianët i zunë territoret e tyre në vitin 1866.

---

[118] *Hanseatic League-Lidhja Hanseatike* (në gjermanisht: *die Hanse*) ishte një aleancë e qyteteve që bënin tregti, të cilat themeluan dhe ruajtën një monopol tregtar mbi Europën Veriore dhe mbi Balltikun për një kohë të gjatë në Mesjetën e vonë dhe në periudhën e hershme moderne (midis shekullit XIII dhe XVII).

Ata renditen midis njerëzve me arsimim më të lartë në Europë. Drezdeni, kryeqyteti i tyre, është qendër arti dhe industrie. Më shumë se 95 përqind e saksonëve janë protestantë.

Fotografi nga Virginia Demont – Breton
Njerëzit e detit – bjondët teutonë ose tipat nordikë

Këtu një artist i njohur ka hedhur në kanavacë cilësitë e dallueshme fizike të një populli më pak të shkathët se sa keltët dhe që kanë fytyra më të gjata, flokë më të zbardhur dhe sy të kaltërt.

## BAVAREZËT

Bavarezët nga ana racore janë populli më i përzier i Gjermanisë, pasi rrjedhin prej sllavëve të gjermanizuar, prej keltëve të ardhur që më parë dhe prej markomanëve teutonikë dhe Quadi[119]. Këta të fundit

vijnë nga lindja dhe marrin emrin Baivari, ndoshta nga *B o j e r,* pasi ata kanë ardhur në vijën Bojerland ose Bohemia.

Ata populljonë një amfiteatër të pafund, rreth 220 milje të gjatë dhe 110 milje të gjerë, të rrethuar prej malesh shumë të larta. Nuk ka territor tjetër të njëllojtë me të në Gjermani që të jetë i rrethuar me kufij natyrorë kaq të dallueshëm; si rrjedhojë, bavarezët kanë zhvilluar një karakter të natyres së vet. Fizikisht ata janë më zeshkanë, me kocka më të vogla, më të natyrshëm dhe më pak të ngurtë se gjermanët në përgjithësi. Ata janë konservatorë, fetarë dhe të dashur.

Drama e Pasionit[120] është luajtur çdo dhjetë vjet prej fshatarëve bavarezë të Oberamergaut që nga viti 1634. Sovranët dhe vetë populli kanë ushqyer muzikën dhe dramën dhe kryeqyteti i tyre Munihu është shkollë e të gjitha llojeve të artit. Dyert e bronxta të Kapitolit në Uashington qenë derdhur në një fonderi Bavareze. Konti Rumford[121], një filantrop dhe njeri i shkencës, i lindur në Uoburn, Masaçuset (*Massachusetts*), për njëmbëdhjetë vjet Ministër Bavarez i Luftës dhe i Policisë e riorganizoi punën dhe reformoi kushtet shoqërore.

Përherë armiq ndaj Prusisë, bavarezëve, që kur u nënshtruan në vitin 1866 u është bërë natyrë e dytë sjellja e vrazhdë ndaj kontrollit

---

[119] *Quadi* ishte një nga fiset më të vogla gjermane, rreth përcaktimit të të cilit dihet fare pak. Historia e popujve të pashkollë shkruhet prej kundërshtarëve të tyre dhe, në këtë rast, mund të dihet vetëm ajo që thonë romakët për këtë fis të quajtur Quadi. Nuk ka mbetur ndonjë shenjë poçerie apo mbetje tjetër kulturore që të ndihmojë për të dalluar atë nga grupe të afërta me ta. Sipas burimeve romake të shekullitë të parë para erës së re, njerëzit e fisit Quadi emigronin bashkë me një numër më të madh të fisit Markomani, emri i të cilëve do të thotë "njeriu i tokave kufitare", pra që jetonin në kufijtë e Gjermanisë që gjendeshin në tokat kufitare me lumin Danub, në jug të të cilit shtrihej territori romak.

[120] *Drama e Pasionit* – Sipas traditës në vitin 1633 banorët e fshatit Oberammergau në Bavari u betuan që, nëse Zoti do t'i shpëtonte nga kolera bubonike që po hakmerrej ndaj rajonit, ata do të luanin një dramë çdo dhjetë vjet, duke përshkruar jetën dhe vdekjen e Jezu Krishtit. Ata shpëtuan dhe drama u luajt për herë të parë në vitin 1634 dhe vazhdon të shfaqet edhe sot. Shfaqja e fundit u luajt në vitin 2000.

[121] *Rumford* – Konti Rumford, sipas të cilit ka marrë emrin oxhaku Rumford, lindi me emrin Benjamin Thompson në Ëoburn, Masaçusets, në vitin 1753 dhe, për shkak se ishte luajalist, iku papritur me britanikët në vitin 1776. Ai kaloi një pjesë të madhe duke punuar për Qeverinë Bavareze, ku mori titullin "Kont i Perandorsë së Shenjtë Romake". Eshtë i njohur për punët studimore që ka bërë, pikë së pari, në natyrën e të nxehtit.

prusian. Dallimet fetare e thellojnë edhe më shumë ndarjen, duke qenë se shtatë të dhjetat e 6.000.000 bavarezëve janë katolikë romakë.

## PRUSIANËT

Prusianët e marrin emrin dhe origjinën nga Borusi, një popull kockëgjerë, luftarak, farefis i lituanezëve dhe i letonezëve që jetonte në shekullin e dhjetë në Ultësirën e Oderit, Vistulës dhe Niemenit. Ata pak që i shpëtuan shfarosjes së Kalorësve Teutonikë kërkuan ndërhyrjen e polakëve, të cilët aneksuan pjesën në perëndim të Vistulës. Në vitin 1525 kryekalorësi Albert i Hohenzollernit e shpalli veten protestant dhe i dorëzoi tokat e veta te Mbreti i Polonisë, i cili që në këtë kohë shpalli Prusinë një Prinicipatë të Dukës, ndërsa atë e bëri Dukë të Madh. Pasardhësi i tij i largët Frederiku, pasi bleu titullin e mbretit nga perandori për një çmim të lartë, në mënyrë madhështore në Konisburg, ku edhe ishte lindur, e kurorëzoi veten Mbret të Prusisë, me datën 18 janar 1701.

Prusianët, edhe pse tërësisht të gjermanizuar, gjithmonë ndryshojnë prej tyre. Gjermanët e tjerë nuk i pëlqejnë ata, madje, as që u besojnë atyre. Fon Treitschke[122] thotë për Prusinë: "Eshtë vendi më i urryer për gjermanët që prej fillimit të saj". Gëte do të shkruante: "Prusiani ka qenë përherë një kafshë dhe qytetërimi do ta bënte atë mizor". Prusianët përherë kanë manifestuar cilësi të veçanta që, ndoshta, rrjedhin nga stërgjyshërit e përbashkët, mbretërit e pamëshirshëm dhe Borusët e egër.

Me ardhjen rishtas të Frederikut, ai u vu në zotërim të një mbretërie prej rreth 91.280 km katrorë dhe prej 1.500.000 banorësh. Një vit më parë Prusia përfshinte 228.200km katrorë dhe 40.000 banorë.

Për të ardhur deri te kjo arritje e mahnitshme, është dashur një politikë e qartë ku të përdoreshin tërë format, përfshirë dyfaqësinë, dhunën, çdo mjet të paturpshëm për të siguruar territore në dëm të popujve të tjerë. Ndërkohë që emri prusian përdoret për tërë shtetasit

---

[122] *Heinrich von Treitschke* (15 shtator 1834 – 28 prill 1896), historian gjerman dhe politikan i shquar i lindur në Drezden.

prusianë, shumica më e madhe jetojnë në shtete të prishura ose të shkatërruara.

Ky sistem ishte i qëndrueshëm dhe i pëlqyer sa kohë që joshej prej fitoreve ushtarake ndaj të huajve. Në luftrat me Danimarkën, me Austro-Hungarinë dhe me Francën helmimi masiv prej triumfit u shpërnda me shpejtësinë e dritës. Por ishte e sigurtë se me ta pësuar humbjen e parë, e gjithë kjo do të binte për tokë me neveri e përçmim nga ana e popullit gjerman të zgjuar nga ai gjumë. Kllapia politike që po përfshin tani tërë Gjermaninë është dëshmia më e mirë e saj.

Fotografi nga Virginia Demont – Breton
Njerëzit e detit – bjondet teutonë, ose tipat nordikë

Këtu një artist i njohur ka hedhur në kanavacë cilësitë e dallueshme fizike të një populli më pak të shkathët se sa keltët, të cilët kanë fytyra më të gjata, flokë më të zbardhur dhe sy të kaltër.

## FISET SLLAVE NË GJERMANI

Fiset sllave të shpërndara prej kohësh anë e mbanë Gjermanisë deri në largësitë e Elbës kanë qenë, thuajse, tërësisht të përthithura prej popullsisë gjermanike.

Polakët, një herë e një kohë të panumërt, ishin, ndoshta, të fundit që u zhdukën. Rajoni në lindje të Hanoverit, ku gjuha e tyre është

folur deri në shekullin e shtatëmbëdhjetë, ende quhet Uend. Në Lusatia, emër që rrjedh prej fisit sllav Lusiç e që tani i takon Saksonisë dhe Prusisë, ka rreth 170.000 Sorbs[123] ose Uends[124]. Në rrethanat më të vështira, ata kanë ruajtur vendosmërisht gjuhën dhe kostumet e tyre, ndonëse jetonin në mes të popullsisë gjermane, e cila ishte tetë herë më e madhe se popullsia e tyre. Të harruar prej botës dhe, gradualisht, të gjermanizuar ata përjetuan një ringjallje nga një zgjim i mrekullueshëm kombëtar në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ndryshe nga Prusia ku ndiheshin të keqtrajtuar, në Saksoni, ku është vendosur kryeqyteti i tyre Bautzen, i cili është një qendër intelektuale, ata gëzonin përkrahje. Gjuha e tyre është një gjuhë e ndërmjetme midis polonishtes dhe çekishtes.

Sllavët, parë nga karakteristikat e tyre fizike, janë njerëzit më kozmopolitë.

---

[123] *Sorbët*, (gjithashtu *lusatianët* ose *uendët*) janë, relativisht, populli më i vogël sllav, që jetojnë si pakicë në rajonin e njohur si Lusatia në shtetet gjermane të Saksonisë dhe të Branderburgut.

[124] *Uends - Sorbs* – janë stërgjyshërit e uendëve, të cilët ishin sllavë perëndimorë të quajtur Milceni dhe Luzici e që zinin një territor në lindje të lumit Oder në Mesjetën e hershme. Atdheu i uendëve është pjesë e territorit të njohur si Lusatia në Gjermaninë Lindore, afërisht 80 km në juglindje të Berlinit. Uendët ia kanë dalë që të ruajnë identitetin e tyre, ndonëse janë sunduar shumë herë prej gjermanëve, hungarezëve, polakëve dhe bohemianëve. Në dy luftërat botërore ata arritën të njiheshin nga fuqitë e mëdha si një komb shtet.

## SKANDINAVËT

Skandinavët ose danezët, norvegjezët dhe suedezët, janë popuj teutonikë aq të afërt në racë dhe në histori, sa, përveç disa gjërave që i dallojnë, do të ishte e vështirë që të flitet për ta veç e veç. Emërtimi "skandinav" ka origjinë dhe kuptim të panjohur, përdoret prej shumë kohësh dhe i përmbledh tërë këta popuj.

Zgjatimi pa fund i gadishullit verior midis Gjirit të Bothnisë dhe Atlantikut i dyfishuar në gjerësi në drejtim të jugut dhe i dyjzuar, duket sikur do të fusë gadishullin e Danimarkës në mes të gjymtyrëve të veta.

Danimarka Perëndimore dhe Norvegjia kanë dalje të drejtpërdrejtë në oqean. Danimarka Lindore dhe Suedia shohin drejt Balltikut dhe Europës. Aty u vendosën të ardhurit e veriut të Gjirit të Finlandës dhe të lindjes së Gjirit të Bothnias dhe vendosën një Princ varangian[125] në fronin rus. Që nga ajo koshere njerëzore e Suedisë vërshuan gotët si mizë blete drejt Gjermanisë dhe Rusisë jugore dhe më pas drejt Italisë dhe Spanjës, duke e lënë emrin e tyre në gjuhën suedeze si në Gotenberg, ashtu edhe në Gotlandin, me pasuri përrallore ku "gratë tjerrin me furka floriri".

Fëmijë suedezë

[125] *Varangian Guard*, truprojet e perandorëve të mëposhtëm bizantinë të formuar prej Varangianit (më vonë duke përfshirë edhe anglo-saksonët).

Ngjashëm me këtë, prej një Norvegjie të mbipopulluar, valët e mëdha të emigracionit shpërthyen drejt fushave të Rinit dhe të Elbës. Oqeani, gjithësesi, ofronte më shumë mundësi. Kalorësit u afroheshin betejave nga deti dhe emri Viking kishte një tingull madhështor. Vikingu rrjedh prej fjalës së vjetër Norse[126] që do të thotë pirat. Askush nuk është më i pamëshirshëm se piratët. Guximtarë, plaçkitës, pengmarrës ata i vinin flakën gjithçkaje. Për dy shekuj me radhë ata u bënë tmerri i Ishujve Britanikë dhe i Francës. Më pas filluan të vendoseshin në tokat që vetë i kishin shkatërruar duke u përballur me piratë tjerë, që tani bënin mbi ta atë që kishin bërë këta vetë dikur.

Norvegjezët e sotëm trashëgojnë tërë guximin dhe mjeshtërinë detare të vikingëve, por jo barbarizmin dhe egërsinë e tyre.

Në vitin 1913 ata kanë pasur një tonazh më të madh anijesh tregtare se çdo vend tjetër përveç Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë. Emigrantët skandinavë në Shtetet e Bashkuara kanë qenë të panumërt dhe të mirëpritur.

Në vitin 1864 Prusia rrëmbeu provincën daneze të Shlesvingut dhe të Holshtainit duke përvetësuar mbi dhjetë mijë kilometra katrorë nga territori dhe një popullsi prej një milion e gjysmë banorësh.

Në mbretërinë e Danimarkës në vitin 1918 kishte rreth 3.000.000 banorë. Danimarka zotëron Groenlandën dhe Islandën. Norvegjia kishte 2.400.000 banorë në vitin 1910, Suedia 5.758.000 në vitin 1916.

Shumica dërrmuese e skandinavëve janë flokëbardhë, me sy blu, me çehre të hapur, dhe me kokë të gjatë. Në përgjithësi norvegjezët dhe danezët janë të pavarur, demokratë. Te suedezët kjo vihet re më pak.

Krishterimi, pa diskutim, qe ngulitur midis tri kombeve në shekullin e njëmbëdhjetë pas një rezistence këmbëngulëse të banorëve vendas. Tani të gjithë janë protestantë të vendosur.

Skandinavët e lashtë kanë folur një gjuhë teutonike të përbashkët të njohur si Dönsk tunga[127] e njohur prej Norvegjezëve si Norska e

[126] *Norse – Mitologjia e Norsëve*, mitologjia skandinave, mitologjia vikingase, të gjitha i referohen periudhës parakristiane të popujve norvegjezë, suedezë, islandezë dhe danezë. Ca libra e grupojnë mitologjinë finlandeze me atë norse, por librat e vjetër e ndajnë atë nga të tjerat, sado që kanë disa paralele interesante.

[127] *Dönsk tunga* – është një gjuhë gjermanike, një herë e një kohë e folur prej banorëve të Skandinavisë dhe atyre që u vendosën matanë detit gjatë Kohës së Vikingëve deri aty.

Vjetër. Norvegjezët që u vendosën në Islandë në shekullin e dhjetë e morën këtë gjuhë me vete. Brenda Norvegjisë, katër shekuj më vonë, Mbretëresha Margaret u imponoi danishten dhe norska ose norse përdoret tani vetëm prej fshatarëve. Por në Islandë gjuha e vjetër ka mbijetuar e pastër. Danishtja e folur me theks të rëndë norvegjez është, thuajse e kuptueshme në Suedi sikundër suedishtja, ndonëse me më shumë vështirësi, prapëseprapë kuptohet prej danezëve.

Thorualdsen[128], skulptor dhe Hans Kristian Andersen[129] autori i përrallave magjike kanë qenë danezë; Violinisti Ole Bull[130], zbuluesi Nansen[131] dhe Amundsen[132], zbuluesit e Polit të Jugut, ishin norvegjezë; Frederika Bremer[133] shkrimtare, Jenny Lind[134], "Bilbili Suedez" dhe Linneaus[135], babai i botanikës, ishin po ashtu suedezë.

Të tre këta kombe, ndonëse nganjëherë nën të njëjtin sovran, shpesh kanë luftuar kundër njëri-tjetrit. Nervegjia me shpirt nëse jo edhe me armë, ka mbajtur anën e Danimarkës. Tani ato nuk janë më në armiqësi. Megjithatë, këngët, dramat dhe ritregimet për fitoret mbi danezët janë përherë të pranishme dhe popullore në teatrot suedeze.

---

[128] *Bertel Thorvaldsen*, (1770-1844) skulptor danez me famë europiane.

[129] *Andersen - Hans Christian Andersen* (1805-1875), shkrimtar dhe poet i shquar danez i famshëm më shumë për përrallat e tij.

[130] *Ole Borneman Bull* (1810-1880), violinist i madh norvegjez. Ai filloi të luajë në violinë dhe të këndojë kur ishte vetëm pesë vjeç. Muzikanti i famshëm Robert Shuman e ka krahasuar atë me Nikolla Paganinin.

[131] *Fridtjof Nansen* (1861-1930), zbulues norvegjez shkencëtar dhe diplomat. Nansen mori Çmimin Nobel në vitin 1922 për punën e bërë si Komisioner i Lartë i Lidhjes së Kombeve.

[132] *Roald Engelbregt Gravning Amundsen* (1872-1928), zbulues norvegjez i rajoneve polare. Ai udhëhoqi ekspeditën e Antarktikut të viteve 1910-1912, e cila ishte e para që arriti në Polin e Jugut.

[133] *Fredrika Bremer* (1801-1865) autore dhe feministe e lindur në Finlandë dhe e rritur në Suedi. Ajo e shkeli tërë Amerikën duke studiuar influencën e demokracisë në jetën e përditshme, statusin e grave, dhe arritjet individuale. Ajo vizitoi burgje, shkolla, fabrika, dëshmoi ankandet e shitjes së skllevërve, mori pjesë në sesione të Kongresit etj. Në vitin 1853 ajo i publikoi letrat që i kishte dërguar motrës së saj për Botën e Re.

[134] *Johanna Maria Lind* (1820-1887) e njohur më shumë si Jenny Lind ishte një këngëtare e lindur në Suedi, e njohur shpesh si Bilbili Suedez.

[135] *Carl Linnaeus*, i njohur, gjithashtu, me emrin e fisnikërisë *Carl von Linné*, por që shkroi me emrin e latinizuar Carolus Linnaeus (1707-1778), ishte botanist suedez, i cili drejtoi themelet e skemës moderne të taksomonisë ose të renditjes biologjike të bimëve dhe të kafshëve. Ai njihet, gjithashtu, edhe si babai i ekologjisë.

## HOLLANDEZËT (DAÇËT)

Ky emër, dikur i kuptueshëm për të gjithë gjermanët, i cili sipas etimologjisë do të thotë popullor ose kombëtar, tani përdoret vetëm në anglisht dhe i adresohet vetëm popullit dhe gjuhës së Hollandës.



Foto nga Edgar K.Frank

Një trio e fuqishme, e zellshme e efektshme, tipike për racën e vet hollandeze. Nuk mund të tregohet me fjalë se si populli hollandez e nxori tokën me aq mundime nga deti duke ndërtuar argjinatura e diga. Ata janë populli i parë që e siguroi lirinë e mendimit. Popujt e tjerë të tëhuajtur u drejtuan drejt Amsterdamit ose Roterdamit siç bënë më vonë drejt Londrës, Gjenevës dhe Amerikës.

Vendi i tyre, duke qenë se është nën nivelin e detit, është një tokë e nxjerrë nga oqeani nëpërmjet argjinaturave të ngritura. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë ata e mundën Filipin II Spanjës, ndërkohë që ai ishte në kulmin e fuqisë së tij. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë provuan karrierën fitimtare, deri atëherë të panjohur të Luisit XIV, dhe luftuan për të zotëruar detet njësoj siç bënë edhe anglezët. Një arritje e tillë e një populli numerikisht të vogël tërhoqi vëmendjen e Europës dhe në Angli i bëri hollandezët të quheshin "daçët" e jashtëzakonshëm.

Baballarët tanë peligrinë, të persekutuar në shtëpitë e tyre, gjetën strehë në Hollandë për dymbëdhjetë vjet përpara se të lundronin për në Botën e Re me Mayflouer[136].

Konflikti i gjatë me Filipin e Dytë zbuloi dhe intensifikoi karakterin e popullit. Të gjithë hollandezët ishin të barabartë në dashurinë për lirinë. Krahinat veriore ishin bujqësore dhe të gjithë flisnin flamandçe ose frisiançe. Krahinat jugore ishin industriale dhe besonin në fenë e krishterë romake, ndërkohë që një pjesë e madhe e popullsisë fliste frëngjisht. Kjo kundërshti interesash çoi në ndarjen e vendit. Pjesa veriore u bënë Shtetet e Përgjithshme të Hollandës, ndërsa Jugu mbeti nën sundimin spanjoll ose austriak deri në kohën e Revolucionit Francez. Të mbajtura së bashku me forcë, sapo ra Napoleoni, Jugu ose krahinat belge u ndanë duke formuar për vete, në vitin 1830, Mbretërinë e Belgjikës.

Në vitin 1916 ka pasur gjithsej 6.600.000 hollandezë. Elementi i vjetër frisian është ende edhe sot i fortë në veri, ndonëse pjesërisht janë shkrirë midis hollandezëve që përbëjnë shumicën. Përkundër prurjes së të huajve karakteri i njerëzve dhe përkatësia racore kanë ndryshuar shumë pak. Hugo Grotius,[137] babai i Ligjit Ndërkombëtar dhe Erasmus[138] janë hollandezë.

---

[136] *Bota e Re* – është fjala për Amerikën, ndërsa Mayflouer është anija me të cilën ata bënë udhëtimin.

[137] *Hugo Grotius* (Huig de Groot ose Hugo de Groot) (1583-1645) ishte jurist në Republikën Hollandeze dhe themeloi fondacionin e së drejtës ndërkombëtare bazuar në ligjet e natyrës. Ai ishte, gjithashtu, filozof, dramaturg, poet dhe mendimtar i shquar.

[138] *Desiderius Erasmus Roterodamus* (1466-1536) humanist Hollandez dhe teolog i shquar.

Hollanda ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbulimin dhe në popullimin e Botës së Re. Nju Jorku, për shumë kohë ishte krahinë e Hollandës së Re; qyteti njihej si Amsterdami i Ri. Ndikimi hollandez ishte një prej faktorëve më të fuqishëm në formimin e institucioneve politike amerikane. Dy presidentë të SHBA–së kanë pasur gjyshër hollandezë.

## ZVICRA

Zviceranët e sotëm paraqesin një objekt më interesant se ç'paraqet vetë problemi i pazgjidhur i origjinës së stërgjyshërve të tyre të lashtë dhe i atyre që zunë ato toka përreth liqeneve të bukura. Ata janë pasardhës të drejtpërdrejtë të helvetëve keltikë të latinizuar, të luftëtarëve Alemani[140] të ardhur nëpër male nga veriu, të burgundianëve[141] që vinin nga perëndimi pas një qëndrimi të përkohshëm në Francë, të rhaetëve në Lindje dhe të italianëvë që arratiseshin nga Jugu. Larmia dhe zemërgjerësia qenë karakteristika të tyre që në fillim. Ishin "Njerëzit" e Urit, "Bashkësia" e Shvejzës dhe "Shoqëria" e Unter-Valden-it që hartuan "Lidhjen e Përjetshme" në gjuhën latine në vitin 1291.

Historia e Vilhelm Telit dhe Betimi i Rutlit,[142] ndonëse janë larg nga historia e vërtetë, kanë krijuar instinktin në shpirtin e një populli, i cili i fitoi "betejat e vogla të kujtesës së pavdekshme," si: Morgarten, Sembah, Nafels, Morat, Keppe[143], dhe shumë tjerë që nuk numërohen.

---

[141] *Emri i Burgundianëve* ka mbetur përherë i lidhur me një zonë në Francën e sotme, e cila ende e mban atë emër. Megjithatë, midis shekullit VI dhe XX kufijtë dhe lidhjet politike të zonës kanë ndryshuar shpesh dhe asnjë prej këtyre ndryshimeve nuk kanë të bëjnë asgjë me Burgundianët e hershëm.

[142] *Betimi i Rütl-it* - Kur Mbreti *Rudolf i Habsburgëve,* i pari Perandor Gjerman, vdiq në vitin 1291, popujt nga Uri, Shëyz dhe Underualden patën frikë se *Kontët e Habsburgëve* do të përpiqeshin që të rifitonin ndikimin mbi territoret e tyre. Kështu, ata u betuan që të ndihmonin njëri-tjetrin kundër çdokujt që do të përpiqej t'i nënshtronte. Kjo është historia e legjendës së Betimit të Rütlit (një livadh në brigjet perëndimore të Liqenit të Lucernës.) Këtu fillon edhe historia e formimit të Konfederatës Zvicerane.

[143] Morgarten. Në datën 15 nëntor1315, Konfederata Zvicerane në tërë territorin e saj mposhti ushtarët e Dukës Leopold të Austrisë në një pritë afër grykës Morgarten. Dera e Habsburgëve lakmonte zonën rreth Grykës së Gotthardit, me qëllim që të siguronin shtegkalimin më të shkurtër për në Itali, ndërkohë që Konfederata e Urit, Shvyz dhe Untervalden kishin letra lirie nga ish perandorët duke u garantuar atyre autonomi vendore

Që prej asaj kohe, Zyrihu dhe Gjeneva ishin qendra kulture, por sinonimet e heroizmit dhe të lirisë mbetën tre kantonet pyjorë.

Peizazh zviceran

brenda perandorisë. Beteja e Näfelsit, (9 prill 1388) ishte fitorja kryesore për Konfederatën Zvicerane në shekullin e parë të luftës së saj për vetëvendosje kundër pushtimit të Habsburgëve. *Beteja e Moratit* ishte një betejë në Luftërat Burgundiane, e bërë në datën 22 qershor 1467 midis Çarlit, Duka i Burgundit dhe një ushtrie zvicerane në Murten, rreth 30 kilometra larg nga Berna.

Kantonet dalngadalë janë rritur, nga tri që kishte përpara vitit 1300, në dhjetë përpara vitit 1500, të tëra në Luginën Arau deri te njëzet e dy, që janë sot. Valaisi, Njushatel dhe Gjeneva janë ato kantone që u shtuan në vitin 1815.

Pesëdhjetë e pesë përqind të banorëve janë protestantë dhe dyzet e tre përqind janë katolikë romakë. Shtatëdhjetë përqind janë gjermanfolës, njëzet e dy përqind frëngjishtfolës, gati shtatë përqind italishtfolës dhe pak më shumë se një përqind romanshfolës [143], të gjithë zviceranë të barabartë. Në kantonin e Grisonit dhe askund tjetër, flitet latinishtja, një simotër e ngathët e frëngjishtes dhe e italishtes. Prej 3.880.000 zviceranëve 550.000 janë banorë të huaj. Sipërfaqja e Zvicrës është e barabartë me atë të Merilandit dhe të Dolloveres në Shtetet e Bashkuara, të marra së bashku.

Përshtatja e interesave kantoniale, individuale dhe racore nuk kanë qenë as këtu të lehta. Zvicerianët, deri para shtatëdhjetë vjetësh kanë përjetuar mosmarrëveshje të mëdha të brendshme dhe luftë civile. Por atë që kanë dashur, një bashkim thuajse të përsosur, e kanë arritur.

Njëzet e dy "shtetet e saj të vogla, që ndryshojnë prej njëri-tjetrit thuajse në çdo pikëpamje, fetare, politike, shoqërore, fizike dhe gjuhësore", përbëjnë një republikë federative, e cila për të ruajtur mirëqenien publike, të drejtat e individit dhe harmoninë e përgjithshme, është e pakrahasueshme me çfarëdo krijese politike të ndërtuar ndër kohëra.

## ITALIANËT

Një prej mrekullive të historisë së njerëzimit është raca e jashtëzakonshme e italianëve, e cila për 2000 vjet e ka pasuruar botën

---

[143] *Romansch*, (shqiptuar, gjithashtu, *Rumantsch, Romansch* ose *Romanche*) është një prej katër gjuhëve që fliten në Zvicër bashkë me gjermanishten, italishten dhe frëngjishten. Ajo është një gjuhë amtare, e cila besohet se rrjedh prej një latinishteje vulgare të folur që prej kohës së pushtuesve romakë të rajonit dhe, si e tillë, ngjan pak si italiane dhe pak si frënge. Ajo flitet prej rreth 50-70.000 njerëzish në Kantonin e Graubundenit, kantoni i njëqind e pesëdhjetë luginave, dhe përbën vetëm 1% të popullit prej 7.4 milionësh të Zvicrës.

duke i dhënë asaj pandërprerë gjeni të mëdhenj – shpikës, muzikantë, shkrimtarë, krijues të frymëzimeve dhe të përparimit – prej të cilëve kanë përfituar tërë popujt e tjerë.

Italianët, ashtu si amerikanët, janë populli më i përzier. Askund tjetër në Europë nuk ka aq shumë elementë të huaj të përzier me elementin vendas për të dhënë një komb kaq modern. Procesi i përzierjes u bë një praktikë e vazhdueshme në Romë që prej kohës kur qyteti ishte vetëm sa Kodra Palatine[144] e deri sa ai u kthye në një perandori botërore. Që prej asaj kohe, kanë qenë rrethanat, më shumë se sa ndonjë parim bazë që e kanë përcaktuar këtë përzierje.

Foto nga A.F.Sherman
"Hapma zemrën dhe brenda saj do të gjesh të murosur Italinë".

[144] *Kodra Palatine* (*Palatium*) është kodra qendrore midis shtatë kodrave të Romës dhe është një prej pjesëve më të lashta të qytetit të Romës në Itali. Sipas legjendës, vetë Roma e ka origjinën nga Palatina.

Italianët, ashtu si amerikanët, janë populli më i përzier. Askund tjetër në Europë nuk ka aq shumë elementë të huaj të përzier me elementin vendas për të dhënë një komb kaq modern.

Qytetarët romakë janë stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të italianëve. Por jo vetëm ata. Në kohën e Krishtit shumë prej banorëve të Italisë ishin skllevër. Midis popujve të nënshtruar prej romakëve, ata ishin më të fuqishmit, fizikisht më të përsosurit, dhe më të zotët.

Njësoj si Nebuçadnezari i Jerusalemit, pushtuesit romakë zgjodhën dhe ia dolën në krye me "burra të guximshëm", me "zanatçinj dhe kovaçë", duke i lënë prapa "njerëzit më të varfër të tokës". Për shekuj të tërë në Romë mësuesit e shkollave ishin përherë skllevër, ndërsa zyrat e tyre mbanin një emër të caktuar grek. Familjet më krenare të Italisë nuk kanë pse të skuqen pse në damarët e tyre rrjedh gjaku i skllevërve romakë.

Mjeshtri i madh Rafaelo i përjetëson kështu tiparet shpirtërore të tipit greko-latin.

Rafaelo, sikundër tërë gjenitë e penelit, i merr modelet prej njerëzve që e rrethojnë. Në veprën e tij të pashoqe *Madona Sistine,* ai na jep një pamje të mrekullueshme të tipareve greko – latine.

Çdonjëri prej pushtimeve të panumërta bëhej shkak për prurje të reja njerëzore nga Veriu, që më pas mbeteshin aty.

Ndërhyrja dhe sundimi i huaj është pjesë e historisë së Italisë në rrjedhë të Mesjetës dhe deri vonë në kohët moderne. Kjo vjen duke rënë, falë përpjekjeve të izoluara, por të shkëlqyera që bënë qytet-shtetet të cilat demonstruan shkallë të lartë vetëqeverisjeje dhe rendi. Një dekurajim i përgjithshëm përshkonte të gjitha klasat e shoqërisë.

Dhe, prapëseprapë, ndërkohë që Italia po kolovitej midis anarkisë dhe despotizmit, ajo zhvilloi një gjuhë nga më të bukurat e gjuhëve moderne, një letërsi të pasur dhe të gjithanshme dhe shprehjen më të lartë të artit. Për më tepër bota i mbetet asaj borxh për shpikjet dhe zbulimet e rangut më të lartë, si dhe për ndihmesën e dhënë ndaj njerëzimit dhe shkencës induktive.

Edhe më shumë se kaq, kryeqyteti i saj i lashtë, si qendër shpirtërore e Kishës Katolike Romake, është paraqitur si i vetmi ndikim njerëzor në një epokë trazirash të përgjithshme dhe mungese ligji.

Njeriu e ka të vështirë që të kujtojë tërë emrat e italianëve të famshëm. Është thuajse, e pamundur që të zgjedhësh prej një numri kaq të madh. Nuk ka ndonjë fushë të veprimtarisë njerëzore prej së cilës Italia të mos ketë sjellë lavdi: "Nuk ka art, ku ajo të mos jetë adhuruar" – Virgjili, Markus Aurelius, Dante, Tasso, Kolumbus, Rafaelo, Mikelanxhelo, Da Vinçi, Galileo, Kanova, Savonarola, Torriçeli, Galvani, Volta, Markoni.

Në vitin 1870 ëndrrat e parealizuara për një kohë aq të gjatë, qenë realizuar dhe Italia u ribashkua. Që atëherë ajo ka jetuar nën një sistem kushtetues, i cili i ngjan atij anglez më shumë se sa ndonjë sistemi tjetër të kontinentit.

Nuk ka qenë i thjeshtë përfitimi material në territorin e rimarrë bashkë me popullin plot me energji që gjendej aty. Kjo i bëri italianët që të ndiheshin aq të lumtur kur u bashkuan me të afërmit e tyre tirolianë dhe friulianë, por edhe të gëzonin një qeverisje të drejtë, të përbashkët që do t'i emanciponte edhe ata në atdheun e tyre të përbashkët.

Italia në vitin 1917 kishte rreth 37.000.000 banorë në një sipërfaqe prej 143.000 km katrorë. Që atëherë italianët i kanë pushtuar edhe

tokat e armikut edhe Alpet edhe vëllëzërit e tyre, të cilët më parë kanë qenë nën një zgjedhë të huaj duke i nxjerrë ata nga pengu ku kishin mbetur. Shkaqet historike kanë prodhuar shumë dallime në dialekte, të cilat dalngadalë po zhduken. Dialekti toskan i Firences mbetet italishtja më e vjetër.

Siçilia dhe Sardenja janë, thuajse, të së njëjtës madhësi, rreth 16.500 kilometra katrorë; por Siçilia me 3.000.000 banorët e saj është katër herë më e madhe në popullsi.

Tre ishujt, Siçilia, Sardenja dhe Korsika – më vonë degë të Francës, kanë pasur gjatë ekzistencës së tyre aq ndërlikime, sa edhe vetë ky vend në brendësi të tij.

Në Sardenjë, të shqetësuar më pak nga pushtimet, ka shumë pak përzierje gjaku të huaj. Sardenjasit janë më të shkurtërit ndërmjet italianëve. Hence Sergi vjen në përfundimin se ata janë pasardhës të një race të hershme rramaducësh nga Afrika Qendrore. Korsika dhe Siçilia vazhdimisht janë goditur prej çdo dallge pushtimesh të Mesdheut dhe kanë rënë në zotërim të të tjerëve shumë herë. Korsika mbahet si pjesë e Francës, por në gjuhën dhe në racën e hershme i ngjan Italisë më shumë nga ç'ngjajnë Siçilia dhe Sardenja. Të gjitha, një herë e një kohë, kanë qenë banuar nga kolonitë greke. Grekët pohojnë se Bonaparti kishte origjinë greke, i quajtur në fillim si Kalemerida, që është një përkthim pikë për pikë i mbiemrit Bonaparti.

Ishullorët janë të kthjellët, të sjellshëm, krenarë, të paepur, me ndjenjë të lartë nderi. Fizikisht ata janë të fuqishëm dhe të qëndrueshëm.

## MALTEZËT

Gjuha fenikase ishte më e përhapura përpara se grekët dhe romakët të fitonin epërsinë në Mesdhe. Me perjashtim të një kolonie të formuar nga fenikasit, në të gjitha të tjerat gjuha e tyre ishte zëvendësuar ose ishte harruar. Por Malta, edhe pse është nën zotërimin britanik, edhe sot njihet po me atë emër që e thërriste Diodorus Siculus,[145] i cili

[145] *Diodorus Sicilus* ishte një historian grek i lindur në Agyrium në Sicili, tani e quajtur Agira, në Provincën e Ennas. Ai përmendet, për herë të parë, midis viteve 60 dhe 56 para erës së re.

jetonte në kohën e Krishtit - një koloni e fenikasve. Kjo mbijetesë unike e një gjuhe të shuar diku tjetër, tejkalon, për nga interesi, të gjitha pushtimet që mbahen mend dhe rrethimet që ka njohur Malta.

Popullata civile e tre ishujve, Malta, Gozo, Komino, në vitin 1917 ishte 223.741 banorë. Megjithëse aristokratët janë pjesërisht, normanë italianë ose spanjollë, njerëzit pak kanë qenë të ndikuar nga ndikimi i huaj. Ata janë, në pamje të jashtme, me përpjesëtime trupore më të rregulta dhe më të ndritshme se italianët, me fytyra shprehëse dhe, zakonisht, tërheqëse, në përgjithësi më të çelura se ato italiane. Janë të zellshëm dhe të kursyer, të kushtuar ndaj familjeve të tyre dhe Kishës Katolike Romake.

Ishujt shterpë dhe shkëmborë ofrojnë ushqim të pamjaftueshëm, kështu njerëzit detyrohen që të kërkojnë punë nëpër Levant, duke i sjellë fitimet e tyre në shtëpi pas çdo mungese. Ata pretendojnë se Hanibali ka lindur në Maltë. Sido që të jetë, ata do të pranonin ta ndërronin me at ose me Mbretëreshën Dido, madje edhe me Hiramin e Tyres[146] nëse ato personazhe të lashtësisë do të ktheheshin mbi tokë.

## RACAT E GADISHULLIT IBERIK

Gjeografia nuk njeh ndonjë rast tjetër ku dy popuj të jetojnë krah për krah, edhe pse tërësisht të ndryshëm, prapësëprapë, në shumë pikëpamje, të njëjtë, pa ndonjë shkak të dukshëm për ndarje. Natyra, që prej Pirenejve deri në Gjibraltar e që nga Mesdheu deri në Atlantik, tregon se ekziston një interes dhe përcaktim i përbashkët kombëtar. Aty nuk ka barriera të jashtme. Të njëjtat vargmale, të njëjtat lugina të thella, të njëjtët lumenj, të njëjtat trajta gjeografike…

Vetëm një mendje e hollë do të mund t'i ndante fijet e ndërthurura të qenies racore spanjolle e portugeze. Por rëndësia që kanë veç e veç, si dhe roli i madh që secila prej tyre ka luajtur në çështjet botërore,

[146] *Hiram i Tyres* – i njohur edhe si "Huram" dhe "Horam" – ishte Mbreti i Tyrës në kohën e Mbretit David dhe atij Solomon. Ndërkohë që ai ishte politikisht i lidhur me Davidin, punonjësit e Hiramit e ndihmuan popullin e Davidit që të ndërtonte pallatin e këtij të fundit në Jerusalem dhe pastaj, pasi Solomoni e trashëgoi fronin e të atit si Mbret i Izraelit, punonjësit e Hiramit morën pjesë në ndërtimin e Tempullit të Parë.

kërkon që ato të studiohen të ndara. Sidoqoftë, në fillim duhet të vlerësojmë atë që gadishulli u ka lënë atyre për trashëgim.

Tregtarët fenikas dhe grekë ose kolonizatorët dhe, madje, edhe kartagjenasit e ardhur më vonë qenë dukshëm të mirëpritur prej Iberit[147] dhe Keltiberit[148] të hershëm. Pastaj pason historia e qëndresës së pasuksesshme ndaj agresionit romak. Kur pushtuesit teutonë u derdhën mbi Pirenejtë, ata gjetën një popull tërësisht të latinizuar, që gëzonte qytetërimin e plotë të krishterë të Romës. Suebët[149] u vendosën në këndin veriperëndimor, midis Gjirit të Biskajës dhe oqeanit; vandalët u shpërndanë përgjatë vijës bregdetare jugore; visi-gotët pushtuan tërë pjesën e mbetur të vendit, madje mespërmes Pirenejve deri në Loire, në Francë.

Në një shkallë të pazakontë, gjuha, jeta dhe karakteri i spanjollëve dhe i portugezëve janë produkt i zhvillimit historik. Dhe, prapëseprapë, linja ndarëse midis tyre duket qartë deri sa vjen pushtimi prej myslimanëve saraçenë[150] dhe prej murëve[151]. Ai pushtim filloi në vitin 710 dhe përfshiu tërë gadishullin. Charlemagne, duke nxituar që t'i zmbrapste pushtuesit, u mund në Qafën e Roncesxalles dhe u kthye mbrapsht. Rezistenca e të krishterëve, ndonëse në fillim u duk e pashpresë, nuk pushoi kurrë.

---

[147] *Iberi* – emri i lashtë i asaj që sot njihet si Spanja dhe Portugalia; Gadishulli Iberik.

[148] *Celtiberi - Celtiberia,* një term i përdorur nga shkrimtarët grekë dhe romakë për të paraqitur nganjëherë tërë verilindjen e Spanjës dhe nganjëherë pjesën verilindore të pllajës qendrore të gadishullit. Ky i dyti do të ishte, ndoshta, përdorimi më i saktë. Njerëzit e kantoneve Arevaci, Clendones, Berones dhe katër të tjera kanë paraqitur rezistencën më të madhe ndaj romakëve.

[149] *Suebi* - 2000 vjet më parë Deti Balltik ishte i njohur prej romakëve si *Mare Suebicum*. Pjesërisht për shkak të mosnjohjes me popuj të ndryshëm gjermanë duke ndërvepruar me Romën në atë kohë, historiani i asaj kohe Tacitus i referohet të gjithë popujve gjermanë të lindjes si Suebi.

[150] *Muslimanët Saracenas* - Termi *Saracen* vjen nga greqishtja *sarakenoi*. Në shekujt e hershëm të Peandorisë Romake ishte përdorur si emër i një fisi arab në Sinai, në fakt i marrë nga fjala arabe *sharqiyyin (lindorët)*. Pas lindjes së islamit dhe veçanërisht në kohën e Kryqëzatave, përdorimi i këtij termi u shoqërua me fjalën *myslimanë*, veçanërisht për ata në Sicili dhe në Italinë e Jugut. Në letërsinë e vjetër perëndimore, termi "Perandoria Saracene" është përdorur shpesh duke iu referuar *Kalifatit Arab,* të udhëhequr nga dinastitë Amayad dhe Abbasid.

[151] *Moors – Maurët* ishin banorë myslimanë të Mesjetës të al-Andalus (Gadishulli Iberik), ku përfshihen edhe Spanja dhe Portugalia e sotme dhe Magrebi, kultura e të cilëve njihet me emrin "Murish".

## PORTUGEZËT

Poetët portugezë ia atribuojnë ndarjen e kombit dhe të gjuhës së tyre Lusitanit[152], i cili një herë e një kohë, pushtoi perëndimin e gadishullit, duke shkuar drejt veriut deri në Duoro. Të paktën Lusitania,[153] ky emër që ka mundësi të jetë latin, rrjedh prej tyre.

Portuglia ka lindur në fushëbetejë në epokën e kalorësisë. Lufta kundër të pafeve, e cila paradaton kryqëzatat tërhoqi më shumë kalorësit e botës së krishterë. Midis tyre ishte Henri i Burgundit i cili gjendej në një situatë pak më të pavolitshme se Alfonsio i Kastiljes, që ia shpërbleu trimërinë dhe guximin me dhënien e dorës së vajzës së tij dhe e bëri atë Kont të Portit Kale në Douro. I biri i Henrit, Alfonsi, për habinë e të gjithëve, u shkaktoi një humbje të madhe murëve në Ourik në vitin 1139. Ushtarët e tij të ngazëllyer e shpallën atë Mbret të *Portus Kalesë,* që më vonë u njoh me emrin *Portugali.*

Henri e refuzoi kurorën e dhënë vetëm nga ushtria. Për të shmangur ngurrimin e tij, u organizua një festë e madhe. Ajo ishte një ngjarje madhështore. Për herë të parë në historinë e Europës, pëfaqësuesit e popullit të thjeshtë u ulën dhe vepruan si të barabartë me klerin dhe me fisnikët.

Ai tubim tregoi instinktin e një kombi që sapo lindte. Dekretet e tij përsëriten shpesh në Portugali dhe në portugalisht dhe ende tingëllojnë si fjalë të këndshme. Sulmet e Kastiljes, që i quanin portugezët rebelë vasalë, e bashkuan kombin. Dialekti i tyre më pak tingëllues, më shumë hundor me theks perëndimor, deri atëherë i përçmuar, tani po inkurajohej si shenjë e qenies së një kombi.

---

[152] *Lusitani – Lusitianët* (ose *Lusitani* në latinisht ) ishin një fis ose fise të ndryshme nga pjesa perëndimore e Gadishullit Iberik (Provinca e Lusitianës), të cilët flisnin gjuhën lusitane deri sa u pushtuan prej romakëve. Lusitianët janë parë si stërgjyshërit e portugezëve të sotëm që jetojnë në pjesën perëndimore të Gadishullit Iberik. Më e njohur midis lusitianëve ishte Viriathus.

[153] *Lusitania* – një provincë romake, që, afërsisht, përfshin Portugalinë dhe pjesë të Spanjës së sotme (në mënyrë të veçantë bashkësia e sotme autonome Extremadure), e cila ka marrë emrin Lusitani, ose lusitianët. Ata ishin luftëtarë të mëdhenj, origjina e të cilëve nuk dihet aq mirë.

Portugezët kanë qenë gjithmonë një popull krenar dhe luftarak. Shpirti i asaj asambleje demokratike të parë, madje edhe kur është dukur si e errësuar, nuk ka humbur tërësisht. Ishte ai shpirt që, më në fund, i përzuri myslimanët dhe e zgjeroi gjuhën e tyre përtej kufijve natyrorë. Ajo e paraqiti Portugalinë e shekullit të pesëmbëdhjetë si fuqinë me aftësinë lundruese, tregtare dhe kolonialiste më të madhe në botë. Dërgoi Diazin[154], De Gamën[155] dhe Magelanin[156] anë e mbanë deteve. Në udhëtimin e tyre të gjatë rreth e rreth botës, ata bindën njerëzimin se toka ishte e rrumbullakët. Ishte po ai shpirt luftarak, që i nxiti bijtë e Portugalisë që të bënin pjesën e tyre të luftës së Falnderëve dhe i bëri ata bashkëpunëtorë në sakrifica dhe fitore. Kamoensi,[157] shkrimtari i famshëm portugez, i frymëzuar nga dashuria për vendin në "Lusiadis"[158] mishëroi "epikën e zbulimeve" dhe i dha formë dhe e stabilizoi gjuhën portugeze. Letërsia portugeze edhe sot quhet "*E Folura e Kameonit*". Veprat e tij ndonëse më pak krijuese se ato të Dantes, vazhdojnë t'i qëndrojnë kohës.

## SPANJOLLËT

Gadishulli u përpëlit nën thundrën e myslimanëve për tetëqind vjet. Nuk ka komb tjetër që të ketë mishëruar një tragjedi kombëtare kaq të zgjatur. Portugezët, më në perëndim, vuajtën më pak në intesitetin

---

[154] *Bartolomeu Dias* – Lundërtar i famshëm i shekullit të pesëmbëdhjetë, zbuluesi i Kepit të Shpresës së Mirë. Vdiq në det në datën 29 maj 1500.

[155] *Vasco de Gama* – zbuluesi e rrugës detare drejt Indisë, i lindur në Sines, Provinca e Alemtejos, Portugali, aty rreth vitit 1469. Vdiq në 24 dhjetor 1524 në Koçin, Indi.

[156] *Ferdinand Magellan* (1480-1521) ishte një zbulues portugez, i cili lundronte nga Spanja. Ai ishte i pari që lundroi nga Europa në drejtim të Azisë, i pari europian që lundroi në Oqeanin Paqësor dhe i pari që drejtoi një ekspeditë me qëllim që t'i binte globit rreth e qark. Ndonëse Magelani vetë vdiq në Filipine për të mos u kthyer kurrë më në Europë, 18 pjesëtarë të ekipit dhe një anije e flotës së tij u kthyen në Spanjë në vitin 1522.

[157] *Camoens*, Luiz Vaz 1524-1580, poet portugez i lindur në Lisbonë. Ai udhëtoi nëpërmjet Detit të Kuq në Persi dhe në Mozambik dhe kaloi disa vite në Goa, Indi. Pas kthimit në Lisbonë në vitin 1572, ai botoi poemën "Lusiadët", duke rikujtuar udhëtimet e Vasko De Gamës – një vepër e cila mori karakter epik kombëtar në Portugali.

[158] *Lusiadis* do të thotë "portugez", i cili vjen nga fjala Lusitania, emri i vjetër romak për Portugalinë.

e luftës, gjë e cila u ndërthur në karakterin e shpirtit spanjoll. Edhe sot e kësaj dite fshatarët spanjollë i drejtohen njëri-tjetrit me emrin *caballero* ose kalorës. Lufta përpunoi bindje të tilla të rrepta dhe të thella fetare të cilat gjetën shprehje te Torquemada[159] dhe tek inkuizicioni.[160]Thelbi i tyre ishte që të mos pranonin në truallin spanjoll njerëz të një feje tjetër, siç janë hebrenjtë dhe murët. Ferdinanti dhe Isabela,[161] iu bashkuan sovranëve të Spanjës së ribashkuar dhe i dhanë goditjen e fundit myslimanëve në Granada në vitin 1492.

Prej atij kampi në Granadën Kolumbus, me porosi të mbretëreshës, filluan udhëtimet që i sollën Europës zbulimin e Botës së Re. Spanjollëve dhe portugezëve u takon lavdia për zbulimet epokale të bëra prej atij brezi të mahnitshëm burrash të guximshëm. Edhe kombe të tjera u përpoqën të mateshin me ta në këtë fushë, por pa sukses.

Rënia prej vendit të parë që mbante Spanja dhe humbja e pavarësisë nga portugezët, i bien barrë sundimit të Filipit të Dytë, stërnip i Ferdinantit dhe i Isabelës.

Shumë pushtime të gadishullit ndihmuan në shtimin e racës origjinale iberike. Mbretëritë kristiane zhvilluan doke, zakone dhe karaktere të ndryshme. Kështu bëri çdo krahinë ose rajon.

---

[159] *Tomás de Torquemada* - (1420–98), prift dhe inkuizitor i përgjithshëm i Kastiljes dhe i Aragónit. Ai ndihmoi shumë për ta sjellë çështjen e hebrenjve deri në dëbimin e tyre të plotë në vitin 1492. Reputacioni i tij është i lidhur me mizorinë ndaj rregullave të rrepta të procedurave që ai i shpikte për inkuizicionin dhe për format e përdorura për dëbimin e tyre të detyrueshëm.

[160] *Inkuzicioni* – (Latinisht: *Inquisitio Haereticae Pravitatis Sanctum Officium*) ishte një zyrë e Kishës Katolike Romake e ngarkuar për shtypjen e herezisë. Veprimet e saj dhe ndërveprimet me pushtetin vendor janë objekt i një kërkimi të mjaft të madh historik. Inkuizicioni spanjoll, në fund të shekullit të 15 – të nën Ferdinantin dhe Isabelën u bë i pavarur prej Romës. Në luftën e tyre ndaj myslimanëve, hebrenjve dhe të gjithë iluministëve Inkuizicioni Spanjoll me të ashtuquajturën "auto de fe" përfaqëson një periudhë famëkeqe në histori.

[161] *Ferdinanti dhe Isabela* – Monarkë katolikë që mbajnë një titull të përbashkët, i përdorur në histori për Mbretëreshën Isabela I të Kastiljës dhe Mbretin Ferdinant II të Aragonit. Ata u martuan në vitin 1469, duke i bashkuar dy kurorat dhe, më në fund, nëpërmjet pasardhësve, krijuan Mbretërinë e Spanjës. Titulli "Mbreti Katolik" i qe dhuruar prej Papës Aleksandër VI. Një ndër trashëgimitë e tyre të njohura është inkuizicioni, të cilin ata e krijuan me dekret të posaçëm duke persekutuar ose shndërruar në fenë katolike hebrenjtë sefardikë. Mótoja e tyre ishte "Tanto monta, manto tanto" (Ajo vlen kështu, kështu ajo vlen) (It amounts so, so it amounts) .

Në jug fare, Andaluzia, emri i së cilës vjen nga pushtuesit vandalë, ka qenë pjesërisht ose tërësisht e pushtuar nga fenikasit, kartagjenasit, romakët, vandalët, suebët, gotët, hebrenjtë, murët dhe arabët. Aty është zhvilluar një tip oriental, i pashëm dhe i butë, i këndshëm dhe i zgjuar.

Austurianët[162] mund të kenë të drejtë të jenë krenarë. Vargmalet e tyre janë i vetmi rajon në të gjithë gadishullin, të cilën muslimanët nuk ia dolën që ta mposhtnin. Shpella e Kovadonjës,[163] prej nga filloi ripushtimi kristian i Spanjës, është shenjtëruar si Shpella Zvicerane e Rutlit. Që prej vitit 1388 titulli i trashëgimtarit të kurorës spanjolle ka qenë Princi i Asturias dhe, pas kurorëzimit, mbreti bëhej Konti i Kovadonjës. Të izoluar, punëtorë të mëdhenj, nikoqirë, të lënë në varfëri prej ligjeve të ashpra për tokën dhe për taksat, ata e mbajtën lart shpirtin e tyre të pavarësisë dhe krenarinë e historisë dhe të racës.

Midis katalanëve, njeriu shpesh vë re sytë blu, flokët e verdhë dhe çehren e hapur, tregues atavistik të stërgjyshërisë gotike. Gjuha e folur ndryshon nga spanjishtja dhe përbën, pjesërisht, një dialekt të harruar *provençal*. Në këtë gjuhë rapsodët këndojnë këngët e tyre të fundit të mbajtura mend nga koha kur u dëbuan nga Franca. Katalonja është një vend i mbushur me industri të të gjitha llojeve dhe të pajisura shumë mirë. Ndërmarrjet me gamë të madhe prodhimi të Katalonjës e kanë bërë Barcelonën, përkundër pengesave natyrore, një qytet prej 630.000 banorësh dhe kryeqytetin tregtar dhe industrial të Spanjës. Ata janë të njohur për shpirtin e tyre të kundërshtimit të menjëhershëm.

---

[162] *Asturians* – Ky emër rrjedh prej një populli iberik që jetonte aty përpara pushtimit romak (shekulli II para erës së re). Kur Murët e mbushën gadishullin, fisnikët e krishterë ia mbathën për në malet e Asturianëve. Ata krijuan të parën mbretëri të krishterë të Spanjës dhe e mbrojtën veten në betejën e Covadonjas. Nga Asturia erdhi pushtimi kristian i Spanjës. Si pasardhës Alfonso I e shtriu kontrollin e tij mbi Asturia, Galica, León dhe pjesë të Kastiles, Navarros dhe Viscayas. Astoga ishte një prej qyteteve kryesore të Mbretërisë së Asturias në shekullin e 9 – të.

[163] *Shpella e Kavadonjas* gjendet në një fshat të quajtur Ovideo në Veri të Spanjës. Një betejë u zhvillua aty afër midis vitit 718 dhe 725, që ishte e para fitore e të krishterëve mbi murët. Kjo kishte një kuptim të thellë simbolik në ripushtimin e Spanjës. Ky fshat tërheq shumë turistë. Sipas legjendave thuhet se Shpella afër Kavadonjës strehoi mbretin Pelayo. Kisha e shpellës e ka fillimin në shekullin e tetë.

Një zonjushë e Seviljes

Kjo vajzë e pasionuar pas Terpsçikores është diplomuar në njërën prej akademive më të famshme të vallëzimit në Europë. Për spanjollët, ashtu si dhe për rusët, vallëzimi është pjesë e krenarisë së tyre, jo vetëm kombëtare, por edhe mjeshtërore.

Kastilianët zënë territor të gjerë rreth Madridit. Aty gjendet gjuha më e pastër spanjolle, mjeti dhe prova e letërsisë së shkëlqyer. Ata janë tepër krenarë, të kulturuar, dashurues të artit. Admirali fisnik Kervera ishte Kastilian, Servantes dhe Lope De Vega, Velaskues dhe Murillo janë emrat më të mëdhenj të letërsisë dhe të artit spanjoll.

Pesëmbëdhjetë ishujt Balearik[164] kanë 320.000 banorë, të tërë spanjollë. Murët që i mbanin ishujt për më shumë se katërqind vjet, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në pamjen fizike, gjuhën dhe zakonet e njerëzve. Gjuha është po ashtu e përzier me atë provençale.

[164] Balearic, *Balearicus*, *Balearis* – një grup ishujsh larg brigjeve lindore të Spanjës, i përbërë prej Majorkës, Minorkës, Ibizës dhe Formenterës, si dhe prej shtatë ishujsh të tjerë më të vegjël.

Meqenëse Spanja dhe Portugalia, së bashku, ndajnë në mënyrë paqësore më të shumtët e gadishujve mesdhetarë, të njëjtën gjë bëjnë edhe pinjollët e tyre në Hemisferën Perëndimore. Që nga Rio Grande del Norto deri te fundi i Kepit Horn, e tërë Meksika, Amerika Qendrore dhe Jugu i Amerikës, me përjashtim të zonës së Kanalit të Panamasë, që është nën ndikimin e Shteteve të Bashkuara dhe Guajana Britanike-Franceze - hollandeze, janë të sunduar prej gjuhës dhe qytetërimit portugez dhe spanjoll.

## FRANCEZËT

Francezët kanë personalitetin më të dalluar midis popujve të Europës. Kjo vjen, pjesërisht, për shkak të kompleksitetit të origjinës së tyre dhe të situatës krejt të veçantë të vendit ku ata e banojnë. Nëpër shekuj ata janë pjellë e zhvillimit të elementit bazë kelt, i depërtuar më herët prej qytetërimit greko-latin dhe më pas i plotësuar nga teutonët. Nuk ka komb tjetër në Europë, ku këto tri raca të mëdha t'i kenë kontribuar kaq shumë sa kombit francez. Kjo ndihmesë është e ngulur thellë në karakterin e francezit.

Franca është një rrip territorial që lidh Europën Qendrore me atë Jugperëndimore. E vendosur midis Atlantikut dhe Mesdheut, lumenjtë e saj rrjedhin në të dyja anët në drejtim të kundërt me njëri - tjetrin. Prej kësaj ajo bëhet rrugë kalimi natyrore e tregtisë dhe e ideve. Nuk ka një ide të madhe në botë që të mos e ketë origjinën ose të ketë kaluar nëpër Francë. Madje, edhe ide të lindura diku tjetër kanë gjetur zhvillimin më të madh në Francë.

Jo të gjithë francezët flasin frëngjisht. Në cepat e Francës gjenden katër grupe të ndryshme, gjuha amtare e të cilëve nuk është ajo frënge. Ata janë 200.000 flamandë afër ngushticës së Doverit; 200.000 në jugperëndimin e largët të vendit; 250.000 katalanë në juglindje të Pirenejve; dhe 1.000.000 britons në Britoni – të gjithë njësoj patriotë francezë.

Bretonët janë keltë. Gadishulli i tyre i thepisur ka qenë quajtur Armorika. Ardhja masive e britonëve nga Britania e Madhe për të shpëtuar nga anglot dhe saksonët, jo vetëm që e dyfishoi numrin e banorëve, por i dha edhe emrin. Sipërfaqja e gadishullit është më pak se 17.000 kilometra katrorë e, megjithatë, në asnjë rajon të botës, me

një madhësi sa kjo, nuk ka keltishtfolës me shumicë si aty. Por edhe këtu ata, në mënyrë të vazhdueshme, po zvogëlohen.

Disa etnologë të kohëve të fundit, duke i bazuar përfundimet e tyre në kafkat e gjetura në vend e vënë në pikëpyetje nëse bretonët janë vertetë keltë apo jo. Deri sa të dalin argumente më bindëse që vërtetojnë të kundërtën e kësaj, çdokush ka të drejtë që t'i çmojë bretonët pjesëtarë të vlefshëm të racës kelte. Ata janë të thjeshtë dhe naivë, konservatorë, fetarë, që s'e njohin frikën, të pavarur dhe të gjallë.

E folura *d'Oui* dhe ajo *d'Oc* të shënuara në hartë, nuk përfaqësojnë thjesht dallime të zakonshme mesjetare lokale në mënyrën e të thënit PO në gjuhën frënge. Të dyja janë të trashëguara, njëra prej Mbretërisë Frënge Merovingiane,[165] e cila nuk mundi të shtrihej më larg se deri në Loire dhe tjetra prej Mbretërisë Visi-Gotike, e cila u shtri drejt Pirenejve përgjatë vijës bregdetare lindore të Spanjës dhe mbi të gjitha nga Provenca romake. Të dyja del se kenë dallime fizike dhe dallime në temperament, të cilat karakterizojnë edhe veriun edhe jugun e vendit.

Ndaj përbërjes etnike së kësaj të fundit, nuk kanë kontribuar vetëm keltët, latinët dhe teutonët, por edhe liguriansët[166] parahistorikë, kolonët grekë dhe fenikas, murët dhe saraçinët spanjollë. Që këtej u zhvillua dialekti i pasuruar, i rrëmbyeshëm, i cili u bë mjeti më i përshtatshëm për rapsodët dhe për romancat e hershme.

Por diku tjetër në një ishull të vogël të Senës, ku njëherë e një kohë mblidhej tërë Parisi, nisi të flitej një dialekt i veçantë. Ai dialekt do të bëhej gjuha frënge e vërtetë.

Edhe sikur gjithë historitë e Francës të ishin zhdukur, historia si e tërë do të mbijetonte në fazat e mëpastajme të së folurës *d'Oui*. Në vitin 1515 Franci i Parë e dekretoi frëngjishten e Parisit, tashmë një

---

[165] *Merovingianët* ishin dinasti e mbretërve francezë, të cilët e udhëhoqën një zonë shpesh të ndryshueshme në pjesën e sotme franceze dhe gjermane nga shekulliV deri në shekullin VIII të erës së re. Bashkëkohësit shpesh u referoheshin atyre si mbretërit "flokëgjatë" për shkak të flokëve të tyre, simbolikisht, të paqethura.

[166] *Liguriansët* – ishin një popull i lashtë, të cilët i dhanë emrin Ligurias, që, një herë e një kohë, shtrihej nga Italia veriore deri në jug të Galicisë. Ata popullonin ato pjesë që sot njihen si Liguria, Toskana veriore, Piemonti, Lombardia dhe pjesë të Francës jugore. Njihen si popull indoeuropian, të afërt me iberikët.

gjuhë popullore, si gjuhën zyrtare të vendit. E saktë, e plotë, e aftë të shprehë çdo lloj trajte dhe lakimi, çdo lloj mënyre të mirësjelljes, ajo shumë shpejt u bë mjeti i përdorimit në diplomaci dhe në marrëdhënie ndërkombëtare.

Është thënë: "Gjuha frënge e ka bërë kombin Francez". Do të ishte më saktë po të themi se luftuan së bashku drejt pjekurisë krah për krah. Është, pikërisht, gjuha ajo që e bën francezin të jetë aq i qartë, shoqëror, tërheqës e simpatik. Katërqind vjet më parë, udhëtari më kozmopolit, Marko Pollo[167] i mbyllur në burgun e tij gjenovez, për të tërhequr vëmendjen e botës, vendosi që frëngjishtja të ishte gjuha e përshtatshme, në të cilën ai do t'i shkruante historitë e ecejakeve të veta. Nuk mund të mendohet për letërsinë dhe për shkencën franceze pa përmendur arritjet e tyre të panumërta në çdo fushë të mendimit dhe të industrisë, pa përmendur emra, si: Paster, Lavuazje, Kuvier, Volter, Ruso, Roza Bonheur, Molier, Racine, Kornellie, Viktor Hygo, Balzak, Ampere. Në vend të kësaj do të na dilte përpara një pamje e paqartë e burrave dhe e grave franceze në rrjedhën e pafund të viteve. Ata janë të mbuluar me lavdi që tejkalon tërë lavditë e së kaluarës.

Një poet i madh, jofrancez, njëherë e një kohë, shkruante: "Franca është ushtar i zotit". Për më shumë se katërmbëdhjetë shekuj, ajo është parë tek vepron, tek lufton, tek pushton botën. Në truallin e saj bijtë dhe bijat e këtij vendi zhvilluan beteja vendimtare si ajo e Chalons[168], në vitin 451, betejë e cila theu hunët; beteja e Tuors[169] më 732, e cila i zmbrapsi

---

[167] *Marko Pollo* lindi në vitin 1254. Ai jetoi në Venecia. Babai i tij, Nikolla Pollo, kishte ikur ende pa lindur i biri Marko Pollo. Kur u kthye, i biri ishte bërë 14 vjeç. Marko jetoi në Venecia. Në udhëtimin e vet të radhës, Marko shkoi me të atin ku vizituan vende të ndryshme të botës. Kur u kthye, ai i tregoi përshtypjet e veta, por askush nuk e besoi. Kjo e bëri atë të famshëm. Në çastet e fundit të jetës një prift e pyeti në kishin qenë të vërteta tërë ato që kishte treguar, ai u përgjigj: "Nuk kam mundur të tregoj as gjysmën e tyre". Këto ishin fjalët e tij të fundit.

[168] *Beteja e Chalonëve* – e quajtur gjithashtu Beteja e Fushës Catalaunian ose Beteja e Catalumit, u zhvillua në vitin 451 midis forcave të aleatëve dhe trupave të përbashkëta të udhëhequra nga gjenerali romak Aetius dhe mbretit visi-got Theodorik nga njëra anë dhe Hunëve të udhëhequr nga mbreti i tyre Atila dhe aleatët e tyre nga ana tjetër. Kjo betejë ishte operacioni i fundit i madh i Perandorisë Romake të Perëndimit.

[169] *Beteja e Toursit* (shpesh e njohur si *Beteja e Poitiersit),* u zhvillua në datën 25 tetor 732 ndërmjet udhëheqësit frank Carl Martel dhe një ushtrie islamike të udhëhequr prej Emir Abd er Rahman. Frankët e fituan betejën dhe e vranë Rahmanin. Kjo bëri që të ndalej përparimi i islamëve nga Spanja drejt veriut.

myslimanët e Valmit[170] më 1792 e cila fillon "një epokë të re të historisë së njerëzimit" dhe ajo e Marnes,[171] që shtypi një armik që ishte më i pathyeshëm dhe më i frikshëm se vetë myslimanët dhe hunët.

Njerëzimi i është borxh Francës për jetë.

## BASKËT

Baskët janë një popull interesant, të cilët jetojnë në dyja anët e Pirenejve qëndrore, në Francë, në Spanjë, si dhe në juglindje të Gjirit të Biskajës. Numri i tyre është rreth 700.000 frymë prej të cilëve, 100.000 kanë emigruar në Amerikë, të shumtët në Argjentinë dhe në Kili dhe, fatkeqësisht, vetëm pak prej tyre në Shtetet e Bashkuara.

Ata e quajnë veten eskualdanak, zotëruesit e Eskuaras,[172] gjuhës së tyre amtare. Kjo gjuhë, plotësisht e veçantë nga çdo gjuhë tjetër në Europë, është një gjëagjëzë që gjuhëtarët nuk e kanë zgjidhur dot. Disa thonë se gramatika e saj të kujton gjuhën magjare ose atë finlandeze. Të tjerë e shohin atë si një formë moderne të iberishtes së vdekur. Ata përdorin alfabet latin dhe mund të flasin si frëngjisht, ashtu edhe spanjisht. Origjina e tyre është fshehur në paqartësinë që ka shkaktuar koha.

Ndonëse e njohin veten si bij të përkushtuar të Kishës Romake, ata nuk u lejojnë klerikëve që të përzihen në çështjet politike dhe administrative. Priftërinjtë dhe juristët, të cilët dihet se priren drejt despotizmit, nuk zgjidhen në juntën e tyre. Konservatorë, krenarë dhe me respekt ndaj vetes ata nuk falin kur është fjala për të drejtat e tyre.

Shprehja e njohur, *"çdo bask një fisnik"* justifikohet me karakterin e tyre. Me një pamje fizike të shkëlqyer, ata janë punëtorë të palodhur, lundërtarë të mahnitshëm, ushtarë të aftë dhe trima të paepur. Nga

---

[170] *Beteja e Valmit* (The Battle ofValmy) 20 shtator 1792, shënoi një pikë kthese në luftërat e shoqëruara me Revolucionin Francez.

[171] *Beteja e Marnës* (Battle of Marne 1914-1918), u zhvillua në datën 15 shtator 1918, ku morën pjesë nëntë divizione nga SHBA, nën komandën franceze, të drejtuara nga Marshalli Ferdinant Foch nga njëra anë dhe armata gjermane e parë, e tretë, e shtatë dhe e nëntë e forcave gjermane. Kjo shënoi fitoren e parë të Aleancës në ofensivën e vitit 1918.

[172] *Gjuha Eskuara* – Gjuhë baske e cila përcakton edhe vetë kulturën baske, që quhet Eskuara.

*Bilbaoi*, qendra e tyre industriale, rrjedh fjala *bilbo,*[173] fjalë e vjetër angleze për shpatën. *Bayonne*, një emër i një qyteti tjetër bask vjen nga fjala *bajonetë*.

Ignatus Loyola[174] themelues i Urdhrit të Jezuit dhe të Shën Francis Havier[175] misionarë të njohur ishin baskë. Ky i fundit megjithëse me sy të kaltër, me flokë bjondë dhe me mjekër, me gjatësi që mezi e kapte një metër e gjysmë, nuk u ngjante bashkatdhetarëve të tij të zeshkët, shtatlartë e të fuqishëm. Marshalli Fosh[176] Gjeneralizmi i Forcave Aleate është një bask më tipik.

## BELGËT

Frëngët e Belgjikës dhe flemingët

Mbretëria e Belgjikës zë fill që në vitin 1830 kur shtatë krahina të krishtera u ngritën në revoltë kundër bashkimit me Mbretërinë e Hollandës. Shpirti i pavarur dhe lufta për të drejtat e veta është ruajtur mirë te këta popuj heroikë.

Belgët e lashtë e pushtuan gjithë Gaulinë[177] nga veriu i Senës dhe perëndimi i Rinit. Rheimsët, soisonsetët, amiennsët dhe bellavacët i përjetësuan emrat e Remit, Suesiones, Ambianit dhe Bellovaci[178], fiset luftarake që luftuan kundër Qezarit.

---

[173] *Bilbo* – një shpatë e hollë me teh të mprehtë, e fortë por e përkulshme.

[174] *Ignatus Loyola*, Shën Ignatius i Loyolas, i njohur edhe si Íñigo López de Loyola (1491 – 1556), ishte themeluesi dhe eprori i përgjithshëm i Shoqërisë së Jezusit, një urdhër fetar i Kishës Katolike Romake, e cila i shërbente drejtpërsëdrejti Papës. Pjesëtarët e atij urdhri quheshin Jezuitë.

[175] *Shën Francis Havier,* i lindur në vitin 1506 në mbretërinë spanjolle të Navaros. Gjuha e tij amtare, ashtu sikundër edhe e Shën Igbatius Loyola ishte baske. Ai trashëgoi një temperament krenar dhe pasionant si raca e tij.

[176] *Marshalli Foch,* lindur në vitin 1851 në Tarbes në Hautes – Oienej. Ai mori pjesë në Luftën Franko Prusiane të vitit 1870-1871.

[177] *Gaul,* banor vendas i Galisë së lashtë, një rajon që i korrespondon afërsisht Francës së sotme dhe Belgjikës me pjesë në Gjermani dhe në Hollandë, më parë edhe në Italinë e veriut.

[178] *Remit, Suesiones, Ambiani* dhe *Bellovaci* ishin fiset verilindore më të fuqishme dhe më të shumta në numër të Belgjikës të pushtuara prej Jul Qesarit në vitin 57 para erës së re. Ai emër ka mbijetuar edhe sot në qytetin francez të Beauvias.

Belgët tani përbëhen nga dy grupe kryesore: nga njëra anë frëngët e Belgjikës dhe nga tjetra uallunët dhe flemingët.

Uallunët, që në gjuhën e vjetër teutonike do të thotë i *huaj*, gjenden në jug të Belgjikës, ku janë Liege dhe Namur mbi Muese, në pjesën veriore të Francës me qytetet e saj, Lille, Douai, Kambrai dhe Valencienes dhe në disa fshatra të Rinit. Ata flasin frëngjisht dhe kanë tërheqje të madhe ndaj Francës.

Flemingët janë numerikisht më shumë, dhe zënë pjesën më të madhe të mbretërisë, si dhe brigjet detare të veriut me Dunkirkun. Ata flasin flamandçe që është një dialekt gjerman. Duke qenë gjermanë në prejardhje ata janë, mbi të gjitha, të ndjeshëm në çështjen kombëtare dhe i kanë arritur uallunët në guxim dhe në përkushtim. Gjatë luftës së fundit, gjermanët përdorën çdo lloj mjeti për t'i tëhuajtur ata prej uallunëve, por pa sukses.

Në vitin 1910 prej 7.571.000 belgëve, 3.221.000 flisnin vetëm flamandçe, 2.833.000 vetëm frëngjisht dhe 871.000 edhe frëngjisht edhe flamandçe. Qeveria belge, në fillim, e kundërshtoi idenë e të folurit flamandçe si gjuhë zyrtare, por në vitin 1878 ajo qe bërë e barabartë me frëngjishten në gjykata dhe në administratë dhe në vitin 1883 edhe në shkolla. Provincat flamande u bënë kështu dy-gjuhësore.

E drejta e plotë fetare është e siguruar. Shumica e popullsisë mendohet të jetë katolike romake, por që në vitin 1891 regjistrimet nuk e përfshijnë pyetjen në lidhje me profesionin dhe as lidhjet shpirtërore.

Në fillim të Luftës Botërore[179], në vitin 1914 mbretëria kishte një sipërfaqe prej 18.537 km katrorë. Konferenca e Fuqive të Mëdha në vitin 1831 përcaktoi kufijtë midis Belgjikës dhe Hollandës. Ndonëse e detyruar prej rrethanash të caktuara që të njihte pavarësinë e Belgjikës, konferenca nuk mbajti anën e autorëve të revolucionit. Për rrjedhojë vija kufitare u tërhoq në dëm të belgëve. Hollandezëve iu dhanë territore në lindje të Lumit Meuse të banuara prej njerëzish që ishin

[179] Autori i referohet *Luftës së Parë Botërore* me emërtimin Luftë Botërore, pasi deri atëherë kishte ndodhur vetëm një luftë e tillë. Më vonë ndodhi e Dyta, e cila i klasifikon tani këto luftëra me numra e Para, e Dyta. Dhëntë zoti nuk do të kete të tretë.

pro-belgë deri në vdekje; kështu ndodhi edhe me dy brigjet e Lumit Sheldt duke e prerë daljen në det të Portit të Madh të Adverpit, përveçse nëpërmjet ujrave hollandeze. Askush nuk dyshon se kjo padrejtësi duhet ndrequr. Gjashtëmbëdhjetë vjet më parë në librin e tij, "Racat e Gjalla të Europës", Hatçinson[180] pat thënë se "Tek belgët, trimëria, zgjuarsia dhe energjia janë më të fuqishme se kurrë". Ata dallohen sot në paqe aq sa dalloheshin në të shkuarën në artin e luftës. Ata tani paraqesin një pamje tërheqëse të një populli të vogël, me mirëqenie të lartë, paqësorë dhe të rehatuar në çdo pikëpamje.

Dy fjalitë e para janë ende të vërteta. Ato veç sa janë intensifikuar më shumë. Kuptimin e fjalisë së tretë i mbetet Europës dhe Amerikës që ta restaurojë.

## IRLANDEZËT

Fjala irlandez rrjedh nga fjala poetike *Erin*, e cila tani ka kuptimin poetik të fjalës Irlandë. Mitet dhe legjendat nuk mungojnë në lidhje me origjinën e popullit irlandez, por prapëseprapë nuk dihet mirë rreth origjinës së tyre përpara shekullit të pestë. Ndoshta ata rrjedhin prej Milesianëve,[181] të cilët kanë ardhur prej andej ku askush nuk mund të thotë se nga dhe, me sa duket, e kanë mbajtur pjesën më të madhe të ishullit nën pushtim.

Irlandezët sikundër edhe skocezët gaelikë dhe disa banorë të Ishullit të Man-it i takojnë Goedilikut ose degës së Gaelikut të familjes kelte. Ky element kelt i jep qëndrueshmërinë karakterit irlandez dhe e bën atë faktorin kryesor të historisë irlandeze. Megjithatë, është e vërtetë se pak popuj janë më të përzier se irlandezët. Në strukturën e tyre gjenden anglezë, skocezë, uellsas, danezë, norvegjezë dhe francezë. Luftërat shfarosëse shkaktuan largime masive nga vendi, si dhe rekrutimin e më shumë se 400.000 irlandezëve në ushtritë europiane

---

[180] Hutchinson

[181] *Milesians* – ose Libri i *Gabhálës* (Libri i Pushtimeve) është libri më i rëndësishëm i shënimeve për historinë legjendare të Irlandës dhe të Gaelas. I shkruar në shekullin XI, ai është vlerësuar të jetë "i një rëndësie themelore dhe të qëndrueshme në formimin e mendimit historik irlandez".

gjatë një harku kohor prej gjashtëdhjetë vjetësh, duke e shterruar popullsinë vendase. Kolonizimi, i përsëritur shumë herë, solli një mori të huajsh dhe kjo, domosdoshmërisht, ka çrregulluar ekuilibrin e jetës racore.

Megjithatë, irlandezi ka përthithur gjakun dhe ka përvetësuar gjuhën e pushtuesve të vet, duke e ruajtur te të gjithë tipin kelt - tipik në zakone, mentalitet, prirje, karakter dhe në një shkallë të madhe në pamjen e tij.

Diçka nga natyra irlandeze duket që i ka tërhequr të huajt që merreshin me ata në mesjetë. Gjatë katër shekujve të parë të pushtimit nga ana e anglezëve, ata që u vendosën aty në ishull, pa marrë parasysh në shkallë të ulët apo të lartë, përshtatën mënyrat irlandeze, u martuan me ta, dhe i përshtatën emrat sipas emrave irlandezë. Shumë prej emrave irlandezë, të dëgjuar shpesh, mund të gjurmohen deri në ato kohë që u tha më sipër. Kjo prirje nuk pushoi krejt edhe pas reformave të ashpra fetare të shkaktuara prej protestantizmit.

Irlandezët kanë qenë përherë njerëz fetarë. Për gjashtëqind vjet vendi i tyre njihej si "*Vendi i Shenjtorëve.*" Ndërkohë që vende të latinizuara dukej sikur po zhyteshin në barbarizmin pagan, irlandezët po themelonin shkolla dhe dërgonin misionerë në Skoci, Angli, Uells dhe në tërë Europën. Shën Patriku[182], i cili e krishteroi Irlandën, ndërtoi një shkollë në Armagh që ndiqej nga mijëra studentë. Shën Kolumbia krijoi në Iona të Hebrides seminare murgjish si qendra të fuqishme të mësimit të krishterimit, të cilat gumëzhinin prej të rinjve të huaj që nuk e kishin atë fat të mësonin në vendet e tyre.

Të krishterët irlandezë, të shkëputur prej kohësh prej Romës, më pas u bënë të krishterët më të përkushtuar. Përpjekjet energjike të Henrit VIII dhe të disa prej pasardhësve të tij për të imponuar protestantizmin mbi ta, vetëm sa i acaroi më tepër. Sikur anglezët të kishin mbetur katolikë ose irlandezët të shndërroheshin në protestantë, dallimi ndërmjet tyre i shfaqur më vonë, si dhe grindjet që rrodhën prej tyre nuk do të kishin ndodhur. Vendosja e kolonëve anglezë dhe

---

[182] *Shën Patriku,* (493) është shenjti kryesor i Irlandës. Ai ishte lindur diku përgjatë bregdetit të Bretanjës. Irlandezët e festojnë ditën e Shën Patrikut në çdo vend të botës, kudo që gjenden.

skocezë në cepin verlindor të ishullit e ndërlikoi edhe më tepër gjendjen, duke paraqitur edhe një element armiqësor fetar.

Prej irlandezëve të Irlandës, 3.243.000 vetë ose tre të katërtat e tërë popullsisë, janë katolikë romakë. Më shumë se një milion protestantë janë pjesëtarë të kishave protestante episkopale dhe presbiteriane.[183]

Atdheu i irlandezëve ka një sipërfaqe prej 53.115 km katrorë. Gjerësia e Kanalit Verior, midis atij që quhet Mulla e Cantire (Skoci) dhe Torr Head është vetëm afro 3 km, Deti Irlandez, midis Dublinit dhe Holiheadit (Uells) është më pak se 114 km i gjerë, ndërsa Kanali i Shën Gjergjit në anën fundore të jugut është më shumë se 80 km.

Gjuha irlandeze ose "*gjuha klasike e keltëve*" është ajo që e lidh me Anglinë. Ndërsa në mesin e shekullit të kaluar atë e fliste më shumë se gjysma e popullsisë, tani ajo flitet prej më pak se nga një e shtata. E njëjta gjë ndodh edhe me popullsinë, shtimi i së cilës ka rënë në mënyrë të ndjeshme.

Në Irlandë, në vitin 1801 ka pasur një milion banorë më shumë se sot. Një regjistrim shumë i kujdesshëm i popullsisë është bërë nga ana e qeverisë Britanike në Aktin e Bashkimit[184] për të përcaktuar numrin e përfaqësuesve irlandezë në parlament, i cili varet nga numri i popullsisë. Një numër i tillë, i përcaktuar, qe bërë i qëndrueshëm, sepse qeveria donte që irlandezët të ndienin se ata kurrë nuk do të kishin më pak përfaqësues se atëherë, gjithashtu, sepse besohej se irlandezët meqë ishin shumë pjellorë, me kohë mund të kishin një numër shumë të madh të përfaqësuesve në parlament. Siç doli më pas,

---

[183] *Kisha Protestante dhe Episkopale ose Anglikanizmi,* është një term për të shenjuar besimin fetar dhe pozitën e pjesëtarëve të kishës së themeluar nga Anglia dhe të kishave komunikuese në zotërimet britanike, në Shtetet e Bashkuara dhe gjetkë. Ajo përfshin ata, të cilët kanë pranuar çështjen e reformimit si të mishëruar në Kishën e Anglisë ose në Kishat e vendeve të tjera, që i janë bashkuar të paktën, substancialisht doktrinës, organizimit dhe liturgjisë së saj. Në përgjithësi ato gjenden në vendet që kanë qenë nën flamurin britanik.

[184] *Traktati i Bashkimit (Act of Union)* midis shteteve të pavarura të Anglisë dhe Skocisë u zbatua nëpërmjet dy Akteve të Bashkimit; aktet binjake të parlamentit, të kaluara në vitin 1707, respektivisht Parlamenti Anglez dhe ai Skocez. Me këtë u krijua Mbretëria e Britanisë së Madhe, ndonëse ky emër përdorej që prej vitit 1604.

megjithatë, në ditët e sotme Irlanda ka një përfaqësues për rreth 42.000 njerëz dhe Anglia një për rreth 72.000 vetë. Skocia, me disa qindra mijëra banorë më shumë, ka rreth dy të tretat e anëtarëve të parlamentit që ka Irlanda.

"Thirrja e gjakut është më e forta që njohin keltët e lashtë". Nuk ka asgjë më të përsosur ose më kelte se sa përkushtimi i irlandezëve në tokat e huaja ndaj të afërmve të tyre dhe vendit të vet.

Natyra e tyre e harlisur, qëllimet e tyre nganjëherë të çmendura, përpjekjet jopraktike, shpirti i tyre i guximshëm dhe bujar, natyra simpatike dhe besimtare, mirësjellja dhe mprehtësia, dashuria për poezinë dhe këngët, vihen re edhe te keltët e vjetër edhe tek ata modernë. Askush tjetër përveç keltëve nuk do ta kishte zgjedhur harpën si simbol kombëtar.

## BRITANIKËT

Emrat anglez, skocez, uellsas, janë emra historikë, secili i mbarsur me traditat e veta. Secili ka marrë një emër që është i lidhur tërësisht me zonën e kufizuar të një ishulli të vogël, siç është edhe vetë. Për shkak se anglezët përbëjnë shumicën e popullsisë, të huajt, shpesh, bëjnë gabime kur flasin për, bie fjala, "Ambasadori anglez", "Ushtria angleze", "Marina angleze", kur në fakt një gjë e tillë nuk ekziston. "Flamuri meteor" nuk është simbol dallues i një shenje të thjeshtë ishullore të vockël, por i racës britanike. Në një kuptim më të gjerë, për britanikun, anglezi, skocezi, uellsasi, irlandezi të gjithë janë të humbur dhe të harruar.

## BANORËT E UELLSIT (UELLSËT)

Uellsi dikur zotëronte bregdetin perëndimor të Britanisë duke u nisur nga gryka e Severnit në drejtim të veriut në një gjatësi prej treqind miljesh. Ata tani, kryesisht, gjenden në Principatën e Uellsit. Ndonëse të përzier me më shumë njerëz, ata zotërojnë një dallueshmëri të kënaqshme për veten e tyre.

Së bashku me bretonët[185] e Bretanjës në Francë dhe me kornishët,[186] tani të shkrirë në gjakun britanik (gjuha kornishe ka mbi njëqind vjet që nuk flitet më), ata përbëjnë një grupim brythonik[187] ose gjysmën e asaj që njëherë e një kohë njihej si familja e madhe kelte. Brython është emri, me të cilin Uellsi përfshin veten e tij dhe britonët e lashtë.

Përkundër ringjalljes së dukshme të përpjekjeve letrare për të mbajtur gjallë gjuhën e Uellsit, duket se gjatë dy shekujve të fundit ajo po i hap udhë në mënyrë të dukshme gjuhës angleze. Në vitin 1911 vetëm katër të dhjetat e dy milion njerëzve të Uellsit mund të flisnin gjuhën e tyre kelte. Tridhjetë vjet më parë kjo gjuhë ishte në përdorim të përditshëm dhe shtatë në çdo dhjetë vetë komunikonin me njëri-tjetrin pikërisht në atë gjuhë.

Nuk ka pasur aty as tmerre pushtimi, as forma rezistence, as faza të ndërmjetme fitoreje, humbje ose paqe, që prej kohës së Romës, në të cilat Uellsi të mos ketë marrë pjesë dhe të mos ketë luajtur një rol kryesor. Më në fund, Llevellin[188] u nënshtrua ndaj Eduardit të Parë në vitin 1277. Trashëgimtari i fronit anglez duhej të mbante titullin e Princit të Uellsit dhe nipi i uellsëve, Ouen Tudori[189] nga Uellsi u bë Mbret i

---

[185] *Bretonët,* banorë vendës të Britanisë në veriperëndim të Francës.

[186] *Gjuha Kornish* është një gjuhë kelte e brythonikëve (ose 'P'kelte) e cila mund të quhet kushërirë e afërt e gjuhës së Uellsit dhe motër e gjuhës bretone. Kur pushtuesit saksonë të shekullit V deri në shekullin VIII e ndanë Britonën në ato pjesë që njohim sot, Uellsin, Kornishin, Kumbrianin dhe (indirekt) Bretonjën, atëherë filloi një sagë për gjuhën kornishe, që zgjati 1500 vjet. Kjo ishte koha e Mbretit Artur dhe Tristanit e Izoltës, si dhe koha e emigrimit të madh të irlandezve dhe e banorëve të Uellsit, të cilët, bashkë me shenjtorët e tyre, udhëtuan mespërmes Kornuallit dhe Britanisë. Të vendosurit e rinj në Britani erdhën nga Dumnonia dhe Uellsi Jugor duke sjellë me vete gjuhën e tyre.

[187] *Gjuha brythonike* formon njërën prej dy degëve të familjes së gjuhës Insulare Kelte. Emri brythonik rrjedh nga fjala e gjuhës së Uellsit *brython*, që do të thotë Briton si kuptim i kundërt me atë anglo-saksone ose Gael.

[188] *Llywelyn ap Iorwerth* (1173-1240) ishte Princi i Gëynedd. Ndonëse atij shpesh i referoheshin si Princi i Uellsit, titulli i tij zyrtar ishte "Princi i Aperfrau dhe Lord i Snoudounit" (Princi i parë i njohur botërisht i Uellsit ishte i biri Dafydi). Ai njihej gjithashtu si *Llywelyni i Madh,* në gjuhën e Uellsit *Llywelyn Fawr.*

[189] *Owen Tudor - Owen* (ose *Owain*) *Tudor* (1400-1461) ishte një ushtar nga Uellsi dhe oborrtar, pasardhës i drejtpërsëdrejti i Lordit Rhys por i mbajtur mend vetëm për rolin e tij në themelimin e Dinastisë së Tudorëve dhe për marrëdhëniet e tij me Katerinën e Valoisit, e veja Mbretit Henri IV i Anglisë.

Anglisë me emrin Henri VII dhe që këtej themeloi Dinastinë e Tudorëve. Fill pas kësaj, populli i Uellsit iu bashkua Anglisë dhe që atëherë gëzon tërë të drejtat dhe privilegjet njësoj si dhe vetë populli anglez.

Fotografi nga Paul Tompson
Uellsianët, vëllezërit e racës së Tomas Xhefersonit dhe të David Llojd – Xhorxhit

Të dhënat për ushtarët nga Uellsi në luftë vërtetojnë idenë e përgjithshme se ata janë të denjë për të qenë bijtë e një race të lashtë dhe të pathyeshme. Populli i Uellsit është një popull demokrat, i fortë, i guximshëm deri në kokëfortësi dhe i pakompromis në mbrojtjen e të drejtave të veta.

Populli i Uellsit trashëgon gjithë karakteristikat më të larta të stërgjyshërve të tyre të paepur. Ata janë të fortë, demokratë, seriozë, të vendosur deri në kryeneçësi, këmbëngulës për t'u arsimuar, fetarë në kuptimin më të plotë të fjalës dhe të pakompromentueshëm kur bëhet fjalë për të drejtat e tyre. Ata i kanë dhënë botës figura të tilla si Tomas Xheferson[190] në Shtetet e Bashkuara dhe David Lloyd Xhorxh[191], Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar.

[190] *Thomas Jefferson* (13 prill 1743 – 4 korrik 1826), Presidenti i tretë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, (1801-1809) burrë shteti, ambasador në Francë, filozof, politikan,

## SKOCEZËT

Një hijeshi e veçantë e përshkon fjalën Skoci. Nuk ka vend tjetër si ky që të jetë mishërim i poezisë dhe i romancës. Çdo lum dhe liqen i saj është burim frymëzimi dhe është skalitur në imagjinatën e artistëve duke u përjetësuar në vepra arti.

Përveç hamendjeve nuk ekziston ndonjë e dhënë tjetër në lidhje me origjinën e piktsëve[192], banorëve të parë të këtij vendi të njohur, tashmë, kundërshtarë të paepur të romakëve. Kur skocezët, një popull kelto - irlandez erdhën aty, i gjetën piktsët në zotërim të vendit. Ishin skocezët të cilët bënë që vendi i njohur më parë me emrin Hibernia të merrte emrin Skoci, ndërsa vendi me emrin Skoci të quhej Hibernia, emër të cilin Irlanda e mbante nga shekulli i tretë deri në shekullin e dhjetë. Kështu, në mënyrë shumë të çuditshme dhe të pashpjegueshme dy vendet ndërruan emrat.

Skocezët dhe piktcët i kombinonin sulmet ndaj britonëve, të cilët nga ana e tyre kërkonin ndihmën e rrezikshme të veriorëve. Bandat e veriorëve të tjerë suleshin për gjatë tërë vijës bregdetare. Gradualisht dolën në pah dy Anglitë: Një që i korrespondon Anglisë moderne e që shkon deri në Humber dhe një që shkon shumë më tutje se Tuid. Banda të njëjta pushtuesish, që flisnin një farë anglishteje që ishte në formim e sipër, i formuan të dyja dhe ishin në mënyrë të ndërsjellë jo miqësorë dhe të dyshimtë. Mbretëria veriore ishte besnike e vendosur ndaj mbretërve pikcë, të cilët i bënin nderime Mbretit të Anglisë.

Mbretëria veriore, e cila i binte tërë ishullit brinjas dhe zinte pjesën më pjellore dhe më të begatshme të vendit, banohej prej një populli të vendosur, që nuk ishte pushtuar kurrë, madje as prej normandëve. Ky pozicion do të përcaktonte edhe historinë e mëvonshme të Anglisë dhe të Skocisë. Sulmet e ashpra në kufi, agresioni i kurorës angleze,

---

revolucionar, agronom, kopshtar, pronar tokash, arkeolog, pronar skllavësh, shkrimtar, shpikës dhe themelues i Unversitetit të Virginias.

[191] *David Lloyd George* (17 janar 1863 – 26 mars 1945), burrë shteti shumë i shquar britanik.

[192] *Picts* banorë të Pictavias ose Pictlandin – Caledonia (Skoci) në veri të Lumit Forth – përpara pushtimit të Skocisë (*Sgaothaich*) nga Irlanda.

luftërat e shpeshta, Sir Uilliam Uallace,[193] Robert Bruce,[194] Banokburn[195] dhe Floden,[196] të gjitha këto ishin rrjedhojë e natyrshme e tërë kësaj.

Banorët qenë kristianizuar që herët siç kishin bërë edhe piktsët, prej priftërinjve misionarë irlandezë, të cilët nuk njohën pavarësi nën Romën. Kështu, që herët, qe bërë e njohur se bindja fetare nuk e dëmtonte karakterin e paepur të skocezit. Edhe më vonë, kur u futën në bashkësinë fetare romake, qoftë si katolikë, qoftë si protestantë kjo nuk arriti të prekte kurrë natyrën e të menduarit dhe të të shprehurit të lirë të skocezëve.

Malësorët skocezë i përthithën brenda vetes piktsët, por sulmoheshin për vete dhe u dobësuan nga këto sulme të herëpashershme të veriorëve, të cilët i shtynë ata më në thellësi të ishullit, duke zënë për vete tërë brigjet detare. Ata populluan, gjithashtu, Sherlandin, Orknejsin dhe Hebriden. Nga veriu i Skocisë deri në jug të Norvegjisë, ata i dhanë emrin Southerland që vazhdon të përdoret edhe sot. *Norse* përkundi galikët në malet e thepisura. Gjithsesi ajo gjuhë nuk flitet më, prapëseprapë ka lënë pas shumë emra vendesh dhe shumë vende përkujtimore që dëshmojnë epërsinë e kohës së tyre.

Ndarja si me thikë midis maleve dhe fushave ka ndikuar thellë në jetën e vendit. Duke qenë të përbërë prej racash dhe gjuhësh të ndryshme, banorët e secilës anë, prej kohësh, e shihnin njëri - tjetrin me një mospërfillje të tillë që shkonte deri në përçmim. Të dyja palët janë skocezë si në krenarinë për lashtësinë ashtu edhe në ndjenjat

---

[193] *William Wallace* (1276-1305) kalorës skocez, i cili udhëhoqi bashkëfshatarët e tij në rezistencën ndaj dominimeve angleze në rajonin e Mbretit Eduard I gjatë periudhave të rëndësishme të luftërave për pavarësinë e Skocisë.

[194] *Robert Bruce* (1274-1329) një ndër mbretërit më madhështorë të Skocisë (1306-1329) dhe një prej luftëtarëve më të famshëm të brezit të vet, që e udhëhoqi Skocinë gjatë luftërave për pavarësinë e Skocisë nga Anglia. Ai pretendoi fronin mbretëror të Skocisë si një stër-stërnip i Davidit I të atij vendi.

[195] *Bannockburn* është një fshat në fundin jugor të qytetit Stirling në Skoci. Ai është i njohur për betejën e Bannockburnit që u zhvillua në vitin 1314 dhe si një shtyllë e Luftërave për Pavarësi midis Skocisë dhe Anglisë.

[196] *Beteja e Floddenit* u zhvillua në veri të Anglisë më datën 9 shtator 1513 midis një ushtrie pushtuese skoceze të drejtuar nga Mbreti Xhejms IV dhe një ushtrie angleze të komanduar nga Tomas Houard.

kombëtare. Të dy në një shkallë të lartë rrjedhin prej të njëjtës origjinë racore, ndonëse në malësi mbizotëron elementi kelt dhe në fushë ai anglez.

Fotografi nga William Reid
Një i ri skocez

Në racën skoceze djali i veshur me fustanellë përçon një trashëgimi të paçmueshme, sepse ajo është sinonim i cilësive të zemrës dhe të karakterit të pastër. Skocezët, në përgjithësi, janë të ngazëllueshëm, të kujdesshëm dhe të kursyer. Por, kur e do puna, nuk ka popull më të drejtë, më bujar dhe që të reagojë më shpejtë ndaj rrezikut...

Përparimi i vazhdueshëm i gjuhës angleze, i ka kontribuar asimilimit. Sot më pak se një e njëzeta e skocezëve mund të flasin gjuhën gale dhe vetëm një e dhjeta e atyre që përmendëm, mund të flasin vetëm gjuhën gale. Në tërë ishujt Shetland dhe Orknei ka vetëm

120 vetë që flasin galisht. Galishtja, megjithatë mbizotëron në Hebriden,[198] e cila po çpopullohet me shpejtësi.

Skocezët, në përgjithësi, janë të ngazëllueshëm, të kujdesshëm dhe të kursyer. Por nuk ka popull më të drejtë, më bujar, më të shpejtë ndaj rrezikut të jetës, të pasurisë ose të pozitës kur detyra e thërret. Nuk ka më mendjemprehtë se ata. Emri skocez ka kuptimin e cilësive më të pastra të zemrës dhe të karakterit njerëzor.

Nuk ka fushë të filantropisë, të jetës politike ose të arritjeve të njerëzimit, në përgjithësi, ku skocezët të mos kenë dhënë ndihmesën e tyre. Le të përmendim vetëm disa: Valter Skot,[199] Karlyle,[200] Hume,[201] Xhon Knoks,[202] Robert Luis Stevenson,[203] Aleksander Graham Bell[204], Xhejms Vat[205], Robert Burns,[206] Gladstone,[207] Balfour,[208] Bryce,[209] Haig[210] dhe Beaty.[211]

---

[198] *Hebriden* - një grumbull ishujsh në brigjet lindore të Skocisë.

[199] *Walter Scott*, Bart (1771-1832), një romancier shumë prodhimtar skocez dhe poet i njohur në tërë Europën. Në një farë mase ishte i pari shkrimtar, i cili njohu një shpërndarje të veprave të tij në tërë botën në të gjallë të vet. Ai njihej ndonjëherë edhe si "Magjistari i Madh".

[200] *Thomas Carlyle* (1795-1881), eseist dhe historian skocez, vepra e të cilit pati një ndikim të jashtëzakonshëm gjatë kohës Viktoriane.

[201] *David Hume* ( 1711-1776), folozof, historian dhe njëri prej figurave më të rëndësishme të iluminizmit skocez, së bashku me Adam Smith dhe Thomas Reid. Ditëlindja e tij, 7 Maji, festohet si Dita Ndërkombëtare e Bashkimit Moral dhe Njerëzor.

[202] *John Knox,* (1514-1572), reformator i madh skocez, i cili luajti rol të rëndësishëm në reformimin e Kishës së Skocisë në një mënyrë presbyteriane.

[203] *Robert Luis Stevenson*, eseist dhe poet skocez dhe autor librash të trilluara i njohur veçanërisht për romanet e tij me aventura.

[204] *Alexander Graham Bell* (1847-1922), shkencëtar, shpikës, dhe themelues i *Bell Kanadaja*, i njohur si babai i telefonit. Përveç telefonisë, ai dha kontribut të madh në aviacion dhe në flotat nënujore. Ai ka qenë edhe bashkëthemelues dhe drejtues i Shoqërisë "National Geographic".

[205] *James Watt* (1736-1819), shpikësi i makinës me avull në një burim praktik fuqie, gjithashtu, shpikës i një pajisjeje se si të kontrollohet kjo fuqi.

[206] *Robert Burns* (1759-1796), poeti më i njohur i ultësirës skoceze. Ai mblodhi, gjithashtu, këngë popullore nëpër tërë Skocinë duke i përpunuar dhe përshtatur ato.

[207] *William Ewart Gladstone* (1809-1898), ishte një burrë shteti britanik dhe kryeministër i atij vendi (1868-1874, 1880 1885, 1886, 1892-1894). Ai ishte politikan reformator i shquar. Dallohej për fjalimet e bukura të ndjekura nga populli dhe ishte për shumë vite politikani rival i Benjamin Dizraelit. Eshtë pagëzuar me emrin "Plaku i Madh" ose "Uiliami i Popullit".

## ANGLEZËT

Thuhet se fjalët arabe (siç janë: algjebër, alkimi, kafe, alkool etj.) kanë ushtruar më shumë ndikim mbi gjuhën angleze se sa të gjitha fjalët kelte në fjalor. E, megjithatë, fjalët Britani dhe britanik, që i dhanë emrin ishullit, janë me origjinë kelte. Emrat e kodrave dhe të lumenjve në Angli dhe ato që përfundojnë me *ford* (va, kalime në vendin më të cekët të lumit), *ton* ose *don* (ferma) dhe *ham* (home – shtëpi) janë thuajse të tëra kelte. Kështu Saverna, Dee, Ouse, Thames, London, Epsom (shtëpia e Ebas), Horsham (stalla e kuajve), Oksfordi, (Vau i Ouses) janë dëshmitarë të përditshëm që, pa u vënë re, na i kujtojnë keltët. Megjithatë, keltishtja mezi gjendet në gjuhën angleze edhe më pak në gjakun e anglezëve.

Zhdukja kaq e madhe nga Anglia e racës që u bëri ballë romakëve dhe që nxori nga gjiri i vet Boadiçean[212] dhe Karaktakusin[213] është e habitshme. Ndoshta vikingët ishin nga natyra jo më mizorë se sa barbarët e tjerë të kontinentit. Por keltët ose britonët ishin këmbëngulës,

---

[208] *Arthur James Balfour* (1848-1930), burrë shteti konservator anglez, Kryeministër i Anglisë në vitet 1902-1905. Gjatë udhëheqjes së tij u formua Komiteti i Mbrojtjes Perandorake dhe krijimi i një *entente cordiale* (marrëveshje miqësore, (1904). Balfuri ishte ai që lëshoi deklaratën në favor të një hapësire kombëtare në Palestinë, e cila u njoh me emrin "Deklarata Balfour".

[209] *David Bryce* (1803-1876). Arkitekt, idhtar i stilit "Baronik Skocez", shembujt e punës së të cilit përfshijnë Kolegjin Fettes dhe Spitalin Mbretëror në Edibburg, si dhe më shumë se 100 shtëpi.

[210] *Earl Haig* (1861 - 1928), Field Marshall që i komandoi trupat e aleatëve në Frontin perëndimor gjatë luftës së Dytë Botërore. Më vonë ai u kritikua për mënyrën se si e drejtoi fushatën, për shkak të numrit të madh të të vrarëve.

[211] *Konti David Beatty* (1871-1936), admiral britanik i Luftës së Parë Botërore. Si komandant në betejat me kryqëzorët gjatë Luftës së Parë Botërore, ai doli fitimtar mbi kryqëzorët gjermanë pranë brigjeve të Heligolandit në vitin 1914 dhe në Dogger Bank më 1915. Po kështu, ai luajti një rol vendimtar në Betejën e Jutlandit. U bë i pari Lord i Detit (1919-1927).

[212] *Boudicca* (e shkruar, gjithashtu, si *Boudica, Boadicea, Buduica, Bonduca*), ishte një prijëse kelte, e cila i udhëhoqi icenët dhe një numër fisesh kelte në një kryengritje të përgjithshme kundër pushtuesve romakë në Britani në vitet 60 dhe 61 të erës së re gjatë sundimit të perandorit Neron.

[213] *Caractacus*, prijës britanik, i biri i Cunobelinusë. Ai mori pjesë në rezistencën ndaj pushtimit romak në vitin 43 dhe, kur u mund, iku për në Yorkshire prej nga e dorëzuan te romakët në vitin 51 të erës së re.

të shumtë në numër dhe të fuqishëm, ndërsa bandat e anijeve pirate ishin të vogla, të pabashkuara dhe të mbarsura me rreziqe më të mëdha. Vetëm me terrorizëm ose me shfarosje do të mund t'i mposhtnin ata britonët.

Sipas kronikanëve saksonë, në vitin 800, Egbert,[214] mbreti i parë i atij vendi që gjendej, po ashtu, për herë të herë parë i bashkuar, lëshoi një dekret që vendi të quhej Angli ose England. Pas kësaj rrodhën dyqind e pesëdhjetë vjet të mbushura me pushtime të herëpashershme ku përfshihen emra të famshëm si ai i saksonit Alfred,[215] i danezit Kanute.[216]

Pikturë e Abel Boye
Bijë ndërtuesish të perandorive

Kjo është një vajzë angleze E saj është gjuha që flasin dyqind milionë banorë të botës. Paraardhësit e saj ishin kampionët e lirisë, të cilët nënshkruan Magna Kartën në fushën e Runnymedes.[217] Vëllezërit e saj gjenden në ishujt britanikë, në

[214] *Egbert, Mbret i Ueseksit* (Wessex) ( 802-839). Në vitin 825 ai korri një fitore vendimtare afër Svindonit, duke i dhënë fund supermacisë Merciane dhe aneksoi Kentin, Eseksin, Surrein dhe Suseksin. Në vitin 829, Mercia vetë ra në duart e Egbertit.

[215] *Alfredi Sakson,* i njohur si Alfredi i Madh (849-899), Mbret i Ueseksit 871-899. Me rezistencën e tij ai mbrojti Anglinë Jugperëndimore nga pushtimi viking. Themeloi flotën angleze, dekretoi kode të reja ligjore dhe nxiti zhvillimin e letërsisë dhe të mësuarit e gjuhës angleze.

[216] Canote the Dane.

[217] *Runnymede* – një livadh në jug të bregut të Thames afër Ëindsor - it. Ky vend është bërë i famshëm për lidhjen që ka me Magna Kartën, e cila u nënshkrua nga Mbreti Xhon në vitin 1215 aty pari ose në atë rrethinë.

> Amerikën e Veriut, në Australi, në Zelandën e Re dhe në Afrikën e Jugut... Ata e mbajnë tani dhe do ta mbajnë përherë besën që të mbrojnë të dobëtin, të ndihmojnë nevojtarin, të ruajnë rendin dhe të afrojnë ditën, për të cilën poeti i saj laureat këndonte:
>
> "Një Zot, një ligj, një forcë e natyrës,
> Një ngjarje hyjnore e largët,
> Drejt së cilës lëvizin tërë krijesat."

Më në fund në fushën e hastingëve[218] ishin të pranishëm të gjithë ata elementë racorë, nga të cilët varej e ardhmja e Anglisë: e një populli anglez, me karakterin e tij të farkëtuar në rrjedhën e gjashtë shekujve luftërash të pandërprera e të tmerrshme dhe, normanët, jo më pak të fuqishëm dhe trima, madje të kalitur me çelik edhe më të fortë në rrjedhën e plot dy shekujve qëndresë ndaj Francës. Për disa orë, pasi beteja ishte humbur, anglezët e vazhduan luftën rreth mbretit të tyre të vrarë dhe pas vitesh të kaluara në ikje nëpër pyje dhe male ata shpërthyen me furi në rrebelim të dëshpëruar.

U deshën luftëra qindravjeçare midis popullit anglez dhe atij francez që të arrinin deri te bashkimi i anglezëve me normanët dhe kështu franko-normandishtja të zëvendësohej nga anglishtja si gjuhë e ligjit dhe e gjykatës.

Turmat e emigrantëve të mëvonshëm, të arratisur nga Hollanda dhe Huguenots[219] e Francës do ta rritnin fuqinë industriale të Anglisë, por jo aq sa të ndikonin ose të modifikonin trungun ose karakterin e saj racor.

Ishte forca që u përplas te hastingët, e cila pas brezash përpjekjesh e luftërash, kulmoi në madhështinë e anglezit modern.

Është bërë e zakonshme që të flitet për anglezët si një popull anglo-sakson edhe pse shprehja është e pasaktë. Të gjithë anglso-saksonët janë anglezë, por jo të gjitha turmat angleze janë anglo-saksonë. Në odén e tij drejtuar Aleksandrës, Tenyson[220] i afrohet një të vërtete: "Normanët, saksonët dhe danezët jemi ne".

---

[218] *Warren Hastings* (1732-1818), administrator kolonizator britanik. Në vitin 1774 ai u bë i pari Guvernator i Përgjithshëm i Indisë dhe, gjatë kohës që e ushtroi atë detyrë, ai bëri shumë refoma administrative me rëndësi jetike për mbajtjen me kujdes të sundimit britanik mbi Indinë.

[219] *Huguenot*, protestant francez i shekullit XVI.

[220] *Tennyson, Alfred I,* Baroni Tennyson i Alduorthit dhe Freshuoterit (1809-1892), poet i famshëm anglez. Poemat e tij të para të publikuar që në fillim të viteve 1830, janë

Vepra kryesore e saksonëve u krye që kur ata e pushtuan dhe e populluan Britaninë e Madhe. Ai i dha masën bazë një populli të fuqishëm, të vendosur dhe të qëndrueshëm. Skandinavi, i cili ishte Norsman ose Norman, ishte më i pavaruri dhe më aventurieri midis tërë bërësve të hershëm të Europës moderne. Nëpërmjet zgjerimit të pafund në tokë dhe në oqean, nga Rusia dhe nga Deti i Zi deri te Islanda dhe Groenlanda e largët, nuk ka rajon ku pasioni i tij për zbulime dhe pushtime të mos ketë qenë i pranishëm. Anglezët, me luanët e hedhur të anglo-saksonëve dhe të normanëve trashëgojnë gjithçka që ishte e mirë në stërgjyshërit e tyre.

Arritjet e pakrahasueshme sa në tokë, aq edhe në dete, ndërtimi i një perandorie ndaj së cilës Perandoria Romake do të dukej e vogël, krijimi dhe zhvillimi i Magna Kartës, i një qeverie kushtetuese dhe e ligjit si bazë dhe detyrim i arritjeve të tilla, kurajoja që nuk njeh mposhtje, janë kontribute jo të një fisi ose të një grupi të vetëm të stërgjyshërve, por një lëvizje që del nga shpirti i kombinuar i asaj që është mishëruar te të tërë ata. Një francez i madh e gjen çelësin e karakterit anglez në një fjalë të vetme: "*vetëbesues*".

Nuk është lufta e fundit që e ka krijur anglezin. Ai nuk është i ndryshëm tani nga ç'ka qenë përpara se të fillonte ajo. Thjesht ia ka dalë që të rizbulojë para vetes më parë, dhe pastaj përpara të tjerëve atë çka është në të vërtetë: shpesh arrogant, por pa dobi, i ndershëm në luftë dhe i drejtë në fitore; zemër ëmbël me sjellje gjakftohtë; konservator fundamental e deri radikal; ishullor dhe i ngushtë; prapëseprapë gjeni i rendit –botëror; rrallë i dashur jashtë vendit të tij, por i dashur dhe dashurues në vendin e vet; përçmues pakuptim dhe mashtrues e, prapëseprapë besnik ndaj vetes deri në fund.

Nëse do t'i krahasonim italianët, francezët dhe britanikët asnjë juri nuk do të mund të gjendej që të ishte e aftë të përcaktonte se cili prej tyre qëndron më përpara në prodhimtarinë e jetës intelektuale. Ka, megjithatë, një emër të jashtëzakonshëm, një emër anglez, ndonëse nuk duket që t'i takojë aq një race të vetme të veçantë, sa vetë racës

"Mariana", "Ngrënësit e Zambakëve të Ujit", "Zonja e Shalotit". Më pas ai botoi një koleksion veprash me titull "Vdekja e Arturit". Në ditët e fundit të jetës së tij ishte poeti më i dashur i kohës.

njerëzore – Shekspiri – interpretuesi i sjelljes njerëzore, mendjendrituri dhe, prej tërë shkrimtarëve, më i përkthyeri dhe më lehtësisht i kuptueshmi.

Prej ishujve britanikë raca britanike gjithmonë ka ardhur duke u zgjeruar deri sa ka përfshirë tokën. Më shumë se ndonjë racë tjetër, në tërë të kaluarën, ajo ka mbajtur me vete qytetërimin dhe ka siguruar liri dhe mundësi të barabarta. Nën mbrojtjen e saj edhe në kontinentet dhe në detet më të largëta, filizat e rinj kanë ngritur bazën e së ardhmes. Në zotërimet dhe komunuelthet e saj, trashëgimia më krenare mbetet prejardhja dhe besnikëria britanike.

## POPUJT ANGLISHTFOLËS

Gjuha angleze flitet gati prej 200.000.000 njerëzish si gjuhë amtare. Ata 200.000.000 vetë, anë e mbanë globit janë njerëzit më sipërmarrës, më të pasur dhe më të zgjuar në botë.

Përveç shumicës së panumërt e cila i është dhënë nga Zoti, shtrirja e saj midis milionave është duke u rritur me shpejtësi. Njeriu do të befasohej sapo ta dëgjonte atë të shprehur në komandën e avulloreve të lindjes, në komunikimin ndërmjet manjatëve të huaj, në gojën e fshatarëve të largët, ku mendohet se asnjë person nga Britania nuk ka shkelur kurrë.

Në trashëgiminë e asaj gjuhe, thuajse universale, amerikanët kanë pjesën e vet. Në lidhjet dhe simpatitë e krijuara ajo gjen miqtë dhe të afërmit e vet.

Në mënyrë elokuente qenë kujtuar këto trashëgimi prej një zotërie modest, i cili kryesonte dominimet britanike kur i uroi mirëseardhjen në Britaninë e Madhe, Presidentit të Shteteve të Bashkuara:

"Ne Ju urojmë ju mirësardhjen në vendin prej nga rrjedhin stërgjyshërit tuaj, aty ku ende gjenden trojet e tyre, prej vendit ku i ka rrënjët Uashingtoni dhe Linkolni… Ju keni ardhur tek ne si kreu zyrtar dhe zëdhënësi i lidhjeve më të fuqishme me të cilat Komunuelthi na bashkon. Njerëzit e tij flasin gjuhën e Shekspirit dhe të Miltonit. Letërsia jonë është e juaja, sikundër e juaja është, gjithashtu, e jona,

dhe njerëzit e letrave, në të dyja anët, janë bashkuar që të ruajnë lavdinë tonë të pavdekshme".

"Juve, jo më pak se neve ju takojnë kujtimet e heronjve tanë kombëtarë nga Mbreti Alfred[221] deri thellë në ditët e Filip Sidneit[222] dhe të Drakes,[223] Raleighit,[224] Blakes,[225] Hampdenit[226] dhe ditët kur jeta politike e trungut anglez në Amerikë sapo fillonte. Ju ndani me ne traditat e vetëqeverisjes së lirë që është aq e vjetër, sa Magna Carta."

"Ne e njohim detyrimin që kemi për të njohur më thellë idetë e përbashkëta, të cilat popujt tanë i mbajnë gjallë. Më së pari, midis atyre ideve, ne vlerësojmë atë që vlerësoni edhe ju: lirinë dhe paqen. Të privilegjuar siç kemi qenë, që të bëheshim eksponentët dhe shembujt e jetës kombëtare të mbështetur në parimet e vetëqeverisjes popullore të bazuar në ligje të barabarta, tani na bie barra, të dyja palëve njësoj, të shohim se si këto parime mund të zbatohen përtej kufijve tanë për të mirën e botës."

Në shoqërinë e mrekullueshme të aleatëve të Antantës, britanikët dhe amerikanët, për herë të parë në tërë historinë e tyre, i kanë bashkuar

---

[221] *Mbreti Alfred* (849?-899) ose Mbreti *Ælfred,* ishte Mbret i Mbretërisë Anglo-Saksone të jugut të Ëessexit nga viti 871-899. Ai ishte i famshëm për mbrojtjen e mbretërisë së tij kundër danezëve (vikingëve), duke u bërë prej kësaj i vetmi monark anglez që do të merrte epitetin "I Madh" prej popullit të vet. Detajet e jetës së tij janë të njohura si rezultat i një pune të bërë prej studiuesit nga Uellsi, Asser. Duke qenë se ishte vetë një burrë i arsimuar, Alfredi nxiti arsimimin edhe për të tjerët dhe përmirësoi sistemin ligjor të mbretërisë.

[222] *Sir Filipi i Sidneit* (Sir Philip of Sydney) (1554-1586), u bë njëri prej figurave më të shquara të kohës elizabetiane. I famshëm në ditët e tij në Angli, si poet, oborrtar dhe ushtar, ai mbeti i njohur më vonë si shkrimtar sonetash.

[223] *Nën-Admirali Sir Francis Drake* ( 1540-1596), ishte një pirat anglez, lundërtar, politikan dhe inxhinier civil i periudhës elizabetiane. Ai ishte i pari anglez (dhe i pari i një kombësie tjetër që nuk ishte në një anije spanjolle) që i ra botës rreth e qark me anije nga viti 1577 deri në vitin 1580. Me t'u kthyer, ai u fisnikërua si kalorës prej Mbretëreshës Elizabetë I. Ishte numri dy në komandën e flotës angleze, e cila mposhti Flotën Luftarake Detare Spanjolle në vitin 1588.

[224] *Sir Walter Raleigh* (1554-1618), shkrimtar dhe poet i famshëm, spiun dhe zbulues i njohur në kohën e vet.

[225] *Robert Blake* (1599-1657) ishte komandanti ushtarak më i rëndësishëm i Komunuelthit të Anglisë dhe njëri prej admiralëve më të famshëm anglez të shekullit XVII.

[226] *Augustus Charles Hobart-Hampden* (1822-1886) kapiten anglez lundrimi (1822-1886) dhe admiral turk i lindur në Leicestershire. Ai ishte djali i tretë i Kontit të gjashtë të Bukingamit.

forcat kundër të njëjtit armik. Ata kanë derdhur gjak së bashku si kampionë që të mbajnë gjallë të drejtat e tyre individuale duke nderuar të drejtat e njerëzimit. Megjithatë, nuk ka pergamen zyrtar të shkruar dhe të nënshkruar që mund t'i forcojë më shumë dhe t'i shenjtërojë kaq hijshëm aleanca të tilla të zemrës dhe të qëllimit.

Siç thotë Gjenerali Pershing[227], në raportin e tij pas përfundimeve të veprimeve luftarake: "Ka qenë thellësisht prekëse për ne që lidhjet e gjuhës dhe të gjakut të sillnin britanikët dhe ne aq pranë e pranë, në gjak, në gjuhë, tërësisht dhe në mënyrë të pandashme."

[227] *John Josef Pershing* (1860 –1948), oficer i ushtrisë së Shteteve të Bashkuara. Ai u ngjit deri në rangun më të lartë të mbajtur ndonjëherë në ushtrinë e SHBA-së, i barabartë vetëm me rangun që iu dha pas vdekjes Xhorxh Uashingtonit.

Shkrimi që vijon është vënë në këtë libër për të sjellë në vëmendjen e lexuesit një rreth të larmishëm racor, të një vendi më të afërt gjeografisht me Shqipërinë: Maqedonia, vendi ballkanik i një mozaiku kaq të larmishëm popujsh. Materiali i paraqitur i mundëson lexuesit të kuptojë brishtësinë apo përthyeshmërinë e shtetit maqedon, për shkak të shumëllojshmërisë së grupeve etnike dhe popujve që e përbëjnë atë. Shqiptarët janë aty kombi më i vjetër. Këtë e pohon edhe Luigi Villari, në studimin e tij "Çështja ballkanike", të botuar në vitin 1912, ku vihet re prania masive e shqiptarëve aty. Kur u botua ky studim, shqiptarët ishin në përpjekjet më serioze për formimin e shtetit të tyre kombëtar, të shtrirë në territoret e tyre etnike. Për fat të keq kjo nuk ndodhi, sepse fuqitë e kohës u dhuruan copa të tëra fqinjëve që e rrethonin kombin dhe popullin shqiptar. Është kjo arsyeja pse Maqedonia, ende edhe sot, është kaq e brishtë dhe noton midis ekzistencës dhe rrezikut të shpërbërjes, për shkak të vështirësisë që grupet sllave kanë për të pranuar realitetin historik të pranisë shqiptare aty, si kombi më i lashtë i rajonit. Njohja e përbërjes së popullsisë së Maqedonisë para

Luftës së Parë Botërore i jep mundësinë lexuesit të kuptojë se *si* dhe *pse*, edhe pas gati pesëdhjetë vjetësh komunizëm në Jugosllavi, që të jetojë e qetë, Maqedonia duhet të vijë deri tek marrëveshje të tilla si *Marrëveshja e Ohrit, 2002*. Shkaku i kësaj situate e ka zanafillën pikërisht tek padrejtësia historike që mban emrin "Konferenca e Ambasadorëve në Londër, 1913", e cila mohoi tërësinë territoriale të shtetit shqiptar, që ishte i shpallur si i tillë më 1912, në territoret e banuara prej shqiptarëve.

# RACAT DHE FETË NË MAQEDONI[228]

## Shkruar nga Luigi Villari

Sikur popullsia e Maqedonisë të kishte qenë homogjene, problemi maqedonas do të ishte zgjidhur prej kohësh, por përzierja e racave ka qenë përherë një karakteristikë kryesore e Gadishullit Ballkanik dhe në asnjë pjesë të tij nuk ka qenë më shumë se në Maqedoni.

Është e domosdoshme të fillojmë me shpjegimin e asaj se çfarë kuptojmë me fjalën Maqedoni? Ky vend nuk formon asnjë njësi gjuhësore, as racore, as politike. Gjeografikisht ajo është një njësi që kufizohet nga Malet e Sharrit në veri, malet e Shqipërisë në perëndim, lumi Bistrica dhe deti Egje në jug dhe Malet Rodope në lindje. Dikur, në historinë e largët, ajo formonte një mbretëri. Vendi të cilin tani e quajmë Maqedoni, përbëhet prej tri vilajetesh, ai i Selanikut, i Manastirit dhe i Kosovës, ndërsa çështja maqedonase ka të bëjë me kushtet e këtyre vilajeteve - krahinave. Megjithatë, si shprehje ajo

[228] Shkrimi është marrë nga libri "Çështja ballkanike", botuar në vitin 1912, shkruar nga Luigji Villari, autori i artikullit "Rusia nën hijen e madhe".

shpesh përfshin territore deri në vilajetin e Adrianopulit[229], ku kushtet janë thuajse të njëjta, ndonëse gjeografikisht këto territore janë tërësisht të ndarë nga Maqedonia.

Duhet mbajtur parasysh fakti që ndarja administrative turke në vilajete nuk ka qenë bazuar në ndonjë vijë ndarëse etnografike, por më tepër në qëllimin për të futur sa më shumë elemente konfliktuale që të ishte e mundur në të njëjtin territor, në mënyrë që të thjeshtoheshin detyrat e qeverisë. Përzierja e gjuhëve dhe e besimeve e bën problemin e reformës ose të autonomisë së Maqedonisë më të vështirë nga ç'është në rastin e Greqisë, Kretës, Bullgarisë dhe Serbisë.

Por nuk është vetëm qeveria turke që duhet fajësuar për përzierjen e racave. Për dymijë vjet Maqedonia ka qenë "vendi ku shkarkoheshin" popuj të ndryshëm, duke formuar, në të vërtetë, "një muze të pasur etnografik". Natyra malore e pjesës së brendshme e bën atë vend të vështirë për t'u pushtuar. Prandaj edhe pushtues të ndryshëm nuk arritën asnjëherë të bënin për vete popujt e ndryshëm që gjenin aty.

Ndërsa pjesa më e madhe e një rajoni ishte pushtuar prej të huajve, banorët vendas tërhiqeshin nëpër vende të sigurta nëpër male dhe atje ruanin qenien e tyre: një racë e këtij vendi vendosej në bregdet, ndërkohë që tjetra zinte pjesët e brendshme. Në të njëjtën kohë, qendra të caktuara - qytete të mëdha, porte detare, fusha pjellore – i tërhiqnin njerëzit e të gjitha racave për qëllime biznesi ose lehtësi të tjera. Kështu, në disa pjesë të Maqedonisë gjejmë që dy ose më shumë raca mbizotëruese të jetonin krah për krah.

Ndarja e racave në Maqedoni nuk është bazuar tërësisht në dallimet e origjinës ose të tipit antropologjik. Aty mund të gjenden tipa karakteristikë grekë, bullgarë ose turq, por midis atyre që e quajnë veten grekë, ka shumë që, prej tipareve dhe origjinës, nuk janë të tillë. Dhe kështu ndodh edhe me të tjerët. Në rajone të caktuara gjejmë pjesëtarë të tri racave, që dallohen kur flasin gjuhët e tyre përkatëse, por që janë të gjithë shumë të ngjashëm si tipa.

Gjuha është mjeti më i besueshëm i klasifikimit, pasi shumica e grekëve flasin greqisht, e bullgarëve bullgarisht, e shqiptarëve shqip, e

---

[229] Ederneja e sotme në Turqi, qyteti më i afërt me kufirin turko-bullgar.

kështu me radhë. Por feja bën një dallim tjetër dhe metoda turke e klasifikimit të popujve sipas besimit të tyre bie ndesh me ndarjen sipas racës ose gjuhës.

Ne mund të themi se për myslimanët, feja është vijë e ndarjes, pasi tërë myslimanët (përveç shqiptarëve) mund të përshkruhen me saktësi si turq; për bullgarët është kisha kombëtare, pasi praktikisht çdo pjesëtar i bashkësisë bullgare është pjesëtar i Kishës Eksarke, megjithëse, pa dyshim, propaganda është baza e ndarjes, pasi kisha, në radhë të parë, është një institucion politik; për grekët kjo është më shumë çështje përkatësie, bazuar në besnikërinë ndaj idesë greke të qytetërimit, dhe vetë shoqëria greke mbledh në vetvete shumë pjesëtarë të racave të tjera; për serbët dhe për rumunët është kryesisht kombësia, sepse ata nuk kanë kishë të ndarë, siç e kanë bullgarët dhe shumë prej atyre që janë serbë ose rumunë prej race, jo domosdoshmërisht i takojnë edhe kishës serbe ose rumune, sipas rastit.

Banorët më të hershëm të Maqedonisë ndoshta i takojnë racës së madhe, të cilën ne e quajmë racë trake, për të cilën dimë fare pak, ndërsa pjesa perëndimore e gadishullit popullohej prej ilirëve. Pasardhësit e të parëve thuhet të jenë kutzo-vllahët ose rumunët, ndërkohë që ilirët përfaqësohen prej shqiptarëve.

Grekët kurrë nuk arritën ta helenizonin tërë Maqedoninë, vendbanimet e banorëve të së cilës mbetën në kufijtë e qyteteve bregdetare.

Më pas erdhi pushtimi romak. U ndërtuan rrugë, qytetet u vendosën në të gjitha pjesët e vendit, ndërkohë që u formuan edhe koloni ushtarake. Trakët i përvetësuan shpejt mënyrat e jetesës dhe gjuhën e romakëve, të cilët ishin populli i parë i qytetëruar me të cilin ata kishin ardhur në kontakt. Ndërkohë ndikimi grek u ruajt vetëm në bregdet. Gjatë ditëve të para të Perandorisë Romake, me qytetërimin e saj greko-latin, vazhduan të bashkëjetonin dy gjuhët, si dhe disa prej dialekteve vendore.

## SHQIPTARËT NË MAQEDONI

Rajoni perëndimor i Vilajetit të Manastirit dhe një pjesë e madhe e atij të Kosovës janë të banuar prej një race më të egër dhe më të

vjetër se çdo tjetër që gjendet në Europë, prej shqiptarëve. Shumë pak dihet për këtë popull interesant e të çuditshëm, përveç asaj që ata flasin një gjuhë indoeuropiane, por nuk i takojnë asnjërit prej grupeve të njohura të familjes ariane. Besohet se ata rrjedhin prej ilirëve të lashtë, të cilët qenë shtyrë me forcë drejt perëndimit, prej valëve sllave që përparonin në atë drejtim. Gjuha e tyre, si dhe vetë populli që e flet, është e egër, pa rregulla dhe nuk ka letërsi[230]. Madje edhe këngët e popullit nuk janë aq të shumta.

Qeveria turke i ka mbajtur ata me paramendim në një gjendje barbarizmi dhe injorance, duke i përdorur për të frikësuar popujt e tjerë fqinjë.

Ata janë të ndarë në tri fe, në atë myslimane, të cilën e mbajnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të popullsisë, të krishter katolikë dhe ortodoksë. Megjithatë, feja zë pak peshë në jetën e tyre dhe nuk ka asgjë ndër ta që mund të dukej si fanatike. Në çdo fis, përveç atyre të Mirditës që janë tërësisht katolikë, madje në shumë familje mund të gjesh edhe myslimanë, edhe të krishterë. Megjithëse ata vazhdimisht luftojnë kundër njëri-tjetrit, feja asnjëherë nuk është bërë shkak për zëniet midis tyre. Ata merren pak me bujqësi, por nuk kanë as tregti dhe as industri; dhe, në të vërtetë, kanë pak punë për të bërë, përveçse të luftojnë. Turqit i kanë përdorur ata në Europë në mënyrë shumë të ngjashme me atë çka kanë bërë me kurdët në Azi, duke u dhënë leje që të plaçkitnin dhe duke u dhënë një autonomi praktike, e cila është ofruar në këmbim të besnikërisë ndaj sulltanit. Gjithashtu, ata japin një argument të përdorshëm kundër reformave në Maqedoni: kur fuqitë kërkojnë që sulltani të përmbushë premtimet e tij, menjëherë kërcënon një kryengritje e shqiptarëve dhe shpesh ndodh me të vërtetë.

*Me gjithë barbarizmin, shqiptarët kanë shumë cilësi të shkëlqyera. Ata janë trima, mikpritës dhe, nëse arrihet t'u merret besa dhe të bëhen për vete, ata mbeten absolutisht besnikë gjer në vdekje.* Ambasadat e huaja dhe konsullatat në Turqi pëlqejnë që të punësojnë shqiptarë si kavasë,[231] bazuar në

---

[230] Duket se autori nuk ka njohuri për zhvillimin e letërsisë shqipe në atë kohë, e cila shkruhej nga rilindësit tanë të mëdhenj apo për periudhat e mëparshme të zhvillimit të saj.

[231] *Kavasë (Kavasses)* – roje të armatosura ose korrierë, të cilët shërbenin pranë konsullatave të huaja në Stamboll.

besnikërinë e tyre. Ata i kanë dhënë Perandorisë Turke disa prej gjeneralëve më të zotë, si dhe punonjës civilë. Por cilësitë e tyre më të larta shfaqen vetëm kur ata janë jashtë vendit të tyre. Në Shqipëri përherë ata janë pak a shumë të ashpër.

Austria dhe Italia kanë bërë diçka për arsimimin e shqiptarëve katolikë të veriut. Françeskanët dhe jezuitët kanë hapur shkolla në qytete të ndryshme dhe qeveria italiane kujdeset për kolegjet në Shkodër dhe në vise tjera; Silogji grek ka hapur ca shkolla për shqiptarët ortodoksë. Por për myslimanët nuk është bërë asgjë. Qeveria turke nuk i lejon ata që të mësojnë në gjuhën shqipe dhe, në të vërtetë, kundërshton të njohë qenien e saj si gjuhë, ndonëse shumica e tyre nuk flasin gjuhë tjetër.

## BULLGARËT JANË FINLANDEZË TË SLLAVIZUAR

Barbarët e parë që po vinin nga verilindja dhe që u vendosën përfundimisht në Gadishullin e Ballkanit ishin bullgarët, një popull finlandez, vendi i të cilit ishte rajoni i Vollgës së Mesme. Tani ata pushtuan pjesën jugore të Danubit. Sllavët, thuhet të jenë derdhur në këtë rajon që herët, në shekullin e tretë, por nuk qenë vendosur aty deri në pushtimin bullgar.

Pozita e tyre në lindje të Europës përmban ngjashmëri të caktuara me ato të teutonëve në perëndim. Ata shpejt u përzien me bullgarët dhe u dhanë atyre gjuhën e vet; rezultati i këtij bashkimi është populli i ri bullgar, i cili mund të përshkruhet si popull finlandez i sllavizuar.

Nuk kanë mbetur gjurmë të bullgarëve të parë, megjithëse disa prej maqedonasve kanë tipare finlandeze dhe bullgarët e sotëm flasin një sllavishte të pastër. Sllavët dhe bullgarët i shtynë tutje racat që jetonin në brendësi të vendit që përpara tyre; sllavët i zhvendosën gjithë të tjerët, duke lejuar që gjuha latine të flitej vetëm në vendbanime të veçuara të vllehëve të tërhequr nëpër male, *ndërkohë që ilirishtja vazhdoi të flitej në rajonin perëndimor të njohur me emrin Shqipëri*.

Kështu, vetëm në shekullin e nëntë gjejmë në Maqedoni shumë prej atyre që tani përbëjnë popullsinë e atij vendi – grekët në bregdet dhe në qytete të mëdha; sllavët në brendësi; ilirët ose shqiptarët në perëndim

dhe elementë të izoluar, trakë ose vlleh të latinizuar nëpër male. Sllavët vetë u ndanë shpejt në dy grupe – bullgarë të sllavizuar dhe serbë.

Këta elementë të ndryshëm ishin pjesërisht nën zotërimet e Perandorisë së Lindjes, e cila, megjithatë nuk ishte aq e fortë sa t'i helenizonte ata, dhe pjesërisht nën zotërimin e princave sllavë. Me kohë ata mund të jenë shkrirë në njëri-tjetrin, megjithëse, duke pasur parasysh kushtet e veçanta të Gadishullit të Ballkanit, procesi ishte i paracaktuar të ishte i ngadalshëm. Por pushtimi turk i ndoqi nga pas dhe i kristalizoi dallimet racore, kështu që secila palë ruajti kombësinë dhe veçantitë e veta. Turqit nuk kanë qenë asnjëherë aq të mëdhenj në numër sa të përthithnin popujt e nënshtruar, por kjo nuk i pengonte ata të ndalonin secilin prej këtyre popujve që të bëhej mbizotërues.

Ndryshe nga pushtuesit e tjerë, ata nuk u përpoqën t'u impononinn gjuhën ose zakonet e tyre popujve të pushtuar, por u përpoqën që t'i shndërronin ata në islamë. Një numër i grekëve, i sllavëve, i shqiptarëve dhe i vllehve u bënë myslimanë, por ata që nuk u bindën, duhej të ishin të përgatitur për t'u ballafaquar me përndjekjen dhe shfryrjen e egër fanatike. Kjo i bëri ata ta ruajnë kombësinë. Kështu, këta elemente kundërthënëse mbijetuan deri në ditët e sotme.

Ky rivalitet midis racave të ndryshme të krishtera e bëri për turqit sundimin e Maqedonisë një punë thuajse të lehtë. Turqit i shfrytëzuan këto dallime deri në shkallën më të lartë. Por shtypja e pandërprerë dhe përndjekja do të merrte fund, pasi i bëri tërë të krishterët të pakënaqur sa prej anarkisë, aq edhe prej keqqeverisjes. Lufta civile arriti një pikë të tillë, ku ndryshimi i regjimit u bë domosdoshmëri absolute, thuajse për të gjithë.

## MYSLIMANËT NË MAQEDONI

Maqedonia ishte vendi i parë në Europë që iu nënshtrua pushtimit osman; madje shumë më përpara se të pushtohej Kostandinopoja, turqit e nënshtruan atë dhe e mbushën me koloni të shumta të tyre.

Të gjithë udhëtarët që e njohin Turqinë, dëshmojnë për shumë cilësi të mira individuale të myslimanëve, veçanërisht të turqve të vërtetë osmanllinj. Ata janë të matur, të durueshëm, fetarë, të pasur në zakone dhe dinjitozë në qëndrimet e veta.

Por, nga ana tjetër, nuk ka dyshim se, kur vjen fjala tek aftësitë e turkut për të qenë sundues i mirë, e veçanërisht kur i duhet të sundojë të krishterët, fshatari turk që jeton midis tyre është mësuar t'i përbuzë ata të shkretë që janë të paarmatosur, ndërkohë që ai mban armë dhe vetë nuk i nënshtrohet drejtësisë për asnjë lloj dhune që mund të ushtrojë ndaj tyre; në këtë mënyrë ai bëhet arrogant dhe gjakatar nga natyra. Në një bashkësi kryesisht bujqësore, grindjet për pronësinë mbi tokën dalin pandërprerë dhe në këto raste përparësinë gjithmonë e ka turku.

Myslimanët vuajnë prej kaosit të plotë dhe prej korrupsionit të qeverisë turke. Teorikisht ata janë klasa e privilegjuar, por këto privilegje u janë dhënë në formën e lejes për të grabitur dhe, në raste vrasjesh, të lejes për të vrarë fqinjët e tyre të krishterë.



Treg i vjetër në Maqedoni

Në thelb turqit janë shtegtarë dhe në të gjitha ngjarjet në Europë ata janë pak më shumë se një ushtri pushtuese që e mbajnë vendin falë kthetrës ushtarake. Ideja për ta braktisur Rumelinë (në përgjithësi, me Rumeli turqit kuptojnë territoret europiane të ish-Perandorisë Osmane) është vlerësuar prej tyre si një mundësi për t'ua sjellë ndër mend se kjo edhe mund të ndodhë, ndonëse ata mjaft natyrshëm nuk duan kurrsesi që ta shohin këtë ide të realizuar. Nëse vendi do të vihej nën një qeverisje të krishterë, atëherë brenda një kohe të shkurtër shumica e tyre do të ktheheshin në Azinë e Vogël.

Përpara se Bullgaria dhe Serbia të mëvetësoheshin, të dyja këto vende kishin një numër turqish i cili me kohë, dalëngadalë por vendosmërisht, u zvogëlua, sapo këto vende u ndanë prej Turqisë. Një karakteristikë tjetër e tyre është pirja për t'u mbledhur në bashkësitë e veta nëpër qytete.

Më e rëndësishme në tërë këtë histori është rënia shkallë-shkallë e numrit të tyre. Raca turke shfaq një pirje të njëtrajtshme të zvogëlimit dhe prej autoriteteve kompetente thuhet që sëmundja e sifilizit është një ndër arsyet kryesore për këtë. Në Maqedoni, megjithatë, numri i tyre është ruajtur me mjete artificiale. Në radhë të parë janë oficerët e ushtrisë, si dhe nëpunësit e administratës civile ata që e ruajnë këtë numër; por një numër edhe më i madh i tyre vjen nga *muhaxhirët* ose emigrantët që vijnë nga provinca më të zhvilluara. Nga Tesalia, Bullgaria, Bosnja dhe Kreta ka patur një rrymë të vazhdueshme të myslimanëve, që vijnë në zotërimet që janë ende në dorë të Padishahut dhe shumë prej tyreve u janë dhënë toka në Maqedoni, pjesërisht sepse aty ka më shumë pasuri të patundshme të lira, dhe pjesërisht sepse ajo është kthyer edhe një herë në një krahinë kufitare. Gjatë kryengritjeve të fundit, autoritetet osmane i vendosën *muhaxhirët* e tyre në toka ku pronarët e krishterë ishin vrarë ose kishin ikur. Kjo i shtoi një element tjetër trazues gjendjes, pasi zakonisht emigrantët janë më të egër ndaj fqinjëve të tyre të krishterë.

## TË KRISHTERËT NË MAQEDONI

Në lidhje me numrin e tanishëm të turqve në tri vilajetet e Maqedonisë, është e pamundur të gjenden statistika të besueshme. Sipas llogaritjeve më të besueshme, popullsia myslimane nuk i kalon të 700 000 vetët, prej të cilëve ndoshta një e treta janë turq osmanllinj. Të krishterët janë rreth 1 300 000 deri në 1 500 000, kështu që është e qartë që vendi nuk mund të vlerësohet si tokë myslimane, dhe aq më pak si tokë turke.

Të krishterët e Maqedonisë nuk janë të bashkuar as prej gjuhës, as prej lidhjeve racore dhe as prej aspiratave politike. Është kjo arsyeja që ka penguar deri tani emancipimin e vendit. Në Maqedoni ka katër

bashkësi të krishtera – greke, bullgare, serbe dhe rumune ose kutzo-vllahe; secila prej këtyre kombësive është e lidhur me fije gjuhe dhe aspiratash politike me njërin ose me tjetrin shtet të lirë ballkanik.

Tërë të krishterët e Maqedonisë i takojnë Kishës Ortodokse të Lindjes, me përjashtim të disa katolikëve shqiptarë në veri dhe të disa të shndërruarve në variante të ndryshme nga misionet e huaja. Por, në kuptimin kishtar të fjalës, ata janë të ndarë në dy kisha kryesore: në Kishën Greke ose në Patriarkanën Ekumenike dhe në Kishën Eksarke Bullgare. Të parës i takojnë grekët, serbët, vllehtë, shqiptarët ortodoksë dhe një pjesë e bullgarëve; të dytës i takojnë shumica e bullgarëve. Kjo ndarje përbën shkakun kryesor të urrejtjes që ekziston ndërmjet grekëve dhe bullgarëve.

## GREKËT NË MAQEDONI

Pas rënies së Kostandinopojës në duart e turqve, grekëve, ndonëse vazhdimisht të persekutuar, të masakruar dhe të plaçkitur prej sundimtarëve, prapëseprapë iu ruajtën disa privilegje të caktuara, duke përfituar, më në fund, një pozitë dhe një ndikim të konsiderueshëm në Perandorinë Turke. Me termin *grek* nuk kuptohej vetëm heleni, por të gjithë ish të nënshtruarit e Perandorisë Romake të Lindjes që iu bashkuan Kishës Ortodokse. Ata u quajtën *milét* ose *bashkësi*, që përbëhej prej një vendi dhe një këshilli kishtar, i cili kishte të bënte me çështjet e brendshme të njerëzve dhe shumë zyra të rëndësishme ishin zakonisht në dorë të grekëve.

Grekët arritën deri te mendja e Turqisë dhe përfaqësuesit e qytetërimit Levant.[232] Gjuha greke ishte gjuha e kulturës, madje edhe midis të krishterëve johelenë, ndërsa kisha greke ishte një qendër e fuqishme për përhapjen e ideve greke. Në shekullin e 18-të, ndikimi grek ra dhe lëvizja kryengritëse në atë pjesë që tani quhet *Mbretëri e Greqisë* i bëri turqit t'i shihnin grekët me dyshim dhe urrejtje. Kur Greqia u bë e lirë, banorët e saj menduan se puna e emancipimit ishte

[232] **L***evant:* kjo fjalë vjen nga frengjishtja dhe do të thotë "të lartësohesh". Ajo ka të njëjtin kuptim me fjalën "mashriq" në gjuhën arabe – ose vendi nga lind dielli.

kryer vetëm përgjysmë, dhe kështu iu përveshën një pune tjetër për aneksimin e një pjese më të madhe të territorit të Turqisë. Madje, disa aspironin të ringjallnin një perandori greke, me kryeqytet Kostandinopojën. Megjithatë, shumica prej tyre i kufizonin aspiratat në Tesali, në Maqedoni dhe në disa prej ishujve.

Në shumicën e qyteteve të Maqedonisë elementi grek është më i dukshmi, dhe në disa raste edhe më i pasuri; bankat dhe tregtia janë deri në një masë të madhe në duart e tyre - ndonëse *rumunët* dhe *hebrenjtë* janë konkurrentë të fortë – ndërkohë që të gjitha dyqanet dhe hanet mbajnë tabela në greqisht. Nëpër kafe dhe në vende publike dëgjohet të flitet greqisht dhe shumica e njerëzve me të cilët udhëtari bie në kontakt janë grekë ose greqishtfolës; por kur vijmë te numri i vërtetë i tyre, ata janë shumë më pak se sllavët; edhe në vende të tilla, si në Kostur, ku qyteti është i tëri grek, rrethina e tij është e banuar pothuasje tërësisht me popullsi bullgare. Por kjo nuk i pengon atdhetarët grekë që t'i llogarisin edhe ata si pjesëtarë të tyre. Ata kërkojnë të jenë grekë edhe vllehtë, edhe shqiptarët ortodoksë, edhe bullgarët, të cilët nuk i bashkohen Kishës Bullgare, duke i quajtur sipas rastit ose vllahofonë, ose shqiptarofonë, ose bullgarofonë. Me fjalë të tjera, ata i konsiderojnë që të gjithë maqedonët, të cilët nuk i janë bashkuar Kishës Bullgare, "përçarës", përveç serbëve në pjesën më veriore, të cilët janë përkrahës të palës greke dhe të *"Megalo Idesë"* së tyre. Kështu që, pavarësisht nga ç'mund të thuhet për këtë pushtim, ata duan të provojnë se pjesa më e madhe e Maqedonisë është tokë greke.

Për sa i takon numrit të tashëm të grekëve, statistikat ndryshojnë në mënyrë të dukshme dhe në fakt shkojnë prej 50 000 deri në 700 000; por vetëm vija bregdetare dhe rajonet jugperëndimore mund të quhen si kryesisht ose tërësisht helenike të pastra. Numri i tyre ndoshta arrin në rreth 300 000.

## BULLGARËT E MAQEDONISË JANË NJERËZ PRAKTIKË DHE TË DREJTË

Bullgarët janë një popull kureshtar në shumë drejtime, dhe tërësisht të ndryshëm nga racat e tjera ballkanike. Ata janë njerëz shumë punëtorë, energjikë dhe të fuqishëm. Nuk janë të shkëlqyeshëm, sigurisht janë

më pak të zgjuar se grekët dhe vllehtë, dhe nuk u është dhuruar instinkti i tregtisë. Por si bujq dhe fshatarë, ata janë të admirueshëm; ata gjenden kudo në Gadishullin e Ballkanit, nga Bukureshti në Athinë dhe nga Stambolli në Beograd, duke bërë çdo lloj pune.

Ata ende nuk kanë ndonjë qytetërim të lartë, por kanë treguar se, në kushte të favorshme, janë të zotët të përparojnë shumë. Janë të heshtur, kursimtarë; disa njerëz mund të thonë se janë të vrazhdë, por kanë një meritë të madhe, që fatkeqësisht gjendet rrallë midis njerëzve të Europës Juglindore – janë të çiltër.

Ata janë arsimdashës dhe praktikë. Nuk flasin për stërgjyshërit e tyre të lavdishëm, siç bëjnë grekët ose serbët; më shumë mendojnë për të tashmen dhe të ardhmen. Edhe pse nuk kanë tradita të mëdha historike, janë shpërblyer me cilësi të forta, të cilat mund t'i bëjnë ata të luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen e gadishullit.

## SERBËT

Në Maqedoni nuk është përherë e lehtë të dallosh serbët nga bullgarët, pasi të dyja racat shpesh ndërthuren në të njëjtat rajone dhe gjuha e tyre, sado që është e ndryshme në Serbi dhe në Bullgari, nuk ka aq shumë dallim në Maqedoni.

## "ARUMUNËT" OSE VLLEHTË

Kutzo–vllehtë ose rumunët e Maqedonisë paraqesin një problem interesant gjuhësor dhe etnografik. Ata shpesh merren për pasardhës të trakëve parahistorikë, të cilët u përzien me kolonët latinë dhe përshtatën gjuhën dhe qytetërimin e tyre, duke ruajtur karakteristikat kombëtare, pasi ishin tërhequr në fortesat e maleve të Maqedonisë. Ndikimi latin zgjati edhe  në rajonin e veriut të Danubit, ku qenë formuar koloni të gjera ushtarake. Aty ka një ngjashmëri të madhe midis gjuhës së vllehve maqedonë dhe asaj të banorëve të Rumanisë, ndonëse nuk ka ndonjë lidhje qoftë fisnore, qoftë racore ose politike midis tyre, edhe për faktin se ata janë të ndarë prej njëri-tjetrit prej një rripi të gjerë të një vendi të pastër sllav.

Vllehtë e Maqedonisë janë shumë të shpërndarë, duke pasur vendbanimet kryesore në Vargmalet e Pindit dhe në pjesët fqinje, si Manastiri, Metsovo, Korça, Kërçova, Vodena etj. Ata zbresin gjatë dimrit deri në Gjirin e Korintit, deri në Vlorë dhe Durrës, ku fjala *vllah* merr thuajse të njëjtin kuptim me atë *çoban*.

Ata janë tejet të zgjuar, të pashëm, me aftësi të mëdha në tregti. Fshatrat dhe qytetet e tyre, të cilat gjenden thuajse përherë në majë të kodrave, janë të ndërtuara në mënyrë më të qëndrueshme, krahasuar me ato të çdo race tjetër ballkanike. Kërçova, e cila ka vuajtur kaq shumë gjatë kryengritjeve të fundit, është një shembull i shquar në këtë aspekt.

Por, përkundër dashurisë së tyre për ndërtimin e shtëpive të forta prej guri, vllehtë kanë të përftuar ndjenjën e fortë të endacakut dhe, në kohë vere, vendbanimet e tyre janë pjesët më të braktisura prej tërë meshkujve të aftë, të cilët lëvizin nga një vend në një tjetër, si tregtarë endacakë ose *qiraxhinj*. Shumë prej tyre janë njerëz që merren me importe dhe kanë lidhje biznesi me të gjitha qendrat e Ballkanit dhe të Austro-Hungarisë.

Përsa i takon numrit të tyre, statistikat ndryshojnë në mënyrë shumë të dukshme. Sipas disa autoriteteve, ata janë jo më shumë se 50 000, ndërkohë që atdhetarët rumunë flasin për të paktën gjysmë milioni; sidoqoftë, ata mund të llogariten të jenë rreth 100 000. Por politikisht, rëndësia e tyre është shumë e vogël. Zakonisht ata kanë mbajtur marrëdhënie të mira me turqit, të cilët deri në kryengritjen e fundit i trajtuan më mirë sesa të krishterët e tjerë të pushtuar. Merren me tregtitë e veta dhe pak marrin pjesë në lëvizjet politike. Për një kohë të gjatë nuk dalloheshin prej grekëve, nuk dihej gjuhën e kujt flisnin dhe, në statistikat e Maqedonisë, grekët ende i konsiderojnë ata grekë.

## HEBRENJTË NË MAQEDONI

Në Selanik dhe në disa qytete të tjera të Maqedonisë ka vendbanime të gjera hebrenjsh. Afërsisht, si tërë hebrenjtë e Turqisë, ata janë pasardhës të atyre që u përzunë nga Spanja prej Ferdinandit dhe Izabelës dhe kanë përcjellë deri në ditët tona një dialekt të së

folurës spanjolle, ndonëse zakonisht flasin edhe shumë gjuhë të tjera. Në Selanik ata përbëjnë shumicën e popullsisë. Punët e parapëlqyera që bëjnë janë, pa dyshim, bankat dhe tregtia, por ka edhe hebrenj më të varfër, që janë varkëtarë, portierë, shërbëtorë, dyqanxhinj të vegjël dhe në një ose në dy krahina, edhe fshatarë.

Ata janë e vetmja racë e pushtuar që turqit nuk e kanë përndjekur kurrë dhe, si rrjedhojë, janë besnikë të Perandorisë. Përherë kanë ditur si të marrin "*një gjë të mirë*" prej qeverisë turke dhe, në këmbim të kësaj, meqë i kanë lënë të qetë, janë bërë mbështetja kryesore financiare e saj. Ata janë të zellshëm, të ndershëm dhe të zgjuar. Një pjesë e madhe e tyre janë nënshtruar ose janë bërë të favorizuarit e fuqive të ndryshme të huaja.

Lexuesi tashmë është njohur me "Racat e Europës" dhe "Racat dhe fetë në Maqedoni", shkrime që janë botuar në vitin 1918 dhe 1912. Studimet janë kryer para Luftës së Parë Botërore. "Racat e Europës" është botuar thuajse në mbarim të luftës. Me qëllim që t'i jepet lexuesit mundësia për t'u njohur me Europën e pas Luftës së Dytë Botërore dhe për të bërë krahasimet e nevojshme midis vlerësimeve dhe situatave të ndryshme në kohë, në vijim është studimi "EUROPA".

Botimi në këtë libër i këtij materiali ndjek fillin e dhënies së një infomacioni sa më të gjerë dhe bashkëkohor për kontinentin tonë. Siç dihet, jo vetëm shqiptarët e Shqipërisë, por edhe shqiptarët e tjerë në trojet e tyre etnike në Ballkan jetojnë tani në shtete që i kanë hyrë udhës së integrimit në institucionet europiane. Shqiptarët në Kosovë kanë si objektiv të tyre integrimin në Bashkimin Europian. Të njëjtin objektiv, edhe ata të Maqedonisë. Madje këta të fundit përbëjnë njërën nga dy forcat kryesore etnike të këtij vendi, pa të cilën asnjë vendim nuk mund të merret në atë shtet. Po kështu, edhe shqiptarët e Malit të Zi marrin pjesë në procesin e integrimit europian të atij vendi. Shqiptarët e

Greqisë tashmë janë qytetarë të një vendi anëtar të Bashkimit Europian, nëse janë bërë shtetas grekë. Më të vonuar janë bashkatdhetarët tanë të Luginës së Preshevës, për shkak të vonesave serioze me të cilat ballafaqohet Serbia, si rezultat i mendësisë shoviniste që ende mbretëron në atë vend.

Lexuesi do të ketë rastin që të krahasojë ngjashmëritë thelbësore europiane në një hark kohor shekullor, por edhe dallimet dhe ndryshimet që kanë ndodhur. Ky studim e afron lexuesin edhe një hap tjetër drejt realiteteve europiane të sotme, të mbështetura në shtyllat kryesore nga buron paqja dhe stabiliteti në kontinentin e vjetër. Trajtimi i të njëjtit subjekt, siç është prejardhja e emrit Europë, ose tema tjera janë lënë me qëllim në disa artikuj. Një larmi e tillë e bën edhe më interesant këtë libër.

*"Gjykoj se do ta kem kryer detyrën time, nëse arrij të ndjek rrugën që më duket më e drejtë. Në fakt unë gjykoj se i përgjigjet më shumë së vërtetës teza sipas së cilës të parët e ilirëve e kanë prejardhjen dhe emrin nga pellazgu Hyll, djalë i pellazgut Herkul…Tezën sipas së cilës Hylli, djali i Herkulit dhe i Melitës mori në dorëzim një principatë në trevën ku u shfaq emri ilirik, dhe se prej tij u quajtën Hyllinë edhe popujt e atij vendi, e kanë mbrojtur autorë të vjetër e plot autoritet …*

*Herkuli erdhi në Itali pas ekspeditës hispanike e gale, dhe u prit aty nga Evandri, në vitin 1238 para Krishtit, sipas kronologjisë, afro pesëdhjetë e pesë vjet përpara se Enea të zbriste në Itali. Pasi u largua nga Evandri, përshkroi më këmbë, siç ishte zakon, të dyja brigjet e Adriatikut, deri sa mbërriti në një vend që për shumë shekuj kishte qenë pjesë e Maqedonisë, më vonë u quajt Epiri i Ri, kurse tani thërritet Shqipëri (Albani)… Hylli, i biri i Herkulit dhe i perëndeshës Melita, hodhi bazat sa të mbretërisë së tij, Hyllides, aq edhe të Ilirikut historik."*

D.Farlati[233], "Illyricum Sacrum", 1751

**233** *Daniele Farlati* ishte historian dhe bashkautor i veprës madhore *Illyricum Sacrum*, një nga burimet më të rëndësishme për historinë e Shqipërisë. Lindi më *22 shkurt 1690*, në San Daniele del Friuli (komunë në provincën *Udine*), *Itali*.Vdiq më *25 prill 1773*. Mendohet se vdiq në *Venedik*, Itali. Përfundoi studimet për teologji në Gorz. Farlati dhe Riceputi punuan së bashku për 20 vjet, duke grumbulluar çdo dokument të ruajtur në arkivat e kishës katolike. Rezultati i kësaj pune kërkimore ishte grumbullimi i 300 vëllimeve (me shkrim dore) me dokumente. Riceputi vdiq gjatë përfundimit të hartimit të dy pjesëve më voluminoze të studimit *Illyricum Sacrum*: *Katalogu i martirëve dhe shenjtorëve të krishtërimit në Iliri* dhe *Jeta e Shën Pjetër Orseolos (St. Peter Urseolus)*.

# EUROPA SOT

Europa është një prej shtatë kontinenteve tradicionale të rruzullit tokësor. Fizikisht dhe gjeografikisht, në një farë kuptimi, Europa është gadishulli më i madh dhe më perëndimor i Euro-Azisë, i kufizuar në veri nga oqeani Arktik, në perëndim nga oqeani Atlantik, në jug nga deti Mesdhe, në juglindje nga Malet e Kaukazit, nga Deti i Zi dhe udhët ujore që lidhin këtë det me Mesdheun. Në lindje, Europa është përgjithësisht e veçuar nga ujërat e Maleve Urale, siç janë lumi Ural dhe deti Kaspik. Europa është kontinenti i dytë, më i vogli në pikëpamje të sipërfaqes, e cila kap 10.180.000 kilometra katrorë, ose 2 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës. I vetmi kontinent më i vogël se Europa është Australia. Në pikëpamje të popullsisë, Europa është kontinenti i tretë me popullsi më të madhe dhe vjen pas Azisë dhe Afrikës, me një numër të përgjithshëm prej 710 000 000 banorësh ose 11 % të popullsisë së globit. Megjithatë, termi kontinent mund t'i referohet një dallimi kulturor e politik ose një termi fiziografik, që çon tek pikëpamje të ndryshme rreth kufijve të saktë, territorit dhe popullsisë. Brenda kontinentit, Bashkimi Europian (BE), i përbërë

prej 27 vendesh anëtare, është entiteti më i gjerë ekonomik dhe politik në tërë territorin që quhet Europë, ndërsa Rusia (duke përjashtuar pjesën aziatike) është entiteti i dytë më i madh dhe vendi më i madh. Bashkimi Europian përbën ekonominë më të madhe në botë, me një GDP nominale të vlerësuar në 14.2 trilion dollarë amerikanë në vitin 2006, pra 35 % e GDP-së së tërë botës.

## Etimologjia

Sipas mitologjisë greke, Europa ishte një princeshë fenikase, e cila qe rrëmbyer nga Zeusi, në formën e buallit të marrë nga ishulli i Kretës. Ajo lindi Minosin, Radamantusin dhe Sarpedonin. Për Homerin, Europa ishte një mbretëreshë mitologjike e Kretës, dhe jo një përcaktim gjeografik. Më vonë, Europa merrej për tokën greke dhe, që nga viti 500 p.e.re, kuptimi i saj u zgjerua, duke kuptuar me të tokat drejt veriut. Në etimologji ka një teori e cila na sugjeron se emri Europë rrjedh nga fjala greke "e gjerë" (eurys) dhe pamje (ops) – pasi ky mund të kishte qenë një epitet i Tokës vetë, në fenë e rindërtuar të proto-indiano-europianëve. Megjithatë, një pjesë e vogël sugjerojnë se etimologjia greke është e bazuar në një fjalë semite dhe vjen nga Akkadian erebu, që do të thotë "perëndim i diellit". Nga një pikë e volitshme e Lindjes së Mesme, dielli perëndon mbi Europë, pra në tokat drejt perëndimit. Ngjashëm me këtë, Azia është menduar të ketë rrjedhur nga një fjalë semite, si p.sh., Akkadian asu, që do të thotë "lindje e diellit", dhe është toka drejt lindjes, nga një perspektive e Lindjes së Mesme. Për shekuj të tërë, kur i referoheshin Europës, turqit përdornin termin Frengistan (toka e frankëve).

Shumica e gjuhëve të botës i përdorin fjalët që rrjedhin nga "Europa" për t'iu referuar kontinentit europian.

## Historia

Europa në shekullin e XX

Origjina e kulturës individuale dhe demokratike perëndimore i atribuohet shpesh Greqisë së Lashtë, ndonëse një numër tjetër i madh ndikimesh, në veçanti krishtërimi, mund të kenë gjithashtu meritën e përhapjes së koncepteve siç është barazia dhe universalizimi i ligjeve etj. Pas rënies së Perandorisë Romake, Europa hyri në një periudhë të gjatë ndryshimesh, e cila njihet si *epoka e migracionit*. Ajo periudhë është e njohur si *Mesjeta e errët* ndaj mendimtarëve rilindës. Bashkësi të izoluara manastiresh në Britaninë e Madhe, Irlandë e gjetkë ruajtën dhe përpiluan dijenitë e shkruara, të përmbledhura që më përpara. Me kalimin e kohës, pjesa perëndimore e Perandorisë Romake "rilindi", atëherë kur Perandoria e Shenjtë Romake u njoh si Perandoria e Shenjtë Romake e kombit gjerman. Pjesa lindore e Perandorisë Romake u bë e njohur në perëndim si Perandoria Bizantine, ndërkohë që vetë 'bizantinët" ende e thërrisnin veten *Basileia tMn RomaiMn* – Perandoria e Romakëve. Në vitin 1453, kur Perandoria Osmane ia pushtoi kryeqytetin e saj, Kostandinopojën, perandoria pushoi së ekzistuari dhe u rrudh brenda një shteti të vogël në Trabzon. Jeta e këtij shteti zgjati deri në vitin 1461.

Rilindja dhe monarkët e rinj shënuan një periudhë zbulimesh, eksplorimesh dhe rritje të njohurive shkencore. Në shekullin e XXV, Portugalia hapi epokën e zbulimeve të mëdha, e pasuar shumë shpejt prej Spanjës. Më vonë atyre iu bashkëngjit Franca, Holanda dhe Anglia, në ndërtimin e kolonive me territore të gjera të mbajtura prej tyre në Afrikë, Amerikë dhe Azi. Pas epokës së zbulimeve, ideja e demokracisë zuri rrënjë të thella në Europë. Luftërat për pavarësi u përhapën më së shumti në Francë, gjatë periudhës së njohur si *Revolucioni Francez*. Kjo çoi në përmbysje të mëdha në Europë, pasi këto ide revolucionare u propaganduan anë e mbanë kontinentit. Ngritja e demokracisë çoi tek rritja e tensioneve brenda Europës, mbi çdo tension që tashmë ekzistonte për shkak të konkurrencës brenda Botës së Re. Konflikti më i madh ndodhi kur Napoleon Bonaparti erdhi në pushtet dhe nisi pushtimet duke formuar Perandorinë Franceze, e cila u shemb shumë shpejt. Pas këtyre pushtimeve, Europa u stabilizua, por themelet e vjetra tashmë kishin filluar të shkërmoqeshin.

Revolucioni industrial filloi në fund të shekullit XVII, në Britaninë e Madhe, duke çuar në largimin e popullsisë nga bujqësia, në një prosperitet a begatim të  përgjithshëm shumë më të madh dhe në një rritje të popullsisë si rezultat i ndikimit të këtyre faktorëve. Shumë prej shteteve të Europës e morën formën që kanë sot, si pasojë e Luftës së Parë Botërore. Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, deri në fund të Luftës së Ftohtë, Europa qe ndarë në dy blloqe kryesore politike dhe ekonomike: vendet komuniste të Europës Lindore dhe vendet kapitaliste të Europës Jugore, Veriore dhe Perëndimore. Rreth vitit 1990, me rënien e Murit të Berlinit, u thye a u shpërbë një perde e gjerë hekuri, e bashkë me të edhe vetë Bashkimi Sovjetik dhe Blloku Lindor.

Që prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, integrimi europian ka qenë një temë e njohur në marrëdhëniet europiane, por ai është përshpejtuar edhe më tepër me përfundimin e Luftës së Ftohtë. Bashkimi Europian, trashëgimtari i Bashkësisë Europiane, është zgjeruar nga 6 anëtarë që ishin në fillim, në 27 që janë sot. Pranimi i mundshëm politik i Turqisë është shumë i diskutueshëm, pasi përfshin një vend ndërkontinental, me një shumicë mbizotëruese myslimane. Anketat

tregojnë se shumica e europianëve janë kundër anëtarësimit të Turqisë, duke përfshirë edhe tri të katërtat e popullsisë së Gjermanisë, vendit europian me bashkësinë më të madhe të emigrantëve turq. Turqia është konsideruar gjithashtu edhe si pushtuese e pjesës veriore të Qipros, që në vitin 1974. Qiproja është anëtare e Bashkimit Europian, prandaj bisedimet në këtë pikë pritet të zgjatin shumë. Bashkimi Europian është zhvilluar nga një organizatë me drejtim tregtar, në një organizëm që ngjet me një konfederatë në shumë aspekte. Që me përfundimin e Luftës së Ftohtë, është rritur gjithashtu anëtarësia europiane në NATO, me pranimin e një numri të vendeve të Europës Lindore.

## Aspekte gjeografike të Europës

Hartë politike e Europës, bashkë me disa vende të Azisë dhe Afrikës

Mali Elbrus, më i larti në Europë



Gryka e lumit Tara, më e thella në Europë

Bregdet në Shqipërinë e Jugut, Sarandë



Pamje e majave të maleve Rysy në kufirin midis Polonisë dhe Sllovakisë.

Detifos, ujëvara më e fuqishme në Europë, Islandë

Për shkak të dallimeve, kufijtë europianë përcaktohen në vijë politike dhe kulturore: në disa burime, disa territore nuk janë përfshirë në Europë, ndërsa burime të tjera i përfshijnë ato. Për shembull, gjeografë nga Rusia dhe shtetet e tjera postsovjetike, në përgjithësi, i përfshijnë Uralet në Europë, ndërsa duke përfshirë Kaukazin në Azi, një numër gjeografësh e konsiderojnë kufirin jugor të Azerbajxhanit dhe Armenisë me Iranin dhe Turqinë Jugore dhe Lindore, Sirinë, Irakun dhe Iranin, si kufirin midis Azisë dhe Europës. E njëjta gjë qëndron edhe me ishullin e Qipros, ndonëse më afër me Turqinë,

shpesh përfshihet në Europë. Në një përdorim tjetër, në ditët e sotme, fjala Europë po përdoret gjithnjë e më shumë si një formë e shkurtuar e Bashkimit Europian (BE), i cili mbledh në gjirin e vet 27 shtete. Një proces i gjatë bisedimesh po vazhdon me vende të tjera, të cilat aspirojnë t'i bashkohen Bashkimit Europian, ndër të cilat edhe vendi ynë, Shqipëria, si dhe Kosova, sapo të shpallet e pavarur. Përcaktimi "BE", megjithatë, përjashton vende joanëtare si Zvicra, Norvegjia dhe Rusia.

## Gjeografia fizike

Relievi tokësor në Europë shfaq variacione të shumta, brenda zonash relativisht të ngushta. Rajonet jugore, megjithatë, janë më malore, ndërsa po të shkohet më në veri, terreni zbret prej lartësive të Alpeve dhe Karpateve nëpër toka kodrinore dhe pllaja të gjera e të ulta veriore, të cilat janë të pafundme në lindje. Kjo tokë e ulët e pafund është quajtur *Pllaja e Madhe Europiane* dhe pikërisht në zemër të saj shtrihet *Pllaja Veriore e Gjermanisë*. Një hark i tokave të larta ekziston gjithashtu gjatë vijës bregdetare veriperëndimore, duke filluar në ishujt perëndimorë britanikë, për të vazhduar gjatë maleve të ndërprera prej fjordeve norvegjeze. Ky përshkrim është thjeshtuar. Rajonet e ulëta, siç janë Iberia dhe Italia, përmbajnë tiparet e tyre komplekse, siç i përmban ato edhe vetë Europa, ndërsa këto të fundit janë zona të larta që i bashkëngjiten tokës kryesore, deri aty ku ngritja e nivelit detar i ndërpret ato.

## Biodiversiteti

Duke jetuar për mijëra vjet krah për krah me njerëzit që merreshin me bujqësi, kafshët e Europës dhe bimët kanë qenë thellësisht nën efektin e pranisë dhe punës së njeriut. Me përjashtim të Skandinavisë dhe Rusisë Veriore, ka pak zona në Europë ku kafshët e egra të jetojnë të paprekura, përveçse në ndonjë park kombëtar. Vegjetacioni kryesor natyror në Europë janë pyjet. Kushtet për rritjen e tyre janë shumë të favorshme. Në veri, Golfstrimi (Golf Stream) dhe rryma veriatlantike e ngrohin kontinentin. Europa Jugore mund të përshkruhet si një vend

me klimë të ngrohtë dhe të butë. Në këtë rajon ka vera që shpesh janë të thata. Gjithashtu, kreshtat e maleve kanë ndikim në kushtet e jetesës. Disa prej tyre (Alpet, Pirenejt) janë të drejtuara lindje–perëndim dhe lejojnë erën që të mbajë masa të mëdha ujore nga oqeani në pjesën e brendshme. Të tjerat janë të drejtuara jug–veri (Malet Skandinave, Dinarike, Karpatet, Apeninet) dhe për shkak të reshjeve, së pari mbi faqet e maleve që janë drejtuar nga deti, pyjet rriten mirë, ndërkohë që, në anën tjetër, kushtet janë shumë më pak të favorshme. Ka pak cepa të kontinentit europian ku nuk kanë kullotur bagëtia dhe në një moment kohor edhe prerjet në mjediset e pyjeve parabujqësore kanë shkaktuar ndërprerjen e pllajave origjinale dhe dëmtimin e ekosistemit të kafshëve.

Njëherë e një kohë, tetëdhjetë deri në nëntëdhjetë për qind e Europës ishte e mbuluar me pyje. Ato shtriheshin nga deti Mesdhe deri në oqeanin Arktik. Ndonëse gjysma e pyjeve të hershme europiane u zhdukën në rrjedhë të shekujve, një të katërtën e tokës së vet Europa ende e ka të mbuluar me pyje, siç janë tajgat e Skandinavisë dhe Rusisë, pyjet e Kaukazit dhe pyjet e drurëve në Mesdheun Perëndimor. Gjatë kohëve të vona, shpyllëzimi ka rënë ndjeshëm dhe janë mbjellë shumë pemë. Megjithatë, në shumë raste plantacionet e monokulturës halore kanë zëvendësuar pyjet e përziera natyrore, sepse këto rriten më shpejt. Plantacionet tani mbulojnë zona të tëra tokësore, por ofrojnë mjedise më të varfra për shumë specie që jetojnë në mjediset pyjore europiane, të cilat kërkojnë një përzierje të specieve të drurëve dhe strukturave të larmishme pyjore. Sasia e pyjeve natyrore në Europën Perëndimore është pikërisht 2-3 % ose më pak, dhe në Rusinë Europiane 5-10 %. Vendi me përqindjen më të vogël të zonave pyjore (duke përjashtuar mikroshtetet) është Republika e Irlandës, me vetëm 8%. Në Europën e butë mbizotërojnë pyjet e përziera me gjethe, si dhe ato halore. Drurët më të përhapur në Europën Qendrore dhe Perëndimore janë ahu dhe lisi. Në veri, tajga është përzier me pyje të ndryshme dhe me bredha, pisha dhe mështekna. Edhe më në veri, brenda Rusisë dhe skajit verior të Skandinavisë, tajga, sapo i afrohet arktikut, ia lëshon vendin tundrës. Në Mesdhe janë mbjellë shumë pyje ulliri, që janë përshtatur shumë mirë me klimën përgjithësisht të thatë të kësaj zone;

selvia mesdhetare është, po ashtu, gjerësisht e përhapur në Europën Jugore. Rajoni gjysmë i thatë mesdhetar mban shumë pyje shkurresh. Një gjuhëz e ngushtë lindje–perëndim e lëndinave (stepave), e shtrirë drejt lindjes nga Ukraina dhe Jugu i Rusisë, përfundon në Hungari, duke përshkuar tajgën drejt veriut.

Fauna në Europë gjithashtu është shumë e zhvilluar, por prania e njeriut e ka dëmtuar atë seriozisht. Janë shumë kafshë të egra të zhdukura, si për shembull mamuthët, që u zhdukën qysh para periudhës së neolitikut. Po ashtu arinjtë rrezikojnë të zhduken, bashkë me derrin e egër. Kafshët e tjera vazhdojnë të gjenden në tërë rajonin europian. Edhe detet e oqeanet që rrethojnë Europën janë shumë të pasura me qenie të ndryshme. Ndër to, balenat po ashtu rrezikojnë të zhduken, për shkak të gjuetisë së pakontrolluar mirë ndaj tyre.

## Zhvillimet demografike në Europë




Rritja e popullsisë shënon rënie në vendet europiane

Që në kohën e Rilindjes, Europa ka patur një ndikim mbizotërues në kulturë dhe ekonomi. Lëvizjet demografike europiane janë të rëndësishme jo vetëm historikisht, por edhe në kuptimin e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare dhe çështjeve të popullatës. Disa nga çështjet e të sotmes dhe të shkuarës që përfshihen në problemet demografike europiane janë: emigracioni fetar, marrëdhëniet racore, emigracioni ekonomik, rënia e numrit të lindjeve dhe plakja e popullsisë. Në disa vende, siç është Republika e Irlandës dhe Polonia, qasja ndaj abortit është e kufizuar. Në të kaluarën, kufizime të kësaj natyre, dhe po ashtu kufizime që kanë të bëjnë me kontrollin artificial të lindjeve ishin gjë e zakonshme. Nga ana tjetër, tri vende europiane (Holanda, Belgjika dhe Zvicra) kanë lejuar një formë të kufizuar të eutanazisë vullnetare, për njerëz të sëmurë pa shpresë. Në vitin 2005, sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, popullsia e Europës vlerësohej të ishte 728 milion, që do të thotë se është pak më shumë se një e nënta e popullsisë së botës. Europa ka gati një të katërtën e popullsisë së globit. Popullsia në Europë është shtuar gjatë shekullit të kaluar, por në zona të tjera të botës (veçanërisht në Afrikë dhe Azi) ajo është shtuar shumë më shpejt. Sipas një projekti të Kombeve të Bashkuara (varianti i mesëm), pjesa europiane e popullsisë do të bjerë në vitin 2050 në vetëm 653 milion.

## Gjeografia politike

### Territoret dhe rajonet

Rajonet e Europës, siç janë përvijuar prej Kombeve të Bashkuara. (Kategorizimet e tjera mund të ndryshojnë.)

Europa Veriore
Europa Perëndimore
Europa Lindore
Europa Jugore

Në këtë tabelë vendet janë kategorizuar sipas skemës për nënrajonet gjeografike, të përdorur nga artikuj me referenca të ndryshme ballafaquese. Aty ku ato ndryshojnë, kushtet janë treguar qartë. Sipas përcaktimeve të ndryshme, siç janë vlerësimet e konceptit Europë Qendrore, territoret e mëposhtme dhe rajonet mund të jenë objekt i kategorizimeve të tjera të ndryshme.